REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
"PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN"

DOKUMENT PARLAMENTAR
masl.al

SHTYLLA I

MIRËQEVERISJA

DOKUMENTI ANALITIK

Ky dokument analitik është hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë i përbërë nga: Prof. Dr. **Migena Leskoviku**, Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës; Prof. Dr. **Eralda Methasani**, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Doc. **Klesta Hysi**, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; **Krisela Hackaj**, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim; **Vilma Shurdha**, Avokati i Popullit; **Geron Kamberi**, Qendra për Studime të Demokracisë dhe Qeverisjes; Dr. **Eniana Qarri**, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Prof. Asoc. Dr. **Etleva Bajrami**, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës; **Zef Preçi**, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike; **Adelina Farrici**, Shoqata për Autonomi Vendore; **Marsel Llukmani**, "Biznes Albania"; **Endri Teta**, "Word Vision Albania"; **Amanda Kote**, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, Universiteti Europian i Tiranës; Prof. Asoc. Dr. **Olta Milova**, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës; **Jolanda Trebicka**, Europartners Albania; **Aranita Brahaj**, AIS Open Data Albania; **Qeram Cibaku**, Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore, Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Ky dokument është konsultuar nga ekspertët ndërkombëtar dhe ata të diasporës si vijon: **Tibor Draskovics**, team leader i Projektit "EU4GoodGovernance"; **Dimitrie Vasile Mihes**, specialist i lartë i Menaxhimit të Sektorit Publik, Banka Botërore; **Aleksandar Maskovic**, shef i Departamentit për Mirëqeverisjen dhe Antikorrupsionin, Prezenca e OSBE-së në Tiranë; **Isabelle Thomas Delic**, eksperte/Ambasada Franceze; Prof. **Francesco Tuccari**, zv/shef i Departamentit të Shkencave Juridike, Universiteti i Salentos; As. Prof. Dr. **Judithanne Scourfield McLauchlan**, Universiteti i Floridës së Jugut, SHBA; **Helga Luku**, Universiteti Antwerpen, Belgjikë; **Sabire Lici**, eksperte e pavarur; As. Prof. **Entela Cukani**, Universiteti i Salentos; **Sandra Pernar**, Koordinatore për Evropën, Partneriteti i Qeverisjes së Hapur (OGP); **Mauro Napodano**, ekspert i pavarur.

Mbështetur nga ekspertët e Sekretariati Teknik (ST): Dr. **Besarta Vladi**, Kuvendi i Shqipërisë, Koordinatore e ST-së; **Emerlinda Pema**, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; **Kejsi Rizo**, Avokati i Popullit.

.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 5
HYRJE 16
1.1 Konteksti 22
1.1.1 Konteksti ligjor për transparencën dhe përafrimi me acquis 22
1.1.2 Mekanizmat institucionalë për zhvillimin dhe koordinimin e politikave të transparencës 24
1.2 Arritjet dhe progresi 30
1.2.1 Funksionimi i politikave dhe praktikat e transparencës në qeverisjen qendrore, vendore dhe institucionet e pavarura. Përfshirja e grupeve të interesit. 30
1.2.2 Konsultimi publik dhe Vlerësimi i Ndikimit Rregullator në Shqipëri në kuadër të procesit të integrimit 33
1.3 Gjetjet dhe problematikat 38
1.4 Konkluzione dhe rekomandime 48
Kapitulli II. Integriteti dhe etika në administratën publike 51
2.1 Konteksti 51
2.2 Progresi dhe arritjet 52
2.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional për garantimin e integritetit në administratën publike 52
2.2.2 Kuadri ligjor për adresimin e risqeve të integritetit në sektorët vulnerabël 62
2.2.3 Vlerësimi i riskut në sektorët vulnerabël 67
2.2.4 Qasja individuale për promovimin dhe garantimin e integritetit në administratën publike 68
2.2.5 Sinjalizimi dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve 80
2.2.6 Denoncimi i praktikave korruptive dhe shkeljeve të integritetit në administratën publike nga të tretët 84
2.3 Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet 86
2.4 Konkluzionet dhe çështjet për zgjidhje/drejtimet e ndërhyrjeve 89
Kapitulli III. Llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor 94
3.1. Konteksti 94
3.2. Progresi dhe arritjet 97
3.2.1. Legjislacioni dhe përditësimi i tij i harmonizuar me *acquis* 97
3.2.2. Drejtimi strategjik, koordinimi i politikave dhe infrastruktura institucionale 103
3.3 Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet 111
3.3.1 Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet në lidhje me pushtetin qendror 111
3.3.2 Kontrolli, monitorimi dhe menaxhimi i ndërmarrjeve shtetërore (NSH) 118
3.3.3 Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet në lidhje me pushtetin vendor 121
3.4 Konkluzionet dhe çështjet për zgjidhje/drejtimet e ndërhyrjeve 125

DOKUMENT PARLAMENTAR

Kapitulli IV: Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara 129
4.1. Konteksti 129
4.2. Progresi dhe arritjet 132
4.2.1. Legjislacioni shqiptar në qasje me *acquis* të BE-së 134
4.2.2. Kuadri strategjik dhe politikat aktuale 141
4.2.3. Inteligjenca Artificiale (IA) dhe përdorimi i saj 146
4.2.4. Ofrimi i shërbimeve publike të digjitalizuara dhe aksesi në këto shërbime 150
4.3. Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet 154
4.3.1 Gjetjet dhe problematikat kryesore 1
4.3.2 Rekomandimet kryesore 160
4.4 Konkluzionet dhe çështjet për zgjidhje / drejtimet e ndërhyrjeve 162
Kapitulli V: Efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike 164
5.1 Konteksti 164
5.1.1 Programimi makro-ekonomik dhe monitorimi i riskut 164
5.1.2 Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent 165
5.1.3 Menaxhimi dhe mobilizimi i të ardhurave 167
5.1.4 Kontabiliteti dhe menaxhimi i zbatimit të buxhetit 169
5.1.5 Kontrolli i brendshëm financiar publik 172
5.1.6 Mbikëqyrja e jashtme 174
5.2 Progresi dhe arritjet 176
5.2.1 Progresi për Objektivin Specifik 1 “Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur” 178
5.2.2 Progresi për Objektivin Specifik 2 “Planifikim i mirë-integruar dhe efikas” 180
5.2.3 Progresi për Objektivin Specifik 3 “Mbledhja e të ardhurave” 184
5.2.4 Progresi për Objektivin Specifik 4 “Zbatim efikas i buxhetit” 186
5.2.5 Progresi për Objektivin Specifik 5 “Transparenca e Financave Publike 190
5.2.6 Progresi për Objektivin Specifik 6 “Kontroll i Brendshëm Efektiv” 192
5.2.7 Progresi për Objektivin Specifik 7 “Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike” 195
5.3 Gjetjet dhe problematikat 197
5.4 Konkluzione dhe rekomandime 202
Kapitulli VI : Qeverisja e Hapur: Eficienca dhe performanca në administratën publike 205
6.1. Qeverisja e Hapur dhe modeli OGP 205
6.2. Eficenca në administratën publike 210
6.3 Vlerësimi i performancës së administratës publike në disa shtete të Bashkimit Evropian 212
6.3.1. Konkluzione mbi performancën dhe vlerësimin e saj në sektorin publik 214
Bibliografia 216

DOKUMENT PARLAMENTAR

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Stabiliteti demokratik është i lidhur natyrshëm me parimin e shtetit të së drejtës, praktikat e qeverisjes së mirë dhe një shoqëri të bazuar në mbrojtjen e të drejtave themelore. Qeverisja e Hapur konsiderohet si një kulturë qeverisjeje e bazuar në politika dhe praktika publike inovative dhe të qëndrueshme, të frymëzuara nga parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes, që nxit demokracinë dhe rritjen gjithëpërfshirëse, lufton korrupsionin, si dhe kontribuon në mirëqeverisjen e vendit. Ky model unik siguron që organizatat e shoqërisë civile ose angazhimi i drejtpërdrejtë i qytetarëve të kenë një rol me rëndësi në formimin dhe mbikëqyrjen e qeverisjes. Pjesë e saj është edhe Parlamenti i Hapur.

Në strategjitë e tij të zgjerimit, Komisioni Evropian theksoi reformën e administratës publike si një nga tre fushat *themelore parësore* të procesit të zgjerimit të BE-së: "Adresimi i reformave në fushën e sundimit të ligjit, të drejtave themelore dhe qeverisjes së mirë, mbeten çështjet më urgjente për Ballkanin Perëndimor. Është, gjithashtu, pikë referimi kyçe me të cilën do të vlerësohen perspektivat e këtyre vendeve nga BE-ja".

Nëpërmjet rezolutës së miratuar më 27 maj 2024, Kuvendi i Shqipërisë u angazhua për të ndërmarrë një sërë reformash në funksion të objektivit strategjik për Shqipërinë 2030 në BE. Në kuadër të zbatimit të angazhimeve të ndërmarra nga Kuvendi përmes kësaj rezolute, u ngrit Komision i Posaçëm *"*Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e ligjit për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", me qëllim që përmes një procesi publik, gjithëpërfshirës, transparent, profesional dhe në reflektim të standardeve më të mira ndërkombëtare, mbështetur në mekanizmat, rregullat dhe procedurat përkatëse parlamentare dhe me angazhimin e kontributin aktiv të ekspertizës më të mirë vendase dhe ndërkombëtare, të realizojë drejtimin dhe koordinimin e procesit të thelluar të reformave në mirëqeverisje, luftën kundër korrupsionit dhe sundimin e ligjit.

"Mirëqeverisja", si shtylla e parë dhe objekt i veprimit të Komisionit të Posaçëm, e cila shprehet në gjashtë parime kryesore: pjesëmarrja, përfshirja, mosdiskriminimi, barazia, sundimi i ligjit dhe llogaridhënia, është çelësi për arritjen e rritjes ekonomike, konkurrencës dhe cilësisë më të mirë të jetës. Për këtë arsye, kërkohet një administratë publike e aftë, transparente, e përgjegjshme dhe efektive, që t'u përgjigjet këtyre sfidave.

Ky Dokument Analitik ka si qëllim analizimin e plotë të situatës aktuale sa i përket mirëqeverisjes, identifikimin e arritjeve dhe problematikave kryesore në këtë fushë, si dhe përmbledhjen e gjetjeve dhe rekomandimeve më të rëndësishme, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit. Ky i fundit përbën produktin kryesor të punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Dokumenti Analitik është hartuar me pjesëmarrjen dhe kontributin e ekspertëve të nivelit të lartë (GENL) të ardhur nga institucionet e pavarura, bota akademike, shoqëria civile, përfaqësues të biznesit, si dhe ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë të atashuar pranë kësaj shtylle. Puna e GENL-it është mbështetur nga Sekretariati Teknik (ST) me përfaqësues nga grupet e mësipërme të interesit dhe koordinimi i të gjithë procesit është bërë nga përfaqësues të administratës së Kuvendit.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Burimet kryesore ku janë mbështetur ekspertët për hartimin e këtij dokumenti janë: Raporti i BE-së për Shqyrtimit Analitik për grupkapitullin I "Themeloret" për Shqipërinë, publikuar në korrik 2023 (më poshtë referuar si raporti *Screening*); Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2022, 2023, 2024), Raporti i Komisionit Evropian për Shtetin e së Drejtës 2024, Raportet e OECD/SIGMA, Raportet e GRECO-s etj. Në të njëjtën kohë, analiza fokusohet në legjislacionin shqiptar të trajtuar sipas specifikave të kapitujve, masat dhe rekomandimet e parashikuara në Udhërrëfyesit "Për reformën[1] në administratën publike 2023-2030" dhe "Për funksionimin e Institucioneve demokratike" [2] si dhe analizën e dokumenteve strategjike të qeverisë shqiptare për periudhën 2023-2030 që trajtojnë çështje të mirëqeverisjes dhe reformës në administratën publike; Raporte të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC); Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 për Qeverisjen e Hapur etj.

Dokumenti Analitik i shtyllës së Mirëqeverisjes ndahet në 6 kapituj: kapitulli I "Transparenca në administratën publike"; kapitulli II "Integriteti dhe etika në administratën publike"; kapitulli III. "Llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor"; kapitulli IV "Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara"; kapitulli V "Efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike"; kapitulli VI "Qeverisja e Hapur: Eficienca dhe performanca në administratën publike".

Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur sfidat dhe rekomandimet kryesore të BE-së, në lidhje me mirëqeverisjen në Shqipëri, si dhe rekomandimet kryesore të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) për adresimin e tyre, të ndara sipas kapitujve të analizës.

Sa i përket kapitullit të parë "Transparenca në administratën publike" është një nga elementet kryesore të qeverisjes së hapur, që ndikon në rritjen e besimit të qytetarëve në administratën publike dhe shërben si mekanizëm për të forcuar përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e organeve publike në ushtrimin e funksioneve të tyre dhe ofrimin e shërbimeve publike. Duke marrë parasysh rolin e saj kyç në progresin e vendit, mirëqenien e qytetarëve dhe ofrimin e shërbimeve, administrata publike duhet të ushtrojë veprimtarinë e saj me profesionalizëm, efikasitet, integritet, llogaridhënie dhe transparencë. Si rrjedhojë, reforma në administratën publike ka qenë në qendër të përpjekjeve të qeverisë shqiptare prej disa vitesh jo vetëm si një mjet për të avancuar zhvillimin e vendit, por edhe si një parakusht për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Shqipëria ka sfida për përmirësimin e legjislacionit, krijimin e hapësirave më të mëdha për konsultimin publik dhe garantimin e aksesit për të gjitha grupet e shoqërisë, monitorimin më efikas mbi zbatimin e ligjit për konsultimin publik, rritjen e kapaciteteve të nëpunësve, në veçanti në pushtetin vendor, për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi etj. Për të adresuar këto sfida dhe për të rritur besimin e qytetarëve te administrata publike, BE-ja ka dhënë rekomandime të ndryshme.

[1] VKM Nr. 737, datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030"
[2] VKM Nr. 611, datë 2.10.2024 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike

DOKUMENT PARLAMENTAR

Siç vihet në pah edhe në Raportin më të fundit të Progresit të Komisionit Evropian (2024) autoritetet publike duhet të forcojnë transparencën me përgjegjësi më të lartë. Në këtë fushë Shqipëria ka ende sfida, për të zbatuar me efikasitet legjislacionin lidhur me të drejtën e informimit, si dhe për të forcuar rolin e koordinatorëve për informimin. Në lidhje me konsultimin publik, Bashkimi Evropian vlerëson se përqindja e akteve që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik duhet të rritet, bazuar në një interpretim më gjithëpërfshirës të kritereve të ligjit për konsultimin publik, dhe se duhen më shumë nisma për të inkurajuar grupet e interesit, në veçanti shoqërinë civile, për të marrë pjesë në këto procese. Gjithashtu, Bashkimi Evropian nënvizon se cilësia e RIA-ve duhet të rritet, edhe për të thjeshtuar proceset për qytetarët, edhe për të rritur aksesin e të gjitha grupeve në informacion.

Në lidhje me kapitullin e dytë "Integriteti dhe etika në administratën publike", një nga objektivat e administratës publike është arritja e efektshmërisë në të gjitha nivelet përmes zbatimit të rolit, funksioneve dhe përgjegjësive me integritet individual e profesional. Në këtë kuptim objektivat shumëdimensionale të administratës publike kërkojnë që efektshmëria të mos jetë e përqendruar vetëm tek analiza kosto-përfitim. Gjithashtu, ajo duhet të përfshijë elementin thelbësor që është vlera e shtuar për qytetarët, përmes ofrimit të një shërbimi të vlefshëm e në kohë, duke pasur parasysh se qytetarët janë financuesit dhe përfituesit e tij të drejtpërdrejtë. Përmes politikave qeveritare synohet që institucionet e administratës publike të ofrojnë garanci për respektimin e të drejtave të qytetarëve nëpërmjet zbatimit në praktikë të parimit të ligjshmërisë. Për këtë arsye, në mënyrë që të mbrohet interesi publik gjatë ushtrimit të veprimtarisë së këtyre institucioneve, kërkohet që ato të veprojnë me integritet dhe në mënyrë transparente.

Lidhur me rekomandimet e BE-së dhe sfidat që ka vendi theksohet se duhet të përmirësohet ndërgjegjësimi i zyrtarëve publikë për standardet etike dhe mënyrën se si ato zbatohen, për një administratë me integritetit. Po ashtu, duhet të rritet cilësia dhe zbatimi i planeve të integritetit, të vendosura në nivel qendror dhe lokal. Krijimi i kulturës së integritetit mbetet një sfidë, me qëllim që të garantohet që normat, strukturat dhe proceset administrative garantojnë që zyrtarët publikë e ushtrojnë veprimtarinë në të mirë të interesit publik.

Për sa i përket kapitullit të tretë "Llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor", mund të argumentohet se llogaridhënia është parakushti themelor për të parandaluar abuzimin e pushtetit dhe për të siguruar që pushteti të orientohet drejt arritjes së efikasitetit, efektivitetit, përgjegjësisë dhe transparencës.
Për sa i përket llogaridhënies, Bashkimi Evropian rekomandon miratimin e strategjisë së re të reformës së administratës publike sa më parë, si dhe rishikimin e efektivitetit të strukturave aktuale të monitorimit, për të garantuar qëndrueshmërinë e reformave. Gjithashtu, rekomandohet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive dispozitat për rekrutimin, promovimin dhe shkarkimin e bazuar në merita, në përputhje me ligjin e shërbimit civil, në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin e lartë dhe të fillojë sërish automatizimi i sistemit të listës së pagave. Në këtë drejtim Shqipëria ka sfida për të garantuar një shërbim civil bazuar në meritë, profesionalizëm, paanësi dhe performancë të lartë në realizimin e interesit publik.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Ndryshimet në legjislacionin e shërbimit civil janë të nevojshme për të përmirësuar mekanizmat e vlerësimit të perfomancës, për promovimin dhe karrierën në shërbimin civil. Po ashtu, BE-ja rekomandon se duhet të përmirësohet legjislacioni në lidhje me kriteret për krijimin e organeve vartëse, si dhe linjat e llogaridhënies ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe atyre vartëse, për t'u zbatuar në të gjithë administratën. Kuvendi duhet të forcojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit dhe të trajtojë problemin e mungesës së reagimit të organeve të administratës publike, me qëllim forcimin e mekanizmave të llogaridhënies.

Forcimi i kapaciteteve administrative për ta bërë menaxhimin më të përgjegjshëm/llogaridhënës i shërben po ashtu këtij qëllimi**.** Sistemi i qeverisjes/menaxhimit të ndërmarrjeve shtetërore (NSH) duhet të përmirësohet dhe sfidë mbetet që qeverisja e NSH-ve të përputhet plotësisht me standardet ndërkombëtare, gjë që duhet të reflektohet edhe në qëndrueshmërinë financiare të këtyre ndërmarrjeve dhe në pronësinë shtetërore të tyre si dhe standartet e raportimit fiskal dhe jo fiskal të tyre.

Lidhur me pushtetin vendor, Bashkimi Evropian vë në pah nevojën për përmirësimin e burimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore, kapacitetin administrativ dhe autonominë e tyre. Sfidë mbetet përmirësimi dhe forcimi i efikasitetit, transparencës, llogaridhënies e menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, në linjë me parimin e decentralizimit, autonomisë dhe subsidiaritetit në ofrimin e shërbimeve.

Lidhur me kapitullin e katërt "Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara", vlen të përmendet se një nga elementet thelbësore në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian është modernizimi i ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët dhe biznesin. Ky proces transformues nuk është vetëm një kërkesë nga Bashkimi Evropian, por edhe një nevojë e brendshme për përmirësimin e cilësisë së qeverisjes. Procesi i digjitalizimit të shërbimeve publike ka kulmuar me krijimin e platformës qeveritare e-Albania. Në raportin *Screening* të BE-së për Shqipërinë theksohet: "Administrata publike vendos përdoruesit në qendër dhe ofron shërbime me cilësi të lartë dhe lehtësisht të aksesueshme *online* dhe *offline* për të gjithë njerëzit dhe bizneset. Digjitalizimi mundëson vendime të bazuara në të dhëna, procese efektive dhe efikase, si dhe shërbime cilësore dhe të aksesueshme".

Shqipëria përballet me sfida për zbatimin e standardeve të sigurisë në administratën publike dhe mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve duhet të jenë prioritete për të siguruar besimin e publikut në shërbimet digjitale, si dhe të jenë të harmonizuara me standardet dhe legjislacionin evropian për të përmbushur kriteret e anëtarësimit në BE. Në këtë fushë, BE-ja rekomandon përmirësimin dhe konsolidimin e kuadrit ligjor për shërbimet digjitale, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave në përputhje me *acquis* e BE-së. Gjithashtu, BE-ja rekomandon akses të barabartë në shërbimet *online* për të gjithë qytetarët dhe në këtë drejtim mbetet sfidë përmirësimi i cilësisë, infrastrukturës digjitale dhe aksesi i barabartë për të gjithë qytetarët si në zonat urbane, ashtu dhe rurale, që të përfitojnë njësoj nga shërbimet publike *online* dhe pa kufizime. Sfidë mbetet ofrimi i shërbimeve për grupet vulnerabël (personat me aftësi të kufizuar, mosha e tretë, persona që nuk kanë mundësi/janë të paaftë të përdorin shërbimet *online*, komuniteti rom/egjiptian, etj.) dhe përshtatja e platformave ekzistuese *online* për këto kategori personash, në mënyrë që të garantohet akses i njëjtë në shërbime pa diskriminim.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Në lidhje me kapitullin e pestë "Efektiviteti dhe transparenca në Menaxhimin e Financave Publike", zbatimi i reformës së Menaxhimit të Financave Publike shërben si udhërrëfyes për Shqipërinë, për të ruajtur qëndrueshmërinë e financave publike. Objektivi i përgjithshëm i strategjisë së reformës së MFP-së është të arrijë një buxhet më të balancuar dhe të qëndrueshëm, me një raport të reduktuar të borxhit përmes menaxhimit financiar më të fortë dhe proceseve të kontrollit dhe auditimit, dhe ku ekzekutimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë.

Në këtë fushë, Shqipëria duhet të përmbushë rekomandimet e BE-së për rritje të qëndrueshmërisë së parashikueshmërisë së tavaneve buxhetore afatmesme, nëpërmjet përcaktimit të treguesit "devijime të tavaneve të Programit Buxhetor Afatmesëm/nga tavani buxhetor i miratuar nga Parlamenti". Gjithashtu, nga BE-ja kërkohet monitorim efektiv i risqeve fiskale, veçanërisht atyre që lidhen me detyrimet kontingjente të ndërmarrjeve shtetërore. Në këtë drejtim mbetet synim dhe sfidë ngritja e një strukture të pavarur monitoruese për vlerësimin e risqeve fiskale dhe monitorimin e tyre në përputhje me rregullat fiskale. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i mekanizmave në drejtim të kontratave me sektorin privat është një tjetër sfidë për të përmbushur rekomandimin e Bashkimit Evropian mbi hartimin dhe miratimin e metodologjisë së përditësuar për inventarizimin, vlerësimin dhe zhvlerësimin e aseteve në sektorin publik.

Sa i përket kapitullit të fundit, në lidhje me qeverisjen e hapur, eficiencën dhe performancën e administratës publike, sigurimi i aksesit në informacionin legjislativ dhe krijimi i mekanizmave për pjesëmarrjen e publikut, janë thelbësore për ndërtimin e një marrëdhënieje transparente dhe besimi me qytetarët. Ky angazhim është vendimtar edhe për progresin e përgjithshëm të Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE, edhe për krijimin e një roli më aktiv dhe më kuptimplotë të Kuvendit në zhvillimin e vendit[3]. Iniciativa Globale e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP) shërben si një platformë për bashkëveprim dhe partneritet, për një vendimmarrje më të mirë dhe gjithëpërfshirëse, për kryerjen e reformave, për të zhvilluar iniciativa që rrisin transparencën, fuqizojnë qytetarët, luftojnë korrupsionin dhe përdorin teknologjitë e reja për të përmirësuar qeverisjen. Shqipëria ka theksuar vendosmërinë e saj edhe në Planin Kombëtar të Veprimit 2023-2025 të Qeverisjes së Hapur për të promovuar, mbështetur dhe zhvilluar politika specifike për një qeverisje të hapur, në të cilën transparenca, digjitalizimi i administratës, lufta kundër korrupsionit, drejtësia, përfshirja institucionale dhe llogaridhënia përfaqësojnë vlera vendimtare në zhvillimin e demokracisë, bazën e politikave në nivel të qeverisjes, duke respektuar agjendën e qytetarëve[4]. Gjithashtu, Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 për Qeverisjen e Hapur thekson përmirësimin e efikasitetit të administratës shtetërore dhe publike, me qëllim plotësimin sa më efikas të nevojave të qytetarëve dhe ekonomisë, si dhe masat që synojnë forcimin e transparencës, përgjegjësisë dhe integritetin.

[3] Partneriteti për Qeverisje të Hapur, Plani Kombëtar 2023-2025, Tiranë, mars 2023, f.203, https://ogp.gov.al/uploads/2023/4/20230420175207_plani-kombetar-i-veprimit-2023-2025-pqh-mars-2023.pdf.
[4] Po aty, f.4.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Marrë në konsideratë të gjitha sfidat e mësipërme me të cilat përballet vendi ynë në fushën e mirëqeverisjes, si dhe rekomandimet e organizmave të ndryshëm ndërkombëtar si BE-ja, OECD/SIGMA, OGP-ja etj., për të adresuar këto sfida, ekspertët kanë propozuar rekomandimet e mëposhtme për secilin kapitull, referuar edhe përshtatshmërisë së këtyre rekomandimeve me kuadrin rregullator dhe legjislativ të vendit tonë.

Transparenca në administratën publike

- Ligji për konsultimin publik duhet të amendohet me synimin për të zgjeruar kategoritë e akteve që i nënshtrohen procesit të konsultimit. Fusha e zbatimit të ligjit për konsultimin publik duhet të zgjerohet me qëllim përfshirjen e akteve nënligjore në tërësinë e atyre ndaj të cilave realizohet konsultimi publik. Monitorimi më i mirë i zbatimit të ligjit duhet të gjejë reflektim në amendimet ligjore.
- Raportimi i rezultateve të procesit të konsultimit publik duhet të përfshijë informacionin për raportin e pranimit të komenteve të mbledhura gjatë të gjithë procesit, duke i bërë ato transparente për çdo akt. Konsultimi publik duhet të digjitalizohet më tej.
- Është e domosdoshme që rregullimi i procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA) të jetë në nivelin e një ligji, me qëllim që RIA të zbatohet edhe në rastet e hartimit të projektligjeve nga aktorë të ndryshëm, nga Këshilli i Ministrave dhe për legjislacionin sekondar, si dhe të forcohet zbatimi i procedurave për përgatitjen e RIA-ve.
- Roli i institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të forcohet, si organe kyçe për monitorimin e shkeljeve dhe sigurimin e transparencës në institucionet publike.
- Kuvendi duhet të rrisë ndjeshmërinë dhe vëmendjen në raportimet vjetore të organeve të pavarura dhe të organeve të tjera që raportojnë pranë tij për çështjet e transparencës. Vendimi i Kuvendit, që rregullon formatin e raportimit, mund të përmirësohet duke i kushtuar një vëmendje më të madhe transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve.
- Kuvendi duhet të organizojë dëgjesa të dedikuara me organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të medias për të tërhequr opinionin e tyre, për çështje të transparencës në administratën publike, dhe problematikat që hasin në lidhje me zbatimin e ligjit për informimin dhe për konsultimin publik.
- Duhet të vlerësohet krijimi i grupeve të përhershëm konsultative pranë Kuvendit me përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve të interesit, akademisë, përfaqësues të organeve të pushtetit qendror dhe vendor etj., në fusha me interes kombëtar. Organet e pushtetit vendor kanë nevojë për mbështetje në fushën e digjitalizimit dhe për rritje të kapaciteteve administrative për zbatimin e detyrimeve ligjore në lidhje me të drejtën për informim të qytetarëve dhe konsultimin e akteve.
- Roli i koordinatorëve të informimit duhet të forcohet. Duhet vlerësuar mundësia e ndryshimeve ligjore për të caktuar në rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit nëpunës të nivelit të mesëm ose të lartë të hierarkisë në autoritetet publike.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Për personat me aftësi të kufizuar nuk ka përshtatje të dokumenteve publike me nevojat e tyre, si dhe për t'i aksesuar fizikisht më lehtë. Informacionet publike duhet të përshtaten në formate alternative, si *Braille*, audio, ose formate digjitale të aksesueshme. Në këtë drejtim, ligji për konsultimet publike duhet të përmirësohet për të përfshirë rregullime specifike për grupet e margjinalizuara, qytetarët në zona të largëta dhe personat me aftësi të kufizuar, të cilët shpesh mbeten jashtë proceseve vendimmarrëse.
- Qeveria dhe institucionet duhet të përqafojnë një qasje pro-aktive dhe jodiskriminuese për përfshirjen në procesin e konsultimit publik të grupeve të nën përfaqësuara nëpërmjet njoftimeve paraprake dhe konsultimeve të synuara për t'u dhënë zë këtyre grupeve të synuara.

Integriteti dhe etika në administratën publike

- Administrata publike duhet të ndërmarrë një sërë hapash që forcojnë aspektet që lidhen me etikën, integritetin dhe shmangien e konfliktit të interesit, të cilat bëjnë të mundur shmangien e fenomenit të korrupsionit dhe një shërbim më cilësor ndaj qytetarëve.
- Në këtë kuadër është i rëndësishëm rishikimi i ligjit "Për rregullat e etikës në administratën publike, i Kodit Etik Ministror, Kodit Etik të Parlamentit dhe institucioneve të sigurisë e gjyqësorit.
- Nga ana tjetër, hartimi i një ligji të ri për shmangien e konfliktit të interesit dhe ndryshimet në ligjin "Për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur, emëruar apo që ushtrojnë funksione publike", kanë rëndësi të veçantë për të garantuar një administratë publike që udhëhiqet nga parimet e etikës dhe integritetit.
- Transparenca përkundrejt qytetarëve në raport me çështjet e etikës, integritetit dhe performancës së administratës duhet të garantohet përmes krijimit të mekanizmave institucionalë në nivel parlamentar, që e monitorojnë dhe e mbikëqyrin këtë proces, siç është portali i perfomancës dhe integritetit të administratës publike.

Llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor

- Mbetet prioritet finalizimi dhe miratimi i strategjisë së re për reformën e administratës publike, për të kompletuar Kuadrin Strategjik të Reformës në Administratën Publike (SFRAP) në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian.
- Nevojitet amendimi i ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", si dhe hartimi i akteve nënligjore në bazë të ndryshimeve ligjore, me qëllim: krijimin e kuadrit efektiv të llogaridhënies për institucionet e varësisë dhe mirëpërcaktimin e tipologjisë së institucioneve të varësisë dhe të agjencive autonome.
- Monitorim më efektiv dhe përmirësim i qëndrueshmërisë financiare të reformave, si dhe planifikimi më i mirë buxhetor afatmesëm dhe koordinimi i politikave në funksion të llogaridhënies.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Po ashtu, nevojitet rishikimi i pozicionimit institucional të autoriteteve rregullatore që raportojnë aktualisht në Kuvend, si dhe forcimi i mekanizmave të llogaridhënies nga Kuvendi mbi institucionet e administratës publike që monitorohen dhe raportojnë në Kuvend.
- Rritja e përdorimit dhe përmirësimit të cilësisë së vlerësimeve të ndikimit rregullator dhe konsultimeve publike.
- Përmirësimi i monitorimit dhe zbatimit të RAP-it. Forcimi i koordinimit ndërmjet ministrive dhe institucioneve të tyre përkatëse të varësisë dhe ndërmjet qeverisë qendrore dhe vendore.
- Ndryshimi i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" në lidhje me strukturën e pagave, si dhe miratimi i metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës pas ndryshimeve ligjore.
- Finalizimi i zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Burimeve Njerëzore në administratën e qeverisë qendrore, duke siguruar plotësimin e tij dhe automatizimin e listës së pagave, si dhe adoptimi i politikave kombëtare të burimeve njerëzore që bazohen në të dhëna dhe prova. Qëllimi është krijimi i një shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, forcimi i kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet, me fokus te meritokracia dhe profesionalizmi.
- Nevojiten politika mbështetëse që mbulojnë zhvillimin e menaxhimit të burimeve njerëzore për të zbatuar Udhërrëfyesin për Reformën e Administratës Publike (PAR) 2023-2030.
- Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore duhet të realizohet në përputhje me politikën rajonale dhe të kohezionit të BE-së.
- Duhet të vazhdohet me Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillimin, dhe kohezionin rajonal, dhe të përfundojnë/miratohen planet e zhvillimit rajonal, të cilat duhet të nxisin potencialin zhvillimor nëpërmjet ndërhyrjeve të decentralizuara bazuar në plane të integruara lokale dhe/ose rajonale.
- Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore është i rëndësishëm për Shqipërinë në drejtim të zbatimit të programit kombëtar IPA dhe përdorimit e menaxhimit të fondeve të BE-së.
- Institucionet e përfshira në SFRAP (me miratimin/plotësimin e kornizës së re SFRAP-it) duhet të plotësojnë boshllëqet që ekzistojnë në kornizat e treguesve të performancës, duke përfshirë finalizimin e treguesve dhe objektivave të nivelit të rezultateve, për të qenë në gjendje të matin progresin drejt objektivave të reformës.
- Kontrolli, monitorimi dhe menaxhimi i ndërmarrjeve shtetërore duhet të përmirësohet që të realizohet në mënyrë efektive, me instrumente të qarta llogaridhënieje.
- Këshilli Konsultativ që vazhdon të funksionojë si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor, nevojitet të zgjerohet duke ftuar edhe aktorë të tjerë.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Duhet të forcohet bashkëpunimi ndërvendor për një aplikim më të gjerë të këtij bashkëpunimi në të gjithë vendin.
- Fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për rrezikun e korrupsionit dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse janë të rëndësishme për të krijuar një kulturë të përgjegjshmërisë dhe të integritetit në shoqëri.

Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara

- Nevojitet një kornizë gjithëpërfshirëse strategjike që mbulon të gjitha aspektet e dizajnit dhe ofrimit të shërbimit të përqendruar te përdoruesit.
- Po ashtu, miratimi i Strategjisë mbi Inteligjencën Artificiale mbetet një prioritet. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në përmirësimin e shërbimeve publike, po ashtu mbetet objektiv ambicioz për vendin.
- Në përputhje me progresin e bërë në fushën e digjitalizimit, duhet të përforcohet kuadri ligjor që rregullon sigurinë kibernetike dhe privatësinë e të dhënave, si dhe zbatimi i tij praktik sa më mirë.
- Miratimi i projektligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit, që synon të përafrohet me Rregulloren Evropiane të Identitetit Digjital që krijon kornizën e re të shërbimeve të identitetit digjital dhe të mirëbesimit të BE-së.
- Qeveria duhet të fillojë zhvillimin e projekteve për miratimin e portofolit elektronik dhe mjeteve dhe standardeve të tjera të reja të prezantuara nga Rregullorja Evropiane e Identitetit Digjital të 2024 (Rregullorja (EU) 2024/1183).
- Duhet të krijohet një mekanizëm i përhershëm ndërministror për reduktimin e barrës administrative si për analizën *ex-ante* të ligjeve dhe akteve nënligjore, ashtu edhe për analizën *ex-post* të barrës ekzistuese në praktikë.
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave statistikore mbi performancën digjitale dhe konkurrencën digjitale, sipas Indeksit të Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale.
- Të gjitha institucionet e qeverisë qendrore që ofrojnë shërbime publike të mbledhin, publikojnë dhe analizojnë tregues të krahasueshëm të performancës, bazuar në përkufizime dhe kritere të përbashkëta.
- Nevojitet bashkëpunim më i fortë me sektorin privat dhe shoqërinë civile për të përmirësuar zbatimin dhe monitorimin e politikave të sigurisë kibernetike.
- Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurt, të qëndrueshme dhe me shërbime të aksesueshme, si objektiv dhe prioritet që buron nga dokumenti i politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor", pjesë e Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor.
- Zgjerimi i infrastrukturës digjitale dhe ofrimi i trajnimeve për përmirësimin e aftësive digjitale të qytetarëve. Aktorët lokalë mund të luajnë një rol të rëndësishëm duke ofruar trajnime për përdorimin e platformave *online*, si dhe asistencë në aksesimin e pajisjeve digjitale për grupet në nevojë.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Përfundimi i harmonizimit të legjislacionit të posaçëm sektorial me Kodin e Procedurave Administrative, bazuar në metodologjinë e dakordësuar dhe sigurimin e burimeve të nevojshme. Ministria e Drejtësia (MD), në bashkëpunim me AKSHI-n, duhet të shfrytëzojë, gjithashtu, këtë mundësi për të thjeshtuar dhe ri-inxhinieruar procedurat administrative.
- Përmirësimi i aksesit dhe transparencës në administratën publike. Për të siguruar një administratë më të hapur dhe të përgjegjshme, rekomandohet forcimi i sistemit të llogaridhënies përmes instrumenteve të monitorimit të pavarur.
- Përmirësimi i aftësive digjitale të qytetarëve. Një element tjetër kyç është rritja e aftësive digjitale të qytetarëve, veçanërisht të atyre që kanë vështirësi për të përdorur platforma teknologjike.
- Rritja e investimeve në infrastrukturën digjitale dhe forcimi i kapaciteteve administrative. Investimet në infrastrukturën digjitale mbeten një prioritet kyç për qeverinë shqiptare.
- Mbështetja për grupet më vulnerabël. Për të përmirësuar qasjen në shërbime për personat e moshuar dhe ata me aftësi të kufizuara, rom/egjiptian, etj., sugjerohet vendosja e disa qendrave *Info Points* për shërbime dhe ofrimi i ndihmës teknike nga operatorët e qendrave të dedikuara. Po ashtu, duhet të krijohen programe asistence specifike për këta individë, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive digjitale të tyre.
- Duhet të bëhet funksionale qendra e kontaktit *omnichannel*, duke shërbyer si një "asistent informacioni" i mundësisë së fundit, për të ofruar informacion për përdoruesit e shërbimeve elektronike që hasin probleme.
- Nevojitet përmirësimi i masave të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale për të parandaluar sulmet e ardhshme dhe për të mbrojtur të dhënat sensitive të qytetarëve, në zbatim të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale të harmonizuar plotësisht me *acquis* e BE-së.

Efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike

- Krijimi i një autoriteti të pavarur (Këshilli Fiskal) për të siguruar vlerësimin e pavarur të politikës fiskale, duke rritur kështu besueshmërinë e projeksioneve fiskale dhe qëndrueshmërinë e financave publike në afat të mesëm, si dhe duke monitoruar risqet fiskale me qëllim uljen e tyre.
- Përmirësimi i menaxhimit dhe ulja e detyrimeve të prapambetura, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të Sistemit të Informacionit Financiar të Qeverisë.
- Krijimi i praktikës për diskutimin e kuadrit makro-Fiskal dhe Programit Buxhetor Afatmesëm në Kuvend, si dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore të Kuvendit në lidhje me analizat buxhetore.
- Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit në shqyrtimin e akteve normative për ndryshim buxheti.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Përshtatja e legjislacionit të PPP/koncesioneve me direktivat e Bashkimit Evropian. Agjencia e Prokurimit Publik (APP) duhet të rishikojë sistemin e kufijve financiarë për zbatimin e dispozitave të ligjit të prokurimit publik në mënyrë të tillë që respektimi i rregullave të BE-së të mos varen nga luhatjet e kursit të këmbimit lekë/euro.
- Përfshirja e kritereve të respektimit të mjedisit (prokurimi *green*) në procedurat e prokurimeve publike nëpërmjet identifikimit të numrit të procedurave të prokurimit që reflektojnë kërkesat për eficiencën e energjisë.
- Raportim i rregullt fiskal periodik i ndërmarrjeve shtetërore nëpërmjet standardizimit të metodologjisë së raportimit fiskal të tyre me qëllim identifikimin dhe reduktimin e risqeve fiskale. Rritja e rolit të Kuvendit në këtë proces nëpërmjet raportimit të ministrisë së linjës pranë këtij institucioni.
- Në kontekstin e transparencës së financave publike, koncepti i llogaridhënies menaxheriale brenda institucioneve publike ende nuk është kristalizuar plotësisht dhe duhet të zhvillohet, dhe lehtësohet një kuptim më i thellë i përgjegjshmërisë menaxheriale nga niveli ekzekutiv me mjetet e nevojshme.
- Kuvendi dhe KLSH-ja duhet të zhvillojnë më tej bashkëpunimin e tyre për përdorimin efektiv të raporteve të KLSH-së nga Kuvendi.

Qeverisja e Hapur: Eficienca dhe performanca në administratën publike

- Angazhimet e Parlamentit të Hapur po rriten me shpejtësi në kuadër të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (OGP), gjë që është tregues i rolit në rritje të Parlamentit në lidhje me mbikëqyrjen, transparencën, llogaridhënien dhe eficiencën.
- Koncepti i sotëm i qeverisjes së hapur, synon një qasje që në mjaft raste ndërlidh të tre pushtetet (legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin).
- Shumica e angazhimeve të Parlamentit të Hapur fokusohen në rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes, por nevojiten më tepër angazhime që përfshijnë masa të llogaridhënies.
- Në lidhje me OGP-në duhet të synohet që Parlamenti të përfshihet më shumë si zbatuesi kryesor i angazhimeve të Parlamentit të Hapur dhe të përfshijë më shumë elemente të mbikëqyrjes publike dhe llogaridhënies.
- Mbetet prioritet rritja e efektivitetit të administratës publike, e cila do të përmirësojë cilësinë dhe efikasitetin e kostos së shërbimeve publike, duke forcuar besimin e publikut tek institucionet.
- Përmirësimi i përdorimit të mjeteve të menaxhimit të performancës do të mundësonte monitorimin më nga afër dhe rritjen e efektivitetit të sektorit publik, si dhe në arritjen e objektivave dhe reformën në administratën publike.
- Për të përdorur në mënyrë efektive menaxhimin e performancës, me qëllim rritjen e produktivitetit të sektorit publik, institucionet publike duhet të fokusohen si në vlerësimin e performancës, ashtu edhe në motivimin e stafit, për t'i ndihmuar ata të rriten profesionalisht. Kjo kërkon jo vetëm përafrimin e qëllimeve individuale dhe organizative dhe fillimin në nivelet më të larta të shërbimit civil, por edhe përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së kontekstit se si vlerësohet performanca për lloje të ndryshme pune.

DOKUMENT PARLAMENTAR

HYRJE

Analiza e situatës së elementeve që lidhen me mirëqeverisjen në Shqipëri merr një vlerë të veçantë duke pasur parasysh se Shqipëria më 15 tetor 2024 hapi zyrtarisht procesin e negociatave për anëtarësim në BE me grupkapitullin I "Themeloret", ku janë përfshirë kapitujt më të rëndësishëm, në të cilin administrata publike zë një vend të veçantë. Ndaj, shtylla e "Mirëqeverisjes" merr rëndësi primare kur flasim për reformën në administratën publike, në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Transparenca është një nga elementet kyç të mirëqeverisjes, e cila përfshin në vetvete parimin e miradministrimit. Ky i fundit, nën ombrellën e tij përfshin transparencën, llogaridhënien, nivelin e përgjigjes të administratës kundrejt nevojave të qytetarëve, eficiencën, efektivitetin, qasjen e hapur, pjesëmarrjen, parashikueshmërinë e veprimtarisë, shtetin e së drejtës, koherencën, barazinë, sjelljen etike, antikorrupsionin, përfundimin e procesit administrativ brenda kohës së arsyeshme, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe thjeshtimin e procedurave. Ajo është parim ku duhet të mbështetet aktiviteti i administratës publike, aq edhe qëllim i synuar nga administrata publike dhe, pa diskutim, mjeti që administrata duhet ta përdorë për realizimin e funksioneve të saj.

Transparenca dhe llogaridhënia në shumë dokumente e politika trajtohen së bashku, por për shkak të gjerësisë së fushave, në këtë dokument analitik janë trajtuar të ndara. Gjithashtu, transparenca e financave publike gjen mbulim në një kapitull më vete, për t'i dhënë fokusin dhe vëmendjen e duhur këtij komponenti të rëndësishëm të reformës së administratës publike. Transparenca e Kuvendit dhe e organeve të sistemit të drejtësisë trajtohen në dy shtyllat e tjera të Komisionit të Posaçëm. Analiza përqendrohet te zhvillimet kryesisht nga viti 2022 e në vijim, jo thjesht për të qëndruar koherent me nevojat aktuale, por edhe për të mundësuar një lidhje logjike me zhvillimet në kuadër të publikimit të raportit *Screening* të Komisionit Evropian në vitin 2023. Statistikat e referuara në këtë analizë janë marrë nga raportet zyrtare të publikuara deri në momentin e hartimit të këtij dokumenti (dhjetor 2024) dhe informacionet/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet publike.

Gjithashtu, integriteti dhe etika në administratën publike janë elemente thelbësore për mirëfunksionimin e një shteti të drejtë dhe demokratik. Një administratë publike e ndershme dhe efektive ndihmon në rritjen e besimit të qytetarëve tek institucionet shtetërore, përmirëson ofrimin e shërbimeve dhe kontribuon në zhvillimin ekonomik e social të vendit. Pa integritet dhe efektivitet, administrata publike bëhet e brishtë ndaj korrupsionit dhe paaftësisë, duke minuar kështu cilësinë e politikave publike dhe efikasitetin e burimeve shtetërore. Për këtë arsye, sigurimi i integritetit dhe efektivitetit në administratën publike në Shqipëri është i domosdoshëm për të garantuar që interesat e qytetarëve të mbrohen dhe vendimet të mbështeten në parimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë.

BE-ja, ndër aspektet kryesore për të vlerësuar cilësinë e administratës publike dhe çdo nevojë për reforma, vlerëson edhe llogaridhënien*:* "Organizimi i administratës publike duhet të jetë efikas dhe efektiv në të gjitha nivelet e qeverisjes. Organet e administratës publike janë të hapura dhe transparente dhe zbatojnë mekanizma të përcaktuar qartë të llogaridhënies së brendshme dhe të

DOKUMENT PARLAMENTAR

jashtme. Organet mbikëqyrëse mbrojnë të drejtat e qytetarëve dhe interesin publik"[5]. Të njëjtin koncept për llogaridhënien jep edhe raporti i monitorimit OECD/SIGMA 2024 për Shqipërinë[6]. Llogaridhënia gjen pasqyrim edhe në pjesë të ndryshme të legjislacionit shqiptar që lidhen me veprimtarinë e administratës publike (shih pikën 3.3.1 më poshtë).

Një administratë publike efikase, e përgjegjshme dhe transparente është jo vetëm e një rëndësie të madhe për funksionimin e duhur të një vendi, por, gjithashtu, është mjeti bazë përmes të cilit mund të zbatohen strategjitë e qeverisë për të arritur objektivat zhvillimorë, si dhe një mjet drejt arritjes së qëllimeve të zhvillimit të nivelit më të lartë – veçanërisht rritjes së barabartë, uljes së varfërisë, paqes dhe stabilitetit.

Po ashtu, raporti i OECD/SIGMA 2024 evidenton edhe gjashtë parimet e administratës publike sa i takon llogaridhënies[7], si vijon:

-organizimi dhe menaxhimi i administratës publike nxit llogaridhënien, efektivitetin dhe efikasitetin;

-përgjegjësitë janë të shpërndara qartë ndërmjet niveleve të qeverisjes, duke përqafuar parimin e subsidiaritetit dhe autonomisë lokale, dhe duke lehtësuar koordinimin ndërinstitucional me mekanizma efektivë të mbikëqyrjes;

-administrata publike është transparente dhe e hapur;

-Parlamenti, Avokati i Popullit dhe institucioni suprem i auditimit (KLSH) monitorojnë në mënyrë efektive administratën publike;

-e drejta për një administratë të mirë garantohet përmes procedurave administrative, rishikimit gjyqësor dhe përgjegjësisë publike;

-një sistem koherent dhe gjithëpërfshirës i integritetit të sektorit publik minimizon rreziqet e korrupsionit.

Modernizimi i shërbimeve publike është një nga prioritetet kryesore të qeverisjes. Objektivi kryesor i tij është eliminimi i dritareve të shërbimit fizik dhe thjeshtimi e lehtësimi i të gjithë procesit duke përdorur infrastrukturën digjitale. Kjo është theksuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021–2030 (SKZHI III) dhe, po ashtu, është përcaktuar në strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, të cilat përbëjnë kuadrin e përgjithshëm për modernizimin, transformimin e institucioneve dhe praktikave të administratës publike në vend, me vizionin e ofrimit të shërbimeve me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset; në mënyrë transparente, efektive dhe efikase nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe në përputhje me kërkesat e anëtarësimit në BE përmes nëpunësve civilë të paanshëm, profesionistë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficiente.

Revolucioni digjital i shërbimeve publike në Shqipëri ka ndryshuar prej kohësh perceptimin e qytetarëve, në lidhje me komunikimin elektronik me institucionet shtetërore, duke bërë që sot të

---

[5] *European Commission* (2023), *Screening Report Albania 2023*, f.22; https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en;

[6] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024*, (*Assessment against the Principles of Public Administration)*, SIGMA *Monitoring Reports,* OECD Publishing, Paris; f.67.

[7] Parimet 13-18 të Administratës Publike: OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024*, *(Assessment against the Principles of Public Administration),* SIGMA *Monitoring Reports*, OECD Publishing, Paris; f.67.

DOKUMENT PARLAMENTAR

kemi 1247 shërbime *online* ose rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike. Qeveria shqiptare, si promovuese e shndërrimit të shërbimeve *offline* në shërbime *online*, e shndërroi platformën e-Albania, në një histori suksesi dhe me qëllim që të rivendoste besimin e qytetarëve në institucionet publike. E gjithë veprimtaria bazohet në një kornizë të posaçme ligjore, e cila ka ecur paralelisht me proceset e implementimit teknik të procedurave, për zhvillimin e e-Qeverisjes në vend. Qëllimi i këtyre politikave është lehtësimi i procedurave për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike elektronike, ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarin dhe përmirësimin e jetesës. Kjo qasje ndaj digjitalizimit të shërbimeve është vlerësuar edhe nga raportet e mjaft organizatave ndërkombëtare, si: OKB-ja, BE-ja, OECD/SIGMA[8].

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale, rrjeteve të telekomunikacionit/komunikimeve elektronike të shpejta dhe shumë të shpejta është një domosdoshmëri për të mbështetur gjithë transformimin digjital të ekonomisë dhe zhvillimet inovatore në sektorë strategjikë si energjia, transporti, industria, edukimi, arsimi etj., si dhe përmirësimin rrënjësor të cilësisë së shërbimeve publike. Qeveria shqiptare ka vazhduar promovimin e TIK-ut në sektorë të ndryshëm, duke prezantuar dhe implementuar strategji dhe politika të ndryshme, të cilat e kanë TIK-un në fokusin e tyre, zhvillimin e shoqërisë së informacionit, agjendën digjitale dhe zhvillimin e Broadband-it[9].

Ndër komponentët e mirëqeverisjes është edhe efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike. Ai përfshin mekanizmat përmes të cilëve mblidhen, shpërndahen, shpenzohen dhe llogariten burimet publike. Këto procese përfshijnë të gjithë ciklin buxhetor, prokurimin publik, praktikat e auditimit dhe mbledhjen e të ardhurave. Qëllimi i menaxhimit të financave publike është të ofrojë shërbime publike cilësore dhe të sigurojë stabilitet ekonomik e shoqëror duke rritur besueshmërinë e qytetarëve. Në këtë kontekst, Shqipëria ka zbatuar me sukses disa reforma të menaxhimit të financave publike gjatë dekadave të fundit, ku mund të përmendim Strategjinë e parë të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2014-2020, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 17.12.2014, e cila krijoi një terren të përshtatshëm për rikthimin e financave publike në një trajektore të qëndrueshme, si një nga detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimin Evropian.

Në vijim të strategjisë së parë u hartua dokumenti i dytë strategjik, MFP 2019 – 2022 e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 18.12.2019, e cila zëvendësoi strategjinë e mëparshme për periudhën 2014-2020 dhe kishte si qëllim të konsolidonte mësimet e nxjerra dhe ndryshimet e dakordësuara pas MTR[10] dhe të ofronte një kornizë dhe udhërrëfyes, që të udhëhiqte përmirësimet në rezultatet e MFP-së për periudhën deri në dhjetor 2022.

Aktualisht, për të bërë të mundur garantimin e një sistemi të financave publike që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik, Shqipëria

[8] Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021–2030 (SKZHI III), f. 62.
[9] Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021–2030 (SKZHI III), f. 62.
[10]Vlerësimi Afatmesëm(MTR) i strategjisë së MFP-së me qëllim identifikimin e progresit, arritjeve, sfidave dhe mangësive.

DOKUMENT PARLAMENTAR

mbështetet në Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2023-2030, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 12.6.2024 dhe Planin e saj të Veprimit 2023-2026. Kjo strategji udhëhiqet nga Ministri i Financave dhe paraqet reformat e planifikuara për përmirësimin e sistemeve të MFP-së. Strategjia e MFP-së është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022-2030. Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të krijojë një sistem të menaxhimit të financave publike që garanton transparencë, llogaridhënie, disiplinë fiskale, efikasitet dhe barazi në përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe zhvillimit ekonomik, që të sigurojë një integrim të lehtë dhe të shpejtë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE).

Qeverisja e Hapur është çelësi për qëndrueshmërinë e një demokracie funksionale në një shoqëri moderne dhe gjithëpërfshirëse. Qeverisja e Hapur ka në themel partneritetin e institucioneve me shoqërinë civile dhe qytetarët, me qëllim forcimin e demokracisë dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Pjesë e saj është angazhimi/qasja për një Parlament të Hapur. Një parlament i hapur që inkurajon transparencën, pjesëmarrjen dhe llogaridhënien gjatë gjithë procesit legjislativ është një kriter thelbësor për një parlament demokratik dhe gjithashtu është një pjesë shumë e rëndësishme e një qeverisjeje të hapur. Veprimet që mund të ndërmarrin parlamentet për të avancuar qeverisjen e hapur përmes legjislacionit, mbikëqyrjes/monitorimit, hapjes së institucioneve dhe proceseve parlamentare, si dhe nxitjes së dialogut marrin rëndësi në këtë drejtim.

Për efekt të trajtimit në këtë kapitull, merr rëndësi analiza e dy elementeve në kuadër të qeverisjes së hapur që janë eficienca dhe performanca në administratën publike.

Administrata publike tradicionalisht bazohet në arritjen e eficiencës në punën e organeve publike, në realizimin e qëllimeve që kanë të bëjnë me ofrimin e të mirave dhe shërbimeve publike. Prandaj, efikasiteti gjen një vend të përhershëm në analizën e administratës publike dhe punën e qeverisë. Vlen të theksohet se kur analizohet eficienca mbahen parasysh pasja dhe funksionimi i strukturave organizative racionale dhe efikase administrative, bazuar në vlera, në një sistem demokratik. Efikasiteti në administratën publike është më shumë se një marrëdhënie teknike midis burimeve dhe produktit; ai ka një dimension tjetër që përfshin *outputet* në lidhje me vlerat dhe llogaridhënien si një cilësi e qenësishme e qeverisjes demokratike.

Reformat në fushën e administratës publike synojnë ndër të tjera përmirësimin e matjes dhe menaxhimin e performancës, për të mbështetur vendimmarrje më të mirë, për të harmonizuar veprimtarinë e organeve dhe institucioneve publike me nevojat e qytetarëve dhe palëve të interesuara. Për të siguruar që shërbimet publike të ofruara janë të shpejta, efikase dhe me kostot më të ulëta të mundshme, është e domosdoshme që të matet dhe vlerësohet performanca e administratës publike[11]. Mekanizmat e vlerësimit të performancës përmirësojnë eficiencën dhe efektivitetin e sektorit publik. Lidhja e performancës me pagën dhe shpërblimet trajtohet në qasjen

[11] OECD (2017), *Government at a Glance* 2017, OECD *Publishing*, Paris http://dx.doi.org/10.1787/gov_glance-2017-en

DOKUMENT PARLAMENTAR

e sistemeve të ndryshme e rregullimeve që aplikohen dhe mbetet një sfidë për adresim, edhe në kuadrin e strategjisë së re të reformës në administratën publike shqiptare.

Në secilin kapitull është ndjekur në përgjithësi e njëjta strukturë pune, ku përfshihet: konteksti, progresi dhe arritjet, gjetjet, problematikat dhe rekomandimet, si dhe konkluzionet dhe çështjet për zgjidhje/drejtimet e ndërhyrjeve.

Konteksti në mënyrë të përmbledhur parashtron një vlerësim/konsideratë të situatës aktuale për komponentin përkatës në mënyrë të përgjithshme, mbështetur edhe në vlerësimet që mund të rezultojnë të trajtuara nga raportet e institucioneve kombëtare dhe ato ndërkombëtare, kryesisht ato të BE-së, OECD/SIGMA, KiE-së, GRECO-s, OGP-së, DASH-it, etj. Te **progresi dhe arritjet** përshkruhen në mënyrë të qartë, me argumente dhe të dhëna/fakte konkrete vlerësimet dhe gjetjet pozitive që konstatohen për fushën e këtij komponenti, progresin dhe arritjet e krijuara në vite, si dhe politikat apo nismat e suksesshme në fushën e komponentit përkatës, duke u bazuar kryesisht në vlerësimet e raporteve ndërkombëtare (si raporti *Screening* 2023 dhe Raporti i Progresit i BE-së 2024 për Shqipërinë, raporti i monitorimit OECD/SIGMA 2024, etj.,) por edhe nga raportet e institucioneve tona kombëtare dhe organizatave të ndryshme vendore të shoqërisë civile, biznesit, medias etj. **Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet** si pjesë e analizës, bazohen kryesisht në raportet e ndryshme ndërkombëtare, por dhe institucioneve e organizatave vendore. Analiza mbyllet me pjesën e **konkluzioneve dhe çështjeve për zgjidhje/ndërhyrje.** Mbështetur në përshkrimet e mësipërme, kjo pjesë e dokumentit trajton për secilin komponent konkluzionet me çështjet kryesore që duhen adresuar për trajtim e zgjidhje, si dhe drejtimet e mundshme për ndërhyrje.

Drafti i parë i analizës i është nënshtruar konsultimit publik përmes publikimit të përmbledhjes në faqen *web* të komisionit www.masl.al dhe diskutimit të tij gjatë tryezave publike dhe forumeve qytetare të organizuara për këtë qëllim. Gjithashtu, ky draft është dërguar për mendim dhe komente tek institucionet e pavarura dhe ekzekutivi, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, akademia dhe biznesi. Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) të kësaj shtylle, ka shqyrtuar dhe adresuar të gjitha komentet e ardhura me shkrim lidhur me këtë dokument. Informacioni i analizuar në këtë shtyllë bazohet në burime të ndryshme, të bëra publike deri në dhjetor 2024. Përfaqësuesit e institucioneve të administratës publike kanë vënë në dispozicion të GENL-it çdo informacion/dokumentacion shtesë të nevojshëm me kërkesë të komisionit.

Për të realizuar analizën e kuadrit ligjor është marrë në konsideratë i gjithë korpusi i normave parësore dhe dytësore, me një fokus më të madh në ligjet e mëposhtme:

- Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike";
- Ligji nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Ligji nr. 14/2024 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë".
- Ligji nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit";
- Ligji nr.43/2023 "Për qeverisjen elektronike", i ndryshuar;

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”;
- Ligji nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”;
- Ligji nr.102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”;
- Ligj nr. 60 /2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve’’;
- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 114/2015 “Mbi kontrollin e brendshëm të sektorit publik’’, i ndryshuar;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit“, i ndryshuar;
- Ligji nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”;
- Ligji nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin’’, i ndryshuar.
- Ligj nr. 10034 datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve’’;
- Ligji nr. 9936, 26.6.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ;
- Ligji nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligji nr. 9049/2003, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike’’, i ndryshuar.
- Ligj nr. 9131 datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike’’.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Kapitulli I: Transparenca në Administratën Publike

1.1 Konteksti

1.1.1 Konteksti ligjor për transparencën dhe përafrimi me *acquis*

Në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria duhet të përafrojë legjislacionin e saj me *acquis.* Transparenca është një nga parimet kryesore të Bashkimit Evropian e përcaktuar në traktatet e BE-së, dhe legjislacioni i BE-së në këtë fushë ka parashikime e rregulla që lidhen me të drejtën për informim, konsultimin e akteve, si dhe dialogun me qytetarët e grupet e interesit. Këto parashikime rrjedhin nga traktatet, rregulloret dhe normat e "buta" të BE-së, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Parimet e administratës publike, SIGMA/ OECD në lidhje me transparencën[12], përbëjnë një pikë orientimi për reformën e administratës publike, si dhe një element monitorimi periodik për Shqipërinë. Dokumenti i hartuar në vitin 2014 dhe i rishikuar në vitin 2023 përmban 32 parime që përvijojnë vlerat, sjelljet dhe rezultatet dhe 270 nënparime që japin udhëzime më të detajuara se si të arrihen këto rezultate dhe të sigurohet kapaciteti i duhur administrativ.[13] Konkretisht nën rregullimin e fushës tematike "Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja'', gjen parashikim parimi 15 'Administrata publike është transparente dhe e hapur', i cili përmban elementet kryesore që do duhet të garantohen nga shtetet në këtë drejtim.[14] Gjithashtu, transparenca përmendet si element kyç në fushën e ofrimit të shërbimeve, prokurimit publik, rekrutimeve në administratë etj.

[12] Sipas SIGMA-s, *Parimet e Administratës Publike* janë një kuadër gjithëpërfshirës standardesh që shprehin vlerat dhe sjelljet që qytetarët dhe bizneset presin nga një administratë publike moderne. Ato janë krijuar për të udhëzuar administratat e zgjerimit dhe fqinjësisë së Bashkimit Evropian në përpjekjet e tyre reformuese për të trajtuar mangësitë e administratave të tyre publike dhe për të përmbushur kërkesat e BE-së për një nga "reformat themelore" të procesit të anëtarësimit.
Parimet u zhvilluan nga SIGMA, një nismë e përbashkët e BE-së dhe OECD-së, e financuar kryesisht nga BE-ja, me kërkesë të Komisionit Evropian (KE). Parimet bazohen në *acquis* ekzistues të BE-së, në instrumentet ligjore të OECD-së, në standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe në praktikat e mira të BE-së dhe të vendeve të OECD-së.
Parimet e Administratës Publike, SIGMA/ OECD, 2023. Dokumenti i plotë gjendet në faqen: The Principles of Public Administration - 2023 edition - Albanian (sigmaweb.org)

[13] *Ibid.*, faqe 10.

[14] Nënparimet e lidhura me administratën e hapur dhe transparente: a) Qeveria ka vendosur objektiva strategjike për të promovuar hapjen dhe transparencën e administratës publike, duke caktuar përgjegjësi të qarta për aktorë të veçantë; b) Individët, përfshirë jorezidentët, dhe personat juridikë kanë të drejtën ligjore që të marrin informacionin publik pa arsyetuar kërkesën e tyre; c) Informacioni publik përfshin të gjithë informacionin e regjistruar në dokumente që mbahen nga administrata publike dhe nga individë ose persona juridikë që ushtrojnë autoritet publik. Përjashtimet ekzistojnë vetëm kur ka arsye bindëse për klasifikimin e informacionit; ato janë të përcaktuara me saktësi në ligj; d) Administrata publike i ndihmon palët të identifikojnë informacionin e kërkuar dhe e jep atë menjëherë në formatin e kërkuar dhe pa pagesë, me përjashtim të kostos së fotokopjimit dhe të printimit; e) Administrata publike i komunikon arsyet e refuzimit të qasjes në informacionin publik dhe palët kanë të drejtë ta ankimojnë këtë vendim në një organ të pavarur ose në gjykata; f) Përgjegjësia për monitorimin e respektimit të legjislacionit për informimin publik, dhënien e udhëzimeve dhe vendosjen e sanksioneve është caktuar dhe zbatohet në mënyrë të qartë; g) Administrata publike mban regjistra të përditësuar të dokumenteve, përcakton dhe ndjek rregullat në lidhje me ruajtjen dhe asgjësimin e dokumenteve me qëllim që të ruajë prova të aktiviteteve dhe vendimeve publike, të cilat gjenden pa vështirësi.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Legjislacioni në Shqipëri në fushën e transparencës, gjatë 10 vjetëve të fundit, ka pësuar disa ndryshime, duke filluar me miratimin e një ligji të ri për informimin në vitin 2014, miratimin për herë të parë të një ligji për njoftimin dhe konsultimin publik në vitin 2014, me miratimin e një Kodi të ri të Procedurave Administrative në vitin 2015, miratimin për herë të parë të një ligji për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik në vitin 2022, miratimin e ligjit për qeverisjen elektronike në vitin 2023 etj. Të gjitha këto dinamika në hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit kanë qenë të ndikuara edhe nga nevoja për të përafruar legjislacionin vendas me standardet e BE-së dhe modelet e vendeve të tjera anëtare.
Edhe pse Kushtetuta e Shqipërisë nuk përcakton në mënyrë të shprehur të drejtën e qytetarëve, grupeve të interesit dhe shoqërisë civile për përfshirjen në politikëbërje apo në proceset e vendimmarrjes publike, ajo përfshin disa parime të ndërlidhura me të, si e drejta e referendumit, liria e shprehjes, e drejta e informimit, e drejta e grumbullimit, e drejta e organizimit, e drejta për të propozuar ligje, liria e aksesit në informacionin publik, etj. Gjithashtu, Kodi i Procedurave Administrative rregullon parimin e transparencës[15] dhe të informimit[16], në përputhje me parimet dhe rregullat evropiane në këtë fushë.

Në të njëjtën linjë, ligji për të drejtën e informimit[17] garanton aksesin në informacion për çdo person, pa motivuar kërkesën dhe cakton rregullat mbi kostot për marrjen e informacionit. Gjithashtu, ligji detyron autoritetet të publikojnë rregullisht informacione të rëndësishme në mënyrë pro-aktive dhe të ofrojnë dokumente sipas kërkesës, përveç rasteve të veçanta të parashikuara nga ligji. Ndryshimet e fundit me ligjin nr. 78/2023 kanë përmirësuar më tej këtë kuadër, duke shtuar mekanizma për forcimin e cilësisë së përgjigjeve nga institucionet dhe përshpejtimin e procedurave për dhënien e informacionit. Parashikimet kushtetuese dhe ligji për të drejtën e informimit dhe ndryshimet e tij në vitin 2023 vlerësohen pozitivisht, dhe në tërësi si në përputhje me standardet evropiane.[18] Më herët, ligji për të drejtën e informimit është renditur si një nga më të mirët, i gjashti në botë në indekset e legjislacioneve për aksesin në informacion.[19] Megjithatë, siç do të trajtohet në vijim, në praktikë evidentohen një sërë problemesh në zbatimin e ligjit.

Shqipëria miratoi ligjin "Për njoftimin dhe konsultimin publik" në vitin 2014[20] dhe Udhëzuesin për Konsultimin Publik. Kuadri ligjor për konsultimin publik në përgjithësi është vlerësuar se

[15] Neni 5, ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".
[16] Neni 6, *ibid*.
[17] Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", i ndryshuar.
[18] *Rule of Law Report, country chapter on the rule of law situation in Albania*, 2024, f. 18. Raporti i plotë gjendet në faqen: *0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en (europa.eu)
[19] Shih për më shumë: https://countryeconomy.com/government/global-right-information-rating/albania#:~:text=Albania%20is%20in%206%C2%BA%20place%20in%20the%20ranking%20of%20transparency&text=With%20that%20score%20Albania%20is,transparency%20and%20access%20to%20information
[20] Ligji nr. 146/2014, datë 30 tetor 2014 "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*".https://www.legislationline.org/download/id/8099/file/Albania_law_notification_public_consultation_2014_en.pdf. Përveç kësaj,vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.8.2003, "Rregullorja e punës së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar, përcakton këtë parim në procesin e hartimit të akteve normative nga Këshilli i Ministrave.

DOKUMENT PARLAMENTAR

është në përputhje me standardet evropiane.[21] Në raportin *Screening* në këtë drejtim bëhen rekomandime për përmirësim të ligjit siç do të trajtohet në vijim.

Ligj nr. 45/2022, datë 28.4.2022 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare"[22] është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të transparencës në administratën publike. Konventa për aksesin në dokumente zyrtare vendos standarde ndërkombëtare për të drejtën e qytetarëve për të pasur qasje në informacionin publik dhe dokumentet zyrtare, duke përcaktuar si parim bazë që informacioni publik duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë. Gjithashtu, Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", i cili ka përafruar direktivën (BE) 2019/1024 mbi të dhënat e hapura. Përafrimi i akteve të sipërpërmendura në kuadrin rregullator shqiptar është një mundësi për pjesëmarrjen e qytetarëve në mirëqeverisje dhe një shprehje e ushtrimit efektiv të demokracisë përfaqësuese.[23]

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), është angazhuar në procesin e hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 33/2022.[24] Ndërkohë, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 3.7.2024, "Për shtimin e kategorive tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe". Ky vendim përputhet pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit Europian 2023/138/BE, datë 21 dhjetor 2022, e cila përcakton një listë specifike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe për publikimin dhe ripërdorimin e tyre.[25]

1.1.2 Mekanizmat institucionalë për zhvillimin dhe koordinimin e politikave të transparencës

Në Shqipëri në fushën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave të transparencës veprojnë disa mekanizma institucionalë. Efektiviteti i veprimtarisë së tyre ndikon drejtpërdrejt me shkallën e transparencës së organeve publike në vend dhe qëndrueshmërisë së politikave. Në vijim trajtohen shkurtimisht disa prej tyre dhe gjetjet mbi veprimtarinë e këtyre organeve.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave miratoi në vitin 2021 një udhëzues, i cili shërben si manual i proceseve të konsultimit publik për institucionet e administratës shtetërore. Shih manualin në shqip, në https://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/URDHER-Nr.-3-Dt.-29.01.2021-compressed.pdf.

[21] Raporti i KE-së për Shqipërinë, 2022.

[22] Teksti i plotë gjendet në faqen: https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Per-ratifikimin-e-Konventes-se-Keshillit-te-Evropes-Per-aksesin-ne-dokumente-zyrtare.pdf

[23] Strategjia institucionale *2022 – 2025*, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, faqe 6.

[24] Sipas informacionit të dërguar në grupin e ekspertëve nga zyra e Komisionerit, më datë 19.09.2024 rezulton se është në proces hartimi i akteve nënligjore në lidhje me udhëzimin "Për miratimin e licencës standarde" dhe projekvendimin "Për shtimin e të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe të lëvizshmërisë dhe transportit publik".

[25] Celex 32023R0138, *Commission Implementing Regulation* (EU) 2023/138 *of 21 December* 2022 *laying down a list of specific high-value datasets and the arrangements for their publication and re-use.*

DOKUMENT PARLAMENTAR

- *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale*

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është krijuar në vitin 2008 me miratimin e ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Kompetencat e Komisionerit gjenden të shpërndara në disa akte ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, të drejtën e informimit, si dhe është përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e së drejtës për ripërdorim të dokumenteve. Gjithashtu, Komisioneri ka kompetenca edhe në fushën e konsultimit publik që rrjedhin nga ligji. Veprimtaria e institucionit vlerësohet pozitivisht në rezolutën më të fundit të Kuvendit, ku nënvizohet se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka realizuar plotësisht rekomandimet e lëna në rezolutën e datës 8.6.2023 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe rekomandimet e adresuara nga raporti i progresit për vitin 2023 për Shqipërinë.[26] Në raportin *Screening* vlerësohet se në kuadrin ligjor për të drejtën për informim në të ardhmen, kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale duhet të forcohen duke ofruar mekanizma për zbatimin e vendimeve dhe mandatin për të kryer inspektime gjithëpërfshirëse.[27] Me ndryshimet ligjore të vitit 2023, këto gjetje të raportit *Screening* vlerësohen se janë adresuar.

Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023–2030 parashikon forcimin e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe të institucioneve të administratës publike për transparencën dhe menaxhimin e hapur të të dhënave, përmes trajnimeve të certifikuara të ofruara nga ASPA (afati dhjetor 2025).[28] Në lidhje me këtë masë Zyra e Komisionerit është duke bashkëpunuar me projektin "Bashkimi Evropian për qeverisjen e mirë", me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale dhe koordinatorëve për të drejtën e informimit për zbatimin efektiv të ligjit nr. 45/2022 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare" (Konventa 205) dhe ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik".[29] Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka filluar trajnimet *online* për "Të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit dhe regjistrin elektronik për kërkesat dhe përgjigjet".

Në lidhje me pavarësinë e Komisionerit, në kuadër të Misionit të Vlerësimit të BE-së (Peer Mission Revieë) vlerësohet se: "Kuadri ligjor siguron në mënyrë adekuate funksionimin e pavarur të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me përjashtim të autonomisë organizative (autonomia për të krijuar në mënyrë të pavarur strukturën organizative).

[26] Rezolutë, "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023", Kuvendi i Shqipërisë, datë 4.7.2024.
[27] Raporti *Screening* për grupin e parë "Themeloret" për Shqipërinë, publikuar më 24 korrik 2023, f. 31. Raporti i plotë gjendet në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en
[28] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030".
[29] Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga Zyra e Komisionerit, më datë 19.9.2024.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Kuadri legjislativ, gjithashtu, krijon terren të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dyja të drejtave. Megjithatë, ka probleme në praktikë për zbatimin efektiv të rekomandimeve".[30]
Nëpërmjet ndryshimeve të ligjit nr. 78/2023 forcohet roli i Komisionerit dhe saktësohen e zgjerohen kompetencat e tij.[31]

Statistikat e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitet 2021-2023[32]

Viti	Numri i ankesave (të administruara nga Zyra e Komisionerit përgjatë vitit kalendarik dhe ato të mbarturat nga viti i mëparshëm)	Numri i ankesave të zgjidhura gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ (informacioni është vënë në dispozicion ankuesve)	Numri i vendimeve të Komisionerit në lidhje me ankesat/ Numri i vendimeve të Komisionerit në lidhje me zbatimin e programit të transparencës	Numri i rekomandimeve për zbatimin e programit të transparencës	Numri i proceseve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë
2021	1036	698	45/5	36	34
2022	1081	643	51/0	28	47
2023	1004	609	41/9	18	42

Numri i ankesave që shqyrton Komisioneri mbetet i lartë dhe duket një trend i qëndrueshëm për tre vitet e fundit. Për vitin 2023 numri i vendimeve të dhëna nga Komisioneri është 45, shumë i afërt me mesataren e 8 vjetëve nga nisja e zbatimit të ligjit nr. 119/2014.[33] Siç shihet nga të dhënat në tabelën e mësipërme, peshën më të madhe të vendimeve e zënë çështjet për të drejtën për

[30] Raporti Vjetor i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023, f. 33.
[31] Ndryshimet sjellin përmirësime në drejtim të përcaktimit më të mirë të kompetencave të Komisionerit; përcaktimin e përgjegjësisë së çdo nëpunësi/punonjësi të administratës, të cilët me veprimet apo mosveprimet e tyre nuk përmbushin detyrimet ligjore; detyrimin e autoritetit publik të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit (moszbatimi i kësaj vendimmarrjeje do të dënohet me sanksion administrativ, i cili do të aplikohet ndaj titullarit të institucionit); përcaktimin në mënyrë të qartë i detyrimit për publikimin e programit të transparencës në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik dhe detyrimi për reflektimin e datës së përditësimit të fundit; Koordinatori për të Drejtën e Informimit përveç pagës mujore, përfiton edhe një shtesë për natyrë të veçantë pune; rishikimin e kufirit minimal të sanksioneve (gjobave), duke vendosur një raport më të drejtë dhe proporcional me të ardhurat në administratën publike.
[32] Burimi i informacionit: Raportet vjetore të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti_2023.pdf
https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti-Vjetor-2022.pdf
https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf
[33] E drejta e informimit 2023. Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit - Shumë zhurmë për asgjë? "Res Publica", op.cit, f. 11.

DOKUMENT PARLAMENTAR

informimin, në krahasim me vendimet mbi programet e transparencës. Komisioneri ka një numër të lartë rastesh të zgjidhura gjatë procesit të hetimit administrativ, në krahasim me numrin e vendimeve përfundimtare. Këto shifra mund të lexohen si hap pozitiv, pasi informacioni ka arritur te kërkuesi, por, nga ana tjetër, mund të ndikojnë negativisht si një model sjelljeje institucionale për të zvarritur kërkesat për informacion dhe dhënien e informacionit jashtë çdo afati, gjatë hetimit administrativ të Zyrës së Komisionerit.

- *Avokati i Popullit*

Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është një aktor kyç në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e drejtësisë në Shqipëri. Ai ka një funksion të rëndësishëm si ndërmjetësues mes qytetarëve dhe autoriteteve shtetërore, duke ofruar rekomandime për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe duke ndërmarrë masa për të siguruar zbatimin e tyre. Sa i përket zhvillimit dhe koordinimit të politikave të transparencës në Shqipëri, Avokati i Popullit ka një rol të rëndësishëm përmes monitorimit, rekomandimeve, nxitjes së politikave të reja, edukimit dhe bashkëpunimit. Avokati i Popullit kontribuon në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike, duke siguruar që institucionet të veprojnë në mënyrë më të hapur dhe më të përgjegjshme kundrejt qytetarëve. Në raportin *Screening* theksohet se Parlamenti duhet të forcojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit dhe të adresojë problemin e mungesës së reagimit të organeve të administratës publike.[34] Po ashtu, rekomandohet që vetë institucioni të përforcojë transparencën duke botuar raportet e veta edhe më parë se vetë Kuvendi t'i botojë ato.[35]
Në përgjigje të kërkesës së grupit të ekspertëve që janë angazhuar në përgatitjen e kësaj analize, zyra e Avokatit të Popullit ka evidentuar disa nga çështjet kryesore që adresojnë rekomandimet e këtij institucioni në lidhje me transparencën e administratës publike:

- Përgjegjësia institucionale. Rekomandimet e Avokatit të Popullit në shumë raste nxjerrin në pah mungesën e transparencës nga institucionet që nuk i përgjigjen kërkesave të tij për shpjegime, duke penguar kështu hetimin administrativ. Kjo problematikë është më së shumti e theksuar në institucionet e pushtetit vendor. Rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit në këtë rast synojnë të tërheqin vëmendjen ndaj problematikës dhe njëkohësisht të ndërgjegjësojnë institucionet mbi rëndësinë e bashkëpunimit dhe transparencës.
- Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe qasja në informacion. Avokati i Popullit ka kërkuar përmirësime në mënyrën se si institucionet publike bashkëpunojnë dhe ofrojnë informacion për qytetarët. Rekomandimet theksojnë rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për të adresuar çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve dhe për të siguruar që kërkesat e tyre të trajtohen në mënyrë të koordinuar dhe efektive.

[34] Raporti *Screening*, *op.cit*., f.31.
[35] Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2024, f.35. Raporti gjendet në faqen: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

- Transparenca në publikimin e të dhënave. Rekomandimet për publikimin e të dhënave, si në rastin e Censit të popullsisë dhe identitetit të pakicave kombëtare, synojnë të rrisin besimin e publikut dhe të garantojnë që të dhënat të jenë të qarta, të sakta dhe lehtësisht të kuptueshme.[36]

- *Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit*

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) luan një rol të rëndësishëm në Shqipëri në drejtim të qeverisjes së hapur dhe transparencës, si dhe mundëson shmangien e kontaktit direkt të qytetarëve me shumë sportele e institucione. Portali e-Albania ofron aktualisht *1242 shërbime elektronike* të cilat kryhen plotësisht *online* dhe nuk kërkojnë praninë fizike. Tre milionë qytetarë dhe biznese janë regjistruar në portalin e-Albania dhe marrin shërbime çdo ditë përmes saj.[37]

Që nga 1 maji 2022, dhënia e dokumentit përfundimtar për të gjitha aplikimet që bëhen përmes e-Albania ka vlerë të plotë ligjore. Kjo do të thotë se 95% e të gjitha shërbimeve publike janë ofruar ekskluzivisht *online* përmes portalit qeveritar e-Albania dhe në fund ato ofrojnë një dokument të vulosur/ të nënshkruar elektronikisht.
Portali qeveritar e-Albania është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (*Government Gateway* - GG), e cila është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në mënyrë të sigurt dhe të besueshme, duke garantuar shërbime elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike.[38] 61 sisteme elektronike janë të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit duke automatizuar procedurat administrative. Platforma Qeveritare e Ndërveprimit mundëson që 68% e formularëve të aplikimit të plotësohen paraprakisht nga komunikimi në kohë reale i regjistrave elektronikë të institucioneve të ndryshme me njëri-tjetrin, duke thjeshtuar procesin e aplikimit për qytetarët dhe bizneset dhe duke reduktuar dokumentacionin shoqërues të tyre.

- *Agjencia për Media dhe Informim*

Agjencia për Media dhe Informim është krijuar në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 512 datë 18.9.2021, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informim". Agjencia ka si mision të sigurojë transparencën në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet, si dhe qëllimin, objektivat, risitë apo problematikat që zgjidhen nëpërmjet akteve të Këshillit të Ministrave dhe të akteve të tjera të ministrave dhe çdo institucioni të administratës shtetërore.[39] Krijimi i kësaj Agjencie është pritur fillimisht me kritika

[36] Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga zyra e Avokatit të Popullit, datë 19.9.2024.
[37] Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga AKSHI, datë 18.9.2024.
[38] Partneriteti për qeverisje të hapur. Plani kombëtar 2023-2025, f. 12.
[39] Pika 3, Dispozita të Përgjithshme, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 18.9.2021, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informim".

DOKUMENT PARLAMENTAR

nga shoqëria civile, siç vihet në dukje edhe në raportin e Komisionit Evropian për Shtetin e së Drejtës.[40] Nga regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, për vitin 2023 rezulton se pranë Agjencisë janë depozituar 70 kërkesa,[41] 17 kërkesa më shumë se në vitin 2022.

- *Koordinatorët për të drejtën e informimit*

Ligji për të drejtën e informimit parashikon një rol të veçantë, i cili duhet t'i caktohet një nëpunësi në çdo organ publik.[42]
Ndryshimet kryesore të ligjit për të drejtën e informimit (ligji nr.78/2023), përforcuan rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit. Kështu, me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore, parashikohet:[43]

- Detyrimi autoritetit publik që gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj nëpunësit të caktuar si koordinator për të drejtën e informimit për shkelje të dispozitave të këtij ligji, të kërkojë mendimin e Komisionerit mbi çështjen dhe në vendimin përfundimtar të arsyetojë edhe mbi pranimin ose refuzimin e mendimit të dhënë prej tij.
- Përfitimi i një shtese për natyrë të veçantë pune mbi pagën mujore që nëpunësi i autoritetit publik do të përfitojë gjatë periudhës që është caktuar si koordinator për të drejtën e informimit. Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune, si dhe kriteret për përcaktimin e saj do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.[44]

Në raportin *Screening* evidentohet se roli i koordinatorëve të informimit duhet të forcohet.[45] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023–2030 parashikon si masë të veçantë se të gjithë koordinatorët për të drejtën e informimit kanë ndjekur trajnimin e certifikuar, të zhvilluar nga ASPA dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbi të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit dhe të dhënat e hapura.
Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me SIGMA-n ka miratuar dokumentin "Udhëzime për koordinatorët për të drejtën e informimit"[46] ku udhëzon autoritetet publike rreth mënyrës për garantimin e zbatimit efektiv të ligjit për të drejtën e informimit, ku rolin qendror e luan promovimi

[40] *Rule of Law Report, country chapter on the rule of law situation in Albania*, 2024, *op.cit*, f. 18.
[41] Të dhënat e plota gjenden në faqen: https://mia.gov.al/programi-i-transparences/
[42] Sipas pikës 1 të nenit 10, të ligjit "Për të drejtën e informimit": "Titullari i autoritetit publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit". Detyrat e koordinatorit janë të përcaktuara në pikën 2 të nenit 10.
[43] Neni 7 i ligjit ndryshues.
[44] Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, referuar pikës 2, 3 dhe shkronjës "d" të pikës 4 të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", ka nisur bashkëpunimin me DAP-in, nëpërmjet takimeve dypalëshe dhe komunikimeve, për hartimin e aktit nënligjor (VKM) për pagesën e një shtese page për natyrë të veçantë pune për koordinatorët e së drejtës për informim, në zbatim të pikave 4, 5 dhe 6 të nenit 10, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.
[45] Raporti *Screening, Op.cit.,* faqe 31.
[46] Udhëzime për koordinatorët për të drejtën e informimit, https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Udhezime_per_koordinatoret_per_te_drejten_e_informimit.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

i funksionit të koordinatorit për të drejtën e informimit si brenda autoritetit publik, ashtu dhe jashtë tij.

1.2 Arritjet dhe progresi

1.2.1 Funksionimi i politikave dhe praktikat e transparencës në qeverisjen qendrore, vendore dhe institucionet e pavarura. Përfshirja e grupeve të interesit.

Transparenca e administratës publike është trajtuar së bashku me llogaridhënien si pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike 2015 -2020, efektet e së cilës u shtynë deri në 2022. Në këtë fushë, fokusi i Strategjisë dhe më pas i raporteve monitoruese të zbatimit të saj, ka qenë te konsultimi i akteve si mjet për rritjen e transparencës dhe funksionimi i Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve. [47]

Transparenca në veprimtarinë e administratës publike pritet të mbetet një parim themelor edhe në Strategjinë e re për Reformën në Administratën Publike 2024-2030, e cila është në proces finalizimi nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, dhe nga Departamenti i Administratës Publike. Përgjatë gjithë strategjisë së re, transparenca përfaqëson një komponent kyç të vizionit për institucione dhe procese të hapura, duke qenë pjesë integrale e 5 shtyllave të ndërhyrjeve të parashikuara në draft-paketën strategjike. Edhe më konkretisht, në Shtyllën IV "Organizimi, përgjegjshmëria dhe mbikëqyrja e administratës publike", transparenca adresohet përmes një objektivi specifik për institucione transparente, me synim kryesor avancimin e standardeve të mirëqeverisjes dhe hapjen e institucioneve publike kundrejt qytetarëve.[48]

Me miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030,[49] si dokument i politikave shtetërore dhe piketa hapëse e grupkapitullit I "Themeloret", në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ngarkohen Departamenti i Administratës Publike dhe të gjitha institucionet që kanë në përgjegjësi për masat e përfshira në udhërrëfyes për zbatimin e tyre. Udhërrëfyesi parashikon disa masa që lidhen me legjislacionin dytësor për të drejtën e informimit dhe për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, si dhe forcimin e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe të institucioneve të administratës publike për transparencën dhe menaxhimin e hapur të të dhënave, përmes trajnimeve të certifikuara të ofruara nga ASPA, etj.

Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, parashikon nën fushën I të tij "Zhvillimin dhe koordinimin e politikave", angazhimin e vendit për të përmirësuar kuadrin ligjor për konsultimin publik, si dhe të marrë masa për zbatimin më efektiv të tij. 55% e çështjeve të

[47] Raportet gjenden në faqen: https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/204-raportet-e-monitorimit-te-strategjise.
[48] Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga kabineti i ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin më datë 18. 9.2024.
[49] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, *op.cit.*

identifikuara nën kuadrin strategjik dhe institucional adresojnë konsultimin publik dhe vlerësimin e ndikimit rregullator. Udhërrëfyesi ka caktuar si objektiva me prioritet në këtë fushë: përmirësimin e harmonizimit mes programimit ligjor dhe proceseve të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (VNR/RIA); rritjen e cilësisë së raporteve të konsultimit publik dhe të vlerësimit të ndikimit rregullator; plotësimin e strukturave përgjegjëse me staf të përgatitur dhe të mirëtrajnuar; përdorimin e vlerësimit të ndikimit rregullator *ex-post* për të siguruar që kuadri ligjor të monitorohet dhe përmirësohet vazhdimisht për një efektivitet sa më të lartë. Në Udhërrëfyesin e Reformës në Administratën Publike (PAR), si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për partneritetin e qeverisjes së hapur (OGP),[50] gjithashtu, janë përfshirë objektiva për përmirësimin e procesit të konsultimit publik gjë që tregon për rëndësinë që i bashkëngjitet këtij procesi. Përmirësimi i transparencës dhe përfshirjes edhe në proceset e hartimit të ligjeve është qasje për forcimin e transparencës në vend.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030 parashikon në Objektivin specifik 5.1: Forcimin e demokracisë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor. Strategjia parashikon një sërë masash që lidhen me ndryshime legjislative për saktësimin e kompetencave mes këshillave dhe administratës, plotësimin e kuadrit ligjor për konsultimin publik dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen vendore, si dhe miratimin e ligjit për referendumin për çështjet vendore. Gjithashtu, parashikohen masa që lidhen me e-qeverisjen, transparencën e vendimmarrjes, forcimin e kapaciteteve të qeverisjes vendore nëpërmjet fuqizimit të rolit të ASPA-s dhe institucioneve të tjera mbështetëse etj.[51]

Në kuadër të të dhënave të hapura, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 147/2015, dokumenti i politikës për të dhënat e hapura, si dhe është në funksion portali http://opendata.gov.al/. Ndërkohë, në muajin dhjetor 2024 u lançua "Transparent Albania", e cila pritet të funksionojë si një portë unike që do të mundësojë aksesin më të lehtë dhe më të shpejtë në një kategori të gjerë informacioni zyrtar dhe kontakti të drejtpërdrejtë me burimin e informacionit zyrtar, autoritetet publike. Në fokus të kësaj platforme do të jetë transparenca buxhetore, aksesi më i lehtë në programet e transparencës dhe do të ketë një dritare të dedikuar për pasqyrimin në mënyrë të përditësuar të të gjitha akteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, Kryeministri dhe ministrat.[52] Kjo nismë, i përgjigjet objektivave dhe rezultateve të pritshme të parashikuara në Agjendën Kombëtare të Reformave 2024 – 2027, ku transparenca është instrument horizontal i të pestë shtyllave të kësaj agjende, ndërsa nën shtyllën V. Shteti i së drejtës/themeloret, ka objektiva specifik në lidhje me rritjen e transparencës. Konkretisht, synohet rritja e transparencës, duke ngritur brenda muajit dhjetor 2024, një platformë të hapur të të dhënave për

[50] Partneriteti i Qeverisjes së Hapur, Shqipëri, Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025, mars 2023.
[51] *Ibid.*
[52] Platforma "Transparent Albania", u lançua gjatë eventit publik "Ndërtimi i Besimit: Rruga e Shqipërisë në BE Drejt Qeverisjes Transparente", më 13.12.2024, organizuar nga ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe projekti *EU for Good Governance*.

buxhetin dhe shpenzimet publike, qendrore dhe vendore, në partneritet me shoqërinë civile, dhe publikimin e të gjitha deklaratave të pasurisë në faqen e internetit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. [53]

Organet e pavarura, sikurse çdo autoritet tjetër publik, duhet të kenë programin e tyre institucional të transparencës, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe duhet të caktojnë koordinatorin e të drejtës për informim.[54] Kuvendi luan një rol kryesor në monitorimin e tyre, nëpërmjet raporteve vjetore periodike që dorëzojnë pranë tij, si dhe seancave dëgjimore.
Po ashtu, organet e vetëqeverisjes vendore duhet të garantojnë transparencën e veprimtarisë së tyre dhe në përputhje me ligjin duhet të bëjnë transparente vendimmarrjen e tyre, si dhe duhet të konsultojnë një kategori aktesh sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore''.[55] Në ligj përcaktohet se aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.[56]
Që prej vitit 2015, për të ndihmuar në rritjen e transparencës në njësitë e vetëqeverisjes vendore, është krijuar portali https://www.vendime.al/, i cili bën të mundur pasqyrimin e të gjitha vendimeve të këshillave bashkiak, portal ky që nuk është në administrim të institucioneve, por nismë kjo e Qendrës për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP me disa donatorë.[57] Portali mund të shërbejë si një model i mirë për institucionet në të ardhmen, me qëllim lehtësimin e aksesit në vendimet e këshillave.
Aktualisht janë në zbatim 28 plane integriteti në bashkitë e vendit.[58] Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka hartuar raportin vjetor të monitorimit për vitin 2023,[59] ku masat e zbatuara nga bashkitë janë të lidhura me parandalimin e korrupsionit dhe me transparencën dhe llogaridhënien. Për vitin 2024 Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore ka planifikuar asistencën teknike për 7 bashki të tjera për hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit, duke çuar në 35 numrin e bashkive të pajisura me këtë mekanizëm.

Sipas raportit vjetor të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023 rezulton se në të gjitha autoritetet publike është caktuar koordinatori për të

[53] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda kombëtare e reformave 2024–2027"", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor", f.140.
[54] Detyrime që rrjedhin nga nenet 4, 8, 10 të ligjit nr. 119/ 2014 "Për të drejtën për informim'', i ndryshuar.
[55] Nenet 15, 16, 17 18, ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore'', përcaktojnë rregullat se si garantohet transparenca.
[56] Neni 18 pika 3, ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore''.
[57] Për më shumë informacion vizito: https://www.vendime.al/rreth-nesh/
[58] Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, datë 18.9.2024.
[59] Raporti gjendet në faqen: https://qeverisjavendore.gov.al/decentralizimi/planet-e-integritetit/

DOKUMENT PARLAMENTAR

drejtën e informimit dhe të dhënat e tyre përditësohen edhe në portalin pyetshtetin.al, si dhe 305 autoritete publike kanë publikuar/përditësuar programin e transparencës dhe në 310 autoritete publike është funksional/përditësuar regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve.[60]

Në një vlerësim krahasues mes organeve të pushteteve të ndryshme, në raport me përmbushjen e detyrimeve për programet e transparencës, "Res Publica" ka evidentuar se: "Autoritetet kushtetuese dhe ato të pavarura vijojnë të paraqiten në një nivel më të mirë se kategoritë e tjera...Përmirësim të ndjeshëm kanë shënuar kategoritë e autoriteteve të vartësisë të pushtetit ekzekutiv dhe autoritetet e drejtësisë, ndërsa më pak përmirësim shënon kategoria e pushtetit vendor''.[61] Nga tryezën e konsultimit publik të organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të prezantimit të gjetjeve paraprake të këtij raporti me aktorët që veprojnë në fushën e transparencës dhe llogaridhënies, nga pjesëmarrësit u ndanë shembuj të institucioneve të cilët kanë mungesë transparence. Kjo kërkon që autoritetet publike të angazhohen për një respektim më të lartë të ligjit për të drejtën e informimit.[62]

Do të ishte me interes që Komisioneri apo organizatat e shoqërisë civile, të realizonin herë pas here monitorim të saktësisë së informacionit të publikuar në faqet zyrtare të institucioneve. Kjo do të shmangte ruajtjen në faqet zyrtare të dokumenteve dhe akteve që kanë humbur aktualitetin apo kanë pasaktësi dhe që potencialisht krijojnë konfuzion te qytetarët, si dhe do të siguronte se informacioni i bërë publik pa pagesë nuk gjendet në faqe thjesht formalisht. Në këtë kuadër, lind nevoja e një debati publik me qëllim përforcimin e informimit, në bashkëpunim me Komisionerin, për të përmirësuar programet e transparencës së institucioneve dhe rritur vizibilitetin e programeve të transparencës.

1.2.2 Konsultimi publik dhe Vlerësimi i Ndikimit Rregullator në Shqipëri në kuadër të procesit të integrimit

Performanca e Shqipërisë në fushën e konsultimit publik dhe koordinimit të politikave ka treguar përmirësim. Sipas raportit të fundit të monitorimi të SIGMA-s, numri i projektakteve të konsultuara dhe numri i projektligjeve të shoqëruara me RIA-n ka ardhur në rritje në krahasim me gjetjet e raportit të vitit 2021. [63]

Qeveria e Shqipërisë ka investuar në rritjen e kapaciteteve për konsultimin publik me miratimin e Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në vitin 2014. Procesi i konsultimit publik, në nivel të qeverisjes qendrore, rregullohet nga legjislacioni si më poshtë vijon:

1. Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik";

[60] Raporti vjetor, 2023, *op.cit*.
[61] E drejta e informimit 2023. Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit - Shumë zhurmë për asgjë?, *op.cit.*
[62] Tryezë publike me temë "Qeverisja e Hapur" e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë në datë 6.12.2024, në kuadër të veprimtarisë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".
[63] SIGMA *Monitoring Reports, Public Administration in Albania, 2024*, f. 30 dhe 33. Raporti gjendet në faqen: https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

2. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 828/2015 "Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të njoftimit dhe konsultimeve publike";
3. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 584/2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar;
4. Urdhër i sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, nr. 3/2021, "Mbi miratimin e udhëzimeve për procesin e konsultimit publik".

Vlerësimi i ndikimit rregullator ka ndikuar në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të hartimit të politikave/legjislacionit në vendin tonë, duke bërë të mundur që ndërhyrja e qeverisë të drejtohet aty ku është e nevojshme, si dhe të japë rezultate më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative. Përfshirja e objektivave për përmirësimin e procesit të e vlerësimit të ndikimit rregullator, në Udhërrëfyesin e Reformës në Administratën Publike (PAR) si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur (OGP), është tregues i rëndësisë së këtij procesi.

Konsultimi publik dhe i vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA/VNR) janë themelore për një politikëbërje gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në fakte. Të dy këto aspekte edhe pse raportohen se kanë njohur përparim, ende vlerësohen të pamjaftueshëm nga raportet e BE-së. Raporti *Screening* i BE-së për vendin tonë, 2023,[64] në lidhje me konsultimet evidenton se:

- Kuadri rregullator për konsultimin dhe pjesëmarrjen e publikut është pjesërisht i miratuar;
- Kërkesa për konsultim publik nuk zbatohet për aktet nënligjore dhe madje edhe për projektligjet, ligji aktual parashikon përjashtime relativisht të gjera;
- Përqindja e akteve ligjore që i nënshtrohen konsultimeve publike *online* mbetet shumë e ulët;
- Legjislacioni zbatues ende nuk i nënshtrohet konsultimeve publike;
- Kuadri rregullator dhe metodologjik për vlerësimin e ndikimit rregullator aktualisht mbulon vetëm legjislacionin parësor. Legjislacioni dytësor duhet të përfshihet gjithashtu.

Forcimi i pjesëmarrjes së publikut në procesin e politikëbërjes ishte pjesë e Strategjisë së Administratës Publike 2015-2020, e shtyrë deri në vitin 2022[65] ndërsa projektstrategjia 2023-2030 nuk është hedhur për konsultim publik, çka bën të pamundur kuptimin e qasjes ndaj konsultimit publik dhe vlerësimit të ndikimit rregullator në të.[66] Në kuadrin strukturor, Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri siguron edhe një monitorim cilësor të kryerjes së konsultimit publik nga institucionet e qeverisjes qendrore. Rezultatet e këtij monitorimi paraqiten në mbledhjen e nivelit të lartë të sekretarëve të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) përfshin periodikisht në planin vjetor të trajnimit, trajnime për konsultimin publik dhe vlerësimin e ndikimit rregullator. Madje, ASPA ka

[64] Raporti *Screening*, *op.cit*.
[65] http://dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/PAR_Strategy_2015-2020_English.pdf
[66] DAP ka njoftuar fillimin e punës për hartimin e kësaj projektstartegjie, por nuk ka një projekt për konsultim publik. Shih në: https://www.dap.gov.al/dap/evente/649-vijon-puna-per-hartimin-e-strategjise-se-re-snrap

hartuar një manual dhe kurrikul të dedikuar konsultimit publik edhe me mbështetjen e shoqërisë civile në vend, si dhe është në proces hartimi të një kurrikule për vlerësimin e ndikimit rregullator.[67] Gjithsesi, trajnimet për konsultimin publik duhet të vijojnë dhe duhet të shtrihen edhe tek aktorë të tjerë të shoqërisë. Kapacitetet e shoqërisë civile për konsultimin publik janë po aq të nevojshme të forcohen.

Në kuadër të punës koordinuese dhe monitoruese mbi këtë proces, Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA përgatit dhe publikon Raportin Vjetor të Performancës mbi Konsultimin Publik[68], duke paraqitur gjetjet kryesore për procesin dhe, gjithashtu, duke rritur transparencën në lidhje me performancën e çdo institucioni. Disa nga treguesit e marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së këtij raporti janë[69]:

Indeksi i frekuencës së konsultimit publik: ky indeks është rezultat i numrit të akteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, krahasuar me numrin e akteve të miratuara objekt i procesit të konsultimit publik.

a. Gjatë vitit 2022 janë miratuar në Këshillin e Ministrave 49 akte, nga të cilat 40 i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Indeksi i frekuencës për këtë vit është 81,6%.
b. Gjatë vitit 2023 janë miratuar në Këshillin e Ministrave 64 akte, nga të cilat 59 i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Indeksi i frekuencës për këtë vit është 92%.
c. Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024 janë miratuar në Këshillin e Ministrave 32 akte, nga të cilat 30 i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik. Indeksi i frekuencës për këtë periudhë është 93,7%.

Indeksi i respektimit të kohëzgjatjes së konsultimit publik (IPCDC): ky tregues paraqet të dhënat në lidhje me kohëzgjatjen minimale të konsultimeve publike për projektligjet dhe projekt-strategjitë, të parashikuara në ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik. Ai mat përqindjen e projektligjeve, projektdokumenteve strategjike dhe të politikave të konsultuara, për të cilat konsultimi publik ka zgjatur të paktën 20 ditë pune (afati ligjor). Kuadri ligjor parashikon një afat publikimi prej 20 ditësh për konsultimin elektronik, por ky afat respektohet vetëm për 60% të akteve dhe nuk është gjithmonë i përshtatshëm për nisma politikash komplekse.

a. Gjatë vitit 2022, 36 akte nga 40 të konsultuar gjithsej kanë respektuar afatin ligjor prej të paktën 20 ditë pune. Indeksi IPCDC për këtë vit është 90%.

[67] https://aspa.gov.al/en/events/konsultimi-publik/ si dhe https://idmalbania.org/sq/modul-trajnimi-konsultimi-publik/
[68] Lista e Raporteve (konsultimipublik.gov.al)
[69] Të dhënat e integruara për 3 vjet janë dërguar pranë grupit të ekspertëve nga Drejtoria e Ndikimit Rregullator, Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave më datë 27.9.2024.

b. Gjatë vitit 2023, 53 akte nga 59 të konsultuar gjithsej kanë respektuar afatin ligjor prej të paktën 20 ditë pune. Indeksi IPCDC për këtë vit është 90%.
c. Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2024, 27 akte nga 29 të konsultuar gjithsej kanë respektuar afatin ligjor prej të paktën 20 ditë pune. Indeksi IPCDC për këtë periudhë është 93%.

Indeksi IERNPC: ky tregues paraqet të dhëna lidhur me përdorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për kryerjen e konsultimeve publike mbi projektligjet dhe projektstrategjitë. Treguesi paraqet përqindjen e projektligjeve të konsultuara, projektdokumenteve strategjike dhe të politikave për të cilat janë kryer konsultimet publike, përmes Regjistrit Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJKP).

a. Në vitin 2022, 40 nga 42 akte të konsultuara janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Indeksi IERNPC është 95,2%.
b. Për vitin 2023, 58 nga 59 akte të konsultuara janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Indeksi IERNPC është 98%.
c. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, 29 nga 30 akte të konsultuara janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Indeksi IERNPC është 97%.

Indeksi i frekuencës së organizimit të takimeve publike (IPM): ky tregues paraqet të dhëna në lidhje me frekuencën e organizimit të takimeve publike si mjet për konsultimin e projektligjeve, projektdokumenteve strategjike dhe të projektdokumenteve politike.

a. Për vitin 2022, nga gjithsej 40 akte të konsultuara, për 35 akte janë organizuar takime publike. Indeksi IPM është 87,5 %.
b. Për vitin 2023, nga 59 akte të konsultuara gjithsej, për konsultimin e 48 prej tyre janë organizuar takime publike. Indeksi IPM është 81,35%.
c. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, nga 30 akte të konsultuara gjithsej, për konsultimin e 21 prej tyre janë organizuar takime publike. Indeksi IPM është 70%.

Digjitalizimi i procesit është një faktor që ndikon në trendin rënës të zhvillimit të takimeve, pasi aktorët e interesit marrin njoftime automatike për publikimet për konsultim. Megjithatë, rezulton se metodat e përzgjedhura kanë siguruar një proces cilësor dhe efektiv konsultimi publik për aktet e miratuara përgjatë vitit 2023 objekt i këtij procesi.

Treguesi IPARTICIP: mat numrin e pjesëmarrësve (aktorë të jashtëm joqeveritarë) që kanë kontribuar në konsultimet publike për projektligjet dhe projektstrategjitë me komentet dhe rekomandimet e tyre përmes metodave të ndryshme si: regjistri elektronik, takimet publike, komunikimi elektronik, grupe konsultative, grupet e menaxhimit të integruar të politikave etj.

DOKUMENT PARLAMENTAR

a. Për vitin 2022, ministritë raportuan 2313 pjesëmarrës në konsultime publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, ndërsa 477 prej tyre kontribuuan me komente dhe reagime.
b. Për vitin 2023, ministritë raportuan 2586 pjesëmarrës në konsultime publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, ndërsa 382 prej tyre kontribuuan me komente dhe reagime.
c. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, ministritë raportuan 945 pjesëmarrës në konsultime publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, ndërsa 108 prej tyre kontribuuan me komente dhe reagime.

Përgjatë vitit 2023 u shënua numri më i lartë i komenteve të mbledhura në procesin e konsultimit publik (848 komente nga të cilat janë pranuar 593) në krahasim me vitet e mëparshme (497 komente në 2022 nga të cilat janë pranuar 341). Duke konsideruar numrin e akteve të konsultuara që pritet të miratohen deri në fund të vitit 2024, trendi parashikohet konstant.

Gjatë vitit 2022 janë miratuar në Këshillin e Ministrave gjithsej 86 projektligje, prej të cilëve 23 i plotësonin kriteret për t'u shoqëruar me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit dhe për 19 prej tyre raporti RIA i konfirmuar ka qenë pjesë e dokumentacionit shoqërues të aktit. Gjatë vitit 2023 janë miratuar në Këshillin e Ministrave gjithsej 98 projektligje, prej të cilëve 35 i plotësonin kriteret për t'u shoqëruar me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit dhe për 30 prej tyre raporti RIA i konfirmuar ka qenë pjesë e dokumentacionit shoqërues të aktit.
Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, janë miratuar në Këshillin e Ministrave gjithsej 53 projektligje, prej të cilëve 28 i plotësonin kriteret për t'u shoqëruar me Raportin e Vlerësimit të Ndikimit dhe për 26 prej tyre raporti RIA-s i konfirmuar ka qenë pjesë e dokumentacionit shoqërues të aktit.

Krahas numrit të përgjithshëm të raporteve të përgatitura nga institucionet përgjegjëse, si dhe të shqyrtuara dhe/ose miratuara nga Njësia, një tregues tjetër i efikasitetit të realizimit të këtij procesi është edhe cilësia e raporteve të vlerësimit të ndikimit. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten pikët mesatare për raportet e konfirmuara gjatë këtyre tre vjetëve, sipas një vlerësimi të kryer mbi kriteret e përcaktuara në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian (EUD).



DOKUMENT PARLAMENTAR

1.3 Gjetjet dhe problematikat

Politikat dhe praktikat e transparencës

Raporti i 2024 i Komisionit Europian për Shqipërinë vë në pah se autoritet publike duhet të forcojnë transparencën me përgjegjësi më të lartë.[70] Ndërkohë, SIGMA në raportin më të fundit të monitorimit për Shqipërinë vë në dukje se publikimi i informacionit në mënyrë pro-aktive nuk është i qëndrueshëm dhe se perceptimi i publikut për transparencën e qeverisë është më i ulëti në rajon.[71] Gjithashtu, SIGMA evidenton se në pak se gjysmat e faqeve në internet të ministrive (39%) mund të gjendet informacion bazik si organigramat, pikat e kontaktit, funksionet, planet vjetore dhe raportet.[72]

Në lidhje me problemet që hasen në praktikë në zbatimin e ligjit për informimin, Zyra e Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe të Dhënat Personale nënvizon se[73]:

- Titullarët e autoriteteve nuk kanë dijeni ose nuk kujdesen për mbarëvajtjen e faqeve zyrtare dhe për rrjedhojë për publikimin e informacionit në Programin e Transparencës.
- Përditësohen me informacion ne kohë reale rrjetet sociale (*Twitter*, *Instagram*, *Facebook*/*Meta*), por jo programet e transparencës që janë detyrimi ligjor.
- Konstatohet rezistencë, si dhe padijeni/mungesë ndërgjegjësimi nga ana e administratës për të publikuar në mënyrë pro-aktive informacion me karakter publik, duke filluar nga jetëshkrimi i drejtuesve/këshilltarëve, legjislacioni i përditësuar, rregulloret, listën e kontratave të nënshkruara dhe deri tek informacioni mbi ofrimin e shërbimeve për qytetarët.
- Ligji "Për të drejtën e informimit" parashikon në nenin 7 të tij (programi i transparencës) minimumin e transparencës pro-aktive të autoritetit publik, duke i dhënë mundësi këtij të fundit që në varësi të specifikave të veprimtarisë së tij të publikojë, gjithashtu, çdo informacion tjetër që gjykon të dobishëm për qytetarët, në rubrikën e fundit të programit të transparencës. Ky parashikim i ligjit për të drejtën e informimit nuk rezulton të respektohet nga autoritetet publike.
- Në tërësi konstatohet mungesë ndërgjegjësimi në lidhje me kuadrin ligjor për të drejtën e informimit nga ana e zyrtarëve publik të çdo niveli, shoqëruar dhe me neglizhencë. Kjo reflektohet qartë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit administrativ, ku mbi 70% e ankesave (nga rreth 1000 të tilla në vit) zgjidhen dhe merret informacioni me fillimin e procesit, situatë, e cila prodhon kosto të panevojshme në lidhje më perceptimin publik për transparencën e autoritetit publik dhe në tërësi për zbatimin e së drejtës për informim.

[70] Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2024, *op.cit*., f. 27.
[71] SIGMA *Monitoring Reports*, *Public Administration in Albania,* 2024, f. 77. Raporti gjendet në faqen: https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf
[72] *Ibid*., f. 78.
[73] Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga zyra e Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe të Dhënat Personale, datë 22.10.2024. Informacioni mbështetet në fjalën e Komisionerit Z. Besnik Dervishi në Konferencën VI Kombëtare për të Drejtën e Informimit "Ndërtimi i besimit: Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit" dhe në raportin vjetor të institucionit për vitin 2023.

Gjithashtu, prodhon kosto dhe administrative/në kohë dhe në burime njerëzore, por më e rëndësishmja kosto edhe në procesin e integrimit në BE, ku transparenca dhe llogaridhënia e administratës publike është një nga kriteret bazë të anëtarësimit.

- Ende konstatohet ndryshim i shpeshtë i koordinatorit, caktimi i tij ose i saj në nivel ekzekutiv apo të ulët drejtues, si dhe kufizim aksesi në strukturat e tjera të AP-së. Rekomandimi i vazhdueshëm është fuqizimi i koordinatorit për të drejtën e informimit, si fytyra e autoritetit publik në raport me qytetarët, nëpërmjet aksesit të drejtpërdrejtë me titullarin, si dhe për aq sa mund të jetë e mundur krijimi i një pozicioni/strukture të dedikuar për këtë funksion.
- Gjatë trajtimit të ankesave nga ana e koordinatorëve është ngritur si shqetësim, si dhe konstatohen vonesa që shkaktohen nga ana e drejtuesve të lartë apo strukturave të caktuara, në verifikimin e përgjigjes përfundimtare, e cila sjell shkelje të afateve të përcaktuara në ligjin "Për të drejtën e informimit" për aksesin e informacionit, me kosto të drejtpërdrejtë kjo për transparencën e autoritetit publik dhe vet titullarit të institucionit.
- Vazhdon të ketë paqartësi nga ana e autoriteteve publike lidhur me konceptin e konfidencialitetit në kontratat publike, i trajtuar jo në përputhje me parashikimet e nenit nr. 17 të ligjit (kufizimet). Në kontratat publike parashikohen dispozita konfidencialiteti për informacionin/dokumentacionin që lidhet me to dhe në rast të moszbatimit të tyre, parashikohen sanksione ndaj autoriteteve publike. Për të shmangur këtë problematikë, është e nevojshme që në klauzolat e konfidencialitetit të specifikohet baza ligjore mbi të cilën bazohet autorizimi për përdorimin e këtij kufizimi, si dhe të qartësohen se mbi cilën pjesë të informacionit shtrihen ato, duke pasur parasysh që nuk mund të mbizotërojë mbi parashikimet e ligjit për të drejtën për informim, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligjin specifik.
- Autoritetet publike refuzojnë të vendosin në dispozicion informacionin e kërkuar, duke pretenduar për dëme, të cilat mund t'i shkaktohen shtetit shqiptar nga palë të treta (procese që mund të atakohen në gjykatë/arbitrazh), pa referuar bazën ligjore mbi të cilën ngrihet ky pretendim, si dhe pa bërë testin e domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe interesit publik gjatë kufizimit të informacionit. Pa diskutim që ky është një proces, i cili kërkon një vëmendje të shtuar dhe ekspertizë më të thelluar nga ana e autoriteteve publike, por në çdo rast nuk përben shkak ligjor që të kufizohet një e drejtë kushtetuese për këtë mungesë njohurish nga ana e zyrtarëve.
- Vijon të këtë raste të keqpërdorimit të së drejtës së autorit të subjekteve, të cilët marrin pjesë në një procedurë administrative. Raste, të cilat nuk trajtohen në përputhje me parashikimet e nenit 17 të ligjit për informimin apo legjislacionit specifik që rregullon të drejtën e autorit.
- Shpeshherë delegohen kërkesat për informacion nga njëri autoritet publik tek tjetri, edhe pse informacioni i kërkuar disponohet nga vetë autoriteti që e ka deleguar atë.
- Konstatohet një mosrakordim midis strukturave të autoriteteve publike për përcjelljen në zyrën e medias, të kërkesave të gazetarëve që lidhen me pyetje, intervista apo prononcime

në media të titullarëve. Vetë autoritetet publike duhet të marrin masa organizative për të trajtuar në mënyrë të diferencuar kërkesat për intervista, prononcime apo pyetjet nga gazetarët duke mos ia kaluar për trajtim këto koordinatorit për të drejtën e informimit, pasi nuk kemi të bëjmë më informacion publik në kuptim të ligjit "Për të drejtën e informimit", por me informacion që ka interes për publikun dhe duhet të trajtohet jo sipas rregullimeve në ligjin "Për të drejtën e informimit".

- Autoritetet publike nuk zbatojnë legjislacionet e posaçme, të cilat rregullojnë një fushë të caktuar si, për shembull, ligji për avokatinë, ligji për kadastrën etj., duke sjellë një ngarkesë të panevojshme për Zyrën e Komisionerit.
- Vështirësi në realizimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nga ana e këshillave bashkiak, i cili duhet të koordinohet me administratën e bashkisë dhe duhet të publikohet në faqen zyrtare të saj.

Në tryezën publike mbi Qeverisjen e Hapur, të organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm, pjesëmarrësit vunë në pah disa probleme dhe nevoja në lidhje me transparencën e administratës publike përmbledhur si vijon:

- Nevojitet ndërlidhja e transparencës me ciklin e politikave, identifikimin, formulimin, zbatimin dhe rishikimin, me qëllim që të gjitha fazat e procesit të politikëbërjes të trajtohen nën optikën e transparencës.
- Mungojnë raportet për gjurmimin e ekzekutimit të politikave në vite. Hartimi dhe publikimi i tyre është i nevojshëm të pasqyrohet në programet e transparencës.
- Është e nevojshme që instrumentet e rëndësishme për transparencën si faqet *web*, si dhe programet si ato të transparencës të mbështeten periodikisht për të qenë funksionale, të sakta dhe të përditësuara në kohë.
- Mungon një faqe e vetme interneti për komunikimin e programeve të mbështetura nga BE-ja e përfshirë nën koordinatorin e programeve IPA.
- Bashkitë kanë nevojë të mbështeten për transparencën, në teknologjinë e informacionit, si dhe është e domosdoshme ndërgjegjësimi i drejtuesve.
- Evidentohen probleme në zbatimin e ligjit "Për të drejtën për informim" dhe transparencën e ndërmarrjeve shtetërore, si dhe ka probleme me transparencën e regjistrave publik në vend.
- Faqet e internetit të institucioneve duhen plotësuar me informacion historik dhe të përditësuar, ligjor, institucional dhe financiar, si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në atë angleze.
- Në çdo rast që ka mbështetje nga partnerë, donatorë apo mbështetës të ndryshëm për sistemet e transparencës, ato duhet të jenë në bashkëpunim me institucionet kompetente, si për shembull, AKSHI, dhe të respektojnë kërkesat e kuadrit ligjor vendas.
- Informimi në lidhje me procese me rëndësi parësore, si për shembull, integrimi në BE, i qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve është ende jo i mjaftueshëm. Kjo qasje është me rëndësi, duke marrë në konsideratë se të gjithë këtyre grupeve do t'u lindin të drejta dhe detyrime në kuadrin e të qenit shtet anëtar i BE-së. Mjetet që përdoren aktualisht si këndet

DOKUMENT PARLAMENTAR

e BE-së në bashki, shtëpia e biznesit, programet e transparencës, kanë nevojë të vlerësohen nëse janë të mjaftueshme në kuadër të informimit për integrimin në BE.

- Informimi për veprimtarinë në sektorë të veçantë si për shembull prokurimi publik, pronat, kthim-kompensimi, shpronësimi, tatime, dogana, avokatia e shtetit, mbrojtja e konsumatorit, siguria ushqimore, shërbimi përmbarues, etj., duhet të përforcohet.

Ligji për informimin i njeh të drejtën e organeve për të kufizuar dhënien e informacionit sipas rregullimeve të nenit 17[74] , por paralelisht parashikohet se informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Në këtë drejtim, në raportin më të fundit të Komisionit Europian për Shtetin e së Drejtës, vihet në dukje se mungesa e një përkufizimi të qartë mbi 'interesin publik' i jep institucioneve publike diskrecion të konsiderueshëm për të kufizuar ose mohuar qasjen në informacion.[75] Një tjetër rast i kufizimit të informacionit është mbrojtja e të dhënave personale dhe në dhjetor 2024 u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë ligji nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale''. Ky ligj, i cili pritet të hyjë në fuqi në 2025 sjell risi në përkufizimin e të dhënave personale dhe do të nevojitet një interpretim i kujdesshëm nga Komisioneri midis të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Nga ana tjetër, do të nevojitet një informim i gjerë koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe punonjësve të administratës në tërësi mbi ligjin e ri "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Edhe para miratimit të ligjit të ri, kjo ka qenë një çështje me rëndësi për Komisionerin. Aktualisht, në Strategjinë Institucionale 2022 – 2025 të Komisionerit, nën objektivin 2. "Komunikimi pro-aktiv për konsolidimin e kulturës së transparencës të autoriteteve publike" është parashikuar si aktivitet: orientimi i autoriteteve publike në qartësimin e çështjeve me interes publik dhe rasteve të kufizimit të dhënies së informacionit, sidomos, përdorimin e konceptit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së te dhënave personale.[76]

Në lidhje me forcimin e kapaciteteve të organeve të pavarura dhe rolit të tyre, raporti i vitit 2024 i Komisionit Evropian për Shqipërinë thekson se përqindja e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të zbatuara mbetet e ulët, se ka nevojë për më shumë nisma për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe, gjithashtu, evidenton nevojën për forcimin e kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit.[77] Në lidhje me forcimin dhe mbështetjen nga Kuvendi për Zyrën e Komisionerit, Qendra "Res Publica" vë në pah se burimet njerëzore dhe financiare të Komisionerit janë të kufizuara, kjo raportohet nga Zyra e Komisionerit si një nga justifikimet e pamundësisë së trajtimit të çdo ankese në kohën e parashikuar nga ligji apo të hetimit administrativ për shkelje të tjera të ligjit.[78] Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim thekson sigurimin e burimeve financiare dhe

[74] Neni 17, pika 1 dhe 2 parashikojnë rastet se kur e drejta e informimit mund të refuzohet.
[75] *Rule of Law Report, country chapter on the rule of law situation in Albania*, 2024, f. 18, *op.cit.*
[76] Strategjia gjendet në faqen: https://idp.al/wpcontent/uploads/2024/02/Strategjia_Institucionale_2022_2025_final.pdf
[77] Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2024, f. 27, 34, 35.
[78] E drejta e informimit 2023. Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit - Shumë zhurmë për asgjë? Res Publica, 2024, f. 30. Raporti gjendet në faqen: https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2024/04/E-drejta-e-informimit-2023_Web.pdf

njerëzore të nevojshme për Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave për monitorimin e proceseve të konsultimit.[79]
Në lidhje me raportimin vjetor të Komisionerit në Kuvend, "Res Publica" rekomandon se organizatat të ftohen të marrin pjesë në seancat dëgjimore të prezantimit dhe vlerësimit të punës së Komisionerit për të Drejtën e informimit. Këto organizata duhet të ftohen të japin vlerësime me shkrim lidhur me aktivitetin e Komisionerit.[80]

Lidhur me zbatimin e ligjit "Për të drejtën e informimit", Komiteti Shqiptar i Helsinkit në raportin krahasimor për situatën e të drejtave të njeriut për vitin 2022- 2023 vlerëson se situata e zbatimit të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" vijon të jetë problematike në vendin tonë, duke reflektuar një qasje në tërësi jo transparente të institucioneve publike.[81] Gjithashtu, në këtë raport nënvizohet se: *"*Bazuar në praktikën e KShH-së, vërehet se vonesat prej më shumë se një viti që krijohen si rrjedhojë e kundërshtimeve prej institucioneve, në gjykatë, të vendimmarrjeve pozitive të Komisionerit në favor të së drejtës për informimit dëmtojnë thelbin e të drejtës së informimit në afate të arsyeshme, duke dobësuar aktualitetin e informacionit të kërkuar. KShH-ja thekson nevojën për prioritizimin e shqyrtimit gjyqësor të këtyre ankimeve në afate të arsyeshme, nga sistemi ynë gjyqësor''. [82] Një tjetër çështje e evidentuar si mangësi në zbatimin e ligjit është qëndrueshmëria e koordinatorëve për të drejtën për informim, për të cilën Qendra "Res Publica" rekomandon se në rolin e koordinatorit është e domosdoshme të caktohet një zyrtar i pozicionit të lartë të hierarkisë së autoritetit publik, pasi praktika ka treguar se caktimi i koordinatorëve deri më sot, në një masë të madhe, është bërë thjesht formalisht, duke e bërë rolin e tyre jo eficient.[83]

Për sa i përket transparencës në qeverisjen vendore, raporti i 2024 i Komisionit Evropian për Shqipërinë vlerëson se eficienca, transparenca dhe llogaridhënia mbi menaxhimin e burimeve njerëzore duhet të rritet.[84] Nga Indeksi i Transparencës të Komisionerit për 61 njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2023 rezulton se: 21 njësi të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë pro-aktive të lartë, 43 institucione të njësive të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë pro-aktive mesatare; 6 njësi të vetëqeverisjes vendore janë renditur me

[79] Një dekadë nga ligji për konsultimin publik në Shqipëri. Thirrje për reformë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2023 f. 47.
[80] Qendra "Res Publica", E drejta e informimit. A po synohet të ngrihet një shkallë më lart?, raport për vitin 2022, publikuar në 2023, f. 43. Raporti gjendet në faqen: https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2023/09/E-drejta-e-informimit-2022-Res-Publica-NED.pdf
[81] Raport krahasimor mbi situatën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri për vitet 2022- 2023, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, dhjetor 2023, f. 34. Raporti gjendet në faqen: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/12/Raporti-i-te-Drejtave-te-Njeriut_-Versioni-Shqip.pdf
[82] *Ibid.*
[83] E drejta e informimit 2023. Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit - Shumë zhurmë për asgjë? Res Publica, *op.cit.*, f.31.
[84] Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, *2024*, *op.cit.*, f.24.

transparencë pro-aktive të ulët; vetëm 3 njësi të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë pro-aktive shumë të ulët.[85]

Në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030 vlerësohet: *"*Edhe pse ligjet...janë në fuqi prej më shumë se 5 vjetësh, është e vështirë të gjesh këshilla bashkiakë që veprojnë në përputhje të plotë me këto ligje... Implementimi i parimeve të Mirëqeverisjes mbetet një sfidë për strategjinë e re... Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje nga ana e këshillit në përgjithësi apo dhe vetë administratës vendore është sporadike, jo e vazhdueshme, jo e programuar dhe aq me pak e buxhetuar për aktivitetet specifike që kanë lidhje me vendimmarrjen në këshill...".*[86]*

Nga analiza e raporteve të shoqërisë civile bie në sy se për organet e qeverisjes vendore dhe organet e pavarura ka më pak studime dhe monitorime dhe kjo vështirëson panoramën e përgjithshme dhe krahasimin e të dhënave me raportet e vetë institucioneve. Sipas Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) të dhënat e analizuara nga planet e integritetit evidentojnë për një pjesë të bashkive sfida në drejtim të ngritjes të mekanizmave të duhur dhe zbatimit të masave specifike për rritjen e transparencës së organeve të vetëqeverisjes vendore, veçanërisht në drejtim të plotësimit të të gjitha rubrikave dhe përditësimit të programit të transparencës, caktimit apo emërimit të koordinatorit për të drejtën e informimit, hartimit të raporteve vjetore të transparencës, publikimit të projektakteve në regjistrin e njoftimeve publike në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 146/2014, "Për konsultimin publik."[87]

Transparenca, pjesëmarrja dhe llogaridhënia, si parimet kryesore të qeverisjes së hapur, kërkojnë risi nga autoritetet lokale dhe rajonale në ndërveprimin e tyre me qytetarët dhe mënyrën se si ata i menaxhojnë administratat e tyre.[88]

Pavarësisht politikave të transparencës të ndërmarra në nivel qendror apo vendor, në sondazhin e opinionit publik për besimin në qeverisje të Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim për vitin 2023[89], pjesa më e madhe e të anketuarve, që përbën 59%, u shprehën se nuk ishin dakord ose aspak dakord me pohimin se qeveria qendrore funksionon në mënyrë transparente. Sipas të njëjtit sondazh, e njëjta ndjesi u vu re kur të anketuarit u pyetën për perceptimin e tyre për qeverisjen e tyre vendore. Vetëm 33,6% e të anketuarve kanë deklaruar se e konsiderojnë qeverinë qendrore të përgjegjshme dhe një përqindje pak më e lartë 36,4%, thonë se bashkia e tyre është e përgjegjshme (jep llogari). Rreth 60% ose nuk ishin dakord ose aspak dakord me pohimin se bashkia është transparente. Kjo nënkupton se masat që ndërmerren nuk arrijnë te qytetarët ose ka skepticizëm

[85] Raport monitorimi. Transparenca proaktive e njësive të vetëqeverisjes vendore, 2023, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, f. 17.

[86] Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030, Ministria e Brendshme, 2022, f.57.

[87] Dokument politikash. Sfidat që pengojnë promovimin e kulturës me integritet në qeverisjen vendore. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2022, f. 6.

[88] Rezoluta 435 (2018)2, Mbi transparencën dhe qeverisjen e hapur, Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale, Këshilli i Europës.

[89] Besimi në qeverisje. Sondazhi i opinionit publik 2023, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), f. 34 – 35.

DOKUMENT PARLAMENTAR

dhe mungesë besimi tek institucionet. Edhe në sondazhet e SIGMA-s 2024 për Ballkanin Perëndimor, rezulton se në Shqipëri vetëm 31% e qytetarëve dhe 46% e bizneseve pranojnë se qeveria publikon informacion mbi vendimet e saj, përqindja më e ulët në rajon për publikun e gjerë dhe nën mesataren e rajonit për bizneset.[90]

Garancitë ligjore dhe metodat e përdorura nga institucionet për transparencën e veprimtarisë së tyre, do të duhen të ecin paralelisht me pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve lidhet ngushtë me realizimin efektiv të konsultimeve publike dhe me krijimin e një mjedisi që mbështet zhvillimin e shoqërisë civile. Kur ky proces anashkalohet, jo vetëm që ndikon negativisht në cilësinë e politikave dhe ligjeve, por edhe në besimin e publikut. Konsultimi i qenësishëm duhet të përfshijë të gjithë aktorët relevantë dhe që preken nga vendimmarrja, jo vetëm ata që janë të angazhuar dhe bashkëpunojnë në mënyrë rutinore me institucionin.[91]
Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJKP) është sistemi bazë ku grupet e interesit dhe shoqëria civile mund të përfshihen në vendimmarrja dhe të përcjellin zërin e tyre. Sipas Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, palët e interesuara e shohin RENJKP-në si një mjet jomiqësor për arsye të ndryshme, duke përfshirë vështirësinë e përdorimit të ndërfaqes së platformës, kërkesën për regjistrim përmes e-Albania, opsionet e kufizuara të komenteve dhe probleme të aksesueshmërisë për përdoruesit me aftësi të kufizuara.[92] Nga ana tjetër, nevojitet që mekanizmat e brendshëm të ankesave për konsultimet publike të jenë më efektive, pasi institucionet nuk kanë krijuar sisteme të brendshme për menaxhimin e ankesave të qytetarëve, si dhe ka mungesë të qartësisë në lidhje me llogaridhënien për shkeljet.[93]

Grupet e margjinalizuara dhe personat me aftësi të kufizuar duhet të marrin një vëmendje të veçantë në politikat e transparencës. Informacionet në faqet zyrtare në internet duhet të përshtaten edhe me forma më të thjeshta të komunikimit dhe do të duhet të përshtaten për personat me aftësi të kufizuar në formate digjitale të aksesueshme lehtësisht apo *Braille,* audio etj. Shqipëria ka një Plan Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021- 2025, i cili ka një objektiv specifik 1.3 *Realizimi i aksesueshmërisë në informacion dhe komunikim për personat me aftësi të kufizuara.*[94] Raporti i monitorimit SIGMA 2024 vlerëson: "Ky dokument përmban një analizë për aksesueshmërinë fizike dhe aksesin në informacion, por i mungon një plan i duhur veprimi. Plani përmban listën e institucioneve të përfshira, por nuk ka përcaktuar përgjegjësi specifike, me përjashtim të përgjegjësisë të përgjithshme për zbatimin e planit të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".[95]

[90] SIGMA *Monitoring Reports, Public Administration in Albania,* 2024, f. 78, *op.cit.*
[91] Një dekadë nga ligji për konsultimin publik në Shqipëri. Thirrje për reformë, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, *op.cit*., f. 7.
[92] *Ibid.*
[93] *Ibid*., f. 9.
[94] Dokumenti i plotë gjendet në faqen: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/11/Plani20Komb%C3%ABtar20p%C3%ABr20Personat20me20Aft%C3%ABsi20t%C3%AB20Kufizuara202021-2025-4.pdf
[95] SIGMA *Monitoring Reports, Public Administration in Albania,* 2024, f.102, *op.cit.*

Të rinjtë janë një tjetër kategori që duhet të marrin një vëmendje të veçantë në përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe për të përçuar zërin pranë organeve publike. Vitet e fundit në Shqipëri janë ndërtuar struktura të rëndësishme për të rinjtë, duke përfshirë Agjencinë Kombëtare të Rinisë, Këshillin Rinor Kombëtar dhe Kongresin Rinor Kombëtar, struktura të angazhuara në mënyrë aktive në fuqizimin e të rinjve në Shqipëri.[96] Prania e strukturave rinore në nivel lokal ka arritur nivelin e saj më të lartë në Shqipëri dhe aktualisht 74% e bashkive kanë themeluar me sukses këshillat rinore dhe po bëhen përpjekje për të krijuar organe të ngjashme në qytetet e mbetura.[97] Gjithsesi, mungon një vlerësim se sa merren në konsideratë opinionet e të rinjve në hartimin e politikave, që i prekin ata në nivel vendor dhe qendror.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe vendimmarrje duhet të jetë konstante, jo vetëm si zë i paanshëm në procese të ndryshme, por edhe sepse përcjellin pranë organeve publike zërin e anëtarësisë së tyre ose të qytetarëve me të cilët janë shpesh në kontakt gjatë zbatimit të projekteve. Perceptimi i opinionit publik se organizatat e shoqërisë civile kanë ndikim në politikat qeveritare mbetet i ulët; vetëm 5% e të anketuarve në një sondazh në vitin 2023 mendojnë se organizatat e shoqërisë civile kanë ndikim.[98]

Konsultimi i akteve

Në raportin e vitit 2024 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, në lidhje me konsultimin e akteve vlerësohet se përqindja e akteve që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik duhet të rritet, bazuar në një interpretim më gjithëpërfshirës të kritereve të ligjit për konsultimin publik, dhe se duhen më shumë nisma për të inkurajuar grupet e interesit, në veçanti shoqërinë civile për të marrë pjesë në këto procese.[99] Gjithashtu, nënvizohet se cilësia e RIA-ve duhet të rritet.[100]

Më herët, një studim rajonal i kryer në vitin 2018 nga ReSPA, ka treguar se ka mangësi edhe në legjislacionin e konsultimit publik. ReSPA konstaton se nevojitet një planifikim i kujdesshëm i konsultimeve[101] dhe i metodave të konsultimit, të cilat duhet të vihen në dispozicion të publikut brenda një kohe të caktuar. Afati i përcaktuar për konsultimet publike (më pak se 20 ditë pune), nuk përmbush standardet minimale të parashikuara në rekomandimet e ReSPA.[102]

SIGMA nënvizon se vetëm 47% e raporteve për zbatimin e strategjive janë publikuar.[103] Agjendat, mbledhjet e qeverisë nuk publikohen apo edhe informacione për ciklin e plotë të politikave, kryesisht raportet e monitorimit, nuk publikohen.[104] Raporte të shoqërisë civile pasqyrojnë një

[96] Raporti i Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022, f. 11.
[97] *Ibid.*
[98] *National survey of Albania*, Center for Insights in Survey Research, 2023, f. 12.
[99] Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2024, *op.cit* , f. 26.
[100] *Ibid*., f. 25.
[101] Kasementet. L, Koordinimi i politikave në Ballkanin Perëndimor, 2021, ReSPA, f. 34.
[102] ReSPA 2018, Rekomandim për pjesëmarrjen e publikut në procesin e politikëbërjes për Ballkanin Perëndimor, faqe 5.
[103] SIGMA *Monitoring Reports, Public Administration in Albania, 2024*, f. 23, *op.cit.*
[104] *Ibid*., f. 24.

angazhim të ulët qytetar. Sipas raportit të vlerësimit të IDM-së, në vitin 2023, përqindja e shqiptarëve të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrje ka qëndruar pothuajse e njëjtë (43,2%) në krahasim me vitin 2022 (45,3%). Vetëm 14,4% e të anketuarve nga kjo organizatë e kishin përdorur regjistrin elektronik të konsultimit publik për të marrë informacione apo për të dhënë mendime për projektligje apo strategji gjatë këtij viti, shifër që në vitin 2022 ishte 18,1%. Është shqetësuese që 30,3% e të intervistuarve nga IDM-ja theksojnë se arsyeja e këtij angazhimi të ulët qytetar është mosbesimi në procesin e konsultimit publik.[105] Po ashtu, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), në një Dokument Politikash "Procesi i konsultimit në Shqipëri në kuadër të integrimit europian – roli i shoqërisë civile", vë në pah se ka nevojë të merren masa me qëllim që procesi i konsultimit publik të mos jetë formal dhe të rritet koordinim i dhe bashkëpunimi me institucionet shtetërore për shpërndarjen e informacionit dhe rezultateve të këtij procesi.[106]

Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson se: "...zbatimi i ligjit "Për njoftimin dhe konsultim publik" pasqyron problematika dhe se ka raste të akteve në të cilat mungojnë parashikimet e seksionit të posaçëm për komente në platformë. Procesi i konsultimit vlerësohet si formal. Regjistri elektronik i konsultimit publik krijon shpesh herë vështirësi për t'u aksesuar e përdorur... Vihet re mungesë e reagimeve nga institucionet propozuese për komentet/sugjerimet të përcjella gjatë konsultimit publik...ekzekutivi duhet të zbatojë dëgjesa me grupet e interesit dhe publikun që në fazën fillestare të vlerësimit të nevojës së hartimit të një akti normativ". [107]

Institucionet publike ende nuk i publikojnë të gjitha projektaktet në regjistrin elektronik për njoftim dhe konsultim publik.[108]Aksesi për konsultim në faqet e internetit/kanalet e organeve publike është ende jo i plotë.[109] Qeveria dhe Parlamenti u vlerësua në Raportin *Freedom House* 2024 se kanë dështuar të hyjnë në një dialog konstruktiv me shoqërinë civile, duke treguar se kërkesat për përfshirjen e OJF-ve dhe fuqizimi i konsultimit publik mbetet një premtim.[110]
Institucionet e konsiderojnë këtë proces thjesht si formalist dhe jo të bazuar në përmbajtje. Dëshmitë se si të dhënat nga palët e interesuara merren parasysh në procesin e konsultimit janë të kufizuara.[111] Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në raportin e vitit 2020, vlerëson se nga 129 ligje të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë, vetëm 60 janë hedhur për konsultim publik.[112] Në nivel lokal, BE-ja vlerëson se konsultimi me publikun dhe llogaridhënia në organet e qeverisjes vendore mbetet e limituar.[113]

[105] Shih në: https://idmalbania.org/trust-in-governance-2023-annual-public-opinion-poll-in-albania/
[106] Dokumenti gjendet në faqen: https://em-al.org/sq/dokument-politikash-procesi-i-konsultimit-ne-shqiperi-ne-kuader-te-integrimit-europian-roli-i-shoqerise-civile-qershor-2022/
[107] Komente të paraqitura me shkrim nga Komiteti Shqiptari i Helsinkit pranë grupit të ekspertëve, dhjetor 2024.
[108] https://www.konsultimipublik.gov.al/
[109]Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Raporti Vjetor 2020. Në dispozicion në:http://partnersalbania.org/publication/annual-report-2020/& National Endowment for Democracy, 2017, komenti i ligjit nr. 146/2014 *"Për njoftimin dhe konsultimin publik".*
[110] https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2024
[111]Po aty, faqe 13 & Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, *Raporti Vjetor 2020.* E disponueshme në:http://partnersalbania.org/publication/annual-report-2020/
[112] *Ibid.*
[113] Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2024, *op.cit.*, f. 24.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Nga ana tjetër, zbatimi i procesit të vlerësimit të ndikimit (RIA) në Shqipëri është i rregulluar në nivelin e një vendimi të Këshillit të Ministrave dhe jo të një ligji në vend. Ndërsa procesi është me rëndësi parësore për ligjbërjen, mund të vlerësohet ngritja në nivel ligjor e rregullimit të vlerësimit të ndikimit rregullator. Udhëzuesi për Konsultimin Publik u drejtohet vetëm institucioneve të përzgjedhura të administratës shtetërore. Këto institucione të administratës shtetërore përfshijnë vetëm qendrën e qeverisjes dhe jo institucionet e tjera, që mund të përfshihen në proceset e politikëbërjes.

Platforma e konsultimit publik është një kanal i centralizuar, ku palët e interesuara mund të kenë akses në draft aktet dhe të paraqesin komentet e tyre. Kjo platformë ende nuk njihet dhe përdoret gjerësisht. Gjithashtu, dokumentet e dorëzuara për të sqaruar procesin e konsultimit publik deri vonë nuk kanë pasur informacion të qartë. Përveç kësaj, zakonisht vendoset vetëm një afat kohor i kufizuar për dorëzimin e komenteve ose informacioneve që nuk ushqehen me komente cilësore. Për më tepër, ka raste të ligjeve që nuk vendosen në platformë për konsultim.[114] Platforma nuk është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar, gjë që tregon se nuk është përqafuar një qasje pro-aktive dhe jodiskriminuese për përfshirjen në procesin e konsultimit publik të grupeve të nën përfaqësuara nëpërmjet njoftimeve paraprake dhe konsultimeve të synuara për t'u dhënë zë këtyre grupeve. Konsultimi publik nevojitet të digjitalizohet më tej. Aktorët e shoqërisë civile vlerësojnë se mungojnë platformat e-legislation apo e-konsultim ku të jetë pasqyruar edhe procesi i ndjekjes (*tracking*) dhe mënyra se si është zhvilluar konsultimi publik.[115]

Në lidhje me detyrimin për të shoqëruar projektaktet që dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave me një raport (RIA), përcaktohet në pikën 45 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar. Ky vendim përcakton, gjithashtu, edhe disa kritere përjashtimore, jokumulative, plotësimi i të cilave përjashton projektaktin nga ky proces. Në pikën 45/1 të VKM-së përcaktohet se përjashtohen nga detyrimi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit projektaktet që kanë të bëjnë me një nga kategoritë e mëposhtme:

a. projektakte që trajtojnë çështje, të cilat lidhen me informacionin e klasifikuar shtetëror, çështje të sigurisë kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë;
b. projektakte që lidhen me situata emergjente, fatkeqësi natyrore apo gjendje të krizës;
c. projektakte që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomatike, veçanërisht ratifikime të marrëveshjeve ndërkombëtare apo çështje që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare;

[114] Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim përmend ligjin për regjistrin qendror të llogarive bankare, ligjin për pronarët përfitues etj. Shih: Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Raporti Vjetor 2020, faqe 12 & Komisioni Evropian. Raporti i Shqipërisë 2020, f. 13.

[115] Tryezë publike me temë "Qeverisja e Hapur" e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë në datë 6.12.2024, në kuadër të veprimtarisë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".

d. projektakte që lidhen me menaxhimin buxhetor, projektligji për buxhetin vjetor dhe aktet nënligjore që dalin në zbatim të tij, projektaktet që lidhen me programimin buxhetor afatmesëm, projektaktet që prekin tatimet dhe tarifat doganore;
e. projektakte që prekin legjislacionin penal;
f. projektakte që kanë efekt zbatimi të përkohshëm dhe kalimtar.

Siç vihet re, kuadri rregullator për RIA-n është i kufizuar. Në drejtim të objektivave të Udhërrëfyesit për RIA-n, sipas vlerësimit më të fundit të SIGMA thuhet: "...parashikimet e Udhërrëfyesit për Administratën Publike 2022 -2030 nuk përcaktojnë përgjegjësitë institucionale për zbatimin e masave dhe niveli i përgjithshëm i ambicies mbetet i ulët. Për shembull, kërkesa për të kryer RIA-t në legjislacionin sekondar, i cili tashmë ekziston në mënyrë efektive sipas Rregullores të Këshillit të Ministrave që nga viti 2020, është planifikuar për zbatim, duke filluar nga viti 2030''.[116]
Shqipëria renditet e treta në rajon me 61% të projektligjeve të shoqëruara me RIA përgjatë vitit 2023.[117] Ndërkohë, qeveria ka miratuar një Metodologji të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, e cila përcakton mënyrën sesi duhet të hartohen Raportet e Vlerësimit të Ndikimit në vend,[118] procese këto që janë shumë kërkuese në drejtim të kapaciteteve. Më së pari, ato kërkojnë kapacitete të mirëformuara për identifikimin e problemit, analizës së tij, objektivave, qasjeve politike, ndikimit buxhetor, social, mjedisor, apo edhe në fushën e biznesit. Të gjitha këto kërkojnë të dhëna, statistika, studime dhe analiza të vijueshme në sektorë të ndryshëm të veprimtarisë në vend. Vihet re se mungojnë marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e studimeve të nevojshme për RIA-n me akademinë apo shoqërinë civile, të cilët mund të ndihmonin në përgatitjen cilësore të RIA-ve.

1.4 Konkluzione dhe rekomandime

- Parashikimet kushtetuese, ligji "Për të drejtën e informimit" dhe ndryshimet e tij në vitin 2023 vlerësohen pozitivisht, si dhe në tërësi, si në përputhje me standardet evropiane.
- Ligj nr. 45/2022, datë 28.4.2022 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare"" dhe miratimi i ligjit nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të transparencës në administratën publike.
- Ndryshimet në ligjin "Për të drejtën e informimit" në vitin 2023 janë vlerësuar pozitivisht dhe kanë qartësuar kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si dhe e kanë fuqizuar atë në raport me zbatimin e vendimeve të tij.
- Ligji për konsultimin publik duhet të amendohet me synimin për të zgjeruar kategoritë e akteve që i nënshtrohen procesit të konsultimit. Fusha e zbatimit të ligjit për konsultimin publik duhet të zgjerohet me qëllim përfshirjen e akteve nënligjore në tërësinë e atyre ndaj të cilave realizohet konsultimi publik. Monitorimi më i mirë i zbatimit të ligjit duhet të gjejë reflektim në amendimet ligjore.

[116] SIGMA *Monitoring Reports, Public Administration in Albania*, 2024, f. 30, *op.cit.*
[117] *Ibid.*
[118] Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit. RIA-Metodologjia.pdf (kryeministria.al)

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Raportimi i rezultateve të procesit të konsultimit publik duhet të përfshijë informacionin për raportin e pranimit të komenteve të mbledhura gjatë të gjithë procesit dhe duke i bërë ato transparente për çdo akt. Konsultimi publik duhet të digjitalizohet më tej.
- Është e domosdoshme që rregullimi i procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator (RIA-s) të jetë në nivelin e një ligji, me qëllim që RIA të zbatohet edhe në rastet e hartimit të projektligjeve nga aktorë të ndryshëm nga Këshilli i Ministrave dhe për legjislacionin sekondar, si dhe të forcohet zbatimi i procedurave për përgatitjen e RIA-ve.
- Në Shqipëri veprojnë një sërë mekanizmash dhe platformash për garantimin e transparencës, duke fragmentarizuar kuadrin institucional dhe duke bërë të vështirë monitorimin e zbatimit të ligjeve në fushën e transparencës dhe dokumenteve strategjike. Roli i institucioneve të pavarura si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të forcohet, si organe kyçe për monitorimin e shkeljeve dhe sigurimin e transparencës në institucionet publike.
- Kuvendi duhet të rrisë ndjeshmërinë dhe vëmendjen në raportimet vjetore të organeve të pavarura dhe të organeve të tjera që raportojnë pranë tij, për çështjet e transparencës. Vendimi i Kuvendit që rregullon formatin e raportimit mund të përmirësohet, duke i kushtuar një vëmendje më të madhe transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve.
- Kuvendi duhet të organizojë dëgjesa të dedikuara me organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të medias për të tërhequr opinionin e tyre për çështje të transparencës në administratën publike, dhe problematikat që hasin në lidhje me zbatimin e ligjit për informimin dhe për konsultimin publik. Mund të vlerësohet hartimi i planeve/ kalendarëve vjetore të tryezave tematike, të cilat publikohen në fillim të vitit kalendarik dhe i japin mundësinë grupeve të interesit të përgatiten paraprakisht për të ndarë gjetjet e tyre me Kuvendin. Këto tryeza duhet t'i paraprijnë në kohë raportimeve të institucioneve në Kuvend.
- Duhet të vlerësohet krijimi i grupeve të përhershëm konsultative pranë Kuvendit me përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve të interesit, akademisë, përfaqësues të organeve të pushtetit qendror dhe vendor etj., në fusha me interes kombëtar. Këto këshilla mund të shërbejnë si ura komunikimi e koordinimi mes aktorëve të ndryshëm dhe institucioneve; mekanizma për konsultimin e projektakteve, politikave dhe për rritjen e informimit mbi procesin e integrimit europian për fusha prioritare si për shembull, ekonomia dhe klima e biznesit; sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut; antikorrupsioni; shërbimet publike dhe menaxhimi i burimeve njerëzore etj.
- Organet e pushtetit vendor kanë nevojë për mbështetje në fushën e digjitalizimit dhe për rritje të kapaciteteve administrative për zbatimin e detyrimeve ligjore në lidhje me të drejtën për informim të qytetarëve dhe konsultimin e akteve.
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është organi kryesor që ka kompetenca në fushën e informimit, konsultimit publik, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të të dhënave të hapura. Forcimi i strukturës dhe i kapaciteteve administrative është i domosdoshëm.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Roli i koordinatorëve të informimit duhet të forcohet. Duhet vlerësuar mundësia e ndryshimeve ligjore për të caktuar në rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit nëpunës të nivelit të mesëm ose të lartë të hierarkisë në autoritetet publike.
- Rritja e kapaciteteve të administratës publike për zbatimin më të mirë të legjislacionit duhet të ecë paralelisht me edukimin ligjor të publikut në fushën e transparencës. Përmirësimi i legjislacionit në drejtim të ligjit për informimin, të dhënave të hapura, mbrojtjes së të dhënave personale do duhet të gjejë mbulim në një strategji/plan ndërgjegjësimi të qytetarëve nga Komisioneri.
- Organet publike duhet të krijojnë hapësira për të shpërndarë informacion me metoda më të aksesueshme dhe më miqësore me qytetarët.
- Për personat me aftësi të kufizuar nuk ka përshtatje të dokumenteve publike me nevojat e tyre, si dhe për t'i aksesuar fizikisht më lehtë. Informacionet publike duhet të përshtaten në formate alternative, si *Braille*, audio, ose formate digjitale të aksesueshme. Në këtë drejtim, ligji për konsultimet publike duhet të përmirësohet për të përfshirë rregullime specifike për grupet e margjinalizuara, qytetarët në zona të largëta dhe personat me aftësi të kufizuar, të cilët shpesh mbeten jashtë proceseve vendimmarrëse.
- Qeveria dhe institucionet duhet të përqafojnë një qasje pro-aktive dhe jodiskriminuese për përfshirjen në procesin e konsultimit publik të grupeve të nën përfaqësuara nëpërmjet njoftimeve paraprake dhe konsultimeve të synuara për t'u dhënë zë këtyre grupeve të synuara.
- Raportimi i rezultateve të procesit të konsultimit publik duhet të përfshijë informacionin për raportin e pranimit të komenteve të mbledhura gjatë gjithë procesit dhe duke i bërë ato transparente për çdo akt.
- Konsultimi publik duhet të digjitalizohet më tej duke përfshirë platformat e-legislation apo e-konsultim, ku të jetë pasqyruar edhe procesi i ndjekjes (*tracking)* dhe mënyra se si është zhvilluar konsultimi publik.
- Ligji për konsultimin publik duhet të garantojë qëndrueshmërinë e koordinatorëve për njoftimin dhe konsultimin publik në çdo institucion përgjegjës, duke siguruar që ky rol të ushtrohet nga nëpunësit civilë të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues.
- Duhet nxitur qasje monitoruese dhe vlerësuese nga ana e institucioneve eprore, ndaj atyre të varësisë, për zhvillimin e treguesve krahasues dhe analitike të suksesit, vështirësive dhe sfidave të hasura në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.
- Duhet rritur mbështetja buxhetore për kryerjen e studimeve, analizave për sektorë të ndryshëm të veprimtarisë në vend, pasi RIA është një proces që kërkon mbështetje buxhetore. Institucionet kanë nevojë për studime reale të kohës, me qëllim që të mund të ndërmarrin një vlerësim të mirëfilltë RIA dhe në këtë drejtim mund të rritet bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë dhe shoqërinë civile për realizimin e studimeve me të dhëna reale.
- Është e nevojshme të hartohen kurrikula të trajnimit të dedikuara për përgatitjen e RIA-s dhe të realizohen trajnime periodike të posaçme me koordinatorët në institucionet hartuese të projektligjeve. Përgatitja e RIA-s cilësore kur ka përafrim me *acquis* duhet të marrë një rol të veçantë në këto kurrikula.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Kapitulli II. Integriteti dhe etika në administratën publike

2.1 Konteksti

Që nga viti 2014[119], Komisioni Evropian e ndryshoi strategjinë dhe kaloi në një "dialog më të strukturuar", duke punuar me grupe të posaçme pune për reformën e administratës publike me vendet në zgjerim, përfshirë edhe Shqipërinë. Megjithëse në 23 qershor 2014[120] Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat nga BE-ja, më 9 nëntor 2016, Komisioni Evropian propozoi hapjen e negociatave për anëtarësim të Shqipërisë me BE-në me kusht që të *miratonte ndryshimet e mëtejshme ligjore për reformën në drejtësi dhe të bënte përmirësimet e duhura në Kodin Zgjedhor para fushatës elektorale të vitit 2017*[121]. Ndërkohë, në 18 prill 2018 Komisioni dha një rekomandim të pakushtëzuar për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në, ku rol parësor do të kishte efektshmëria dhe integriteti i administratës publike për të përballuar këto negociata. Në konkluzionet e tij të 26 qershorit 2018, Këshilli Evropian e përcaktoi rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit pas një viti, në varësi të progresit të bërë në fusha kyçe si *gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, shërbimet e inteligjencës dhe veçanërisht administrata publike.*[122]

Komisioni Evropian e përsëriti rëndësinë e rolit të administratës publike edhe në rekomandimin për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit në Paketën e Zgjerimit të miratuar në 9 maj 2019[123]. Në 14 mars 2020, anëtarët e Këshillit Evropian miratuan vendimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe në korrik 2020, drafti i kuadrit negociator që iu prezantua shteteve anëtare e kishte administratën publike një nga çështjet kryesore që do të diskutohej gjatë bisedimeve. Në 27 korrik 2022, kur Komisioni Evropian filloi procesin e skanimit apo shqyrtimit të legjislacionit të *acquis* (*screening process*) dhe më pas i paraqiti Këshillit raportin e skanimit apo shqyrtimit (*Screening Report*)[124] për grupkapitujt I "Themeloret" (5,18,23,24,32), administrata publike kishte një peshë të rëndësishme.

---

[119] *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions Enlargement Strategy and Main Challenges* 2014-15 COM/2014/0700 final */08 October 2014 p. 3 Link. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=celex%3A52014DC0700

[120] *Albania gets EU candidate status, 24 June,* 2014, https://balkaninsight.com/2014/06/24/albania-gets-eu-candidate-status/

[121] *EU recommends openinig accession talks with Albania,* 09 *November* 2016, link: https://www.politico.eu/article/commission-recommends-opening-accession-talks-with-albania/

[122] *Brussels,* 26 *June* 2018 (OR. en) 10555/18 *Elarg 41 Coweb 102 Enlargement and Stabilisation and Association* Process – EU *Council Conclusions* , 28 *pages, link*: https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10555-2018-INIT/en/pdf

[123] *Brussels,* 29.5.2019 *com*(2019) 260 *Final Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2019 Communication on EU Enlargement Policy, 55 pages, link*: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/f7b19f8f-3907-42fa-a899-25596b91dd17_en?filename=20190529-communication-on-eu-enlargement-policy.pdf

[124] *EU Commission Albania Screening Report* /https://neighbourhood enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf *link* 135 *pages*

DOKUMENT PARLAMENTAR

Përgjatë një periudhe 10-vjeçare nga momenti kur Shqipëria mori statusin e vendit kandidat, deri kur filloi zyrtarisht negociatat për anëtarësim me BE-në, efektshmëria dhe integriteti i administratës publike kanë qenë pjesë e rëndësishme e çdo raport progresi apo monitorimi nga institucionet ndërkombëtare ose organizata të shoqërisë civile. Legjislacioni i gjerë i BE-së (a*cquis*), i cili prej vitit 1957 ka mbërritur në 100 000 akte legjislative të BE-së, në fusha të ndryshme, dhe çdo vit përfshin mesatarisht më shumë se 300 direktiva e rregullore[125] të reja apo të amenduara, kërkon një administratë publike me efektshmëri dhe integritet të lartë. Në këtë mënyrë administrata publike mund të jetë në gjendje për të përshtatur e zbatuar këtë legjislacion dhe të përthithë e mirëadministrojë fondet e BE-së në fazën e para-anëtarësimit e anëtarësimit.

2.2 Progresi dhe arritjet

2.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional për garantimin e integritetit në administratën publike

Integriteti i institucioneve publike në zbatimin e reformës në administratën publike

Përgjatë viteve administrata publike shqiptare ka kaluar një sërë ndryshimesh ligjore e institucionale, që kanë ndikuar në ecurinë e rezultatet e saj. Indeksi më i fundit i Integritetit Publik (IPI) i publikuar nga Qendra Kërkimore Evropiane për Antikorrupsionin dhe Shtetndërtimin, e vlerëson Shqipërinë me 7/10 pikë, duke qenë mbi mesataren rajonale (6,37) dhe atë globale (6,02)[126]. Ndërkohë, sipas vlerësimit të detajuar të performancës së administratës publike të realizuar nga OECD/SIGMA në vitin 2021 dhe 2024, Shqipëria vlerësohet me performancën më të lartë rajonale (bashkërisht me Kosovën) në drejtim të integritetit të nëpunësve publikë, me pikëzimin 3,6/5, duke shënuar kështu një rritje me 10% nga vlerësimi i vitit 2017 me 3/5 pikë.[127] Përparimi i arritur është rezultat i përmirësimeve në disa elemente, si perceptimi i ryshfetit nga bizneset, zbatimi i politikave të dedikuara për integritetin në sektorin publik dhe informacioni mbi hetimet.

Me synimin për të harmonizuar ndërhyrjet e veçanta në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e integritetit, transparencës dhe qeverisjes së hapur, si pjesë e zbatimit të reformës në administratën publike, duke filluar nga janari 2024, kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, rol që ishte ushtruar deri në këtë periudhë nga Ministria e Drejtësisë, iu ngarkuan

[125] *EU Legislative Acts-Statistics*, link https://eur-lex.europa.eu/statistics/legislative-acts-statistics.html
[126] *Index of Public Integrity (IPO) European Research Center for Anticorruption and Statebuilding- ERCAS, link:* https://www.againstcorruption.eu/homepage-widgets/index-of-public-integrity/
[127] SIGMA, Vështrim Rajonal: Monitorimi i Ballkanit Perëndimor - Shkurt 2022. OECD *Publishing*, 2022, f. 25, https://www.sigmaweb.org/publications/Regional-Overview-Western-Balkans-Monitoring-February-2022.pdf. ; SIGMA *Monitoring Reports, Public administration in Albania 2024 Assessment against the Principles of Public Administration link:* https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

një ministri të dedikuar Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.[128] Duke udhëhequr reformën në administratën publike dhe angazhimin e qeverisë për respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë, ky pozicion synon ta bëjë luftën kundër korrupsionit një element kryesor në të gjitha nivelet e administratës publike, duke synuar një qasje më të integruar dhe efektive të ndërhyrjeve që planifikohen.

Nga pikëpamja e strukturave institucionale, thellimi i luftës kundër praktikave korruptive dhe rritjes së integritetit së nëpunësve në administratën publike u synua të fuqizohet përmes krijimit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion (DPAK) në vitin 2021, si një strukturë pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Struktura synonte parandalimin e abuzimeve, ashtu edhe hetimin e specializuar administrativ të praktikave korruptive. Ngritja e kësaj strukture nën emërtimin DPAK-së u vlerësua në vitin 2022 nga Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO), si shenjë e progresit institucional në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e integritetit të zyrtarëve publikë.[129] Prej qershorit 2024, përmes VKM-së nr. 436, datë 26.6.2024, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion[130] funksionon tashmë si një person juridik, publik, me buxhetin e saj dhe në varësi të ministrit përgjegjës për antikorrupsionin, që vepron në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Tashmë kjo strukturë është fuqizuar institucionalisht edhe përmes shkëputjes administrative, duke qenë një person i mirëfilltë juridik, në krahasim me statusin e saj të mëparshëm si pjesë përbërëse e Ministrisë së Drejtësisë.[131]

Në përgjigje të rekomandimit të Raportit vjetor të Komisionit Evropian për vitin 2023, mbi nevojën për forcim të kapaciteteve institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion,[132] struktura e rishikuar organizative e drejtorisë është përshtatur për të vendosur një theks më të fortë në monitorimin e zbatimit të politikave dhe parandalimin e korrupsionit. Në këtë kuadër, një hap i rëndësishëm për fuqizimin e kapaciteteve të saj institucionale ka qenë plotësimi me staf të ri në ekipin përgjegjës për monitorimin e kuadrit strategjik. Gjithashtu, është synuar fuqizimi i koordinimit institucional në fushën e antikorrupsionit brenda Drejtorisë së Politikave të

[128] VKM nr. 29, datë 17.1.2024 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin", *Fletore Zyrtare* nr. 14, 2024, f. 2225) *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/14/f490f1f3-ff71-4ce1-9fd2-335db94e4d16

[129] GRECO, Raundi V i Vlerësimit *"Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit"*, Raporti i Përputhshmërisë, 2022, f. 5; Rekomandimi iii): GRECO ka rekomanduar harmonizimin dhe rritjen e koherencës së natyrshme të kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë, veçanërisht në lidhje me personat me funksione të larta ekzekutive, për shembull, duke hartuar norma dhe rregullore në një manual dhe duke ofruar udhëzime mbi detyrimet e çdo kategorie dhe për rolin e çdo organi përgjegjës; *link:* https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6124

[130] VKM nr. 436, datë 26.6.2024, "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion", *Fletore Zyrtare* nr. 108, 2024, f. 11320, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/107/a86431a8-f9cb-4f7f-8340-c8daaab64bbe

[131] Struktura e re dhe organigrama e Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion u miratua me urdhrin nr. 146 të Kryeministrit, datë 1.8.2024.

[132] Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë 2023, f.5, *link:* https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SËD_2023_690%20Albania%20report.pdf

Antikorrupsionit, që është nën varësinë e drejtorit të Përgjithshëm. Për më tepër, Drejtoria e Analizës, Kontrollit dhe Hetimeve Administrative, e cila raporton te drejtori i Përgjithshëm, është ristrukturuar nëpërmjet këtij ndryshimi të fundit, për të vendosur një theks më të madh në parandalimin e korrupsionit dhe analizën e modeleve, duke u mbështetur në rastet individuale. Ky ndryshim ka pasur për qëllim të nxisë një qasje më sistematike në luftën kundër korrupsionit.

Me të njëjtin vendim të sipërcituar u riorganizua edhe struktura e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion[133], e shtrirë nga qershori 2024 në 26 institucione publike, ente dhe shoqëri tregtare me kapital shtetëror.[134] Një nga objektivat e kësaj strukture është lufta kundër çdo lloj forme të korrupsionit dhe forcimi i besimit te qytetarët për një administratë publike eficiente dhe me integritet të lartë në shërbim të qytetarit. Një nga funksionet kryesore të koordinatorëve antikorrupsion është të mbledhin informacion nga burime të ndryshme për veprimtaritë korruptive, praktikat abuzive apo arbitrare dhe të kryejnë hetime administrative mbi këto raste edhe përmes bashkëpunimit me strukturën përgjegjëse për antikorrupsionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit (DPAK) dhe strukturat e brendshme të institucionit, entit publik, apo shoqërisë tregtare me kapital shtetëror. Në këtë proces bashkëpunon ngushtë me DPAK-në në hartimin e raportit përfundimtar të rastit objekt verifikimi dhe e përcjell atë pranë saj, ashtu sikurse kryen çdo detyrë tjetër të kërkuar ose të deleguar në përputhje me kompetencat e tij.

Risia që sjell kjo strukturë lidhet me shpejtësinë dhe efikasitetin në trajtimin e ankesës apo denoncimit nga qytetarët. Përmes Mekanizmit Kombëtar të Referimit të Korrupsionit (MKRK) të të gjitha niveleve, çdo qytetar mund t'i qaset edhe direkt koordinatorit për të denoncuar apo raportuar çdo parregullsi, nga më të lehtat e deri te rastet korruptive. Nëpërmjet ruajtjes së anonimatit të çdo denoncuesi, si dhe garancisë në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave

[133]Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion u krijua në 2021 përmes VKM-së nr. 618 datë 20.10.2021 "Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit", *Fletore Zyrtare* nr. 166, 2021, f. 15105 *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2021/166/a84d47d7-eb7d-4013-bbee-e265aa6f894b .Që prej 26 Qershorit 2024 ajo nuk vijon më si strukturë më vete, por është zëvendësuar me Koordinatorët Antikorrupsion që janë institucionet e përmendura në kreun IV, pika 1 e VKM-së, nr. 436 datë 26.6.2024

[134] Sipas VKM-së nr. 436, datë 26.6.2024, "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion", *Fletore Zyrtare* nr. 108, 2024, f. 11320, *link* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/107/a86431a8-f9cb-4f7f-8340-c8daaab64bbe kreu IV, pika 1 përcakton se lista e enteve publike dhe ndërmarrjeve shtetërore ku janë emëruar Koordinatorët Antikorrupsion përfshin institucione si: Operatori i Blerjeve të Përqendruara, sh.a; Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural; Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në nivel qendror dhe në drejtoritë vendore, sipas përcaktimit të DPAK-së; Agjencia e Trajtimit të Pronave; Autoriteti Kombëtar i Ushqimit; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar; Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; Instituti i Shëndetit Publik; Inspektorati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit; Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Inspektorati Shtetëror Shëndetësor; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë; Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; Posta Shqiptare; Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"; Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"; Spitali Universitar i Traumës; Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni"; Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës "Shefqet Ndroqi"; Shërbimi Social Shtetëror.

DOKUMENT PARLAMENTAR

personale dhe përpunimit të informacionit, synohet që qytetarët të jenë pjesëmarrës aktivë në forcimin e integritetit të administratës, si përfitues të drejtpërdrejtë të shërbimeve nga ana e saj.

Kuadri ligjor për shërbimin civil

Ligji nr. 152/2013 datë 30.5.2013 "Për nëpunësin civil", i cili shfuqizoi ligjin e vitit 1999[135], solli ndryshime rrënjësore në statusin e nëpunësve civilë. Ai u miratua në kuadër të përmbushjes së prioriteteve të BE-së lidhur me përmirësimin e shërbimit në institucionet e administratës publike, si dhe rritjen e besueshmërisë në këto institucione. Nëpërmjet tij u përcaktuan rregulla të detajuara për zbatimin e parimeve dhe standardeve për çdo institucion të shërbimit civil, duke garantuar zbatim të unifikuar të këtij legjislacioni në praktikë nga institucionet e administratës publike. Ligji parashikoi që menaxhimi i shërbimit civil bazohet në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritave, transparencës, profesionalizmit dhe paanshmërisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë dhe vazhdimësinë e shërbimit civil[136]. Të gjitha këto elemente ofrojnë garanci për integritet më të lartë të administratës publike. Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", forcoi rolin e administratës dhe krijoi Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) e ngarkuar me formimin profesional të nëpunësve civilë[137], si dhe një Komisioner për Monitorimin e Shërbimit Civil, një organ administrativ përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë[138].

Me qëllim zbatimin e unifikuar nga ana e institucioneve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" janë miratuar disa vendime nga Këshilli i Ministrave, të cilat parashikojnë aspekte procedurale për zbatim nga institucionet e administratës publike. Në tërësi, kuadri ligjor dhe ai rregullator për shërbimin civil në Shqipëri është hartuar me ekspertizën teknike të OECD/SIGMA. Në monitorimin e vitit 2024 të OECD/SIGMA për performancën e administratës publike shqiptare, në nivel rajonal, sistemi i shërbimit civil shqiptar vlerësohet i konsoliduar dhe i qëndrueshëm mbështetur në funksionimin e tij në bazë të ligjit nr. 152/2013 dhe akteve nënligjore që garantojnë zbatimin e tij. Ky sistem po demonstron një nivel stabiliteti dhe elasticiteti, duke konfirmuar përputhshmërinë e tij me praktikat më të mira evropiane.[139]
Aktualisht, në përputhje me Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030[140], nën drejtimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, si dhe

[135] Ligji nr. 152/2013, datë 30.5.2013 "Për nëpunësin civil", *Fletore Zyrtare* nr. 95, 2013, f. 3952, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2013/95/eabda600-7462-4acf-8ecf-c886525ec91b
[136] *Ibid.*
[137] *Ibid.*
[138] *Ibid.*
[139] OECD/SIGMA, Raport Monitorimi: *Parimet e Adminsitratës Publike*, Shqipëria, 2021, f. 68, https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf ; OECD, SIGMA *Monitoring Reports Public administration in Albania 2024*: *Assessment against the Principles of Public Administration*, 2024 ,148 *pages*, *link*: https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf
[140] VKM nr. 737. datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030", *Fletore Zyrtare* nr. 184, 2023, f. 22098, link https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1

Departamentit të Administratës Publike, është në proces amendimi i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil". Amendimet synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor aktual, duke synuar jo vetëm procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë në nivelet e larta, por edhe forcimin e mekanizmave që garantojnë etikën dhe integritetin në administratën publike.

Kodet e sjelljes dhe etika institucionale

Ligji kuadër për rregullimin e etikës në administratën publike është ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"[141], i cili është hartuar sipas modelit të Këshillit të Evropës. Ky ligj ka për qëllim kryesor përcaktimin e normave të sjelljes për nëpunësit e administratës publike, në përputhje me standardet e kërkuara, duke ofruar udhëzime dhe informuar publikun mbi pritshmëritë ndaj sjelljes së tyre. Dispozitat e ligjit janë të zbatueshme për të gjithë nëpunësit e administratës publike dhe për personat e punësuar nga sektorët privatë që ofrojnë shërbime publike. Ky ligj nuk zbatohet për të zgjedhurit, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe gjyqtarët, si dhe në rastet kur ligjet e tjera parashikojnë përjashtime.

Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 nuk jep përkufizime të veçanta për termat e lidhur me etikën apo sjelljen etike, por përcakton parime që duhet të ndjekin nëpunësit e administratës publike. Këto parime përfshijnë respektimin e legjislacionit, ruajtjen e pavarësisë politike, ndershmërinë, paanshmërinë, efikasitetin, mirësjelljen, shërbimin ndaj interesit publik, shmangien e konfliktit të interesave, si dhe respektimin e të drejtave, detyrave individuale e besueshmërinë. Në këtë drejtim, ai ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë së nëpunësve publike. Ligji "Për rregullat e etikës në administratën publike"[142] u kushton kapituj të veçantë çështjeve të konfliktit të interesave, veprimtarive të jashtme të nëpunësve të administratës publike dhe përfitimeve, përfshirë dhuratat dhe favoret.[143]

Krahas përcaktimit të udhëzimeve gjithëpërfshirëse mbi etikën, ligji i kushton një vëmendje të veçantë edhe çështjes së konfliktit të interesit, duke krijuar në këtë mënyrë një lloj mbivendosje ndërmjet përmbajtjes së tij dhe dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike". Rrjedhimisht, ligji lr. 9131, datë 8.9.2003 do të mund të rishikohet dhe të ndryshohet, në mënyrë që të jetë një pjesë integrale e menaxhimit të etikës për administratën publike në tërësi.[144] Ky rishikim fiton veçanërisht rëndësi

[141] Ligj nr. 9131. datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", *Fletore Zyrtare* nr. 83, 2003, f. 3660, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2003/83/668538f5-52fd-4a83-9ae0-4f619471d77
[142] *Ibid*
[143] IDM, "Forcimi i integritetit të administratës publike në Shqipëri: Analizë e kuadrit mbi etikën që rregullon sjelljen e nëpunësve publikë në Shqipëri", 2021, f. 24, *link*: https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Integrity-in-Public-Administration_Alb-1.pdf
[144] IDM, "Forcimi i integritetit të administratës publike në Shqipëri: Analizë e kuadrit mbi etikën që rregullon sjelljen e nëpunësve publikë në Shqipëri", 2021, f. 48, *link:* https://idmalbania.org/ëp-content/uploads/2021/11/Integrity-in-Public-Administration_Alb-1.pdf

në kuadër të procesit për miratimin e ligjit të ri për konfliktin e interesit, i parashikuar të finalizohet brenda vitit 2025, sipas Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës.

Monitorimi i zbatimit të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", realizohet nga institucionet përkatëse përmes njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore në secilin institucion. Megjithatë, ligji nuk parashikon sanksione për shkeljet e etikës pas përfundimit të marrëdhënieve të punës ose për shkeljet në fushën e lobimit, duke krijuar një vakuum në trajtimin e këtyre çështjeve pas punësimit. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, një numër institucionesh kanë miratuar kodet e tyre përkatëse të etikës/sjelljes për të standardizuar dhe përforcuar sjelljen etike të nëpunësve.[145]
Në zbatim të ligjit nr. 9131/2003, ka hyrë në fuqi në vitin 2021 VKM-ja nr. 874, datë 29.9.2021, e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, klasifikimin e aktiviteteve të jashtme dhe përcaktimin e vlerës së dhuratave të pranueshme gjatë punësimit në administratën publike"[146]. Ky vendim shfuqizoi VKM-në nr. 714, datë 22.10.2004, "Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit në administratën publike"[147]. VKM-ja nr. 874/2021 vendos standarde për të rregulluar aktivitetet e jashtme, përfshirë edhe punësimin dytësor. Sipas rregullores, miratimi për aktivitete të jashtme, përfshirë edhe punësimin dytësor, mund të aprovohet nga eprori i nëpunësit civil, nëse nuk ka konflikt interesi ose nuk krijon pamje të konfliktit të interesit. Gjithashtu, kërkesat fizike dhe mendore të aktiviteteve të punëve të dyta nuk duhet të ndikojnë negativisht në aftësinë e nëpunësit për të kryer detyrat zyrtare, ashtu sikur ato nuk duhet të dëmtojnë imazhin e zyrtarit publik apo të përdorin informacione të përftuara gjatë ushtrimit të detyrës.

Në Kreun VI, VKM-ja nr. 874/2021 përshkruan detajet për kompetencat e Departamentit të Administratës Publike dhe njësitë e burimeve njerëzore për këshillimin, trajnimin, mbikëqyrjen dhe disiplinimin në zbatimin e rregullave të etikës. Në zbatim të VKM-së, si dhe në zbatim të Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, aktualisht janë hartuar projekt-aktet vijuese në zbatim të ligjit për rregullat e etikës në administratën publike, të cilat synojnë përmirësimin e zbatimit të parimeve të etikës dhe integritetit për funksionarët publike, përkatësisht:

1. Manuali i Rregullave Etike për Punonjësit e Administratës Publike;
2. Një udhëzues i ri mbi elementet kryesore procedurale dhe materiale për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore;
3. Metodologjia për monitorimin e zbatimit të rregullave etike në institucionet publike.

[145] Kodet e etikës/sjelljes për secilin institucion mund të aksesohen në secilën nga faqet zyrtare të institucioneve në fjalë.
[146] VKM nr. 874, datë 29.9.2021, "Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike", *Fletore Zyrtare* nr. 66, 2022, f. 8493, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2022/66/9303ce41-8e58-4566-b181-102e560de033
[147] VKM nr. 714, datë 22.10.2004 "Për veprimtarinë e jashtme dhe dhënien e dhuratave gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike", shfuqizuar, *Fletore Zyrtare* nr. 81, 2004, f. 594, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2004/81/0e836394-7a79-46e3-b869-bb1b51ed0160

Këto projektakte do të ndihmojnë në konsolidimin e kuadrit etik dhe sigurojnë një proces të standardizuar për monitorimin dhe zbatimin e rregullave etike në administratën publike.

Po ashtu në përputhje me Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, u finalizuan brenda nëntorit 2024 trajnimet e stafit të dedikuar prej 60 nëpunësish në institucionet qendrore dhe ato të varësisë, për zbatimin e kuadrit rregullator për etikën në administratën publike.[148] Një masë e rëndësishme që pritet të përmbushet deri në vitin 2025 është edhe krijimi i pozicionit të Këshilltarit për Integritet dhe Etikë në të gjitha institucionet publike, së bashku me zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës trajnimi që mbulon çështjet etike në mënyrë sistematike, për të përmirësuar kapacitetet në këtë fushë.

Një kuadër i veçantë rregullator për etikën ekziston edhe për Këshillin e Ministrave përmes Kodit Ministror të Etikës, miratuar me VKM-në nr. 830, datë 15.9.2013[149], i ndryshuar. Ky kod përmban dispozita që lidhen me ruajtjen e konfidencialitetit, respektimin e legjislacionit të shërbimit civil, ndalimet për pranimin e dhuratave dhe përfitimeve, si edhe përdorimin e burimeve publike për qëllime individuale ose politike.[150] Dokumenti kërkon ndërgjegjësim të rregullt për çështjet e integritetit nga anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë.
Rishikimi i Kodit Etik Ministror në vitin 2021 përmes miratimit të VKM-së nr. 875 datë 29.9.2021[151] u vlerësua pozitivisht nga GRECO, si një sinjal i qartë i përpjekjeve të autoriteteve

[148] Masa prioritare parashikon përkatësisht: "Zhvillimi i një programi trajnimi gjithëpërfshirës që trajton çështjet kryesore të etikës dhe integritetit në administratën publike, dhe përmirësimin e kapaciteteve të Departamentit të Administratës Publike për të vepruar si organ qendror ndërgjegjësues".
[149] VKM nr. 830, datë 15.09.2013 "Për miratimin e Kodit Etik Ministror", *Fletore Zyrtare* nr. 157, 2013, f. 7129. *Link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2013/157/9674ef68-f494-40e4-bac5-abd7ff48688b;
[150] Parashikimet e Kodit adresojnë, ndër të tjera, edhe:

- detyrimin e anëtarëve të qeverisë për të ruajtur konfidencialitetin e opinioneve të shprehura në vlerësimet dhe diskutimet që zhvillohen pranë Këshillit të Ministrave (neni 5),
- detyrimin e ministrave për të respektuar dhe zbatuar legjislacionin e shërbimit civil (neni 10), (iii) detyrimin e ministrave për të zbatuar sjelljen e mirë, objektivitetin dhe paanshmërinë ndaj personelit të ministrisë përkatëse (neni 11),
- disa ndalime për anëtarët e qeverisë kundër, ndër të tjera, marrjes/pranimit të dhuratave ose përfitimeve të tjera, keqpërdorimit të autorizimeve dhe delegimeve që rrjedhin nga kompetencat e tij/saj, duke ndikuar në procesin e vendimmarrjes ose marrjen e vendimeve në favor të anëtarëve të familjes së tij/saj dhe personave të tjerë të lidhur me ta (neni 12 dhe 29), përdorimin e burimeve publike për përfitime personale ose politike (neni 13),
- detyrimin e ministrive për të bërë publike, të paktën çdo tremujor, detaje rreth takimeve që ministrat organizojnë me shtetas dhe subjekte vendase dhe të huaja (neni 20),
- detyrimin e anëtarëve të Këshillit të Ministrave për të deklaruar konfliktin e interesit *ad hoc* gjatë një procedure vendimmarrjeje përpara Këshillit të Ministrave, ministrisë ose një institucioni tjetër në varësi të ministrisë (neni 25),
- kufizime të caktuara për anëtarët e qeverisë për të ushtruar veprimtari të jashtme (neni 26) dhe kufizime pas largimit nga detyra (neni 37).

[151] VKM nr. 875. datë 29.9.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 830, datë 15.9.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Kodit Etik Ministror"", *Fletore Zyrtare* nr. 66, 2022, f. 8502, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2022/66/9303ce41-8e58-4566-b181-102e560de033

shqiptare për të adresuar rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare.[152] Një nga hapat pozitivë ka qenë krijimi i Komisionit të Etikës[153], i cili është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të rregullave etike nga anëtarët e qeverisë. Në Raportin e Përputhshmërisë të vitit 2022, GRECO ka shprehur shqetësim për përfshirjen e një anëtari të qeverisë në përbërjen e këtij komisioni, në drejtim të pavarësisë dhe paanshmërisë së Komisionit. GRECO e ka vlerësuar të plotësuar pjesërisht edhe rekomandimin për të përfshirë udhëzime të detajuara në lidhje me konfliktin e interesit dhe çështje të tjera që lidhen me integritetin, si edhe për të garantuar një mekanizëm të fortë mbikëqyrjeje dhe sanksionesh në zbatim të Kodit[154]. Gjithashtu, mbetet ende i pazbatuar plotësisht rekomandimi për rregullimin e sjelljes etike të këshilltarëve politikë dhe për të vendosur mekanizma disiplinor për Kryeministrin në rast shkeljesh nga ana e tij.[155] Për këtë qëllim me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është në proces[156] ndryshimi i urdhrit të Kryeministrit për përbërjen e Komisionit të Etikës. Amendimet kanë qëllim të garantojnë shmangien e zyrtarëve politikë në përbërje të tij dhe caktimin si anëtarë të nivelit drejtues ekzekutivë të lartë (nëpunës civilë). Gjithashtu, projekturdhri parashikon edhe detyrimin për Komisionin e Etikës, për të njoftuar publikun mbi Raportin Përfundimtar të Vlerësimit (RPV), për çdo rast specifik të procedimit disiplinor, në përmbushje të detyrimit për transparencë.

Etika në administratën publike, gjithashtu, është një element themelor, i parashikuar në Draftstrategjinë për Reformën në Administratën Publike, e cila po hartohet nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe nga Departamenti i Administratës Publike. Përgjatë parashikimeve të kësaj strategjie, zbatimi i rregullave të etikës do të forcohet përmes ngritjes së kapaciteteve të stafit në njësitë që monitorojnë etikën dhe menaxhojnë burimet njerëzore. Përmes këtyre masave, synohet nxitja e përgjegjshmërisë institucionale dhe konsolidimi i një administrate të bazuar në ndershmëri dhe integritet.

Planet e Integritetit

Një masë efektive në parandalimin e korrupsionit është vlerësimi i risqeve të integritetit dhe miratimi i Planeve të Integritetit në të gjitha institucionet qendrore (ministritë e linjës dhe kabinetet

[152] GRECO, Raporti i Përputhshmërisë - Raundi V i Vlerësimit "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit", *link:* https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125

[153] Miratuar me urdhër të Kryeministrit nr.90, datë 20.5.2022, "Për ngritjen, përbërjen dhe organizimin e Komisionit të Etikës" i ndryshuar.

[154] GRECO, Raporti i Përputhshmërisë - Raundi V i Vlerësimit "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit", *link*: https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125

[155] *Ibid*. Rekomandimi IV: GRECO ka rekomanduar që i) Kodi Etik Ministror ekzistues të plotësohet me udhëzime konkrete për zbatimin e tij në lidhje me konfliktet e interesit dhe çështje të tjera që kanë lidhje me integritetin (p.sh. dhuratat, kontaktet me palët e treta, lobimin, etj.,); ii) të sigurohet funksionimi efektiv i Komisionit të Etikës, ose i çdo mekanizmi tjetër të besueshëm mbikëqyrjeje dhe sanksionesh, përfshirë edhe në lidhje me kryeministrin, dhe iii) rregullat etike të plotësohen me shembuj ilustrues dhe mekanizma zbatues për këshilltarët politikë.

[156] Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Raporti Kombëtar i hartuar në përgjigje të Raportit të Përputhshmërisë së GRECO për Raundin V të Vlerësimit, dorëzuar në Shtator 2024 nga Delegacioni i Shtetit Shqiptar në GRECO.

e ministrave të shtetit), agjencitë dhe drejtoritë vartëse të ministrive, bashkitë dhe disa institucione të pavarura. Ky instrument është prezantuar prej vitit 2021 përmes asistencës teknike dhe nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit (asokohe, Ministria e Drejtësisë dhe sot Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin). Në këtë kuadër Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion,[157] mbështet institucionet publike përkatëse për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

Qëllimi i këtij instrumenti në çdo institucion është:

1. Vlerësimi i risqeve të integritetit që mund të pengojnë apo kompromentojnë aftësinë për të ofruar shërbim publik në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme, si dhe faktorët që mund të ndikojnë në rritjen ose uljen e këtyre risqeve.
2. Hartimi i masave për t'u përballur me risqet e identifikuara.

Çdo institucion harton Planin e tij të Integritetit duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për qeverisjen qendrore. Plani i Integritetit përmban elemente të tilla si Deklarata e Integritetit Institucional, e cila shpreh përkushtimin e titullarit të institucionit për integritetin institucional, një prezantim të përgjithshëm të procesit të hartimit të Planit të Integritetit, risqet e identifikuara dhe Planin e Veprimit me masat e kontrollit që do të ndërmerren.[158]

Progresi me miratimin e Planeve të Integritetit është vlerësuar nga Raporti i OECD-së mbi Konkurrueshmërinë i vitit 2024, i cili vlerëson faktin se, pavarësisht se ende nuk ekziston detyrimi ligjor, autoritetet shqiptare po vlerësojnë rreziqet e korrupsionit dhe po zhvillojnë Plane Integriteti në mënyrë gjithnjë e më sistematike.[159] Miratimi i Planeve të Integritetit është në përmbushje të Rekomandimit ii) të Raundit V të Raportit të Vlerësimit të GRECO. Ai kërkon miratimin dhe zbatimin e masave të veçanta ndaj rreziqeve të integritetit në çdo ministri dhe veçanërisht ato që lidhen me personat që kanë funksione të larta ekzekutive, në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit mbi aspektet e integritetit dhe antikorrupsionin.[160] Në Raportin e Përputhshmërisë

[157] Hartimi dhe miratimi i Planeve të Integritetit u realizua në kuadër të projektit "Forcimi i Integritetit në Qeverisjen Qendrore – Plani i Integritetit për Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë", financuar nga Projekti ISDA: "Mbështetje për inovacionin kundër korrupsionit: Ngritja e një modeli shërbimesh me në qendër qytetarin në Shqipëri" (2020-2023),

[158] "Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore", 12 tetor 2021, 13 faqe, *link:* https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/METODOLOGJIA-E-MONITORIMIT-TE-PLANIT-TE-INTEGRITETIT.pdf

[159] OECD, *Western Balkans Competitiveness* Outlook 2024, f. 112, *link:* https://www.oecd.org/en/publications/western-balkans-competitiveness-outlook-2024-albania_541ec4e7-en.html

[160] Rekomandimi ii): GRECO ka rekomanduar që i) plane konkrete integriteti të miratohen dhe zbatohen për të gjitha ministritë, duke përfshirë analizën sistematike të rreziqeve të lidhura me integritetin me të cilat mund të përballen ministrat dhe këshilltarët politikë në ushtrimin e detyrave të tyre dhe mekanizmat e monitorimit dhe përputhshmërisë, dhe ii) të hartohen dhe zbatohen masa të përshtatshme korrigjuese që synojnë posaçërisht personat me funksione të larta ekzekutive.

DOKUMENT PARLAMENTAR

të vitit 2022, GRECO[161] ka vlerësuar pozitivisht miratimin e Planeve të Integritetit (PI) të shoqëruara me Plane konkrete Veprimi, për të gjitha ministritë e linjës. Nga ana tjetër, ai ka theksuar nevojën për masa të mëtejshme, për të siguruar monitorimin dhe pajtueshmërinë me planet e integritetit në të gjitha ministritë. Në mënyrë të veçantë është kërkuar të identifikohen masat specifike për të trajtuar rreziqet e lidhura me integritetin që mund të përballen ministrat dhe këshilltarët politikë.
Në përgjigje të këtij rekomandimi, në mars 2024, të gjitha ministritë e linjës hartuan raportet e tyre vjetore të monitorimit për vitin 2023 dhe gjatë muajve korrik-shtator 2024 kryen monitorimin për periudhën e parë 6-mujore të vitit 2024. Paralelisht, u finalizua pajisja me PI (Plane Integriteti) e të gjitha kabineteve të ministrave të shtetit, krahas ministrive të linjës.

Në bazë të të dhënave zyrtare deri në fund të shtatorit 2024:

- **në nivelin qendror,** të gjitha ministritë e linjës (11), ministrat e shtetit (6), 48 institucione varësie të ministrive të linjës, 3 institucione të pavarura (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kuvendi dhe KLP) kanë miratuar Plane Integriteti;
- **në nivelin vendor,** 24 bashki[162] (1 më shumë sesa në fundin e vitit 2023) kanë miratuar Plane të Integriteti deri në fund të shtatorit 2024. Ndërkohë 4 bashki të tjera kanë përgatitur Planet e tyre të Integritetit,[163] dhe janë në pritje për miratim. Sipas monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit të bashkive për vitin 2023, shkalla e realizimit të masave është 58% (nga 635 masa në total, 367 janë të realizuara plotësisht, 137 janë në proces realizimi – 22% - dhe 131 masa rezultojnë të parealizuara – 20%).[164]

Mbështetur në përvojat e marra nga zbatimi i deritanishëm i metodologjisë parësore të miratuar në vitin 2018, është hartuar metodologjia e re, e cila është pilotuar në dy institucione publike te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pesë fushat kryesore për vlerësim sipas kësaj metodologjie janë: 1) llogaridhënia; 2) transparenca; 3) qasja strategjike ndaj integritetit; 4) standardet e integritetit dhe 5) meritokracia e burimeve njerëzore, të cilat vlerësohen sipas dy kritereve: kontrolli ligjor dhe institucional dhe kontrolli i zbatimit në praktikë.[165] Në vijimin e procesit edhe

[161] GrecoRC5(2022)4 *Fifth Evaluation Round - Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies Compliance Report Albania*, 2022, 24 *pages link:* https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125
[162] Bashkitë Elbasan, Patos, Durrës, Mallkastër, Mat dhe Gjirokastër e kanë miratuar Planin e Integritetit në vitin 2020; Bashkitë Belsh, Përmet, Pogradec, Bulqizë, Tiranë, Berat, Kukës, Pukë, Himarë, Kavajë, Maliq, Has, Rroskovec dhe Lezhë e kanëmiratuar Planin e Integritetit në vitin 2022; Bashkitë Rroskovec, Lushnje dhe Librazhd e kanë miratuar Planin e Integritetit në vitin 2023 dhe Bashkia Libohovë në vitin 2024.
[163] Bashkitë Shkodër, Fushë-Arrës, Përrenjas dhe Vlorë.
[164] Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, *Raporti i Monitorimit të Realizimit të Planeve të Integritetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2023,* publikuar më 2024.
[165] IDM, *Indeksi i Integritetit të Institucioneve Publike,* janar 2024 Link**.** https://idmalbania.org/sq/indeksi-i-integritetit-te-institucioneve-publike-janar-2024/

DOKUMENT PARLAMENTAR

sipas metodologjisë së re, mbetet sfidë e vazhdueshme monitorimi dhe transparenca në realizimin e aktiviteteve që përmbajnë planet e veprimit për çdo institucion.

Zbutja e risqeve të integritetit në sektorët me risk të lartë korrupsioni

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe garantimit të procedurave institucionale me integritet, në raportin e shqyrtimit analitik për grupkapitullin I "Themeloret", i publikuar në korrik 2023[166], Komisioni Evropian ka theksuar veçanërisht, se në përgjithësi, masat kundër korrupsionit vazhdojnë të kenë një ndikim të kufizuar në sektorët veçanërisht të ndjeshëm ndaj korrupsionit: infrastruktura publike, kadastra dhe të drejtat pronësore, doganat, administrata tatimore, arsimi, shëndetësia, prokurimet publike, kontratat e partneriteteve publike-private etj. Në vlerësimin e KE-së, këta sektorë kërkojnë vlerësime të veçanta lidhur me nivelin e rrezikut ndaj shfaqjeve të korrupsionit dhe ndërhyrje të individualizuara.[167] Aktualisht, shënohen disa hapa konkrete në këtë drejtim, së pari, përmes reformimit të kuadrit ligjor me synim rritjen e garancive të integritetit, si dhe përmes angazhimeve për nisjen e analizave të thelluara sektoriale për të identifikuar dhe adresuar risqet e korrupsionit në sektorët e ndjeshëm.

2.2.2 Kuadri ligjor për adresimin e risqeve të integritetit në sektorët vulnerabël

Prokurimi publik: Në raportet më të fundit të SIGMA-s (2021, 2024), fusha e prokurimeve publike mori vlerësimin më të lartë në tre indikatorë që lidhen me cilësinë e kuadrit ligjor, kapacitetin institucional dhe administrativ qendror për të zbatuar dhe monitoruar në mënyrë efektive politikat e prokurimeve publike. Njëkohësisht është vlerësuar edhe zhvillimi i procedurave për shqyrtimin e ankesave, duke shënuar rritje të konsiderueshme në pikëzim në raport me vitin 2021.[168]

Në raport theksohet se në përgjithësi ka pasur një përmirësim të konsiderueshëm në fushën e prokurimit publik, i cili është kryesisht për shkak të miratimit të një Strategjinë Gjithëpërfshirëse të Prokurimit Publik dhe forcimin e kapaciteteve administrative të APP-së, veçanërisht në lidhje me monitorimin dhe raportimin e prokurimit publik, duke përfshirë ekzekutimin e kontratave.[169]

Ndërkohë, në përgjigje të gjetjeve të Komisionit Evropian, si në Raportin vjetor, ashtu edhe në raportin *Screening* për grupkapitullin "Themeloret", të cilat identifikuan prokurimet publike si një fushë me ndjeshmëri të lartë ndaj fenomenit të korrupsionit, janë bërë përpjekje për të forcuar mekanizmat antikorrupsion në këtë sektor përmes miratimit të ligjit nr. 16/2024 "Për disa shtesa

[166] Raporti i skanimit për grupkapitullin e I "Themeloret", *Screening Report Albania Cluster* 1 – Fundamentals , 135 pages link https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf -

[167] *Ibid* f. 48.

[168] SIGMA *Monitoring Report, The Principle of Public administration in Albania 2021,* page 157 (184 pages) link https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf

[169] SIGMA *Monitoring Reports, Public administration in Albania* 2024 *Assessment against the Principles of Public Administration* page 128 (142 pages) Link https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimet publike"[170]. Ky ligj i ri ka sjellë ndërhyrje prioritare në sektorin e prokurimeve publike, duke rritur përafrimin me *acquis* të BE-së dhe duke siguruar disa risi kyçe për të garantuar barazi në tendera, transparencë dhe forcimin e mekanizmave për të luftuar praktikat korruptive, përfshirë: (i) digjitalizimin e të gjithë sistemit të prokurimeve publike; (ii) vlerësimin automatik të përputhshmërisë me kriteret e përgjithshme dhe specifike për kualifikimin e operatorëve ekonomikë në fazën fillestare të parakualifikimit dhe (iii) profesionalizimin e të gjithë stafit të angazhuar në ciklin e prokurimeve përmes certifikimit dhe trajnimit të detyrueshëm.

Si rrjedhojë në Progres Raportin e vitit 2024 të Komisionit Evropian për Shqipërinë vlerësohet: "Kuadri ligjor për prokurimin publik është kryesisht në përputhje me direktivën e BE-së të vitit 2014 për prokurimin publik dhe prokurimin e shërbimeve komunale. Përafrimi i mëtejshëm u arrit përmes një ndryshimi në ligjin e prokurimit publik, i miratuar në shkurt 2024, duke hequr kategorinë e prokurimit të shërbimeve të konsulencës, ndër ndryshime të tjera. Ndryshimet lejojnë që kufijtë financiarë të prokurimeve të përshtaten nga qeveria. Në maj të vitit 2024, qeveria miratoi një vendim që afronte pragun me atë të përcaktuar në direktivën e BE-së. Për sa i përket parandalimit të korrupsionit në prokurimet publike, Shqipëria duhet të fokusohet në forcimin e mëtejshëm të funksionimit të sistemit për të rritur konkurrencën dhe profesionalizimin"[171]

Gjithashtu, ligji nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimet publike"", sjell ndryshime në rregullimin e konfliktit të interesave, duke përcaktuar qartë detyrimin që autoritetet ose subjektet kontraktuese të marrin masa të përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit që lindin gjatë procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave. Ata duhet ta realizojnë këtë në përputhje me legjislacionin aktual, për të shmangur deformimin e konkurrencës, si dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Për më tepër, një sërë masash specifike që synojnë integritetin në procesin e prokurimeve publike janë parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe Planin e saj të Veprimit 2024-2027, e cila u miratua me VKM-në nr. 304, datë 22.5.2024.[172] Aktivitetet e tjera të planifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë përfshijnë zhvillimin e një Plani Integriteti Model për të gjitha Autoritetet Kontraktuese, me vëmendje të veçantë në integritetin e procesit të prokurimeve publike. Këto plane do të zbatohen, gjithashtu, në nivele përtej administratës qendrore.

[170] Ligjit nr. 16/2024, datë 8.2.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimet publike"".
[171] Progresraporti i BE-së 2024, *EU Progress Raport for Albania*, 2024, page 57 (103 *pages*) *link*: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf –
[172] VKM nr. 304, datë 22.5.2024 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj 2024-2027", *Fletore Zyrtare* nr. 89, 2024, f. 10131, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/89/1961ec46-defd-44fb-878f-669ff7901820

Krahas kësaj, Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 përfshin posaçërisht *përmirësimin e Sistemit Elektronik të Prokurimeve*, i cili parashikon shtimin e funksionaliteteve për identifikimin e *flamujve të kuq* për të shmangur praktikat korruptive, përfshirë edhe përdorimin e teknologjisë së avancuar të inteligjencës artificiale dhe proceseve robotike. Për të përmirësuar kapacitetet profesionale të stafit me fokus në integritetin e prokurimeve publike, janë organizuar aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin mbi rrezikun e korrupsionit në prokurimet publike. Në kuadër të reformës së përgjithshme të proceseve të prokurimit publik, e cila mori një shtysë të re përmes miratimit të ligjit nr. 16/2024, është forcuar edhe rregullimi për konfliktin e interesit. Ky ligj detyron autoritetet kontraktuese të parandalojnë, identifikojnë dhe zgjidhin në mënyrë proaktive konfliktet e interesit, në përputhje me legjislacionin ekzistues, duke ruajtur integritetin e proceseve të prokurimit si një fushë e identifikuar me rrezik të lartë korrupsioni.

Inspektimi publik

Si pjesë e reformës së Inspektorateve, e nisur nga Inspektorati Qendror, miratimi i ligjit të ri për inspektimet, pas konsultimeve publike, është parashikuar si një masë që do të thellojë luftën kundër praktikave korruptive në sektorët vulnerabël. Ky ligj do të ristrukturojë plotësisht inspektimet publike, duke mundësuar që të gjitha organet e inspektimit t'i nënshtrohen një reforme gjithëpërfshirëse që synon jo vetëm standardizimin e proceseve të inspektimit, bazuar në vlerësimin e riskut, por edhe rritjen e profesionalizmit të inspektorëve për të eliminuar mundësitë për korrupsion dhe/ose abuzim.
Relacioni që shoqëron ligjin e ri "Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë" ka evidentuar disa sfida kritike që kanë ndikuar negativisht në efektivitetin dhe transparencën e proceseve inspektuese. Ndër problematikat kryesore përfshihen: mungesa e një procesi objektiv për përzgjedhjen e subjekteve të inspektimit, që aktualisht bazohet në një qasje subjektive dhe jo në vlerësimin e riskut, duke krijuar mundësi për abuzim dhe korrupsion; ndikimi i jashtëm dhe politik në vendimmarrjen inspektuese, që ka cenuar pavarësinë dhe integritetin e inspektorëve; mungesa e besueshmërisë në komisionet e ankesave, ku vetëm 6% e vendimeve përfundimtare i nënshtrohen apelimit administrativ; dhe mungesa e trajnimit dhe profesionalizmit të inspektorëve, gjë që i bën ata të ndjeshëm ndaj presioneve dhe abuzimeve. Këto problematika theksojnë nevojën për ndërhyrje në strukturën dhe procedurat ekzistuese të inspektimeve, për të garantuar një sistem inspektimi transparent dhe të bazuar në integritet. Përkundër miratimit në Kuvend, ligji nr. 99/2024 është kthyer nga Presidenti i Republikës për rishqyrtim.[173]

Policia e Shtetit

Policia e Shtetit Shqiptar është identifikuar vazhdimisht si një sektor me rrezik për integritetin në gjetjet e Komisionit Evropian. Si pjesë e përpjekjeve të Shqipërisë për të përmbushur

[173] Dekret nr. 357, datë 10.10.2024 "Për kthimin e ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"", https://president.al/presidenti-begaj-dekreton-kthimin-e-ligjit-nr-99-2024/.

Rekomandimet e Raundit V të GRECO-s, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit" më 25 korrik 2024.[174] Ky ligj i ri adreson disa rekomandime kyçe, veçanërisht rekomandimet xiii, xiv, xvii, xviii dhe xxiii, të cilat, mes të tjerash, targetojnë:

- **Zbatimin e politikave** që adresojnë në mënyrë të duhur rreziqet e korrupsionit dhe konfliktit të interesit në ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës.
- **Miratimin e rregullave** për të eliminuar ose të paktën kufizuar rreziqet e korrupsionit dhe konfliktit të interesit të lidhura me donacionet ose sponsorizimet private për policinë.
- **Krijimin e një sistemi** dhe emërimin e individëve të trajnuar dhe të besuar për të ofruar këshillim konfidencial mbi çështjet e etikës dhe integritetit për të gjithë stafin e policisë.
- **Hartimin e rregullave të qarta** për kufizimet pas punësimit për oficerët e policisë në funksion të integritetit dhe luftimit të korrupsionit në Policinë e Shtetit.
- **Etika dhe integriteti:** Pavarësisht miratimit të Manualit për Etikën dhe Integritetin në Policinë e Shtetit, në vlerësimin e vitit 2022 të GRECO-s, ai është thjesht një përmbledhje e teksteve ligjore dhe i mungojnë udhëzimet praktike me shembuj dhe shpjegime konkrete për sjelljen e pritshme të punonjësve të policisë.[175]Në zbatim të Rekomandimit xvi),[176] manuali i ri i miratuar trajton specifikisht etikën, integritetin dhe korrupsionin; etikën dhe konfliktin e interesit; policimin etik; vendimmarrjen etike, dhe barazinë gjinore, mosdiskriminimin dhe integritetin.[177] Manuali është bërë, gjithashtu, pjesë e trajnimeve dhe është zhvilluar një modul trajnimi për t'iu transmetuar të gjithë punonjësve të policisë si pjesë e programit "Për sinjalizimin, hetimin administrativ dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe rregullat e etikës dhe sjelljes për oficerët e Policisë së Shtetit", i miratuar me vendimin nr. 634, datë 29.5.2023, të zyrës së dekanit të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimeve në Akademinë e Sigurisë.
    - **Vetëdeklarimi:** Procesi i verifikimit të integritetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, u thellua më tej në qershor 2024 me miratimin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të datës 17.06.2024 për miratimin dhe zbatimin e 'Formularit të vetëdeklarimit'. Ky procesi synon të pastrojë strukturat e Policisë nga individë që shkelin ligjin dhe integritetin e organizatës. Në kuadër të këtij procesi, çdo punonjës i Policisë së Shtetit vetëdeklaroi të dhëna të rëndësishme për sigurinë, duke përfshirë:
        - dënimet ose hetimet penale si brenda, ashtu edhe jashtë vendit;
        - shkeljet e rregullave të sigurisë së informacionit të klasifikuar;
        - marrëdhëniet me persona të përfshirë në krimin e organizuar.[178]

[174] Ligj nr. 82, datë 26.7.2024 "Për Policinë e Shtetit", *Fletore Zyrtare* nr. 141, 2024, f. 17620, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/141/1b120f4d-3fa8-4ecb-a8b0-889ee054599f

[175] GRECO, Raundi V i Vlerësimit "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit", Raporti i Përputhshmërisë, 2022, f. 17, https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6124;

[176] Rekomandimi xvi): GRECO ka rekomanduar që parimet etike dhe rregullat e sjelljes të përfshira në Rregulloren e Policisë së Shtetit të plotësohen me një manual që përmban udhëzime praktike që merr parasysh specifikat e Policisë së Shtetit, shumëllojshmërinë e detyrave dhe dobësitë.

[177] Policia e Shtetit, Manuali i Etikës Policore, miratuar me urdhrin nr. 980, datë 30.6.2023, të drejtorit të Përgjithshëm, https://asp.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Manuali-i-Etikes-Policore.pdf

[178] https://asp.gov.al/thellohet-procesi-i-verifikimit-te-integritetit-te-punonjesve-te-policise-se-shtetit/

DOKUMENT PARLAMENTAR

- **Donacionet**: Në zbatim të Rekomandimit xiii) të lënë nga GRECO,[179] është finalizuar analiza e detajuar e strukturës ligjore lidhur me dhuratat dhe sponsorizimet për Policinë e Shtetit, në bashkëpunim me asistencën teknike të zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, mbi bazën e së cilës janë hartuar parashikimet specifike për dhurimet edhe në ligjin e ri "Për Policinë e Shtetit". Dokumenti i analizës i përgatitur për këtë qëllim ofron informacion të detajuar mbi të gjitha fazat e procesit të donacioneve, çështjet e lidhura me konfliktin e interesit dhe aspektet që lidhen me transparencën dhe raportimin. Analiza merr parasysh kuadrin ligjor aktual të zbatuar nga strukturat e policisë, rastet praktike nga vitet 2021-2022-2023, dhe rekomandimet përkatëse për veprim. Gjithashtu, aktualisht, çdo dhuratë ose sponsorizim privat dhënë PSH-së publikohet rregullisht në faqen zyrtare.[180]
- **Ofrimi i shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës:** Miratimi i VKM-së nr. 591/2022 "Për miratimin e llojeve të shërbimeve shtesë që ofron Policia e Shtetit dhe tarifat e pagesës për personat juridikë e fizikë, publikë apo privatë"[181] është vlerësuar pozitivisht nga GRECO. Sipas parashikimeve të VKM-së, çdo person mund të bëjë një kërkesë online për ofrimin e shërbimeve nga Policia e Shtetit dhe brenda 48 orëve mund të marrë një përgjigje për pranimin ose refuzimin. Shërbimet janë të lidhura me organizimin e ngjarjeve kulturore e sportive kombëtare ose ndërkombëtare, përdorimin e uniformës së policisë, armëve, automjeteve dhe ambienteve për qëllime kinematografike, shoqërimin e mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshme, mbrojtjen dhe sigurinë e përkohshme të subjekteve strategjike ose investimeve. Në përgjigje të shqetësimit të GRECO-s për mungesën e një vlerësimi të rreziqeve të korrupsionit dhe konflikteve të interesit lidhur me ofrimin e shërbimeve me pagesë nga Policia e Shtetit, është realizuar një analizë që identifikon rreziqet që mund të lindin në situata ku policia ofron shërbime me pagesë për individë privatë dhe thekson nevojën për ndryshime në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me këto rreziqe. Nëpërmjet konkluzioneve të analizës janë propozuar gjashtë rekomandime për të forcuar më tej sistemin e ofrimit të shërbimeve me pagesë nga Policia e Shtetit. Të gjitha këto rekomandime janë pasqyruar në ligjin e ri për Policinë e

[179] Rekomandimi xiii): GRECO ka rekomanduar (i) që të kryhet një analizë e gjerë mbi kuadrin ligjor dhe praktikën e dhurimeve dhe sponsorizimeve private për Policinë e Shtetit dhe që, nën dritën e gjetjeve të saj, të miratohen rregulla për të hequr dorë nga dhurimet/sponsorizimet private për Policinë ose, si minimum, të kufizohen rreziqet e korrupsionit dhe konfliktet e interesit në këtë drejtim; dhe (ii) që dhurimet dhe sponsorizimet e marra të publikohen në baza të rregullta (përfshirë edhe në internet), duke treguar natyrën dhe vlerën e secilit dhurim si dhe identitetin e donatorit.

[180] Dhurimet publikohen rregullisht në Faqen Zyrtare të Policisë së Shtetit, *link*: https://asp.gov.al/category/donacione/

[181] VKM nr. 591, datë 7.9.2022 "Për miratimin e llojeve të shërbimeve shtesë që ofron Policia e Shtetit dhe tarifave të pagesës për personat juridikë e fizikë, publikë ose private", *Fletore* Zyrtare nr. 121, 2022, f. 15839, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2022/121/72e4a5b9-74c2-4826-9941-0715d9d217ef

DOKUMENT PARLAMENTAR

Shtetit.[182] Në vijim, pritet miratimi i akteve të tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji të ri, si dhe trajtimi i rekomandimeve të tjera të identifikuara në dokumentin e analizës.[183]

2.2.3 Vlerësimi i riskut në sektorët vulnerabël

Një sërë masash janë parashikuar në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030[184] për kryerjen, deri në vitin 2025, e vlerësimit të risqeve të integritetit dhe korrupsionit në nivel sektorësh, pasuar nga hartimi i planeve të veçanta për reduktimin e tyre. Sektorë të tillë përfshijnë pronat, shëndetësinë, arsimin, prokurimet publike e PPP-të, si dhe tatimet dhe doganat. Synimi final i këtij procesi që përfshin shumë sektorë është ulja deri në vitin 2030 e rasteve të korrupsionit. Kjo do të arrihet edhe përmes matjes, çdo vit, të efektivitetit të ndërhyrjeve që janë parashikuar në bazë të treguesve të performancës të Strategjisë së re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit deri në vitin 2030.[185] Në përgjigje të këtij rekomandimi, Strategjia Antikorrupsion 2024-2030 u hartua mbi bazën e përpjekjeve ekzistuese, duke përfshirë një metodologji të standardizuar për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit, që është e zbatueshme në të gjithë sektorët që përballen më shumë me këtë fenomen.

[182] Konkretisht::
- Neni 2, pika "d" e ligjit i referohet mes objekteve të ligjit edhe "përcaktimit të formave të bashkëpunimit të Policisë së Shtetit me komunitetin dhe subjekte të tjera publike e private";
- Neni 121, pika 2, shkronja "c", parashikon si shkeljen disiplinore ushtrimin e veprimtarive me pagesë, jashtë funksionit, pa miratim paraprak me shkrim të eprorit;
- Neni 128, pika 2: "Policia e Shtetit bashkëpunon me organizatat që operojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, bashkësitë fetare të njohura me ligj, organizatat jofitimprurëse dhe shoqatat për të krijuar partneritet për rendin dhe sigurinë publike", dhe pika 4: "Policia e Shtetit bashkëpunon me institucionet e sigurisë publike dhe administratës shtetërore, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, me përmbaruesit gjyqësorë, me personat fizikë e juridikë, me shoqërinë civile, me përfaqësuesit e komuniteteve fetare, me komunitetin, si edhe me organe apo subjekte të tjera, sipas përcaktimeve në legjislacionin e posaçëm në përmbushjen e funksioneve të saj".

[183] Rekomandimet janë:
- Rekomandim: Ndryshimi i urdhrit nr. 442, datë 21.3.2023, të Drejtorit të Policisë, "Për procedurat standarde operative për ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit për personat juridikë, fizikë, publikë ose privatë, kundrejt pagesës", për të përfshirë të gjitha shërbimet me pagesë të ofruara nga Policia e Shtetit.
- Rekomandim: Ndryshimi i ligjit nr. 19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike", për të minimizuar fleksibilitetin në përcaktimin e rasteve të veçanta kur certifikata e sigurisë nuk mund të jepet.
- Rekomandim: Përfshirja e një vlerësimi të rrezikut për korrupsion dhe konflikt interesi për të gjitha shërbimet me pagesë të policisë (për çdo shërbim veçmas) në një vlerësim periodik institucional të rrezikut për korrupsion.
- Rekomandim: Bërja publike e informacionit mbi ofrimin e shërbimeve me pagesë nga Policia e Shtetit (data e ofrimit, natyra e shërbimeve të ofruara, emri i marrësit të shërbimit, të ardhurat e gjeneruara, burimet njerëzore të policisë të caktuara për të ofruar këtë shërbim, etj., për të siguruar më shumë transparencë dhe mbikëqyrje nga publiku.
- Rekomandim: Kryerja e auditimeve financiare vjetore të të ardhurave të mbledhura nga shërbimet me pagesë, me publikimin e detyrueshëm të gjetjeve.

[184] VKM nr. 736, datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës 2023-2030", *Fletore Zyrtare* nr. 184, 2023, f. 22064, link: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2023/184/22ae40e9-b540-4041-90c8-ec7a09bc33b1

[185]VKM nr. 859, datë 26.12.2024, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës", *Fletore Zyrtare* nr. 225, 2024, f. 26751, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/225/9f19ef0c-97b3-43c9-aa8f-e2181147b789

DOKUMENT PARLAMENTAR

Në përputhje me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030[186] është duke u realizuar vlerësimi sektorial i rrezikut në fushën e prokurimit publik, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, si dhe Autoritetin Kombëtar Italian Antikorrupsion (ANAC). Nga ana tjetër, në bazë të pohimeve nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është evidentuar nisja e vlerësimit të rrezikut në fushën e të drejtave pronësore.[187] Në këtë drejtim, Plani i Veprimit Antikorrupsion 2024-2026 parashikon hartimin e raporteve të detajuara mbi vlerësimin e rrezikut dhe zbatimin e planeve specifike të integritetit për çdo sektor të identifikuar. I njëjti proces do të shtrihet pas vitit 2024 edhe në sektorë të tjerë të ndjeshëm, duke përfshirë një vlerësim vjetor të performancës në nivel sektorësh për të garantuar efektivitetin e ndërhyrjeve strategjike.
Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion po harton një manual për vlerësimin e rrezikut në sektorin publik, i cili do të përshtatet për sektorë që janë identifikuar se preken më shumë nga korrupsioni, siç është sektori i të drejtave të pronësisë, shëndetësia, arsimi, doganat, tatimet, prokurimi publik dhe partneritetet publik-private.

2.2.4 Qasja individuale për promovimin dhe garantimin e integritetit në administratën publike

Dekriminalizimi - Integriteti i personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike

Sigurimi i integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike përbën një shtyllë kyçe në garantimin e besimit të publikut dhe funksionimin e drejtë të institucioneve shtetërore. Për këtë arsye, lidhur me integritetin e administratës publike, ka pasur një përpjekje të hershme për të rregulluar, përmes një kuadri ligjor të mirëpërcaktuar, shmangien e individëve të papërshtatshëm për të punuar në administratën publike. Ky proces ka filluar që me miratimin e ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike e të zgjedhurve"[188], por që u shfuqizua me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 9/2010[189]. Kjo qasje është përforcuar në vitet në vijim, kur Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2015 miratoi ligjin nr. 137/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"",[190] të ndryshuar, i cili ndalon zgjedhjen, emërimin apo ushtrimin e një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në Kushtetutë, ose të krijuara

[186] *Ibid*.
[187] Ministri i Shtetit Për Administratën Publike Dhe Antikorrupsionin, *"Raport mbi ecurinë në luftën kundër korrupsionit dhe reformën në administratën publike* në zbatim të Raportit të Komisionit Evropian 2023, raportit për shqyrtimin analitik për grupkapitullin I "Themeloret", dhe angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Udhërrëfyesve për Shtetin e së Drejtës dhe Reformës në Administratën Publike*".*
[188] Ligj nr. 10034, datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve", *Fletore Zyrtare* nr. 202, 2008, f. 10929, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2008/202/a6ba8cc7-1f26-408b-901b-c505ec0e2ec5
[189] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9 datë 23.3.2010 Me objekt a) Shpallja si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr.10 034, datë 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve"; b) Pezullimi i zbatimit të ligjit deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese (Fletore Zyrtare nr. 42, Viti 2010, Faqe 1527) *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2010/42/fb10533c-9ee6-4caf-92d6-487b64966536
[190] Ligj nr. 137/2015. datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"", të ndryshuar. *Fletore Zyrtare* nr. 219, 2015, f. 14419, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2015/219/94d56b33-bc2c-4723-bb1f-5635e82b23a0

me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të Kushtetutës, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, miratoi më pas ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"[191], i ndryshuar, si dhe vendimin e Kuvendit të RSH-së nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"" (dekriminalizimit)[192]. Qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike. Kjo arrihet përmes pengimit të zgjedhjes, emërimit dhe largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të RSH-së, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë një vepër penale, duke përfshirë këtu dhe veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike. Ky ligj përcakton mekanizmat për kontrollin e figurës së nivelit drejtues në administratë publike, si dhe kohëzgjatjen për të ushtruar një funksion publik nëse dikush dënohet, në varësi të afateve të ndalimit që parashikon ligji. Nëse të dhënat përfshihen brenda afatit të ndalimit të parashikuar nga ligji, DAP-i përcjell vendimin e prokurorisë, institucionit ku është i punësuar subjekti vetëdeklarues, të cilët janë të detyruar të marrin masat administrative për lirimin e tij nga detyra. Këto afate ndalimi për emërim në funksione publike variojnë nga ndalimi për emërim/kandidim/zgjedhje apo ushtrim të detyrës gjatë gjithë jetës; 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg; 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg; si dhe nga momenti i përfundimit të dënimit me burg deri në momentin e rehabilitimit të personit, sipas dispozitave të Kodit Penal, duke kontribuar kështu në garantimin e integritetit të institucioneve publike dhe besimin e publikut në administratën shtetërore.

Bazuar në këtë kuadër ligjor dhe rregullator, sa i takon garantimit të zbatimit të tij në administratën publike, DAP-i është organi përgjegjës për administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit të dorëzuar nga nëpunësit civil, shërbimi diplomatik dhe drejtues në administratën publike qendrore dhe vendore.[193] Nga viti 2021 deri në shtator 2024, DAP-i ka administruar

[191]Ligjin Nr. 138/2015, datë 17.12.2015 Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", *Fletore Zyrtare* nr. 220, 2015, f.1447, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2015/220/29f99967-2614-4ca4-a6c4-834dd9dd7d41

[192] Vendim nr. 17, datë 4.3.2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"", *Fletore Zyrtare* nr. 38, 2016, f. 2799, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2016/38/b79eaae2-84b4-406f-8863-5a29b3060ed0

[193] Përkatësisht:

- Nëpunës në shërbimin civil;
- Nëpunës në shërbimin diplomatik (diplomat, konsull, këshilltar dhe sekretar ambasade, ministër fuqiplotë);
- Drejtues të çdo niveli në administratën publike të nivelit qendror dhe vendor që nuk përfshihen në shërbimin civil (përgjegjës, dhe drejtor në institucione me Kod Pune, nënkryetar bashkie, përgjegjës, drejtor në shoqëritë tregtare që administrohen totalisht apo në mazhorancë nga shteti (me përjashtim të funksionarëve politikë, zëvendësministrave, deputetëve, kryetarë dhe këshilltarë bashkiakë, ministra etj.).

gjithsej 8580 formularë vetëdeklarimi.[194] Gjatë kësaj periudhe, një numër i konsiderueshëm subjektesh kanë rezultuar në kushtet e ndalimit (2021: 13 subjekte; 2022: 14 subjekte; 2023: 20 subjekte; janar-shtator 2024: 14 subjekte). Po ashtu, për verifikim në Prokurorinë e Përgjithshme janë përcjellë gjithsej 219 subjekte.
Në përgjithësi, edhe nga monitorimet e përditësuara të organizatave të shoqërisë civile, pranohet se miratimi i ligjit ka pasur një ndikim pozitiv, duke ndaluar përfshirjen e një numri të konsiderueshëm individësh me të shkuar kriminale në pozita publike si deputetë, kryetarë bashkie dhe funksionarë të lartë të administratës.[195]

Njëherësh, në kuadër të kuadrit të ri strategjik të luftës kundër korrupsionit që u miratua në 2024 (Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030),[196] integritetit të nëpunësve publikë i është kushtuar Objektivi Specifik 1.2: "Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes". Konkretisht, masat e parashikuara përfshijnë: a)vlerësimin e numrit të institucioneve që kanë përgatitur vlerësime të riskut të korrupsionit dhe plane të integritetit, b)përgatitjen e një manuali për hartimin e këtyre planeve dhe shpërndarjen e tij, si dhe c) përgatitjen e ndryshimeve në Kodin Etik Ministror për të forcuar kuadrin etik dhe të integritetit. Këto masa përfshijnë gjithashtu edhe elemente të tilla si: a)miratimin e kodeve të sjelljes dhe zbatimin e planeve të integritetit nga ministritë e linjës dhe nga ministrat e shtetit; b)rishikimin e metodologjisë për monitorimin e zbatimit të këtyre planeve; c)integrimin e regjistrit të riskut të korrupsionit në regjistrin e riskut institucional; d)krijimin e një databaze qendrore për nëpunësit civilë të sanksionuar; e) përgatitjen e hapave për monitorimin dhe raportimin e planeve të integritetit përmes sesioneve informuese dhe trajnimeve.

Masat disiplinore për shkeljet e kuadrit ligjor dhe rregullator për nëpunësin civil

Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil"[197] parashikon në kreun X të tij edhe disiplinën në shërbimin civil, përgjegjësitë për masa disiplinore për nëpunësit civilë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre për mosplotësimin e detyrave, për thyerjen e disiplinës në punë dhe të rregullave të etikës, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji duke i klasifikuar në: a) Shkelje shumë të rënda; b) Shkelje të rënda; c) Shkelje të lehta. Disiplina në shërbimin civil është detajuar më tej edhe me

[194] 2021: 2400 formularë; 2022: 2500 formularë; 2023: 2000 formularë; janar-shtator 2024: 1680 formularë.
[195] Instituti i Studimeve Politike, Raport Monitorimi "Dekriminalizimi në Shqipëri 2024 - Gjetje mbi sjelljen e partive dhe institucioneve mbi standardet e dekriminalizimit/integritetit", f. 4, https://dekriminalizimi.isp.com.al/wp-content/uploads/2024/09/ISP-Dekriminalizimi-dhe-integriteti-Raporti-2024-3.pdf. Gjithashtu, ecuria e zbatimit të ligjit monitorohet rregullisht në platformën https://dekriminalizimi.isp.com.al/
[196] VKM nr. 859, datë 26.12.2024 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të perfomancës", *Fletore Zyrtare* nr. 225, 2024, f. 26751, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/225/9f19ef0c-97b3-43c9-aa8f-e2181147b789
[197] Ligji nr. 152/2013, datë 30.5.2013 "Për nëpunësin civil", *Fletore Zyrtare* nr. 95, 2013, f. 3952, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2013/95/eabda600-7462-4acf-8ecf-c886525ec91b

VKM-në nr. 115, datë 5.3.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil"[198], i ndryshuar

Në lidhje me të drejtën e ankimimit, ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nuk parashikon një organ administrativ më të lartë ku nëpunësi civil mund të ushtrojë ankimimin administrativ sipas dispozitave të nenit 129 të Kodit të Procedurës Administrative. Bazuar në pikën 3 të neni 41, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, çdo nëpunës civil ka të drejtën e ankimit para gjykatës kompetente për mosmarrëveshjet administrative kundër çdo veprimi ose mosveprimi që cenon të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm në marrëdhënien e shërbimit civil.

Nga të dhënat e paraqitura[199] mbi masat disiplinore në administratën shtetërore nga viti 2019 deri më 2024, vërehet një ulje e ndjeshme në numrin e këtyre masave. Ndërsa në vitin 2019 u dhanë 186 masa disiplinore, deri në vitin 2023 ky numër pothuajse u përgjysmua, duke u ulur në 97 masa. Megjithëse në vitin 2023 u shënua një rritje krahasuar me vitet e mëparshme, deri në gusht të vitit 2024, numri i masave disiplinore vazhdon të jetë më i ulët se mesatarja e viteve të mëparshme, me vetëm 35 masa të regjistruara.

[198] VKM nr. 115, datë 5.3.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil", *Fletore Zyrtare* nr. 31, 2014, f. 728, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2014/31/d3114229-c0c2-49ec-ac80-168e72ac5752

[199] Të dhënat janë administruar nga Raportet Vjetore të Departamentit të Administratës Publike për vitet 2019-2023, dhe nga përditësimi i marrë nga DAP për ecurinë e proceseve disiplinore për periudhën Janar-Gusht 2024:

- Për vitin 2019: Gjatë vitit 2019, u dhanë gjithsej 186 masa disiplinore për nëpunësit civilë të administratës shtetërore, nga të cilat 49 ishin "Vërejtje", 45 ishin "pezullim i të drejtës për çdo lloj promovimi, përfshirë në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet", 46 masa "mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj", dhe 46 masa "largim nga shërbimi civil". Nga të gjitha këto masa, 60 masa u dhanë për shkeljen e rregullave të etikës.
- Për vitin 2020: Gjatë vitit 2020, u dhanë gjithsej 66 masa disiplinore për nëpunësit civilë të administratës shtetërore, nga të cilat 10 ishin "Vërejtje", 27 ishin "pezullim i të drejtës për çdo lloj promovimi, përfshirë në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet", 16 masa "mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj", dhe 13 masa "largim nga shërbimi civil". Nga të gjitha këto masa, 16 masa u dhanë për shkeljen e rregullave të etikës.
- Për vitin 2021: Gjatë vitit 2021, u dhanë gjithsej 70 masa disiplinore për nëpunësit civilë të administratës shtetërore, nga të cilat 19 ishin "Vërejtje", 20 ishin "pezullim i të drejtës për çdo lloj promovimi, përfshirë në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet", 13 masa "mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj", dhe 18 masa "largim nga shërbimi civil". Nga të gjitha këto masa, 24 masa u dhanë për shkeljen e rregullave të etikës.
- Për vitin 2022: gjatë vitit 2022, u dhanë gjithsej 68 masa disiplinore për nëpunësit civilë të administratës shtetërore, nga të cilat 19 ishin "vërejtje", 27 ishin "pezullim i të drejtës për çdo lloj promovimi, përfshirë në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet", 3 masa "mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj", dhe 19 masa "largim nga shërbimi civil". Nga të gjitha këto masa, 17 masa u dhanë për shkeljen e rregullave të etikës.
- Për vitin 2023: gjatë vitit 2023, u dhanë gjithsej 97 masa disiplinore për nëpunësit civilë të administratës shtetërore, nga të cilat 13 ishin "vërejtje", 53 ishin "pezullim i të drejtës për çdo lloj promovimi, përfshirë në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet", 4 masa "mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj", dhe 27 masa "largim nga shërbimi civil". Nga të gjitha këto masa, 10 masa u dhanë për shkeljen e rregullave të etikës.
- Për vitin 2024 deri më 31 gusht u dhanë gjithsej 35 masa disiplinore për nëpunësit civilë të administratës shtetërore, nga të cilat 10 masa ishin "vërejtje", 12 masa ishin "pezullim i të drejtës për çdo lloj promovimi, përfshirë në shkallën e pagës, për një periudhë deri në dy vjet", 2 masa "mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj", dhe 11 masa "largim nga shërbimi civil". Nga të gjitha këto masa, 10 masa u dhanë për shkeljen e rregullave të etikës.

Ecuria e masave disiplinore për periudhën 2015 - 2023



Këto të dhëna tregojnë për një trend të përgjithshëm dhe të qëndrueshëm në kohë të uljes së shkeljeve disiplinore në shërbimin civil shqiptar si atyre etike, ashtu edhe për të tjera shkelje të disiplinës në punë.

Verifikimi i aseteve, interesave private dhe konfliktit të interesit. Kontrolli i konfliktit të interesit

Një nga iniciativat më të hershme që lidhen me forcimin e integritetit brenda administratës publike ishte miratimi i një kuadri ligjor institucional për parandalimin e konfliktit të interesit, që është një nga çështjet më të ndjeshme. Kontrolli i konfliktit të interesit përbën një nga mekanizmat më të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe një mjet për mbrojtur interesin e publikut gjatë ushtrimit të detyrës shtetërore. Në administratën publike dhe sektorin privat, konflikti i interesit lind kur një individ është në pozicion për të ndikuar në vendime që mund t'i sjellin përfitime vetjake ose familjarëve të tij, në kurriz të interesit publik. Identifikimi dhe menaxhimi efektiv i këtyre situatave është thelbësor për të parandaluar korrupsionin dhe për të garantuar një administratë të ndershme, transparente dhe të besueshme.

Legjislacioni shqiptar në fuqi, i cili trajton aspekte të ndryshme të konfliktit të interesit, është shumë kompleks dhe i shtrirë në disa akte. Ligji kuadër është ligji nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike"[200], i ndryshuar. Miratimi i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006[201]; ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006[202] dhe me ligjin nr.

[200] Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" *Fletore Zyrtare* nr. 31, 2005, f. 1147, l*ink:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2005/31/64002647-b532-41e8-ac13-a458f25f72e7

[201] Ligj nr. 9475, datë 9.2.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", *Fletore Zyrtare* nr. 19, 2006, f. 618, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2006/19/152c3cb0-440d-4bef-8032-b7dbcaeca807

[202] Ligj nr. 9529, datë 11.5.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"", *Fletore Zyrtare* nr. 56, 2006, f. 1603, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2006/56/6418efe6-f280-4457-86eb-e33dc30a527f

44/2014, datë 24.4.2014[203], u pasua me ndryshime institucionale ku Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive (ILDKP) iu shtua edhe funksioni i parandalimit të konfliktit të interesit (ILDKPI). Ligji kuadër e përcakton konfliktin e interesit si një situatë konflikti midis detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, ku ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta që ndikojnë, mund të ndikojnë, ose duket se ndikojnë, në përmbushjen në mënyrë të gabuar të përgjegjësive dhe detyrave të tij publike. Ndërkohë, në çdo institucion publik, në bazë të udhëzimeve të ILDKPI-së, u ngrit struktura përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike.[204]
Ligji nr. 9367/2005 "Për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, parashikon një gamë të gjerë interesash private që duhet të deklarohen, të cilat përfshijnë: a) të drejtat pronësore dhe detyrimet e çdo lloji, çdo marrëdhënie tjetër juridike civile; b) dhuratat, premtimet, favorizimet, trajtimet preferenciale; c) negociatat e mundshme për punësim në të ardhmen nga zyrtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij ose negociatat për çdo lloj tjetër marrëdhënieje me interes privat për zyrtarin pas largimit nga detyra e ushtruar prej tij gjatë ushtrimit të funksionit; d) angazhimet në aktivitet privat me qëllim përfitimi ose çdo lloj aktiviteti që krijon të ardhura, si dhe angazhimet në organizata për përfitim dhe jo për përfitim, e) sindikata ose organizata profesionale, politike ose shtetërore dhe çdo organizatë tjetër; f) marrëdhëniet familjare ose bashkëjetesa komunitare; g) etnike; fetare; marrëdhënie të njohura miqësie ose armiqësi; h) angazhimet e mëparshme nga të cilat kanë lindur ose lindin interesa.

Gjithashtu ai parashikon ndalimet e interesave private, si: a) *ndalimi/kufizimet e lidhjes së kontratave me autoritetet publike; b)ndalimi i marrjes së të ardhurave për shkak të funksionit ose pozicionit; c)ndalimi i marrjes së dhuratave, favorizimeve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale; ndalimi i interesave indirekte; kufizimet e interesave për personat e lidhur me zyrtarin publik*. Kufizimet e interesave private të përcaktuara posaçërisht në këtë ligj zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit që kufizimi që aplikohet është ai më i rrepti.

Megjithatë, kuadri ligjor dhe rregullator është edhe më i gjerë, ku përfshihen veçanërisht aktet ligjore e nënligjore të tilla si:
Ligji nr. 9049/2003 datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë"[205];

[203] Ligji nr. 44/2014. datë 24.4.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"", *Fletore Zyrtare* nr. 70, 2014, f. 2614, *link* :https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2014/70/8802df8e-e954-43f3-b990-922fc3a7514a
[204] Urdhër nr. 1 i ILDKPI-së, datë 27.6.2014 "Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike", *Fletore Zyrtare* nr. 99, 2014, f. 3875, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2014/99/236d4967-e949-4eb5-baa5-5d86b88a45e0
[205] Ligji nr. 9049/2003 datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike", *Fletore Zyrtare* nr. 31, 2003, f. 1005, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2003/31/bd7c2c42-4548-4a30-8b4e-6c1c38b73963

Ligji nr. 9131/2003, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"[206];
VKM-ja nr. 830/2013, datë 15.9.2013"Për Kodin e Sjelljes Ministror";[207]
Ligji nr. 138/2015 datë 17.12.2015 "Për garantimin e integritetit të personave të zgjedhur, të emëruar ose që ushtrojnë funksione publike";[208]
Vendimi i Kuvendit nr. 61/2018, datë 5.4.2018 "Për Kodin e Sjelljes së deputetëve të Kuvendit"[209];
VKM-ja nr. 874, datë 29.09.2021 "Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike[210]".
Si pasojë e një sistemi kaq të ndërlikuar ligjor dhe rregullator, harmonizimi dhe koherenca e tij janë një domosdoshmëri përmes ndërhyrjeve të duhura, me qëllim për të mundësuar një zbatim efektiv dhe në kohë në administratën publike.
Dy janë kategoritë kryesore të nëpunësve dhe funksionarëve publikë, veprimtaria e të cilëve rregullohet përmes këtij kuadri ligjor dhe rregullator gjithëpërfshirës:

(a) Konflikti i interesit në shërbimin civil

Legjislacioni shqiptar për shërbimin civil parashikon dispozita të qarta për shmangien e konfliktit të interesit, duke përcaktuar detyrimin e nëpunësve civilë për të siguruar që interesat e tyre private të mos bien në kundërshtim me detyrimet publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre (neni 46). Në rastet kur konflikti i interesit është i vazhdueshëm, për nëpunësit e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, pezullimi nga detyra kryhet nga njësitë e burimeve njerëzore të institucionit përkatës, ndërsa për nëpunësit e Trupës së Nivelit Drejtues (TND), pezullimi kryhet nga Departamenti i Administratës Publike. Për zgjidhjen e situatave të konfliktit të interesit, ligji parashikon mundësinë e transferimit të nëpunësit në një pozicion tjetër, në rast se kjo mundëson shmangien e konfliktit. Nëse transferimi nuk e zgjidh konfliktin e vazhdueshëm të interesit, atëherë nëpunësi mund të lirohet nga detyra. Vetëm për vitin 2023, raportohet se nga 577 emërime në kategorinë ekzekutive, janë kryer 46 transferime të përhershme të lidhura me arsye shëndetësore dhe konfliktet e interesit.[211]

[206] Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", *Fletore Zyrtare* nr. 83, 2003, f. 3660, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2003/83/668538f5-52fd-4a83-9ae0-4f619471d77a
[207] VKM nr. 830, datë 15.9.2013 "Për miratimin e Kodit Etik Ministror", *Fletore Zyrtare* nr. 157, 2013, f. 7129, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2013/157/9674ef68-f494-40e4-bac5-abd7ff48688b
[208] Ligjin nr. 138/2015, datë 17.12.2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", *Fletore Zyrtare* nr. 220, 2015, f. 14471, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2015/220/29f99967-2614-4ca4-a6c4-834dd9dd7d41
[209] Vendimi i Kuvendit nr. 61/2018 datë 05.04.2018 "Për Kodin e Sjelljes së deputetëve të Kuvendit", *Fletore Zyrtare* nr. 51, 2018, f. 2960, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2018/51/118e0c7c-3e89-4db3-8fe9-00036bd7f270
[210] VKM nr. 874, datë 29.9.2021 "Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike", *Fletore Zyrtare* nr. 66, 2022, f. 849, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2022/66/9303ce41-8e58-4566-b181-102e560de033
[211] Departamenti Vjetor i Administratës Publike, Raporti Vjetor 2023, Shërbimi Civil, f. 23, *link*: https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore

Në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, janë parashikuar masa konkrete, duke përfshirë zhvillimin e moduleve të dedikuara të trajnimit për integritetin e nëpunësve civilë, për të rritur ndërgjegjësimin dhe shmangien e situatave të konfliktit të interesit.

(b) Konflikti i interesit te zyrtarët politikë/personat e ngarkuar me funksione të larta ekzekutive:

Kjo kategori përbën një nga më të rëndësishmet ku identifikohen risqet e integritetit në procesin e vendimmarrjes për politikat publike, duke qenë se në të përfshihet shpesh ndikimi i interesave private mbi funksionet publike, çka kërkon masa të posaçme për parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit. Për këtë arsye:

- Në zbatim të Rekomandimit iii) të Raundit V të GRECO-s, autoritetet shqiptare në bashkëpunim me Këshillin e Evropës kanë prodhuar (i) një Manual Shpjegues "Për rregullat e etikës për anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe Zëvendësministrat, me fokus në konfliktin e interesit" i cili ofron informacion të përditësuar mbi kuadrin ligjor dhe rregullator për parandalimin e konfliktit të interesit nga ana e zyrtarëve politikë, si dhe (ii) një Manual Shpjegues "Për Zbatimin nga ana e Anëtarëve të Këshillit të Ministrave të detyrimeve ligjore lidhur me dhuratat, favoret, premtimet dhe trajtimet preferenciale".

- Në vitin 2024, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Këshilli i Evropës kanë finalizuar hartimin e një kurrikule antikorrupsion për stafin politik të kabineteve ministrore, sipas programit të dedikuar mbi këtë temë në platformën HELP të Këshillit të Evropës. Kursi *online* i ofruar nga Këshilli i Evropës dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)"Njohuri mbi parandalimin e korrupsionit", është i përqendruar në parandalimin e konfliktit të interesit. [212]

Në fushën e konfliktit të interesave, në vitin 2020, GRECO dha disa rekomandime për Shqipërinë në Raportin e Vlerësimit të Raundit të V, të cilat lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor, zbatimin efektiv dhe rritjen e kapaciteteve të organeve përgjegjëse.[213] Gjithashtu, GRECO theksoi nevojën

[212] Kursi mund të aksesohet në linkun: https://help.elearning.ext.coe.int/enrol/index.php?id=7253

[213] Përkatësisht:

- Rekomandimi viii: Kërkon që abstenimi i një ministri ose zëvendësministri nga një vendim i Këshillit të Ministrave, për shkak të një konflikti të mundshëm interesi, të regjistrohet në procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, siç kërkohet me ligj.
- Rekomandimi ix: Kërkon që rregulla të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra të zbatohen si për anëtarët e Këshillit të Ministrave, ashtu edhe për këshilltarët politikë dhe të krijohet një mekanizëm efektiv për zbatimin e këtyre rregullave për të gjithë personat që mbajnë funksione të larta ekzekutive.
- Rekomandimi x: Kërkon që e-platforma e krijuar për deklarimin dhe publikimin e deklaratave të pasurisë dhe interesit të vihet në funksion sa më shpejt të jetë e mundur.
- Rekomandimi xi: Kërkon që të sigurohen burimet e nevojshme ligjore, njerëzore dhe financiare, në mënyrë që ILDKPKI-ja të përmirësojë kapacitetin për verifikimin efikas të deklaratave të pasurisë dhe interesave private.

DOKUMENT PARLAMENTAR

për të miratuar një qasje pro-aktive në drejtim të kontrollit administrativ dhe gjyqësor. Shumica e këtyre rekomandimeve i referohen nevojës për të siguruar funksionimin praktik të kuadrit ligjor për konfliktin e interesit, por ka edhe tri rekomandime që kërkojnë ndryshime shtesë ligjore:

1. Sigurimi që kufizimet pas-punësimit të aplikohen edhe për anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe këshilltarët politikë;
2. Miratimi i rregullave që ndalojnë dhurimet dhe sponsorizimet private për Policinë e Shtetit;
3. Zhvillimi i rregullave të qarta për kufizimet pas-punësimi të punonjësve të policisë, të shoqëruara me mekanizma efektivë për zbatimin e tyre.

Në fazën e parë të vlerësimit nga GRECO, u vërejt se dy rekomandime kryesore për ngritjen e Platformës për Deklarimin dhe Publikimin e Deklaratave të Pasurisë dhe Interesave Private, e cila e lehtëson procesin e deklarimit dhe verifikimit të deklaratave të pasurisë,[214] si dhe për eficiencën e strukturave të SPAK-ut, u vlerësuan si *"Zbatuar në mënyrë të kënaqshme"*. Në të njëjtën kohë, ky vlerësim u bë edhe për rritjen e buxhetit dhe burimeve njerëzore për ILDKPKI-në, duke përforcuar kështu kryerjen eficiente të kompetencave të saj funksionale.[215]

Në raportin e fundit kombëtar dorëzuar në GRECO, në shtator 2024, në përgjigje të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e kreut të Delegacionit Shqiptar në GRECO, ka raportuar mbi përpjekjet e autoriteteve shqiptare për adresimin e rekomandimeve të mbetura, të cilat janë trajtuar përgjatë kësaj analize. Sikurse është shkurtimisht më sipër, në Raportin e Përputhshmërisë në vitin 2022, GRECO ka vlerësuar rritjen e burimeve financiare që janë dhënë nga buxheti i shtetit për ILDKPKI-në 37% nga viti 2019 deri në vitin 2021,[216] si dhe faktin që buxheti për burimet njerëzore ka ndjekur një qasje drejt rritjes, duke kaluar nga 985 000 EUR në vitin 2019 në 1 002 166 EUR në

- Rekomandimi xii: (i) Kërkon që rekrutimi i personelit dhe stafit teknik në SPAK të përfundojë sa më shpejt dhe (ii) që të përmirësohet bashkëpunimi me ILDKPKI-në për zbatimin efektiv të raporteve për deklarimin e pasurisë dhe interesave nga personat me funksione të larta ekzekutive dhe punonjësit e policisë.
- Rekomandimi xiii: (i) Kërkon që të kryhet një analizë mbi kuadrin ligjor dhe praktikën e dhurimeve dhe sponsorizimeve private për Policinë e Shtetit dhe që të miratohen rregulla për të kufizuar rreziqet e korrupsionit dhe konfliktet e interesit në këtë drejtim. (ii) Kërkon që dhurimet dhe sponsorizimet e marra të publikohen në mënyrë të rregullt, duke përfshirë natyrën, vlerën dhe identitetin e donatorit.
- Rekomandimi xiv: Kërkon që politikat për ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës të adresojnë rreziqet për korrupsion dhe konfliktin e interesit.
- Rekomandimi xxi: Kërkon që rregullat për pranimin dhe deklarimin e dhurimeve nga stafi i policisë t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe zbatimit të duhur.
- Rekomandimi xxiii: Kërkon që të hartohen rregulla të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra, të shoqëruara nga një mekanizëm efektiv për zbatimin e tyre, për punonjësit e policisë.

[214] Megjithatë, publikimi i tyre është pezulluar në vitin 2023 nga ILDKPKI-ja për shkak të shqetësimeve të pretenduara mbi sigurinë kibernetike; raportim i autoriteteve shqiptare në kuadër të Raportit të Komisionit Evropian për Shtetin e së Drejtës, 2024, f. 14 *link* https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf

[215] VKM nr. 330, datë 22.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore "Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS", *Fletore Zyrtare* nr. 77, 2020, f. 4563, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2020/77/3d5ff78b-0605-4ef4-9673-676d45339f9e

[216] Konkretisht, në vitin 2019 janë akorduar 142 700 000 lekë (1 204 255 EUR), në vitin 2020 buxheti ka arritur në 158 500 000 lekë (1 337 953 EUR), ndërsa në vitin 2021 është rritur në 195 944 000 lekë (1 653 585 EUR). GRECO, f. 13, *link:* https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6124

vitin 2020 dhe duke arritur 1 052 666 EUR në vitin 2021.[217] Megjithatë, në raportin e shqyrtimit analitik të vitit 2023, është theksuar nevoja për të forcuar kapacitetet institucionale në verifikimin dhe vlerësimin e pasurisë dhe konfliktit të interesit.[218]
Për të adresuar këtë çështje, është propozuar hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për konfliktin e interesit, i cili tashmë është depozituar në Kuvendin e Shqipërisë. Me kërkesë të këtij të fundit, ekspertë nga Këshilli i Evropës kanë shqyrtuar projektligjin dhe, pasi kanë përfunduar vlerësimin e tyre, kanë formuluar disa rekomandime, të cilat janë aktualisht në fazë shqyrtimi. Kjo iniciativë është përfshirë si angazhim konkret i autoriteteve shqiptare në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030 dhe, gjithashtu, është pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 (Objektivi 1.1) dhe parashikohet të miratohet brenda vitit 2025.

Zbatimi i suksesshëm i këtij ligji do të përmirësojë ndjeshëm efektivitetin e kuadrit ligjor mbi konfliktin e interesave, duke përforcuar zbatimin e tij praktik. Elementet kryesore të përmirësimit përfshijnë: krijimin e mekanizmave efektivë për mbikëqyrjen dhe monitorimin e rregullave, përmirësimin e kapaciteteve institucionale për verifikimin e konflikteve të interesit, zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme për zyrtarët publikë, si dhe një bashkëpunim më të ngushtë mes institucioneve. Një legjislacion i tillë, i përditësuar me rekomandimet ndërkombëtare, do të rrisë besueshmërinë e përpjekjeve kundër korrupsionit. Për të siguruar një sistem të fortë të mbrojtjes së integritetit, ligji i ri duhet të balancohet midis masave parandaluese dhe ndëshkuese, duke u përqendruar në detyrat bazë që lidhen me konfliktet e interesit brenda institucioneve publike. Ky sistem do të mundësojë që ILDKPKI-ja ta vendosë theksin në çështjet më kritike, duke rritur kontrollet dhe vlerësimet e riskut, si dhe duke sanksionuar çdo shkelje në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Me miratimin e ligjit të ri, do të përgatiten edhe akte të tjera pasuese, si manuali që ofron udhëzime për detyrimet e çdo kategorie dhe rolin e çdo organi përgjegjës, në adresim të Rekomandimit iii) të GRECO-s.[219]
Një çështje që mbetet ende për t'u adresuar më tej është fakti që Kodi Ministror përmban dispozita që tejkalojnë vetëm deklarimin e interesave private, duke përfshirë çështje që janë kompetencë e

[217] Rekomandimi xi): GRECO ka rekomanduar që të sigurohen burimet e nevojshme ligjore, njerëzore, financiare dhe të tjera, në mënyrë që ILDKPKI-ja të përmirësojë kapacitetin e tij për të kryer verifikimin efikas të deklaratave të pasurisë dhe interesave private.
[218] Komisioni Evropian, raporti i shqyrtimit Analitik të legjislacionit për grupkapitullin I "Themeloret", korrik 2023, f. 30, *link*: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf
[219] GRECO ka rekomanduar harmonizimin dhe rritjen e koherencës së natyrshme të kuadrit
ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë, veçanërisht në lidhje me personat me funksione të larta ekzekutive, për shembull, duke hartuar norma dhe rregullore në një manual dhe duke ofruar udhëzime mbi detyrimet e çdo kategorie dhe për rolin e çdo organi përgjegjës. GRECO, *Council of Europe* 5(2022)4 *Fifth Evaluation Round - Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies - Compliance Report – Albania, link*: https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125

ILDKPKI-së.[220] Kjo mbivendosje duhet të rregullohet më tej për të harmonizuar përpjekjet ligjore dhe për të garantuar një zbatim më të qartë dhe efikas të rregullimit gjithëpërfshirës të konfliktit të interesit.

Deklarimi i aseteve dhe interesave private

Një element shumë i rëndësishëm për menaxhimin e integritetit në shërbimin civil është edhe mandati i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për administrimin e deklaratave të pasurive dhe auditimin e tyre. Në periudhën 2014-2023 ILDKPKI-ja ka kontrolluar dhe administruar të dhëna për 73 527 deklarata pasurie të zyrtarëve. Gjatë së njëjtës periudhë ILDKPKI-ja ka vendosur 2 130 sanksione administrative dhe ka bërë 570 referime penale, duke nënvizuar rolin e saj thelbësor në ruajtjen e integritetit në sektorin publik.

Në përgjigje të Rekomandimit nr. 10 të Raportit të Përputhshmërisë së Raundit V të Vlerësimit të GRECO-s, platforma elektronike e deklarimit të pasurive të zyrtarëve publikë u testua gjatë vitit 2021 në disa institucione të përzgjedhura. Në tetor dhe nëntor të atij viti u miratua Formulari Elektronik për Deklarimin e Pasurisë dhe Interesave Private dhe më 1 nëntor 2021 ILDKPKI-ja publikoi udhëzimin për plotësimin e deklaratave elektronike. Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2021 ILDKPKI-ja organizoi aktivitete trajnimi për rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e procesit të deklarimit dhe nga 1 janari 2022 sistemi elektronik për deklarimin e pasurisë dhe konfliktit të interesave është funksional dhe pranon vetëm deklaratat e dorëzuara në mënyrë elektronike.[221] GRECO e vlerësoi pozitivisht këtë zhvillim dhe arriti në përfundimin se Rekomandimi nr. 10 është zbatuar në mënyrë të kënaqshme. Megjithatë, në vitin 2023 publikimi *online* i deklaratave të pasurisë u pezullua nga ILDKPKI-ja për shkak të shqetësimeve të ngritura mbi sigurinë kibernetike.
Aktualisht, deklaratat e pasurisë që administrohen nga ILDKPKI-ja mund të aksesohen vetëm me kërkesë paraprake pranë inspektoratit. Me synim rritjen e transparencës proaktive, në Agjendën Kombëtare e Reformave 2024-2027[222], në përputhje me Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor të Komisionit Evropian, parashikohet një masë e dedikuar për publikimin e të gjitha deklaratave

[220] GRECO, *Council of Europe* 5(2022)4 *Fifth Evaluation Round - Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies - Compliance Report – Albania* , 143 *pages, link***:** https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125 , f. 7,
[221] VKM nr. 330, datë 22.4.2020, "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore "Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS"", *Fletore Zyrtare* nr. 77, viti 2020, f. 4563, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2020/77/3d5ff78b-0605-4ef4-9673-676d45339f9e
[222] *Brussels*, 23.10.2024 SWD(2024) 242 *Final Commission Staff Working Document-Albania Accompanying the document Commission Implementing Decision approving the Reform Agendas and the Multiannnual Work Programme under the Reform and Growth Facility for the Western Balkans*, *link*: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/9f9ac397-ca8a-4bde-8204-998e27ab4f51_en?filename=SWD_2024_242_2_EN_autre_document_travail_service_part1_v3.pdf

të pasurisë në faqen zyrtare të ILDKPKI-së, në përputhje me ligjin "Për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale", deri në dhjetor 2024.[223]
Një tjetër çështje e identifikuar për adresim nga Komisioni Evropian, e cila duhet të adresohet në vijim, është fakti që mandati i ILDKPKI-së nuk përfshin verifikimin e pasurive që mund të jenë fshehur përmes subjekteve private ose të regjistruara në emra të tjerë individësh, gjë që kufizon efektivitetin e auditimeve, çka mbetet për t'u adresuar në të ardhmen.[224]

Kufizimet pas punësimit

Korniza rregullatore shqiptare përfshin kufizime specifike pas punësimit për sektorët e administratës publike dhe të zbatimit të ligjit, me synimin për të shmangur konfliktin e interesit edhe pas largimit nga pozicioni i punës.

- Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"[225] parashikon që ish-nëpunësit e administratës publike nuk duhet të përdorin informacionin konfidencial të marrë gjatë kryerjes së detyrës për përfitime personale. Për një periudhë dyvjeçare pas largimit nga detyra ish-nëpunësit nuk lejohen të përfaqësojnë asnjë person ose organizatë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me administratën publike shqiptare në lidhje me detyrën e kryer nga ata.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 29.9.2021,[226] përcakton që nëpunësit e administratës publike nuk mund të përdorin për qëllime private informacionin që zotërojnë për shkak të detyrës. Gjithashtu, pas largimit nga detyra, për një periudhë dyvjeçare, ata duhet të mbrojnë dhe ruajnë informacionin zyrtar. Në rast të informacionit konfidencial afatet përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi. Shkeljet e rregullave të etikës ndëshkohen me masa disiplinore sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil.

Kufizimet për Policinë e Shtetit

Në sektorin e policisë, me ligjin e ri nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit"[227], janë adresuar rekomandimet e GRECO-s për krijimin e rregullave të qarta për kufizimet pas punësimit.[228] Ky ligj parashikon që për 1 vit pas largimit nga detyra ish-punonjësit e policisë nuk mund të punojnë

[223] Draftagjenda Kombëtare e Reformave mund të aksesohet në faqen elektronike të konsultimit publik, *link*: https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/744
[224] Komisioni Evropian, Raporti për Shtetin e së Drejtës 2024 – Shqipëria, f. 14, https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf
[225] Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", *Fletore Zyrtare* nr. 83, viti 2003, f. 3660, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2003/83/668538f5-52fd-4a83-9ae0-4f619471d77a
[226] VKM nr. 874, datë 29.9.2021 "Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike", *Fletore Zyrtare* nr. 66, viti 2022, f. 8493, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2022/66/9303ce41-8e58-4566-b181-102e560de033
[227] Ligji nr. 82, datë 26.7.2024 "Për Policinë e Shtetit", Fletore Zyrtare nr. 141 , viti 2024, f. 17620, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2024/141/1b120f4d-3fa8-4ecb-a8b0-889ee054599f
[228] Rekomandimi xxiii: GRECO ka rekomanduar hartimin e rregullave të qarta për kufizimet pas largimit nga detyra, të shoqëruara nga një mekanizëm efektiv zbatues për punonjësit e policisë.

DOKUMENT PARLAMENTAR

në kompani ose organizata që kanë qenë nën mbikëqyrjen e tyre ose ku ata kanë marrë pjesë në komisione për licencime. Gjithashtu, për 2 vjet ish-punonjësit nuk mund të përfaqësojnë persona ose organizata që kanë marrëdhënie me policinë në lidhje me detyrat e tyre gjatë shërbimit (neni 97).[229]

Kufizimet për këshilltarët politikë

Në lidhje me këshilltarët politikë, si një kategori me risk të veçantë integriteti në administratën publike, janë përgatitur amendamente në ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", që përfshijnë kufizime pas punësimi për një periudhë njëvjeçare për këshilltarët politikë, të cilët nuk mund të marrin pjesë në marrëdhënie tregtare me subjekte private apo publike në të cilat ata kanë qenë të përfshirë gjatë 2 vjetëve të fundit të shërbimit të tyre.[230] Këto ndryshime ligjore që priten të amendohen adresojnë rekomandimin e GRECO-s mbi parashikimin e kufizimeve të qarta pas punësimit edhe për këshilltarët politikë.[231]

2.2.5 Sinjalizimi dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve

Mbrojtja e sinjalizuesve është një masë kritike për parandalimin e veprimeve korruptive përmes zbulimit të hershëm të abuzimeve. Sinjalizimi në administratën publike luan një rol kyç si mekanizëm kundër korrupsionit, duke mundësuar që punonjësit apo qytetarët të raportojnë shkelje, abuzime apo sjellje të paligjshme brenda institucioneve shtetërore. Përmes sinjalizimit, individët

[229] Neni 97: Konflikti i interesit
[…]
4. Punonjësit të policisë, për një periudhë njëvjeçare pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, i ndalohet të punojë ose të ofrojë shërbime në shoqëri tregtare, organizata jofitimprurëse, shoqata ose çdo sipërmarrje tjetër, të cilat kanë qenë nën mbikëqyrjen e tij ose që kanë marrë pjesë në komisionet ose në bordet për licencimin apo dhënien e lejeve për ushtrimin e aktiviteteve të tyre gjatë shërbimit policor.
5. Punonjësi i policisë nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një mosmarrëveshje ose në marrëdhënie tregtare me Policinë e Shtetit për një periudhë dyvjeçare pas largimit nga detyra, kur përfaqësimi lidhet me detyrat që ai ka kryer gjatë kohës që ka qenë punonjës policie.
6. Në rast punësimi përpara periudhës njëvjeçare, ish-punonjësi i policisë duhet të informojë strukturën përkatëse në Policinë e Shtetit të paktën 2 javë përpara fillimit të pozicionit të ri të punës.
[…]

[230] Ndryshimi i planifikuar ligjor parashikon shtimin e nenit 17/a "Kufizimet pas punësimit për këshilltarët politikë", si më poshtë:

1. Një këshilltar politik që përfundon rolin e tij nuk ka të drejtë për një periudhë prej 1 viti të emërohet në pozicione drejtuese, të përfshihet në kontrollin e një kompanie tregtare ose të angazhohet në ndonjë formë tjetër punësimi ose marrëdhënie tregtare me ndonjë kompani tregtare, publike ose private, nëse gjatë 2 vjetëve të fundit të shërbimit të tij publik ai/ajo ka qenë drejtpërdrejt i/e përfshirë në aktivitetet tregtare të këtyre kompanive.
2. Për 2 vjet pas përfundimit të rolit të tij, Ministria/zyra e Kryeministrit, ku këshilltari politik ka mbajtur pozicionin e tij, nuk duhet të pranojë kontakte tregtare kur këshilltari vepron si përfaqësues i një subjekti tregtar.
3. Ministria/zyra e Kryeministrit ku këshilltari politik ka mbajtur pozicionin e tij nuk mund të angazhohet në marrëdhënie tregtare me subjektin në të cilin këshilltari është i punësuar në ndonjë formë ose ka pjesëmarrje në të drejtat e themeluesve, menaxhimit ose kapitalit, përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë ose pjesëmarrjes së subjekteve të tjera juridike, derisa të ketë kaluar 1 vit nga përfundimi i rolit të tij.

[231] Rekomandimi ix): GRECO ka rekomanduar të sigurohet që rregullat e qarta për kufizimet pas largimit nga detyra të zbatohen si për anëtarët e Këshillit të Ministrave, ashtu edhe për këshilltarët politikë dhe se të zbatohet një mekanizëm efektiv zbatues në lidhje me këto rregulla për të gjithë personat e besuar me funksione të larta ekzekutive.

kthehen në një zë të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, duke nxjerrë në pah praktika të pandershme që mund të cenojnë besimin e publikut në administratë. Ky mekanizëm jo vetëm që ndihmon në zbulimin e rasteve të korrupsionit, por ndihmon edhe në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit brenda institucioneve publike, duke krijuar një kulturë ku korrupsioni dënohet dhe ndershmëria promovohet. Rregullat për sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni nga sinjalizuesit janë parashikuar fillimisht me ligjin nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"[232], i ndryshuar, i cili u miratua në mbështetje të përvojave e praktikave të mira të vendeve të tjera,[233] për të rritur integritetin dhe luftën ndaj praktikave korruptive brenda administratës publike. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Kontrollit të Interesave (ILDKPKI) është autoriteti përgjegjës që garanton zbatimin e ligjit, ndjek dhe monitoron rastet e sinjalizimit, kujdeset për ngritjen e njësive të sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Përgjatë viteve është plotësuar edhe kuadri rregullator përmes akteve nënligjore të nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë të ligjit.

Raporti *Screening* për grupkapitullin I, "Themeloret", vë në dukje se kuadri ligjor i Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me Direktivën (BE) 2019/1937, duke identifikuar disa aspekte që kërkojnë përmirësim. Këto përfshijnë nevojën për një qasje sektoriale më të strukturuar për raportimin e rasteve të korrupsionit, krijimin e njësive informuese në sektorin privat me më shumë se 50 të punësuar dhe në bashkitë me mbi 10 000 banorë, si dhe zhvillimin e masave mbështetëse në fazat e hershme të procesit të sinjalizimit.[234] Po sipas Komisionit Evropian, deri në shtator 2022 sektori publik dhe ai privat patën krijuar përkatësisht 198 dhe 565 njësi përgjegjëse për trajtimin e raportimeve të sinjalizimit. Për këtë qëllim është krijuar një Regjistër Kombëtar i Njësive Përgjegjëse. ILDKPKI-ja, me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe donatorëve të tjerë, ka ofruar trajnime për 1 522 punonjës gjatë periudhës 2018-2022, duke kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve për trajtimin e rasteve të sinjalizimit.
Në vitet e para të zbatimit të ligjit numri i rasteve të sinjalizuara ka qenë relativisht i kufizuar. Arsyet mund të lidhen me mungesën e besimit të plotë në mekanizëm dhe shqetësimeve mbi mbrojtjen e sinjalizuesve. Megjithatë, është vërejtur një rritje graduale e rasteve të raportuara, sidomos në sektorët me rrezik të lartë për korrupsion. ILDKPKI-ja raporton një numër modest të sinjalizimeve të jashtme gjatë periudhës 2020-2023, me 9 raste në vitin 2020, 11 raste në vitin 2021 dhe 13 raste në vitin 2022.[235] Ndërkohë, sa i takon nivelit lokal, monitorimi më i fundit në 9 bashki të vendit për periudhën 2022-2023 evidenton se në asnjërën prej bashkive të monitoruara nuk është regjistruar asnjë sinjalizim i brendshëm. Komiteti Shqiptar i Helsinkit radhit mes arsyeve kryesore që

[232] Ligji nr. 60 /2016, datë 2.6.2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", *Fletore Zyrtare*, nr. 115, viti 2016, f. 8218, *link*: https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2016/115/c23d2619-b55c-4d54-8558-ef69fee4c270
[233] Këshilli i Evropës, Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Etika Publike: Mbrojtja e sinjalizuesve: Sfidat dhe mundësitë për qeverisjen lokale dhe rajonale, f.70, link: https://rm.coe.int/booklet-a6-protection-whistleblowers-sqi/1680a5a145
[234] Komisioni Evropian, Raporti i Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit për Grupkapitullin I "Themeloret", Korrik 2023, f. 47, *link:* https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf
[235] Raporti i monitorimit të zbatimit të SNKK 2015-2023 dhe të Planit të Veprimit 2020-2023, objektivi A5, f. 53.

shpjegojnë këtë shifër mungesën e besimit të punonjësve për zgjidhjen e rastit nga njësia përgjegjëse: mosnjohja në shkallë të gjerë e ligjit nr. 60/2016, frika e punonjësve nga hakmarrja, si dhe frika e sinjalizuesve potencialë për identifikimin dhe mosgarantimin e konfidencialitetit gjatë trajtimit të rastit.[236]

Ndryshimi i vetëm i deritanishëm i ligjit nr. 150/2020, që shtoi dispozita në ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"[237], përbën një zhvillim të rëndësishëm për fushën e zgjedhjeve, pasi krijimi i njësisë përgjegjëse pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) synon të forcojë mekanizmat e parandalimit dhe adresimit të korrupsionit në këtë proces. Kjo njësi ka autoritetin të trajtojë sinjalizimet për korrupsion aktiv dhe/ose pasiv në zgjedhje, duke i hetuar dhe vendosur masa administrative në rastet kur shkeljet nuk përbëjnë vepra penale. Një element thelbësor është edhe detyrimi i njësisë për të njoftuar menjëherë prokurorinë nëse gjatë hetimit administrativ konstatohet se veprimet ose praktikat e dyshuara përmbajnë elemente të veprës penale. Ky zhvillim premton të rrisë integritetin dhe transparencën e procesit zgjedhor, duke siguruar një mekanizëm efektiv për sinjalizimin dhe trajtimin e shkeljeve, si dhe duke forcuar besimin e publikut tek integriteti i procesit zgjedhur dhe kapacitetet e institucioneve përgjegjëse për administrimin e tij.

Megjithatë, është e menjëhershme nevoja për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Në këtë drejtim, një analizë e thelluar e organizatës Iniciativa Rajonale Antikorrupsion (RAI), e kryer në vitin 2021[238], ka vendosur ligjin shqiptar përballë 21 standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve, të nxjerra nga rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe Direktiva e BE-së. Sipas gjetjeve të kësaj analize, Shqipëria përmbush pjesërisht këto standarde dhe ka disa elemente pozitive, si:

- Detyrimi për të krijuar kanale të qarta raportimi për sinjalizuesit në të gjitha institucionet kryesore;
- Mbrojtja ndaj të gjitha formave të hakmarrjes në vendin e punës;
- Mbrojtja për gabimet e paqëllimshme të sinjalizuesve;
- Garantimi kundër politikave që do të pengonin sinjalizimin e ligjshëm;
- Ruajtja e konfidencialitetit të sinjalizuesve;
- Zhvendosja e barrës së provës te punëdhënësi në rastet e ankimeve për hakmarrje;
- Akses në mjete administrative dhe gjyqësore për të kërkuar ndihmë;

[236] Komiteti Shqiptar i Helsinkit, raport-monitorimi 2022-2023: Sinjalizimi në 9 bashki të vendit, 2024, f. 4, *link:* https://ahc.org.al/ëp-content/uploads/2024/07/Raport-Monitorimi-2022-2023_-Sinjalizimi-ne-9-Bashki-te-vendit.pdf

[237] Ligji nr. 150/2020, datë17.12.2020 "Për disa shtesa në ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", *Fletore Zyrtare* nr. 5, viti 2021, f. 731, *link* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2021/5/28f36109-f011-4360-876d-c2019bc93507

[238] *Breaking the Silence: Enhancing the whistleblowing policies and culture in the Western Balkans and Moldova.. The Gap Analysis of Whistleblower Protection Laws in the Western Balkans and Moldova was conducted by whistleblowing experts of Regional Anticorruption Initiative (RAI), 2021, 113 pages, link:* https://rai-see.org/php_sets/uploads/2021k10/RAI-GAP-Analysis-English.pdf

- Penalitetet disiplinore për hakmarrje apo moszbatim të ligjit;
- Një agjenci përgjegjëse për promovimin e të drejtave të sinjalizuesve dhe ofrimin e udhëzimeve për ta;
- Transparencë në zbatimin e ligjit.

Megjithatë, analiza identifikon edhe disa mangësi dhe dobësi, si:

- Mungesa e përfshirjes së sjelljeve të këqija, përveç korrupsionit, si objekt sinjalizimi;
- Dobësitë në mbrojtjen ligjore të atyre që ndihmojnë në përgatitjen e raportimeve të sinjalizimit dhe atyre që zbulojnë informacion si pjesë e detyrave të punës;
- Testi i besimit për motivet e sinjalizuesve;
- Kanale të papërshtatshme për sinjalizuesit anonimë;
- Shkaqe të paqarta për mos-hetimin e raportimeve të sinjalizimit;
- Mungesa e mbrojtjes nga përgjegjësitë civile dhe penale;
- Mungesa e ndihmës së përkohshme dhe ndihmës ligjore për sinjalizuesit që fitojnë çështjet në gjyq.

Këto gjetje dhe rekomandime ofrojnë një bazë të mirë lidhur me përmirësimet e ardhshme në mbrojtjen e sinjalizuesve në Shqipëri. Në këtë kuadër, rishikimi i mëtejshëm i ligjit për ta përputhur atë me Direktivën e BE-së është parashikuar si një masë e veçantë në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030, si dhe në objektivin 1.6 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, që duhet të realizohet brenda vitit 2025. Ky rishikim synon përmirësimin e efektivitetit të ligjit për sinjalizuesit dhe forcimin e masave mbrojtëse për ta, me synim përafrimin me *acquis*-në e BE-së dhe standardet evropiane.

Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve në Policinë e Shtetit

Në Raportin e Vlerësimit të Raundit V, GRECO[239] vlerëson se sinjalizimi duhet të forcohet veçanërisht në strukturat e Policisë së Shtetit. Në këto struktura, sipas GRECO-s, mbizotëron një kulturë heshtjeje, pasi nuk është raportuar asnjë rast sinjalizimi i jashtëm në lidhje me stafin e policisë në ILDKPKI dhe nuk ka të dhëna të qarta mbi efektivitetin e mekanizmave të brendshëm të sinjalizimit. Për këtë arsye, GRECO[240] rekomandoi nxitjen e raportimit të praktikave korruptive brenda Policisë së Shtetit dhe ndryshimin e perceptimeve negative mbi masat mbrojtëse, përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve nga nivelet e larta drejtuese, duke siguruar anonimat dhe mbrojtje për identitetin e tyre. Gjithashtu, GRECO ka kërkuar që i gjithë stafi i policisë të trajnohet dhe ndërgjegjësohet për këtë proces, duke përfshirë edhe përgatitjen e udhëzimeve praktike mbi sjelljen etike në Policinë e Shtetit.[241]

[239] GRECO , Council of Europe 5(2022)4 *Fifth Evaluation Round - Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies - Compliance Report – Albania , 143 pages, link:* https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125

[240] Ibid.

[241] Rekomandimi xxiv: GRECO rekomandon që të sigurohet efektiviteti i zbatimit të ligjit për sinjalizuesit, sidomos përmes trajnimit të rregullt dhe informimit të stafit të policisë për masat e mbrojtjes së sinjalizimit.

Gjatë periudhës 2020-2022 GRECO vlerësoi progresin në zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe evidentoi miratimin e rregullores për sinjalizuesit, si dhe krijimin e një njësie të brendshme për sinjalizimin. Kjo njësi është bërë e dukshme në të gjitha komisariatet e policisë në vend dhe trajnimet fillestare për ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen e sinjalizuesve janë konsideruar hapa pozitivë. Megjithatë, duke marrë parasysh numrin e madh të punonjësve të Policisë së Shtetit, rreth 12 000, këto masa janë vlerësuar si të pamjaftueshme. GRECO ka bërë thirrje që të intensifikohen përpjekjet dhe të organizohen trajnime të rregullta për të gjitha nivelet e hierarkisë dhe zinxhirit komandues të Policisë së Shtetit. Për këtë arsye, rekomandimi u vlerësua si "pjesërisht i zbatuar" në fazën e parë të vlerësimit.[242] Në adresim të këtyre gjetjeve, këto rregulla tani janë përfshirë në Manualin e ri të Etikës Policore dhe janë bërë përpjekje aktive për të rritur ndërgjegjësimin dhe trajnimin në këtë fushë. Gjithsej 8 780 oficerë të Policisë së Shtetit, nga 11 932 në total, janë trajnuar në vitin 2023, pavarësisht statusit të tyre.[243]

2.2.6 Denoncimi i praktikave korruptive dhe shkeljeve të integritetit në administratën publike nga të tretët

Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion (DPAK)

Që nga krijimi i saj në tetor 2021, DPAK-ja ka ndërmarrë një sërë hetimesh administrative në institucionet kryesore pjesë të rrjetit antikorrupsion. Për periudhën 2021-2023 DPAK-ja ka propozuar 532 masa administrative, ka dhënë 263 rekomandime dhe ka paraqitur 48 kallëzime penale për shkelje që ngrenë dyshime për elementë të veprës penale.[244] Gjatë vitit 2024 (janar-tetor), DPAK-ja ka regjistruar 180 raportime dhe ankesa për praktika korruptive. Me ristrukturimin e drejtorisë dhe thellimin e politikave parandaluese, fokusi i DPAK-së pritet të intensifikohet edhe më shumë në sektorët vulnerabël, ku risqet për korrupsion janë më të larta.

Platforma e Bashkëqeverisjes

Një nga iniciativat kryesore për përmirësimin e integritetit dhe efektshmërisë në administratën publike është Platforma e Bashkëqeverisjes, e krijuar me VKM nr. 638, datë 06.11.2017, dhe ndryshuar me VKM nr. 526, datë 29.07.2022[245]. Kjo platformë, nën drejtimin e Agjencisë për

[242]IBID, page 23, *link:* https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6125

[243] Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Raporti Kombëtar i hartuar në përgjigje të Raportit të Përputhshmërisë së GRECO për Raundin V të Vlerësimit, dorëzuar në shtator 2024 nga Delegacioni i Shtetit Shqiptar në GRECO.

[244] Gjatë vitit 2021, DPA-ja propozoi 96 masa administrative dhe paraqiti 12 kallëzime penale. Në vitin 2022 numri i raporteve përfundimtare arriti në 43, duke përfshirë 259 masa administrative, 88 rekomandime dhe 20 kallëzime për ndjekje penale. Viti 2023 prodhoi 63 raporte përfundimtare që përfshinin 177 masa disiplinore, 175 rekomandime dhe 16 kallëzime për ndjekje penale, duke numëruar 42 persona të kallëzuar.

[245] VKM nr. 526, datë 29.7.2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje", *Fletore Zyrtare* nr. 111, viti 2022, f. 13730, *link:* https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2022/111/49c6b75c-fe5c-40b4-be70-f33cef4b407c

Dialog dhe Bashkëqeverisje pranë Kryeministrisë, u lejon qytetarëve të raportojnë shqetësimet dhe ankesat e tyre mbi shërbimet publike dhe politikat qeveritare. Ajo synon të forcojë transparencën, përgjegjshmërinë dhe përfshirjen e qytetarëve, përmes:

- Përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike, pasi përmes platformës, autoritetet ndërmarrin veprime për përmirësimin e shërbimeve bazuar në reagimet e qytetarëve;
- Rritjes së transparencës dhe integritetit të nëpunësve dhe procedurave, pasi qytetarët mund të ndjekin ecurinë e çështjeve që kanë adresuar dhe të kenë akses në informacion mbi vendimet qeveritare;
- Përfshirjes aktive të qytetareve përmes mundësisë për të kontribuar aktivisht në identifikimin e problematikave në ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e politikave qeveritare;
- Llogaridhënies së shtuar, pasi platforma promovon rritjen e llogaridhënies së përgjegjshmërisë së institucioneve.

Në kuadër të kësaj platforme janë aplikuar disa metoda për të kontrolluar rastet e korrupsionit dhe për të trajtuar ankesat për shërbimet publike. Seksione të veçanta, si "Ankesa ime", "Biznesi im", dhe "Denonco korrupsionin", shërbejnë për adresimin e këtyre rasteve:

"Ankesa ime": Nëpërmjet këtij seksioni paraqiten ankesat për vonesën në marrjen e shërbimit publik apo mospërfitimin e tij, si dhe raportohen sjelljet abuzive të strukturave të administratës shtetërore ose të zyrtarëve të caktuar. Në seksionin "Ankesa ime" paraqiten ankesa ose kërkesa të lidhura me veprimtarinë e administratës shtetërore, që ndikojnë drejtpërdrejt ankuesin, të cilat, duke u bazuar në qëllimin dhe objektin e tyre, mund të jenë:
a) mosveprimi apo neglizhenca e organeve të administratës shtetërore për të nxjerrë akte ose për të kryer veprime administrative;
b) pretendime për parregullsi ose paligjshmëri në veprimtarinë administrative të organit të administratës shtetërore. Në çdo rast këto ankesa ose kërkesa nuk shqyrtohen në themel nga agjencia, por trajtohen përmes ridërgimit për shqyrtim tek organi administrativ kompetent ose i ndërmjetësimit sipas rregullave të këtij ligji.
c) për rishikimin në përmbajtjen e akteve me karakter normativ, për të cilat pretendohet se ka trajtim të padrejtë, të pabarabartë apo të paarsyeshëm, mangësi ose çdo shkak tjetër objektiv.

"Denonco korrupsionin": Ky seksion lejon qytetarët, individët dhe grupet e interesit të denoncojnë aktet korruptive. Agjencia, pas vlerësimit paraprak, e dërgon menjëherë këtë denoncim pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Në rast dyshimi të arsyeshëm, verifikimi të indicieve apo gjetjes së provave për ngjarjen korruptive, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit ia referon çështjen prokurorisë kompetente, në përputhje me legjislacionin procedural penal në fuqi. Me qëllim për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet DPAK-së dhe Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, si dy autoritete të përfshira në trajtimin e denoncimeve të praktikave korruptive nga qytetarët,

DOKUMENT PARLAMENTAR

është në proces nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes dy strukturave për të inkurajuar qytetarët që të raportojnë rastet e korrupsionit në institucionet pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion dhe për të shmangur mbivendosjen në trajtimin e raportimeve.

2.3 Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet

Ashtu siç përmendet edhe në progresraportin e BE-së të vitit 2024, Shqipëria mbetet mesatarisht e përgatitur në fushën e reformës së administratës publike. Ajo bëri progres të kufizuar në përmbushjen e rekomandimeve të vitit të kaluar. [246]

Në lidhje me angazhimin e qeverisë në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e integritetit në administratën publike, duhet theksuar se ato janë konsideruar vazhdimisht si prioritete të rëndësishme nga ana e qeverisë shqiptare. Kjo qasje përforcohet edhe nga ndryshimi institucional që ka ndodhur prej janarit 2024, ku agjenda e reformës në administratën publike dhe roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit u shkrinë në pozicionin e vetëm të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Ky bashkërendim kompetencash ka krijuar një qasje të integruar për adresimin e sfidave që lidhen me transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin në shërbimin civil. Në këtë mënyrë janë hedhur hapa drejt një angazhimi më të qëndrueshëm për të përmirësuar këto aspekte kyçe të qeverisjes së mirë.

Sa u takon kapaciteteve institucionale, ristrukturimi i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion (DPAK), me qëllim fuqizimin e kapaciteteve për monitorimin e politikave parandaluese dhe ndërgjegjësuese, si dhe rritjen e fokusit të veprimtarisë në sektorët vulnerabël, është mbështetur konsiderueshëm në rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin e Shtetit të së Drejtës (2024)[247] dhe Raportin e Shqyrtimit Analitik (2023)[248]. Këto masa përbëjnë një hap përpara në fuqizimin e mekanizmave për adresimin e risqeve të korrupsionit në sektorët më të ndjeshëm, duke synuar krijimin e një kornize më të fortë mbikëqyrjeje në Sekretariatin Teknik të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

DOKUMENT PARLAMENTAR

[246] *EU Progress Raport for Albania*- Progres-raporti 2024, *page* 4, (103 *pages*) https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf –

[247] *Brussels, 24.7.2024 SWD(2024) 828 Final Commission Staff Working Document 2024 Rule of Law Report Country Chapter on the rule of law situation in Albania* https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en?filename=59_1_58088_coun_chap_albania_al.pdf

[248] Raporti i skanimit për Grupkapitullin I "Themeloret", Korrik 2023 -https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572e_en?filename=AL%20Cluster_1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf *Screening Report Albania Cluster 1 – Fundamentals , July 2023, 135 pages.*

Vërehet një ndryshim i qasjes drejt instrumenteve parandaluese në administratën publike. Në vitet e fundit, promovimi i integritetit në administratën publike ka treguar një zhvendosje të qartë drejt përdorimit të instrumenteve parandaluese përballë atyre ndëshkuese. Kjo qasje, e udhëhequr nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, ka synuar të adresojë sfidat e integritetit në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme. Ndërhyrjet janë përqendruar jo vetëm në trajtimin e rasteve individuale, por edhe në eliminimin e rreziqeve sistemike, me synimin për të parandaluar korrupsionin në gjenezë.

Shqyrtimi analitik dhe diagnoza e kuadrit ligjor dhe institucional, i zhvilluar përgjatë vitit 2022-2023, ka luajtur një rol kyç në identifikimin e qartë të mangësive dhe nevojave për përmirësim në kuadrin ligjor dhe institucional të integritetit në administratën publike. Ky proces ka mundësuar që autoritetet shqiptare të ndërmarrin angazhime konkrete dhe të bazuara në afate të qarta, të cilat janë në përputhje me prioritetet strategjike të vendit deri në vitin 2030. Përmes këtij procesi është garantuar që çdo masë të jetë e mirëplanifikuar dhe të shtyjë përpara procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Progresi në zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s për integritetin e zyrtarëve të lartë ekzekutivë dhe agjencitë ligjzbatuese ka avancuar në mënyrë esenciale përmirësimin e kuadrit ligjor për integritetin e personave me funksione të larta ekzekutive dhe agjencitë ligjzbatuese.
Raporti i Monitorimit SIGMA 2024 e renditi sërish Shqipërinë në krye të listës për ecurinë në katër nga gjashtë fushat e vlerësimit në administratën publike. Shqipëria mbetet lider rajonal në funksionimin e administratës publike në pesë nga gjashtë fushat tematike, veçanërisht në menaxhimin e financave publike, menaxhimin e shërbimit civil dhe burimeve njerëzore, si dhe në zhvillimin dhe koordinimin e politikave për reformën në administratën publike

Rishikimi i Kodit Ministror të Etikës në vitin 2021 u vlerësua pozitivisht nga GRECO, duke e konsideruar një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të integritetit të anëtarëve të qeverisë dhe këshilltarëve politikë. Megjithatë, GRECO theksoi nevojën për përfshirjen e udhëzimeve më të detajuara për garantimin e paanshmërisë së Komisionit të Etikës, rregullimin e rasteve të shkeljeve potenciale të kodit nga Kryeministri, si dhe zgjidhjen e dublikimit të shqyrtimit të konfliktit të interesit nga komisioni me kompetencat e ILDKPKI-së.

Indeksi i Integritetit Publik (IPI) dhe përparimet në integritetin e shërbimit civil
Vlerësimi më i fundit i Indeksit të Integritetit Publik (IPI) tregon se Shqipëria ka një performancë të konsiderueshme në këtë drejtim, duke qëndruar mbi mesataren rajonale dhe globale. Me një vlerësim prej 7/10 pikë, Shqipëria ka treguar përmirësim të kapaciteteve për integritet në administratën publike. Po në këtë drejtim, vlerësimi i performancës së administratës publike nga OECD/SIGMA në vitin 2024 konfirmon se Shqipëria ka një nga performancat më të mira rajonale për sa i përket integritetit të nëpunësve publikë.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Në raportin e Komisionit Evropian për vitin 2024 theksohet nevoja për ndërmarrjen e masave të dedikuara për sektorët me risk të lartë për korrupsion, si infrastruktura publike, kadastra, doganat, arsimi dhe shëndetësia. Ky raport sugjeron zhvillimin e udhërrëfyesve dhe vlerësimeve të riskut të veçantë për këta sektorë për të garantuar zbatimin e masave antikorrupsion. Angazhimet e ndërmarra nga autoritetet shqiptare në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030 priten ta adresojnë këtë shqetësim.

Në lidhje me prokurimet publike, në raportin e SIGMA-s për vitin 2024 fusha e prokurimeve publike në Shqipëri u vlerësua për cilësinë e kuadrit ligjor dhe kapacitetet institucionale për të zbatuar politikat e prokurimeve. Megjithatë, kjo fushë mbetet një sektor me risk të lartë korrupsioni sipas Komisionit Evropian.

Sa i takon garantimit të integritetit në inspektimet publike, relacioni që shoqëron ligjin e ri për inspektimet evidenton disa sfida të rëndësishme, si mungesa e profesionalizmit të inspektorëve, ndërhyrjet e jashtme dhe përzgjedhja jo objektive e subjekteve për inspektim. Përmirësimi i kuadrit rregullator për inspektimet dhe eliminimi i ndërhyrjeve politike janë thelbësore për forcimin e integritetit në këtë proces, bashkërisht me ndërmarrjen e mekanizmave për zbatimin efikas të parashikimeve të ligjit të ri.

Sa i takon integritetit të funksionarëve të emëruar, ligji nr. 138/2015 është vlerësuar si një mekanizëm efektiv që ka parandaluar përfshirjen e individëve me të shkuar kriminale në pozita publike. Ky ligj ka kontribuar në forcimin e integritetit të institucioneve shtetërore, duke siguruar një administratë më të pastër dhe të përgjegjshme. Megjithatë, vlerësohet se kuadri ligjor dhe zbatimi i tij në praktikë ka nevojë për qartësime dhe ndryshime të hasura gjatë implementimit të ligjit. Së pari, është e rëndësishme të përcaktohet qartë periudha e ndalimit për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar për personat e dënuar me burgim me vendim të formës së prerë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në rastet kur nga subjekti apo nga organet kompetente nuk është kërkuar njohja e vendimit penal të huaj, duke e bërë të pamundur ndërmarrjen e veprimeve administrative në kuadër të këtij ligji. Së dyti, është e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi dhe trajnimi i personelit të administratës publike për të siguruar që ata të jenë të informuar dhe të aftë për të zbatuar ligjin në mënyrë të saktë dhe efektive.

Në lidhje me deklarimin e pasurive, GRECO ka përshëndetur ngritjen dhe funksionimin e platformës elektronike për deklarimin e pasurive dhe interesave private, e cila u bë funksionale në vitin 2022. Ky sistem ka përmirësuar ndjeshëm procesin e deklarimit dhe ka rritur transparencën dhe llogaridhënien në administratën publike, duke bërë që Rekomandimi X i GRECO-s në Raundin V të Vlerësimit të konsiderohet si plotësisht i zbatuar. Megjithatë, në Raportin mbi Shtetin e së Drejtës 2024, Komisioni Evropian ka identifikuar se një nga çështjet që ende mbetet për t'u adresuar është fakti që ILDKPKI-ja nuk ka autoritetin e duhur për të verifikuar pasuritë që mund

DOKUMENT PARLAMENTAR

të jenë fshehur përmes subjekteve private ose të regjistruara në emra të tjerë individësh. Ky kufizim pengon efektivitetin e plotë të procesit të auditimit të deklaratave të pasurisë.

Sa i takon mbrojtjes së sinjalizuesve dhe sfidave në zbatimin e mekanizmave të sinjalizimit, pavarësisht përpjekjeve për përmirësimin e kuadrit ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, mbeten sfida në implementimin e plotë të këtij ligji. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka ngritur shqetësime mbi mungesën e besimit në mekanizmat e sinjalizimit, mungesën e njohurive të publikut mbi ligjin dhe frikën nga hakmarrja. Në veçanti, në nivel lokal numri i rasteve të sinjalizimeve mbetet i ulët. Ky problem kërkon adresim për të garantuar një qasje më kapilare në mbrojtjen e sinjalizuesve. Njëherësh, Iniciativa Rajonale Antikorrupsion (RAI) ka identifikuar disa dobësi në zbatimin e sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Shqipëri, përfshirë mungesën e mbrojtjes për individët që ndihmojnë në përgatitjen e sinjalizimeve dhe kufizimet për sinjalizimet anonime. Një ndërhyrje e rëndësishme e rekomanduar është përmirësimi i mbrojtjes ligjore për këta individë dhe lehtësimi i procedurave për sinjalizimet anonime, duke garantuar, gjithashtu, mbrojtje dhe ndihmë ligjore për sinjalizuesit. Këto përmirësime duhet të adresohen përmes miratimit të ndryshimeve ligjore në ligjin kuadër deri në vitin 2025, në përputhje me afatet e parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030.

Sipas Komitetit Shqiptar të Helsinkit, një çështje e rëndësishme që mbetet për t'u adresuar është mungesa e të dhënave të detajuara dhe të disegreguara lidhur me vendimmarrjen përfundimtare të ILDKPKI-së për rastet e shqyrtuara. Raportet e Inspektoratit mund të përfitojnë nga një ndarje e qartë e rasteve sipas llojit të institucioneve publike, qoftë në nivel qendror apo vendor, qoftë nga referimi i të dhënave të sakta për nivelin vendor.
Këto gjetje përbëjnë një bazë solide për rekomandimet e ardhshme që synojnë forcimin e integritetit në administratën publike dhe përmirësimin e mekanizmave për luftën kundër korrupsionit, duke siguruar që Shqipëria të ecë më tej drejt përmbushjes së standardeve evropiane dhe forcimit të institucioneve të saj në rrugën e integrimit në Bashkimin Evropian.

2.4 Konkluzionet dhe çështjet për zgjidhje/drejtimet e ndërhyrjeve

Për shkak të rritjes së rolit të tij në zhvillimin ekonomik, sigurimin e standardeve të jetesës për qytetarët e saj, si dhe adresimin e çështjeve kryesore, si ndryshimi i klimës, drejtësia sociale, e veçanërisht në procesin e negociatave me BE-në, krahas progresit të deritanishëm, administrata publike përballet me sfida të shumta, sikurse janë identifikuar më sipër.

Për të adresuar këto gjetje, rekomandohen të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

1. **Rritja e efikasitetit të planeve të integritetit përmes:**
   - Rritjes progresive të kryerjes së Vlerësimit të Riskut të Integritetit dhe hartimit e miratimit të Planeve Institucionale të Integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së ministrive të linjës dhe të gjitha autoriteteve të administratës publike;

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Përmirësimit të monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit me metodologjinë e re që sapo është zbatuar (me tregues të performancës që matin impaktin e masave të Planit të Integritetit);
- Raporteve të monitorimit të zbatimit të Planeve të Integritetit mbështetur në vlerësimin e treguesve të performancës institucionale të përmendur në metodologjinë e monitorimit;
- Realizimit të trajnimeve të vazhdueshme të stafeve të administratës publike mbi detyrimet që shtron Plani Institucional i Integritetit, duke konsideruar dinamizmin në lëvizjet e shpeshta në administratë;
- Ndërgjegjësimit dhe edukimit të vetëpërfshirjes së punonjësve të administratës publike për të promovuar Planin Institucional të Integritetit si gurin e themelit të aktivitetit të tyre ditor;
- Promovimit të Koordinatorëve të Integritetit dhe qëndrueshmërisë së tyre në detyrë për të siguruar historikun institucional të integritetit.

2. **Përqendrimi i vëmendjes në sektorët më të rrezikuar ndaj fenomenit të korrupsionit dhe cenimit të integritetit në përputhje me angazhimet dhe afatet e parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës 2023-2030, duke realizuar nismat e poshtëshënuara:**
   - Hartimi i metodologjisë për faktorët e rrezikut që nxisin korrupsionin në sektorin publik; kategorizimi i faktorëve (shtojca të dedikuara për sektorët e identifikuar si më të ndjeshëm ndaj korrupsionit);
   - Realizimi brenda afateve i vlerësimeve të rrezikut për sektorët më të ndjeshëm ndaj korrupsionit;
   - Hartimi dhe miratimi brenda afateve i planeve të veprimit për ndërhyrje me masa institucionale për faktorë risku, të identifikuar sipas metodologjive specifike të sektorëve të ndjeshëm ndaj korrupsionit;
   - Intensifikimi i marrëdhënieve me partnerët ndërkombëtarë, si ANAC-ja dhe institucione të ngjashme, për të siguruar një zbatim të efektshëm të praktikave më të mira në luftën kundër korrupsionit dhe forcimin e integritetit në institucionet që operojnë në sektorët vulnerabël.

3. **Rritje e efikasitetit në zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor për dekriminalizimin përmes:**

- Përcaktimit të periudhës së ndalimit për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të një funksioni të zgjedhur ose të emëruar për personat e dënuar me burgim me vendim të formës së prerë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në rastet kur nga subjekti apo nga organet kompetente nuk është kërkuar njohja e vendimit penal të huaj, duke e bërë të pamundur ndërmarrjen e veprimeve administrative në kuadër të këtij ligji;
- Rritjes së ndërgjegjësimit dhe trajnimit të personelit të administratës publike për të garantuar kuptueshmërinë e detyrimeve ligjore që adresohen nga legjislacioni për integritetin, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit në mënyrë të saktë dhe efektive.
- Hartimit të metodologjisë për krijimin e një databaze (regjistri) unike qendrore (kombëtare) për subjektet e ligjit "Për dekriminalizimin", si mënyra për të konsoliduar murin mbrojtës

DOKUMENT PARLAMENTAR

të administratës publike nga persona dhe subjekte të papërshtatshme për të qenë pjesë e saj.

4. **Rishikimi i ligjit për etikën në administratën publike në dy drejtime kryesore:**

   i) Miratimin e rregullave specifike për kufizimin e përfshirjes së këshilltarëve politikë në aktivitete private pas largimit nga detyra;

   ii) Shmangien e paqartësive ndërmjet përmbajtjes së tij dhe dispozitave të ligjit për Konfliktin e Interesit;

   iii) Përcaktimin e mekanizmave zbatues nga strukturat përgjegjëse të institucioneve publike në rastet e shkeljeve të rregullave të etikës.

5. **Rishikimi i kuadrit ligjor mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve dhe rritja e efikasitetit të implementimit të tij në praktikë, përkatësisht:**

- Miratimi i ndryshimeve ligjore në ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve brenda vitit 2025, duke adresuar mangësitë e identifikuara nga analizat dhe rekomandimet ndërkombëtare, me qëllimin për ta përafruar atë me *acquis*-në e BE-së dhe standardet evropiane, në zbatim të plotë të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës 2023-2030. Rishikimet e ligjit duhet të garantojnë, mes të tjerash:
  - Përfshirjen e mbrojtjes shtesë për individët që ndihmojnë sinjalizuesit;
  - Lehtësimin e procedurave për sinjalizimet anonime;
  - Sigurimin e mbrojtjes së plotë dhe asistencës ligjore për të gjithë sinjalizuesit.
- Rritje e informimit dhe zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese për publikun dhe institucionet publike për rolin e sinjalizuesve në luftën kundër korrupsionit, si dhe rritje e vëmendjes për zbatimin efektiv në praktikë të kornizës ligjore dhe rregullatore për sinjalizimin në mënyrë kapilare, veçanërisht në nivelin vendor.
- Përmirësimi i raportimit të ILDKPKI-së, përmes: (i) përfshirjes së të dhënave të detajuara për vendimet përfundimtare për çdo rast të sinjalizuar, si dhe (ii) disegregimit të të dhënave të raportuara sipas institucioneve qendrore dhe vendore.
- Ngritja dhe promovimi i një Rrjeti për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në administratën publike

6. **Miratimi i ligjit të ri për konfliktin e interesit brenda vitit 2025,** i cili të garantojë një kuadër gjithëpërfshirës për konfliktin e interesit, për të shmangur mbivendosjet ligjore (veçanërisht me Kodin Etik të Ministrave dhe ligjin nr. 9131/2003), për të adresuar fragmentarizimin e rregullimeve ligjore dhe normative mbi konfliktin e interesit, për të siguruar një zbatim të koordinuar të masave të konfliktit të interesit, dhe, në fund, për të përafruar parashikimet me acquis-në e BE-së dhe standardet evropiane.
   - Hartimi dhe promovimi i manualëve për zbatimin e kuadrit ligjor për konfliktin e interesit, për të harmonizuar kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi;
   - Stafet politike duhet të jenë rregullisht e periodikisht të informuar për kuadrin ligjor në fuqi për konfliktin e interesit;

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Regjistri për konfliktin e interesit dhe marrjen e dhuratave, të ngritur, të bërë publik dhe lehtësisht të aksesueshëm.

7. **Verifikimi më efikas i deklaratave të aseteve dhe interesave private:**

- Konsolidim i rregullt i kapaciteteve financiare dhe njerëzore për ILDKPKI-në;
- Zbatimi me eficiencë i verifikimit të pasurive të fshehura nga ILDKPKI-ja në procesin e verifikimit të aseteve;
- Konsolidimi i strukturave të posaçme dhe plotësisht të përgatitura pranë institucioneve publike, për të mbështetur deklarimin e pasurive nga subjektet që kanë detyrimin e deklarimit.

8. **Promovimi i vazhdueshëm i integritetit në administratën publike, përmes:**
    - Monitorimit të zbatueshmërisë në praktikë të kodeve të etikës/të sjelljes dhe legjislacionit gjithëpërfshirës për etikën;
    - Organizimit të trajnimeve të vazhdueshme për nëpunësit e administratës publike për zbatimin e rregullave të etikës, me fokus respektimin e standardeve etike dhe disiplinore për parandalimin e shkeljeve disiplinore dhe përmirësimin e kulturës organizative në administratën publike;
    - Forcimit të roleve të organeve disiplinore të etikës sipas përcaktimeve të legjislacionit respektiv që do të shqyrtojnë rastet e thyerjeve të rregullave të etikës nga nëpunësit të administratës publike;
- Botimit/publikimit të Planeve të Integritetit dhe kodeve të etikës nga institucionet publike, në kuadër të respektimit të parimeve të rëndësishme të transparencës dhe llogaridhënies, si dhe publikimit të përmbledhur të të gjitha Planeve të Integritetit dhe kodeve të etikës të institucioneve të administratës publike në një dritare të qendërzuar të faqes zyrtare të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

9. **Mbikëqyrja institucionale dhe efektiviteti i inspektorateve dhe strukturave antikorrupsion:**

- Garantimi i zbatimit efikas së reformës së inspektorateve, duke garantuar adresimin e problematikave të evidentuara në relacionin shoqërues së ligjit nr. 99/2024 "Për inspektoratet", në drejtim të rritjes së integritetit të procedurave inspektuese;
- Rritja progresive e pranisë së koordinatorëve antikorrupsion në institucionet qendrore dhe vendore, si mekanizma verifikimi dhe hetimi administrativ për raste të korrupsionit dhe shkeljeje të integritetit;
- Mbështetja e rolit të koordinatorëve antikorrupsion si mekanizma parandalimi për raste të praktikave korruptive dhe abuzive;
- Krijimi i një qasjeje proaktive nga koordinatorët antikorrupsion për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

DOKUMENT PARLAMENTAR

10. **Krijimi i indikatorëve bazë të performancës (KPI) për të gjitha institucionet e administratës që ofrojnë shërbime publike që kanë lidhje drejtpërdrejt me qytetarin;** miratimi çdo vit i raportit vjetor të performancës institucionale në bazë të plani vjetor të punës së çdo institucioni. Matja e kësaj performance, përveç raporteve të auditit të performancës së KLSH-së, të bëhet nga aktorë të tjerë në bazë të miratimit të një fondi që mund ta ketë Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, që miratohet nga Parlamenti.

11. **Krijimi i portalit të performancës së administratës publike pranë Komisionit të Parlamentit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku të botohen raportet e auditit të performancës nga ana e KLSH-së në seri kohore** (që nga fillimi e në vazhdim) dhe raportet vjetore të performancës për të gjitha institucionet e administratës publike.

12. **Miratimi i një Kodi të ri të Etikës e Integritetit për administratën publike** dhe nivelet e larta të qeverisjes në 3 degët e saj (legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor).

13. **Krimi i një Komisioni të Etikës Publike** që ka autoritet të hetojë dhe të marrë masa lidhur me shkeljet e etikës në nivele të ndryshme të administratës publike dhe nivelet e larta të qeverisjes në 3 degët e saj (parlamentar, ekzekutiv e gjyqësor), në bazë të denoncimeve që vijnë nga qytetarët, bizneset dhe mediet përmes një platformë *online.*

14. **Formimi i njësive të integritetit brenda çdo ministrie** dhe strukture të administratës publike përgjegjëse për zbatimin e Planeve të Integritetit, duke ushtruar rol këshillues për punonjësit për çështje etike, duke bashkëpunuar ngushtë me organet qendrore kundër korrupsionit.

15. **Fuqizimi i platformës ekzistuese të parandalimit të konfliktit të interesit** dhe ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave përkatëse, duke përfshirë të dhënat e pronës, regjistrat e kompanive, prokurimin publik etj., që mundësojnë kryqëzimin e deklaratave të zyrtarëve dhe sinjalizimin e konfliktet e mundshme.

16. **Përfshirja me detyrim e simulimeve të detyrueshme të "dilemës etike" për punonjësit e administratës publike** në procedurat e testimit e konkurrimit të DAP-it si një model që zbatohet në vende të ndryshme.

17. **Përcaktimi dhe qartësimi i procedurave ligjore lidhur me procesin e verifikimit të deklaratave të vetëdeklarimit të kandidatëve për deputetë**, kryetarë bashkish e të zgjedhur të tjerë para se ata të marrin pozicionin zyrtar

Kapitulli III. Llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor

3.1. Konteksti

Një administratë publike që funksionon mirë dhe profesionale është thelbësore për një shtet anëtar të BE-së. Sipas kritereve të Kopenhagenit, shtetet që duan të anëtarësohen në BE duhet të kenë kapacitetin administrativ dhe institucional për të zbatuar në mënyrë efektive *acquis*-të dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Për më tepër, e drejta e qytetarëve për një administratë të mirë është e përfshirë në Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së[249]. Detyrimet e përgjithshme kombëtare burojnë, gjithashtu, nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe nga jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht në lidhje me konceptin e mirëqeverisjes. Sipas këtyre standardeve, çdo person ka të drejtën që çështjet e ngritura prej tij të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme nga autoritetet publike. Disa aspekte të tjera janë transparenca dhe marrja e informacionit, të cilat janë mjete të domosdoshme në mekanizmat kombëtare të kontrollit dhe llogaridhënies[250]. Administrata publike në nivel kombëtar dhe lokal është funksionale kur ofron përgjigje ndaj krizave, ofron shërbime, zbaton reforma, menaxhon investimet dhe, në përgjithësi, menaxhon shpenzimet publike për të krijuar vlera të pritshme sociale.

Metodologjia e re e zgjerimit, e miratuar në vitin 2020, e vendosi grupkapitullin "Themeloret" në qendër të negociatave të anëtarësimit, siç pasqyrohet në kuadrin e negocimit me Shqipërinë. Rrjedhimisht, Shqipërisë do t'i duhet të përqafojë dhe zbatojë plotësisht reformat në fushat themelore të shtetit të së drejtës, në veçanti reformën në drejtësi dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtat themelore, forcimin e institucioneve demokratike dhe reformën e administratës publike, si dhe kriteret ekonomike. Kjo, nga ana tjetër, do të nxisë një rritje të qëndrueshme dhe të përshpejtuar ekonomike dhe konvergjencë sociale. Prandaj, të gjithë komponentët e këtij grupi janë baza për një shtet të qëndrueshëm, demokratik, modern dhe mirëfunksionues. Ndër këto elemente përfshihet edhe reforma e administratës publike, duke përfshirë menaxhimin e financave publike, për të garantuar eficiencën, paanshmërinë profesionale, llogaridhënien/përgjegjshmërinë dhe që t'u shërbejë interesave të qytetarëve dhe biznesit[251].
Në lidhje me këtë aspekt, për të avancuar në rrugën e reformave për efekt të integrimit evropian, programi i qeverisë shqiptare thekson përmirësimin e efikasitetit të administratës shtetërore dhe publike, me qëllim plotësimin sa më efikas të nevojave të qytetarëve dhe ekonomisë, si dhe masat që synojnë forcimin e transparencës, përgjegjësisë dhe integritetit. Republika e Shqipërisë, si një

[249] Neni 41 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Shih: *Charter of Fundamental Rights of the European Union, Official Journal of the European Union*, OJ C 326, 26.10.2012.
[250] *FRA (European Union Agency for Fundamental Rights) (2021), "Çfarë nënkuptojnë të drejtat themelore për njerëzit në BE- Anketë për të drejtat themelore"*, Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, f.13, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2020-fundamental-rights-survey-human-rights-summary_sq.pdf
[251] *European Commission (2023), Screening Report Albania 2023, f.3.*

DOKUMENT PARLAMENTAR

nga 77 shtetet anëtare të nismës globale Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP), mbështet parimet e transparencës, luftës ndaj korrupsionit, fuqizimit të qytetarëve dhe përdorimit të përfitimeve të teknologjive të reja për të mundësuar që të gjitha nivelet e administratës publike të bëhen më efikase dhe të përgjegjshme. Shteti shqiptar thekson vendosmërinë e tij për të promovuar, mbështetur dhe zhvilluar politika specifike për një qeverisje të hapur, në të cilën transparenca, digjitalizimi i administratës, lufta kundër korrupsionit, drejtësia, përfshirja institucionale dhe llogaridhënia përfaqësojnë vlera vendimtare në zhvillimin e demokracisë, bazën e politikave në nivel të qeverisjes, duke respektuar agjendën e qytetarëve[252].

Korniza strategjike e reformës së administratës publike është miratuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), që monitorohet në mënyrë permanente nga qeveria dhe palët e interesuara. Në këtë kuadër, me VKM-në nr. 737, dt. 13.12.2023, është miratuar Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023-2030. Kjo VKM vjen si dokument i politikave shtetërore, piketa hapëse e grupkapitullit të parë "Themeloret", në kuadër të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian[253].

Shqipëria ka pranuar *acquis*-të dhe standardet evropiane në reformën e administratës publike dhe menaxhimin e financave publike. BE-ja ofron mbështetje financiare dhe teknike për shtetet anëtare dhe vendet kandidate për të zbatuar reformat e administratës publike, ku përfshin financimin, trajnimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. Komisioni Evropian ka publikuar raportin *Screening* për Shqipërinë, një vit pas hapjes së negociatave të anëtarësimit BE-Shqipëri dhe përfundimit të raundit të parë të takimeve. Raporti thekson progresin e Shqipërisë drejt BE-së, sfidat kryesore në vend dhe arritjet në reformat vendimtare, si dhe paraqet rekomandime për hapat e ardhshëm që do të ndërmerren në kontekstin e procesit të negociatave të anëtarësimit. Në përgjithësi, raporti ofron një vlerësim të progresit të Shqipërisë dhe thekson fushat që kërkojnë vëmendje dhe reforma të mëtejshme, ndërsa vendi ecën përpara në rrugëtimin e tij drejt anëtarësimit në BE. Shteti shqiptar është i përkushtuar të përmirësojë më tej stabilitetin, cilësinë dhe kapacitetin e administratës publike dhe menaxhimit të financave publike. Në tërësi, BE-ja konsideron se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e reformës së administratës publike[254]. Zhvillimet dhe sfidat kryesore që lidhen me zbatimin e reformës së administratës publike përfshijnë kuadrin strategjik, menaxhimin e shërbimit publik dhe burimeve njerëzore, menaxhimin e financave publike, zhvillimin dhe koordinimin e politikave, *llogaridhënien* dhe ofrimin e shërbimeve.

Komisioni Evropian thekson nevojën për të ruajtur progresin e qëndrueshëm në avancimin e reformave të BE-së. Ai ka nënvizuar se progresi në grupkapitullin "Themeloret", përfshirë fushën e reformës së administratës publike, do të përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave të pranimit dhe theksoi përfitimet e reformës për qytetarët dhe bizneset. Komisioni Evropian ka vlerësuar pozitivisht emërimin e një ministri të dedikuar të mandatuar me koordinimin e agjendës

[252] Partneriteti për Qeverisje të Hapur. Plani Kombëtar 2023-2025, Tiranë, mars 2023, f.4, https://ogp.gov.al/uploads/2023/4/20230420175207_plani-kombetar-i-veprimit-2023-2025-pqh-mars-2023.pdf
[253] VKM nr. 737, dt. 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030".
[254] *European Commission* (2023), *Screening Report Albania 2023*, f.22.

DOKUMENT PARLAMENTAR

së RAP-it, si dhe ka ritheksuar nevojën për një udhëheqje të fortë politike për zbatimin e suksesshëm të nismave të RAP-it[255].

Ndonëse raporti *Screening* konsideron se Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në kuadrin e saj strategjik për reformën e administratës publike, sugjerohet që Shqipëria duhet të zhvillojë dhe miratojë në kohë kuadrin e saj të ri strategjik për të siguruar vazhdimësinë e reformave dhe për të përmirësuar koordinimin e politikave. Raporti mbulon, gjithashtu, çështje që lidhen me shërbimet publike, digjitalizimin, mbrojtjen sociale dhe kujdesin shëndetësor, duke sugjeruar përmirësime dhe reforma të mëtejshme në këto fusha. Ekonomia dhe konkurueshmëria, po ashtu, janë aspekte me rëndësi, duke vënë në dukje se ndërsa janë bërë përmirësime në sektorë të ndryshëm, si energjia dhe infrastruktura e transporti, digjitalizimi dhe arsimi, ka ende boshllëqe të konsiderueshme në nivel rajonal dhe evropian. Raporti thekson nevojën për investime të mëtejshme në infrastrukturë, zhvillimin njerëzor, kërkimin dhe zhvillimin, dhe masat për të rritur mbulimin dhe përshtatshmërinë e mbrojtjes sociale[256].
Disa institucione do të mbështeten për të caktuar objektiva të bazuar në rezultate dhe indikatorë të performancës, nëpërmjet të cilëve raportojnë periodikisht tek institucioni mbikëqyrës për rezultatet e arritura, në dy faza:
a) praktika e shtrirë në të gjitha ministritë dhe institucionet e varësisë, (raporti i vlerësimit që do hartohet në dhjetor 2025);
b) Korniza e llogaridhënies për institucionet e varësisë është e përmirësuar dhe ministritë ushtrojnë mbikëqyrje efikase ndaj tyre. Po ashtu, krijimi i institucioneve të reja do bëhet mbështetur në kritere të qarta lidhur me tipologjinë dhe legjislacionin e aplikueshëm[257].

Duke iu referuar nivelit vendor, nevoja për të forcuar në mënyrë të vazhdueshme sistemet e menaxhimit të integritetit, në kuadër të thellimit të procesit të decentralizimit, është evidente. Procesi i decentralizimit i shërben forcimit të llogaridhënies duke e sjellë qeverisjen më afër qytetarëve. Hartimi i planeve të integritetit dhe planeve përkatëse të veprimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) dhe monitorimi i realizimit të tyre ofrojnë kuadrin konceptual për politikat dhe masat për parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë.

Menaxhimi i integritetit institucional dhe monitorimi si hallkë përbërëse e tij synojnë të ndihmojnë politikbërësit, administratat vendore dhe shoqërinë civile për të përmirësuar kontrollin ndaj korrupsionit në shoqëritë dhe komunitetet e tyre. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Planit të Integritetit, si një etapë e rëndësishme e ciklit të menaxhimit të risqeve të integritetit, u mundëson bashkive të shohin potencialin e tyre për përmirësim në fusha specifike të veprimtarisë së njësisë

[255] Takimi i 11-të i Grupit Special të Reformës në Administratën Publike ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, zhvilluar më 27 qershor 2023, www.eeas.europa.eu/delegations/albania/11th-meeting-public-administration-reform-special-group-between-european-union-and-albania_en?s=214
[256] Udhërrëfyesit për vitin 2025 "Masat e ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit evropian", Udhërrëfyesi C, "Reforma në administratën publike".
[257] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, 2023-2030.

DOKUMENT PARLAMENTAR

vendore, gjë që ndihmon në zhvillimin e strategjive të bazuara në evidenca dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave konkrete për të parandaluar ose zvogëluar korrupsionin, duke garantuar qeverisje të mirë dhe efikase. Ndërsa hapi i parë lidhet me hartimin e Planit të Integritetit (detajuar ky i fundit edhe me një plan veprimi 3-vjeçar), monitorimi dhe raportimi i Planit të Integritetit është etapa tjetër e menaxhimit të riskut në nivel vendor. Raportimi është një procedurë e rregullt që do të sigurojë zbatimin e Planit të Veprimit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara[258].

Planet e integritetit kanë sjellë efekte të tjera pozitive në procedurat e prokurimeve publike, llogaridhënien dhe forcimin e rolit të audituesve të brendshëm, qartësimin e detyrave të personelit si dhe përmirësime në menaxhimin financiar dhe transparencën me komunitetin, veçanërisht në treguesit financiarë. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësive të sinjalizuesve. Gjithashtu, janë krijuar e plotësuar regjistrat për shmangien e konfliktit të interesit dhe ai për ankesat dhe kërkesat. Forcimi i procedurave të llogaridhënies lehtëson funksionimin e administratës publike. Përcaktimi i përgjegjësisë dhe ndarja e punës rrit saktësinë dhe kompetencën e administratës, duke ulur në të njëjtën kohë presionin që sjell llogaridhënia dhe kërkesa për transparencë në rritje nga ana e publikut.

3.2. Progresi dhe arritjet

Në vijim trajtohet progresi dhe arritjet në lidhje me llogaridhënien, duke iu referuar aspekteve të caktuara lidhur me:

3.2.1. Legjislacioni dhe përditësimi i tij i harmonizuar me *acquis*

Baza ligjore dhe struktura institucionale për një sistem koherent të politikëbërjes janë tanimë të vendosura. Po ashtu, sa i përket mbikëqyrjes së administratës publike nga institucionet e pavarura, korniza legjislative është përgjithësisht adekuate dhe siguron pavarësi të mjaftueshme të institucioneve mbikëqyrëse, por, gjithsesi, ka vend për plotësim, rishikim dhe harmonizim në përputhje me *acquis*-të e BE-së. Në lidhje me legjislacionin përkatës mbi llogaridhënien, në analizë trajtohen disa nga pjesët më të rëndësishme të tij, me fokus reformën në administratën publike, e posaçërisht llogaridhënien.

Kodi i Procedurave Administrative (KPA) ofron kuadrin legjislativ për të thjeshtuar procedurat administrative në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ndaj, nevojitet të përfundojë procesi i harmonizimit të ligjeve dhe akteve nënligjore sektoriale me kodin. Në prill 2023 qeveria miratoi një dokument të ri politikash për standardet e shërbimeve publike, i cili synon të përmirësojë standardet e shërbimit.

Përgjegjësia dhe llogaridhënia gjen pasqyrim edhe në këtë kod, si parime kryesore të përcaktuara prej tij. Kështu, neni 15 i Kodit të Procedurave Administrative (KPA) parashikon parimin e përgjegjësisë: “Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative,

[258] Raport-monitorimi i realizmit të planeve të integritetit të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

DOKUMENT PARLAMENTAR

mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës". Llogaridhënia është thelbësore për ruajtjen e besimit të publikut, sigurimin e përdorimit efikas të burimeve dhe mbështetjen e parimeve demokratike të mirëqeverisjes dhe shtetit të së drejtës. Llogaridhënia në administratën publike është një aspekt thelbësor që siguron që zyrtarët të përgjigjen për veprimet dhe vendimet e tyre. Ekzistojnë mekanizma të ndryshëm për të siguruar llogaridhënien, duke përfshirë: përgjegjësinë/llogaridhënien ligjore, politike dhe atë administrative.

Neni 21 i KPA-së me titull "Parimi i kontrollit" përcakton se veprimtaria administrative i nënshtrohet:

a) kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e këtij kodi mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi;

b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) çdo kontrolli tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Garantimi i këtij parimi të rëndësishëm mbi të cilin funksionon administrata publike mund të jetë sfidues për shkak të faktorëve të tillë, si: kapaciteti i kufizuar mbikëqyrës, pritshmëritë e shumta të llogaridhënies dhe kompleksiteti i administratës publike.

Po ashtu, krijimi i institucioneve të reja do të bëhet mbështetur në kritere të qarta lidhur me tipologjinë dhe legjislacionin e aplikueshëm dhe i gjithë legjislacioni sektorial të jetë në përputhje dhe i harmonizuar me Kodin e Procedurave Administrative. Pritet që deri në dhjetor 2025 65 akte ligjore të harmonizohen me Kodin e Procedurave Administrative për të përfunduar procesin e harmonizimit dhe duke sjellë përfitime dhe lehtësira për publikun në këtë fushë[259].

Legjislacioni i shërbimit civil (ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore) përcakton kritere të qarta për rekrutimin, largimin nga puna të nëpunësve civilë, procedimin dhe masat disiplinore dhe parashikon të drejtën e ankimit në gjykatë kundër veprimeve ose mosveprimeve administrative. Legjislacioni aktual është në përputhje me parimet thelbësore të rekrutimit të bazuar në merita, sipas parimeve të OECD/SIGMA. Legjislacioni i shërbimit civil rregullon statusin e tri kategorive të punonjësve: institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore. Megjithatë, ai nuk mbulon të gjithë punonjësit e administratës pasi marrëdhëniet e punës në disa institucione që i raportojnë drejtpërdrejt Kryeministrisë, Kryeministrit apo ministrave, rregullohen nga Kodi i Punës dhe jo nga ligji për nëpunësin civil. Kuadri legjislativ, duke përfshirë legjislacionin dytësor për rekrutimin, vlerësimin e performancës, zhvillimin profesional dhe procedurat disiplinore dhe shkarkimet, siguron që nëpunësit civilë të kenë bazën e nevojshme për të kryer detyrat e tyre me profesionalizëm, neutralitet dhe llogaridhënie dhe kufizon ndërhyrjet politike në proceset e burimeve njerëzore[260].

[259] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, 2023-2030.

[260] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024*, (*Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f. 48.*

DOKUMENT PARLAMENTAR

Lidhur me shërbimin civil, vlen të theksohet se ndryshimet e fundit ligjore në lidhje me reformën e pagave në maj të vitit 2023 sollën ndryshime në strukturën e pagave të shërbimit civil, duke përfshirë një rritje të peshës së vjetërsisë në punë dhe një gamë më të gjerë të klasave të pagave. Kjo e bën këtë sektor tërheqës për profesionistët dhe nëpunësit e kualifikuar, për të garantuar një administratë profesionale, eficiente dhe të përgjegjshme. Gjithsesi, mbetet ende të adresohet vlerësimi i performancës së nëpunësve civilë, si dhe kompleksiteti i strukturës së pagave. Zbatimi i vazhdueshëm dhe efektiv i dispozitave për rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e nëpunësve civilë, bazuar në merita në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin e lartë, si dhe vazhdimi i reformës së sistemit të pagave për nëpunësit civilë, mbeten prioritet në vijimësi[261]. Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të zhvillohen më tej. Dispozitat për rekrutimin, promovimin dhe shkarkimin e bazuar në merita vijojnë të zbatohen në mënyrë jokonsistente në të gjitha nivelet. Masat e fundit për rekrutimin e bazuar në merita dhe rritjen e pagave janë marrë në nivel qendror dhe duhet të zgjerohen edhe në nivelin vendor[262]. Duhet që procedurat e rekrutimit për trupën e nivelit të lartë drejtues të mirëpërcaktohen, ndaj nevojiten ndryshime në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", duke respektuar parimin e rekrutimit bazuar në merita, sipas përcaktimeve në ligjin "Për nëpunësin civil", si dhe ndryshime në aktet zbatuese për procedurat e rekrutimit për kategoritë e tjera të nëpunësve civilë.

Ligji nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen" konsiderohet një risi në kuadër të llogaridhënies, vendimmarrjes gjithëpërfshirëse dhe transparencës. Ky ligj bën përcaktimin e rregullave për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse, rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së administratës shtetërore përmes platformës "Me ty për Shqipërinë që duam". Veprimtaria administrative, përveç kontrollit administrativ dhe kontrollit gjyqësor, i nënshtrohet edhe kontrollit sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj, ndaj edhe mekanizmat[263] që burojnë prej tij në kuadër të bashkëqeverisjes konsiderohen se kontribuojnë në forcimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga institucionet e administratës shtetërore nën

[261] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë *2024*, Komisioni Evropian, Bruksel:3 0.10.2024, f. 5, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

[262] Po aty.

[263] Metodat e bashkëqeverisjes janë përcaktuar shprehimisht në nenin 17, pika 1 e këtij ligji.

1. Metodat e platformës, të paraqitura sipas seksioneve në platformë, ndahen në varësi të përmbajtjes së çështjeve që adresohen:

a) metoda e kontrollit, ku përfshihen të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë ose çështje të denoncimit të korrupsionit të paraqitura në seksionet: "Ankesa ime", "Biznesi im", "Denonco korrupsionin";

b) metoda e ndërveprimit, ku përfshihen ide, nisma komunitare nga qytetarë ose persona fizikë apo juridikë të paraqitura në seksionet: "Nisma ime", "Interpelanca ime", "Kuvendimi im", "Shkolla ime";

c) metoda e gjithëpërfshirjes, ku qytetarë ose persona fizikë apo juridikë shprehin vlerësimin e tyre për politikat e qeverisë apo interesin e tyre për të dhënë kontribut në administratën shtetërore, të paraqitura në seksionet: "Fjala ime", "Nota ime", "Dua të kontribuoj".

2. Seksionet e platformës "Me ty për Shqipërinë që duam", sipas metodave të parashikuara më sipër janë: "Ankesa ime", "Biznesi im"; "Denonco korrupsionin", ç) "Nisma ime", d) "Fjala ime", dh) "Interpelanca ime", e) "Shkolla ime"; ë) "Nota ime", f) "Dua të kontribuoj", g) "Kuvendimi ynë".

DOKUMENT PARLAMENTAR

përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe nga entet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas kushteve dhe përcaktimeve të këtij ligji. Ligji, gjithashtu, përcakton mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kompetencat e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje. Kjo agjenci është person juridik publik qendror në varësi të Kryeministrit dhe përgjigjet për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, për garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse, si dhe për rritjen e përgjegjshmërisë e llogaridhënies së administratës shtetërore[264].

Ky ligj lejon paraqitjen e ankesave *online* dhe prezanton një proces ndërmjetësimi që synon të zgjidhë çështjet pa shkuar në gjykatë. Në raportin *Screening* (2023) evidentohet se 60% e ankesave administrative janë zgjidhur përmes këtij mekanizmi, duke ulur kështu ngarkesën gjyqësore. Për sa i përket kësaj procedure të re *online* për mbledhjen e ankesave, 2000 ankesa në javë bëhen nga qytetarët dhe bizneset, ndër të cilat vetëm 10% nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit[265].

Në vitin 2020 Kuvendi miratoi ligjin nr.102/2020 "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin", i cili ka për objekt përcaktimin e parimeve bazë të përgjegjësive dhe të rregullave për zhvillimin rajonal dhe kohezionin në Republikën e Shqipërisë. Përmes zhvillimit rajonal dhe kohezionit synohet të inkurajohen rajonet më pak të zhvilluara për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, nëpërmjet shfrytëzimit të potencialeve të rajoneve për sa i përket kapitalit fizik dhe atij human[266]. Rajonet e zhvillimit nuk janë njësi administrative në kuptim të legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, por ato përcaktohen si njësi territoriale, që përfshijnë disa njësi të vetëqeverisjes vendore. Rajonet e zhvillimit janë territoret për të cilat hartohet, zbatohet dhe vlerësohet politika kombëtare për zhvillimin dhe kohezionin rajonal. Në këtë ligj Fondi Shqiptar i Zhvillimit njihet si aktori kryesor në përgatitjen e dokumenteve të planifikimit dhe programimit të zhvillimit rajonal, por, gjithashtu, edhe në cilësinë e autoritetit menaxhues ky ligj i jep përgjegjësinë për menaxhimin e programit operacional në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar.
Subjektet përgjegjëse në zbatimin e politikës për zhvillimin rajonal, bazuar në parimin e partneritetit dhe të përgjegjësive që përcakton ky ligj, janë: a) organet e qeverisjes në nivel qendror; b) organet e vetëqeverisjes vendore; c) shoqëria civile; ç) sektori privat; d) institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore-shkencore. Këto subjekte përfshihen në proceset e koordinimit, të konsultimit, të negocimit dhe të bashkëpunimit, në mënyrë që të mundësohet dakordësia e tyre për drejtimet strategjike të zhvillimit, duke siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe përfshirje të aktorëve në arritjen e objektivave të politikës rajonale[267].

Sipas përcaktimeve të këtij ligji, bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal janë organet kryesore që promovojnë interesat e rajoneve të zhvillimit dhe veprojnë si një organ i përbashkët i njësive të

[264] Neni 14 i ligjit nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen".
[265] *European Commission (2023), Screening Report Albania 2023*, f.30.
[266] Neni 3/5 i ligjit nr.102/2020 "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin".
[267] Neni 7 i ligjit nr.102/2020 "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin".

DOKUMENT PARLAMENTAR

vetëqeverisjes vendore të rajonit të zhvillimit. Bordet bashkëpunojnë me autoritetet e pushtetit qendror dhe aktorët e tjerë të përfshirë në planifikimin, programimin dhe zbatimin e politikës rajonale, në përputhje me parimin e partneritetit. Në përcaktimin e përbërjes së bordeve zbatohet parimi i partneritetit, duke siguruar praninë e njësive të vetëqeverisjes vendore, të sektorit privat, të institucioneve kërkimore-shkencore, të shoqërisë civile dhe medies[268]. Ajo që mund të konsiderohet një sfidë në lidhje me zbatimin e këtij ligji dhe të politikës së zhvillimit rajonal lidhet me parimin e partneritetit dhe subsidiaritetit në zbatimin praktik të ligjit dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Dalja e këtij ligji është shoqëruar me akte nënligjore të caktuara.
Duke konsideruar objektivin strategjik 1 të SKZHIE-së, pjesë e tij është edhe vlerësimi dhe përcaktimi i prerogativave vendore, rajonale dhe qendrore në zhvillimin vendor e rajonal (shmangia e mbivendosjes mes politikës së zhvillimit rajonal e vendor) dhe vlerësimi i gatishmërisë së decentralizimit të mëtejshëm[269].

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse. Sipas këtij ligji, marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të qeverisjes qendrore bazohen në parimet e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.
Qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikat, legjislacionin dhe normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësive. Po ashtu, njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet të cilave mundësohet prezantimi i opinioneve, komenteve dhe propozimeve të tyre për politikat dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre. Ministritë, sipas fushave të përgjegjësisë dhe kompetencës, monitorojnë veprimtarinë e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV) dhe për funksionet e deleguara kanë të drejtë t'i mbikëqyrin ato. Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj. NJVV-të u nënshtrohen mbikëqyrjes dhe inspektimit financiar për zbatimin e normave e standardeve kombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike, i nënshtrohen kontrollit të jashtëm financiar nga organet e qeverisjes qendrore për përdorimin e fondeve të kushtëzuara dhe/ose të deleguara që financohen nga buxheti i shtetit dhe/ose fondet e ndihmës së huaj, të alokuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga qeverisja qendrore, si dhe janë subjekt i kontrollit nga KLSH-ja.

Sipas përcaktimeve të këtij ligji, parashikohet edhe bashkëpunimi mes njësive të ndryshme të qeverisjes vendore (kreu V i ligjit). Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve specifike

[268] Neni 18 i ligjit nr.102/2020 "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin".
[269] Shih objektivi strategjik 1: *Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor me anë të rritjes së kapaciteteve vendore për menaxhim të integruar të aseteve vendore,* Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).

DOKUMENT PARLAMENTAR

në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion dhe/ose shërbim që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë[270].

Ligji nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" ka si qëllim krijimin e një kuadri ligjor të njëjtë për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, nëpërmjet përcaktimit të kritereve për krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore. Sipas këtij ligji, administrata shtetërore është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore.
Ndër parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore është edhe parimi i llogaridhënies: "Çdo organ, institucion apo njësi administrative, i nënshtrohet drejtimit dhe mbikëqyrjes nga organi epror përkatës, si për veprimtarinë e vet, ashtu edhe për atë të organeve, institucioneve apo njësive administrative vartëse".
Po ashtu, sipas parimit të qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësive, ndarja dhe caktimi i funksioneve dhe detyrave administrative ndërmjet organeve, institucioneve dhe njësive administrative duhet të jenë specifike, të shmangin mbivendosjen, të jenë transparente dhe të bëhen publike në mënyrë të përshtatshme.

Në kuadër të angazhimeve lidhur me masat e ndërmarra në lidhje me procesin e integrimit evropian të vendit, objektiv për vitin 2024-2025, ndër të tjera, është amendimi i ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" deri në dhjetor 2024, si dhe hartimi i legjislacionit dytësor deri në qershor 2025, me qëllim:

- krijimin e kuadrit efektiv të llogaridhënies për institucionet e varësisë;
- mirëpërcaktimin e tipologjisë së institucioneve të varësisë.[271]

Siç përcaktohet në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, harmonizimi ndërmjet programimit ligjor dhe proceseve të vlerësimit të ndikimit rregullator (VNR/RIA) do të përmirësohet me synimin e promovimit të politikëbërjes më efektive dhe efikase dhe, po ashtu, hartimi i udhëzimeve dhe procedurave për të siguruar që vlerësimi i ndikimit rregullator të kryhet përpara se aktet ligjore/nënligjore të propozuara të përfshihen në agjendën legjislative (afati: brenda 2025).

[270] Neni 14 i ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
[271] Udhërrëfyesit për vitin 2025 "Masat e ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit evropian", Udhërrëfyesi C. "Reforma në administratën publike".

DOKUMENT PARLAMENTAR

3.2.2. Drejtimi strategjik, koordinimi i politikave dhe infrastruktura institucionale

Ndërhyrjet e qeverisë në fushën e reformës së administratës publike (RAP) bazohen në dokumente strategjike të konsultuara me të gjitha palët e interesuara, me objektiva dhe tregues të qartë dhe të publikuar, për të siguruar monitorimin nga shoqëria civile[272]. Korniza strategjike e Reformës së Administratës Publike (SFRAP) është e miratuar dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) dhe monitorohet në mënyrë efikase nga qeveria dhe palët e interesuara. Kjo kornizë strategjike përbëhet nga:

- *Strategjia e Reformës së Administratës Publike,*
- *Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike,*
- *Strategjia për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore,*
- *Strategjia Antikorrupsion,*
- *Strategjia e Agjendës Digjitale*[273].

Kur bëhet fjalë për arritjet dhe hapat pozitivë lidhur me kornizën strategjike, Komisioni Evropian ka vlerësuar miratimin e Agjendës Digjitale të Shqipërisë 2022-2026; Strategjinë 2023-2030 për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike dhe inkurajon autoritetet shqiptare që të avancojnë punën e tyre në përgatitjen e strategjisë së re të reformës së administratës publike[274]. Ndërkohë, në dhjetor 2024 është miratuar edhe Strategjia e re Ndërsektoriale Antikorrupsion, plani i saj i veprimit 2024-2026 dhe pasaporta e treguesve të performancës, që janë pjesë përbërëse e tij.[275]. Sipas raportit *Screening* 2023, Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar për sistemin e saj të organizimit dhe llogaridhënies[276]. Duhet të përforcohet funksioni qendror i kontrollit të cilësisë për planifikimin dhe zbatimin e politikave.
Shqipëria ka nisur prej vitit 2017 një projekt ambicioz dhe gjithëpërfshirës të ristrukturimit të administratës, por ideja e racionalizimit të agjencive u përball me pengesa të rëndësishme organizative, teknike dhe politike. Në vitin 2017, pas riorganizimit të ministrive, qeveria shqiptare nisi një projekt në shkallë të gjerë për ristrukturimin e agjencive, që synonte të bashkonte institucionet me funksione të ngjashme për të përmirësuar administratën territoriale dhe të fuste një tipologji të re të organeve administrative. Për të udhëhequr reformat u krijua një komitet drejtues i nivelit të lartë dhe SIGMA ndihmoi qeverinë shqiptare për zhvillimin e një metodologjie të detajuar për të drejtuar dhe udhëzuar procesin e ristrukturimit dhe për të promovuar reformat organizative të bazuara në dëshmi/fakte konkrete[277].

---

[272] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, 2023-2030.
[273] Po aty.
[274] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.10.*
[275] VKM nr. 859, dt. 26.12.2024, "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës", *Fletore Zyrtare* nr. 225, dt. 30.12.2024.
[276] *European Commission* (2023), *Screening Report Albania 2023*, f.32.
[277] Johnsøn, J., L. Marcinkowski and D. Sześciło (2021), "Organisation of public administration: Agency governance, autonomy and accountability", SIGMA Papers, No. 63, *OECD Publishing, Paris,* f.60 https://doi.org/10.1787/07316cc3-en. Për versionin shqip shih: www.sigmaweb.org/publications/SIGMA-Paper-No-63-2021-Albanian.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

Siç është vlerësuar në raportin e fundit të OECD/SIGMA 2024, Shqipëria mbetet lider rajonal në funksionimin e administratës publike në disa fusha tematike, veçanërisht në shërbimin publik dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin dhe koordinimin e politikave, si dhe menaxhimin e financave publike[278]. Vitet e fundit vendi ka bërë progres në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Shqipëria ka zhvilluar procese për të siguruar koordinimin e zhvillimit të politikave dhe politikat janë të harmonizuara me *acquis*-të e BE-së, veçanërisht nëpërmjet rolit të Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC). Megjithatë, koordinimi ndërmjet qeverisë qendrore dhe ministrive të linjës dhe agjencive të tjera në planifikimin dhe monitorimin e punës së qeverisë mbetet i kufizuar[279]. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 26.7.2023 "Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2024 – 2026", janë miratuar politikat prioritare në drejtim të buxhetimit afatmesëm 2024 – 2026. Ky dokument, si komponent i planifikimit strategjik afatmesëm, jep orientime të qarta dhe i paraprin procesit të buxhetimit e programimit afatmesëm, duke siguruar një nivel më të lartë përafrimi me objektivat strategjike të qeverisë. Ky akt është hapi i parë që mundëson që çdo vit një dokument i tillë politikash të miratohet për të udhëhequr procesin e buxhetimit afatmesëm[280].

Lidhur me menaxhimin e shërbimit civil dhe burimeve njerëzore, Komisioni Evropian përsërit rëndësinë e garantimit që të gjitha rekrutimet, promovimet dhe shkarkimet të jenë të bazuara në merita dhe transparente. Gjithashtu, ai inkurajon autoritetet shqiptare të krijojnë një sistem të thjeshtuar, transparent dhe të bazuar në merita; zgjerimin e mëtejshëm të sistemit të automatizuar të listës së pagave dhe përmirësimin e profesionalizimit të shërbimit civil[281].
Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Burimeve Njerëzore vazhdon të zhvillohet dhe të plotësohet me të dhëna personale. Tani lista e pagave mund të gjenerohet me të dhëna nga ky sistem, duke konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e tyre, por kjo gjenerohet vetëm për një pjesë të subjekteve (gjysmën). Për pozicionet e mbetura të dhënat e sistemit duhet të plotësohen dhe verifikohen, pasuar nga një proces financiar i plotë me kontrolle pozitive të vërtetimit. Përmirësimet janë të nevojshme për të shtrirë sistemin në pjesë të tjera të sektorit publik. HRMIS, gjithashtu, ndërvepron me regjistrin civil dhe ndërveprueshmëria me administratën tatimore dhe sigurimet shoqërore është në zhvillim e sipër[282].
Ajo që mbetet të adresohet në lidhje me shërbimin civil ka të bëjë me TND-në. Vakancat e shumta për pozitat e larta drejtuese në administratë vazhdojnë, pavarësisht numrit të mjaftueshëm të

[278] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.9.*
[279] *European Commission (2023), Screening Report Albania 2023, f.26.*
[280] Programi Kombëtar për Aderimin në BE 2024 – 2030 dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator: Nëntor 2023.
[281] Takimi i 11-të i Grupit Special të Reformës në Administratën Publike ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, zhvilluar më 27 qershor 2023.
[282] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.50.*

DOKUMENT PARLAMENTAR

kandidatëve në dispozicion, duke konfirmuar se sistemi nuk funksionon siç duhet dhe kërkon një rinovim të plotë[283].

Lidhur me zhvillimin dhe koordinimin e politikave, vlerësohet pozitivisht miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian 2022-2030[284] dhe Plani Kombëtar 2023-2025 për Integrimin Evropian[285]. Komisioni Evropian ka theksuar rëndësinë e rritjes së përdorimit dhe përmirësimit të cilësisë së vlerësimeve të ndikimit rregullator dhe konsultimeve publike, ndërkohë që pranon ekzistencën e një themeli të fortë për zbatimin e tyre. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 përfshin disa qasje kyçe për të përmirësuar zhvillimin dhe integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ku ndër to përfshihet edhe qeverisja e mirë: forcimi i institucioneve demokratike, lufta kundër korrupsionit dhe përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies. Ndër të tjera, kjo strategji thekson rëndësinë e planifikimeve afatmesme dhe afatgjata në arritjen e suksesit në qëllimet finale. Një pjesë e rëndësishme e planifikimeve është buxhetimi, i cili duhet të realizohet me rëndësinë që ka dhe të jetë pjesë e transparencës dhe llogaridhënies, për të kuptuar nëse institucionet publike janë në rrugën e duhur. Pa diskutim, kërkohet monitorim rigoroz i ecurisë së projekteve apo politikave që zbatohen nëpërmjet fokusit në llogaridhënie.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2023-2025 përfshin një sërë masash konkrete që synojnë të përmbushin kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, e ku mes tyre përmendim reformën administrative, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe rritjen e transparencës dhe efikasitetit të institucioneve publike.
Llogaridhënia në kontekstin e PKIE-së përfshin përgjegjësinë e institucioneve publike për të raportuar dhe justifikuar veprimet dhe vendimet e tyre. Këtu përfshihet: transparenca; raportimi si detyrim për institucionet të raportojnë rregullisht për progresin e tyre në zbatimin e masave të planifikuara dhe për arritjet e tyre, gjë që ndihmon në monitorimin e progresit dhe identifikimin e sfidave; kontrolli dhe auditimi për të siguruar që fondet publike përdoren në mënyrë efikase dhe efektive; përmirësimi i proceseve të prokurimit publik, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha fazat e procesit të prokurimit publik për të parandaluar korrupsionin dhe abuzimin me fondet publike, si dhe përfshirja e qytetarëve, nxitja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe krijimi i mekanizmave për të marrë *feedback* nga publiku mbi zbatimin e politikave dhe shërbimeve publike. Këto masa janë të rëndësishme për të siguruar që procesi i integrimit evropian të jetë i drejtë, transparent dhe i përgjegjshëm.
Ky plan (PKIE) thekson rëndësinë e burimeve njerëzore dhe rritjen e kapaciteteve të tyre nëpërmjet vlerësimit, trajnimeve, etj., duke pasur në fokus një administratë eficiente dhe efektive. Në PKIE janë vendosur një numër prioritetesh në të cilat do të përqendrohet administrata në zbatim të

[283] *Po aty, f.45.*
[284] VKM nr. 88, datë 22.2.2023, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030".
[285] VKM nr. 16, datë 11.1.2024, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026".

DOKUMENT PARLAMENTAR

politikave që i korrespondojnë prioriteteve të përcaktuara. Dhe sikurse theksohet, është prioritet edhe forcimi i mekanizmit të kontrollit të brendshëm[286].

Në fushën e llogaridhënies Komisioni Evropian u kërkon autoriteteve shqiptare të rregullojnë siç duhet kriteret për krijimin e organeve vartëse dhe të qartësojnë linjat e llogaridhënies, si dhe marrjen e masave shtesë për të rritur transparencën dhe për të përmirësuar aksesin në informacion. Po ashtu, në lidhje me ofrimin e shërbimeve, vlerësohen pozitivisht përpjekjet dhe hapat e marra për digjitalizimin e shërbimeve publike, por theksohet nevoja për të siguruar akses të barabartë në shërbimet digjitale për të gjithë qytetarët dhe bizneset, si dhe për të rritur vëmendjen ndaj sigurisë digjitale dhe mbrojtjes së të dhënave personale[287].
Që nga viti 2015, Shqipëria ka zbatuar një kuadër strategjik gjithëpërfshirës të reformës së administratës publike (SFRAP), bazuar në dokumente strategjike të sipërpërmendura. Shqipëria ka siguruar vlefshmërinë e SFRAP-it të saj duke zgjatur jetëgjatësinë e strategjive nga viti 2020 deri në 2023[288]. Në lidhje me elementin "llogaridhënie", OECD/SIGMA në raportin e saj të fundit, 2024, ka vlerësuar se është krijuar një sistem kompleks i përgjegjësisë organizative dhe menaxheriale për agjendën e RAP-it, si në nivelin politik, ashtu edhe në atë administrativ. Struktura organizative e administratës publike karakterizohet nga një numër organesh që raportojnë drejtpërdrejt në Zyrën e Kryeministrit apo edhe në Parlament. Ndërkohë që ka pavarësi dhe kompetenca të mjaftueshme për mbikëqyrjen efektive të administratës publike nga Avokati i Popullit dhe Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), zbatimi i rekomandimeve të tyre mbetet i ulët dhe Kuvendi duhet të ofrojë mbështetjen e duhur për këto organe kushtetuese në rolet e tyre monitoruese dhe mbikëqyrëse ndaj administratës publike[289]. Sa i përket mbikëqyrjes së administratës publike nga institucionet e pavarura, korniza legjislative është përgjithësisht adekuate dhe siguron pavarësi të mjaftueshme të këtyre institucioneve mbikëqyrëse. Në lidhje me institucionin e avokatit të popullit, sërish është vërejtur një rënie në zbatimin e rekomandimeve të tij[290].

Politika rajonale është mjeti kryesor i BE-së për të investuar në një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Shtetet anëtare të BE-së janë përgjegjëse për zbatimin e saj, gjë që kërkon kapacitet adekuat administrativ dhe menaxhim të shëndoshë financiar të hartimit dhe ekzekutimit të projekteve rajonale, vendosjen e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit financiar të shëndoshë dhe, gjithashtu, përmbushjen e elementeve të tjera të *acquis*-së së BE-së, si

[286] VKM nr. 16, datë 11.1.2024 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026".
[287] Takimi i 11-të i Grupit Special të Reformës në Administratën Publike ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, zhvilluar më 27 qershor 2023.
[288] SIGMA/OECD (2021), *Monitoring Report (executive summary): The Principles of Public Administration, Albania, OECD Publishing, Paris, f.10-11*; https://sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-Executive-Summary-2021-Albania.pdf
[289] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.11.*
[290] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.11.*

DOKUMENT PARLAMENTAR

legjislacioni mjedisor ose i prokurimit publik[291]. Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore janë të rëndësishme për Shqipërinë në drejtim të zbatimit të programit kombëtar IPA dhe përdorimit dhe menaxhimit të fondeve të BE-së.

Në raportin e BE-së për vitin 2024 vlerësohet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore[292]. Gjithsesi ka pasur progres, ku në veçanti, përmendim zgjerimin në anëtarësinë e grupit ndërinstitucional të punës për negociatat e Kapitullit 22[293]. Tashmë kërkohen përpjekje për ngritjen e kapaciteteve nga të gjitha institucionet për zbatimin e programeve të politikave të kohezionit, si dhe forcimin e bashkëpunimit institucional[294]. Mbetet të adresohet veçanërisht nevoja për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të detyrimeve që burojnë nga ligji për zhvillimin rajonal dhe kohezionin.
Janë krijuar mekanizma koordinimi ndërmjet ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit dhe ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor lidhur me përgatitjet për Kapitullin 22. Kapaciteti për të menaxhuar fondet publike në nivel lokal kërkon përpjekje të mëtejshme për shkak të rolit të ardhshëm të pushtetit vendor në politikën e kohezionit[295].
Për sa i përket kuadrit institucional për zbatimin e fondeve të kohezionit, është zgjeruar grupi ndërinstitucional i punës për Kapitullin XXII, i kryesuar nga SASPAC, e kjo shihet si një hap pozitiv për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional. Duhet të vazhdojnë përpjekjet për të siguruar bashkëpunimin me autoritetet përkatëse, në veçanti me Ministrinë e Administratës Publike dhe Antikorrupsionit dhe Ministrinë e Pushtetit Vendor.
Lidhur me menaxhimin e fondeve të BE-së në kuadër të IPA III, janë bërë përmirësime në funksion të rolit të ardhshëm në politikën e kohezionit të BE-së. Megjithatë, mbetet një shqetësim performanca e autoriteteve menaxhuese përgjegjëse për programet operacionale shumëvjeçare dhe programet e bashkëpunimit Interreg, për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme administrative, lëvizjeve të stafit, trajnimeve dhe menaxhimit të riskut të autoriteteve menaxhuese. Sa i përket programimit, përpjekjet duhet të vazhdojnë për t'u përgatitur për politikën e kohezionit. Në këtë aspekt, zhvillimi i kornizës kombëtare për zhvillimin rajonal mbetet kyç për të nxitur potencialin e zhvillimit dhe dimensionin territorial në politikat sektoriale në nivel kombëtar. Një element me rëndësi për përgatitjen e politikës së kohezionit do të jetë sigurimi i pronësisë nga organet publike dhe private në nivel kombëtar dhe rajonal, duke ndjekur parimin e partneritetit. Shqipëria duhet të përmirësojë si sistemin e saj të monitorimit, ashtu edhe sistemin e saj kombëtar të vlerësimit, për të siguruar përputhjen me kërkesat e legjislacionit mbi politikën e kohezionit të BE-së[296].

[291] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f.86, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[292] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f.18. https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[293] Kapitulli 22: Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore.
[294] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë *2024*, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f.87. https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[295] Po aty.
[296] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f. 86-88. https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

DOKUMENT PARLAMENTAR

Shqipëria krijoi mekanizmin e parafinancimit për përfituesit, i cili tani duhet të bëhet plotësisht funksional. Vendi duhet të ndërtojë kapacitete të mëtejshme institucionale në lidhje me përgatitjen, vlerësimin dhe procesin e përzgjedhjes së projekteve[297]. Shqipëria, gjithashtu, duhet të adresojë çështjet lidhur me planifikimin strategjik dhe kapacitetin e zbatimit për projektet infrastrukturore të financuara në kuadër të kornizës së investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) sipas Planit Ekonomik dhe Investimeve (EIP) dhe në kuadër të Programit të Reformës dhe Rritjes, pjesë e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor[298]. Këtu, vlen të përmendet miratimi i dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027" (AKR 2024–2027), në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor"[299], në kuadër të lancimit të nismës për propozimin e Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Mbështetja e BE-së do të kushtëzohet nga respektimi i parakushteve dhe realizimi i reformave (ku përfshihen edhe Themeloret), siç përcaktohet në agjendën e reformës.

Planet e Integritetit, hartuar dhe zbatuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV), kanë sjellë efekte të tjera pozitive në procedurat e prokurimeve publike, llogaridhënien dhe forcimin e rolit të audituesve të brendshëm, qartësimin e detyrave të personelit, si dhe përmirësim në menaxhimin financiar dhe transparencës me komunitetin, veçanërisht në treguesit financiarë[300]. Progres është konstatuar në ngritjen dhe funksionimin e njësive të sinjalizuesve. Gjithashtu, janë krijuar e plotësuar regjistrat për shmangien e konfliktit të interesit dhe ai për ankesat dhe kërkesat. Ndër objektivat kryesorë si pjesë e indikatorëve të performancës në një plan integriteti në qeverisjen vendore është edhe forcimi i transparencës, efikasitetit sipas fushave të përgjegjësisë dhe llogaridhënies publike të bashkisë. Zbatimi i planeve të integritetit ka forcuar transparencën dhe llogaridhënien në pothuajse të gjitha bashkitë, por ato që reflektojnë ndikim më të lartë janë bashkia e Bulqizës, Tiranës, Lezhës dhe Kukësit. Në përgjithësi bashkitë e vogla, për shkak edhe të burimeve teknike (financiare dhe IT), kanë shkallë më të ulët të impaktit të zbatueshmërisë së planeve të integritetit në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies[301]. Gjatë vitit 2023 bashkitë kanë treguar angazhim dhe dedikim në materializimin e planeve të integritetit dhe si rrjedhojë në zvogëlimin e risqeve të akteve jo-etike dhe korruptive. Shkalla e përgjithshme e realizimit të planeve të integritetit rezulton me një mesatare prej 58%.

[297] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f.87-88. https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

[298] Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor u miratua nga Komisioni Evropian më 8 nëntor 2023. Plani synon: integrimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor në tregun e vetëm të BE-së, avancimin e bashkëpunimit ekonomik rajonal, thellimin e reformave në lidhje me BE-në, rritjen e financimit të para-anëtarësimit në funksion të përshpejtimit të konvergjencës socio-ekonomike të Ballkanit Perëndimor me BE-në. Shih për më gjerë: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/growth-plan-western-balkans_en

[299] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor", *Fletore Zyrtare* nr.198/2024.

[300] Raport-monitorimi i realizmit të planeve të integritetit të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

[301] Raport-monitorimi i realizmit të planeve të integritetit të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Shkalla e realizimit te plotë të masave/aktiviteteve sipas planeve të integritetit, 2023



Burimi: Raport-monitorimi i realizmit të planeve të integritetit të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2023**.**

Kështu, nga monitorimi evidentohet përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, miratimi i Kodit të Sjelljes, si dhe plotësimi i programeve të transparencës, të cilat janë të publikuara në faqet zyrtare të NJVV-ve. Një sërë indikatorësh monitorimi kanë vlerësuar ndikimin e planeve të integritetit në forcimin e transparencës institucionale dhe llogaridhënies, duke zvogëluar kështu hapësirat për keqpërdorimin e pushtetit dhe kryerjen e akteve jo-etike/apo korruptive. Ky grup indikatorësh përfshin elemente të transparencës në aspektin rregullativ, transparencë në hartimin e politikave lokale dhe në veçanti atyre të identifikuara si prioritete strategjike dhe të zhvillimit. Për shkak të rëndësisë që kanë procedurat e prokurimeve, punësimeve, si dhe komunikimi me publikun, elemente të transparencës përfshijnë publikimin e planit të prokurimit, planit të pranimeve në shërbimin publik, raporte të audituesve, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave të marra nga publiku[302]. Rritja e përdorimit të IT-së dhe digjitalizimit të shërbimeve është një mundësi e mirë për të qenë më pranë publikut dhe direkt apo indirekt realizohet llogaridhënia. Ofrimi i shërbimeve në kohë të shpejtë ndihmon publikun të realizojë aktivitetet e nevojshme shpejt, duke rritur besimin ndaj shërbimeve publike dhe qeverisë. Përdorimi në rritje i IT-së duhet të shfrytëzohet në drejtim të transparencës dhe llogaridhënies nëpërmjet të qenit afër publikut.

Profesionalizmi i nëpunësve në administratën publike është një element me rëndësi që mund të çojë në ofrim më efektiv dhe efikas të shërbimeve publike. Ai ndihmon në nxitjen e një kulture llogaridhënieje dhe transparence brenda institucioneve publike. Në këtë drejtim, ASPA ka një rol me rëndësi në ofrimin e shërbimeve të trajnimit për nëpunësit në institucionet e pushtetit qendror, qeverisjen vendore dhe institucionet e pavarura (shërbim civil). ASPA ofron shërbime të ndryshme në kuadër të programit të trajnimit në klasë, programit të trajnimit për trajnerë, programit të *intership*-it, programit *e-learning*, etj. Për periudhën janar-gusht 2024 janë trajnuar 31938 nëpunës të institucioneve të pushtetit qendror, vendor dhe institucioneve të pavarura[303]. Gjithsesi, nevojitet

[302] Po aty.
[303] Shih: www.aspa.gov.al/trajnime-per-administraten-publike

përmirësimi në vijim i infrastrukturës fizike dhe digjitale të saj në funksion të misionit të kësaj shkolle[304].

Ndryshimet kanë ndodhur edhe në nivelin politik dhe institucional. Kështu, krijimi i postit të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, janë ndër ndryshimet e fundit të natyrës politiko-institucionale. Vlerësohet pozitivisht emërimi i ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (nga janari 2024), të mandatuar me koordinimin e agjendës së RAP-it, si dhe theksohet nevoja për një udhëheqje të fortë politike për zbatimin e suksesshëm të nismave të RAP-it. Kështu, në nivel politik dhe institucional, ky përfaqëson një tjetër zhvillim të rëndësishëm që qartëson përgjegjësinë politike për reformën e administratës publike (PAR)[305], për të rritur integritetin, transparencën dhe llogaridhënien, duke përforcuar qeverisjen e mirë, në përputhje me nevojat e procesit të integrimit me Bashkimin Evropian. Pjesë e fushës së kompetencës së ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është edhe hartimi i politikave për të rienergjizuar sektorin publik përmes tërheqjes dhe konsolidimit të kapitalit njerëzor, duke garantuar meritokraci, transparencë, mundësi avancimi në karrierë dhe vlerësim të drejtë[306].

Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor (MSHPV) i kaloi fusha e përgjegjësisë shtetërore për çështjet vendore në muajin tetor 2023. Ministri mbështetet nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)[307]. Misioni aktual i AMVV-së është garantimi në mënyrë të vazhdueshme i mbështetjes ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore, duke përmbushur me efikasitet dhe eficencë përgjegjësitë ligjore, ku ndër të tjera përmendim edhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe planin përkatës të veprimit[308].

Këshilli Konsultativ është forumi kryesor konsultues midis qeverisë qendrore dhe qeverisjes vendore, me qëllim institucionalizimin e procesit të konsultimit midis dy niveleve të qeverisjes, për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe e detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore kryen funksione ndihmëse dhe administrative në rolin e sekretariatit teknik[309].

---

[304] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f. 26, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

[305] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.9.*

[306] Shih edhe https://www.mapa.gov.al/

[307] Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) funksionon si institucion në varësi të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, veprimtaria e së cilës ushtrohet sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 227, datë 9.4.2024, "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore".

[308] Shih për më tepër https://www.qeverisjavendore.gov.al/amvv

[309] VKM. nr. 244, datë 17.04.2024 "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me veteqeverisjen vendore".

DOKUMENT PARLAMENTAR

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor së bashku me Shoqatën për Autonominë Vendore (SHAV) dhe me disa prej bashkive kryesore në vend, kanë ndërmarrë nismën për krijimin e Akademisë së Pushtetit Vendor, e cila do të mundësonte krijimin e paketave për trajnime specifike, të cilat adresojnë sfidat e NJVV-ve në vend[310].
Për uljen e barrës administrative, në dhjetor 2023 u krijua Grupi Ndërinstitucional i Punës për Rregullimin e Procedurave Administrative në funksion të shërbimeve publike që u ofrohen qytetarëve dhe bizneseve. Ai bashkëkryesohet nga ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit[311]. Evidentohet, gjithashtu, se është bërë përparim në uljen e hendekut të pagave midis niveleve të qeverisjes qendrore dhe vendore me ndryshimet e fundit ligjore.

Planet e integritetit, tashmë të miratuara nga ministritë e linjës dhe disa institucione publike të tjera në vend, janë tregues i një vullneti politik dhe i angazhimit të stafit administrativ për të ndërmarrë një proces vetëvlerësimi dhe për të hartuar një dokument strategjik për të ulur sa më shumë risqet e integritetit dhe korrupsionin në nivel të qeverisjes qendrore, si dhe për të rritur llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë. Pavarësisht kësaj, procesi në institucionet publike është në fillesat e tij, por rezultatet që po merren në këtë fazë duken premtuese për vijueshmërinë e këtij procesi në të ardhmen. Megjithatë, këto dokumente nuk do të prodhojnë efektin e synuar pa një angazhim konkret në zbatimin e masave të parashikuara, pa një vullnet politik dhe të lidershipit, pa një koordinim dhe monitorim të përqendruar, pa zotërim të procesit për identifikimin dhe menaxhimin e riskut për rishikimin e tij në të ardhmen dhe pa një qasje të hapur të institucioneve ndaj publikut dhe organizatave të shoqërisë civile[312].

3.3 Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet

3.3.1 Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet në lidhje me pushtetin qendror

Shqipëria mbetet mesatarisht e përgatitur në fushën e reformës së administratës publike (RAP), vlerësim ky i bërë në Raportin e Progresit të BE-së për Shqipërinë 2024[313], dhe rekomandimet e raportit të mëparshëm pjesërisht janë zbatuar. Posti i ri i ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin u krijua në janar 2024, me synimin që të garantojë një udhëheqje të qartë politike për agjendën e RAP-it dhe të përmirësojë koordinimin e përgjithshëm të përpjekjeve për reforma. Strategjia e re e menaxhimit të financave publike (MFP) për periudhën 2023-2030 u miratua në qershor 2024. Strategjia e re ndërsektoriale kundër korrupsionit u miratua në dhjetor 2024 dhe pritet të miratohet strategjia e re e reformës në administratën publike. Për shkak të

[310] Informacion i ardhur nga AMVV në Kuvend për Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL).
[311] Progresraporti BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f.26, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[312] IDM (2022), Dokument politikash: Integriteti në institucionet e qeverisjes qendrore, mundësitë, sfidat dhe e ardhmja, f.13.
[313] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f.4, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

DOKUMENT PARLAMENTAR

hendekut midis kornizës së mëparshme strategjike dhe pasuesit të tij, gjë që u zgjat duke përfshirë edhe vitin 2024, nuk mund të analizohet plotësisht suksesi i zbatimit ose arritja e rezultateve të synuara, edhe pse u zbatuan disa reforma të pavarura, të tilla si p.sh. rritja e pagave të shërbimit civil, ndryshimet në legjislacionin e prokurimit publik, etj. Po ashtu, kostoja për zbatimin e reformave varet shumë nga donatorët, ku 93% e kostos shtesë së strategjisë së MFP-së do të mbulohet nga burime të jashtme të qeverisë, duke krijuar rreziqe për qëndrueshmërinë afatgjatë të reformave[314].

Sistemi kompleks i grupeve të integruara të menaxhimit të politikave (IPMG) duhet të rishikohet dhe struktura institucionale të thjeshtohet dhe racionalizohet për të përmirësuar këtë koordinim. Shqipëria duhet të përforcojë funksionin qendror të kontrollit të cilësisë për planifikimin dhe zbatimin e politikave të Sekretariatit të Përgjithshëm. Struktura e grupeve të integruara të menaxhimit të politikave (IPMG) dhe grupeve tematike përkatëse ka qenë në rishikim që nga viti 2023[315]. Bazuar në përvojat nga cikli i monitorimit të RAP-it 2022 dhe vitet e mëparshme, organet koordinuese nuk ofrojnë mbështetje të mjaftueshme për zbatimin e strategjive, ata mblidhen zakonisht vetëm për të miratuar raportet vjetore të zbatimit dhe kufizohen në diskutimet e sfidave të zbatimit dhe masave të mundshme për tejkalimin e tyre[316].
Koordinimi i donatorëve dhe bashkëpunimi dypalësh është mjaft i nevojshëm për të mundësuar një bashkëpunim më të mirë, për të shmangur mbivendosjet dhe për efektshmërinë e shpërndarjes së fondeve të asistencës teknike, për efekt të garantimit të mirëqeverisjes. Roli i SASPAC-ut është qendror në këtë proces koordinues, dhe po ashtu sistemi IPMG duhet të rishikohet, të thjeshtohet, në mënyrë që të bëhet më efektiv[317].
Po kështu, Shqipëria duhet të përmirësojë kapacitetin administrativ të ministrive të linjës për planifikimin e politikave, monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave, si dhe duhet të përmirësojë kuadrin rregullator ekzistues për planifikimin e politikave afatmesme, të përmirësojë koherencën ndërmjet planifikimit të politikave dhe buxhetimit dhe të krijojë një funksion qendror të dedikuar të kontrollit të cilësisë për planifikimin dhe zbatimin e politikave[318].

Në lidhje me elementin llogaridhënie, OECD/SIGMA, në raportin e saj të fundit ka vlerësuar se është krijuar një sistem kompleks i përgjegjësisë organizative dhe menaxheriale për agjendën e RAP-it, si në nivelin politik, ashtu edhe në atë administrativ, por nuk ka qenë plotësisht funksional në çdo fushë. Edhe pse kalendarët e takimeve të grupeve tematike të IPMG-së janë të koordinuara përmes sekretariatit teknik, ato mbahen në mënyrë jo të rregullt dhe nuk sigurojnë diskutim të

[314] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.10.*
[315] Me urdhër të Kryeministrit në gusht 2023 janë riorganizuar grupet e menaxhimit të integruar të politikave, duke krijuar 6 grupe të tilla (përfshirë dhe Mirëqeverisjen) dhe ekipe tematike përkatëse për çdo IPMG.
[316] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.18-19.*
[317] Informacion i ardhur në GENL në kuadër të komenteve të sjella prej ekspertëve ndërkombëtare (organizatat ndërkombëtare).
[318] *European Commission (2023), Screening Report Albania 2023*, f.*26.*

DOKUMENT PARLAMENTAR

rregullt të të gjitha fushave tematike. Po ashtu, organizatat e shoqërisë civile nuk kanë qenë të angazhuara sistematikisht në koordinimin e agjendës së RAP-it për të gjitha fushat[319].
Kapaciteti administrativ për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe zhvillimin legjislativ duhet të forcohet më tej. Përdorimi i vlerësimeve të ndikimit rregullator (VNR) u kufizua në gjysmën e projektligjeve të miratuara. Në vitin 2023 qeveria raportoi 60 VNR/RIA dhe 30 VNR/RIA në periudhën nga janari 2024 deri në gusht 2024. Cilësia e VNR-ve, gjithashtu, duhet të përmirësohet. Rregullat ekzistuese për konsultimet publike dhe rregullat e VNR-së nuk zbatohen ende për legjislacionin dytësor[320].
Llogaridhënia është e rëndësishme për krijimin e besueshmërisë te publiku. Sipas FMN-së (2016) ky besim ulet për disa arsye, mes të cilave përmendet se parashikimet ekonomike dhe fiskale të qeverisë nuk i nënshtrohen vlerësimit të pavarur dhe nuk krahasohen me ato të parashikuesve të pavarur. Në dokumentacionet buxhetore nuk jepen shpjegime në lidhje me mosrealizimet e parashikimeve apo edhe analizë të efekteve që kanë në ekonomi mosrealizimi i parashikimeve. Qeveria nuk publikon një vlerësim të saktësisë së parashikimit të saj të kaluar[321].

Ligjet kuadër të organizimit të administratës publike i njohin agjencitë si pjesë të administratës publike në të gjitha rastet. Tipologjitë zyrtare të agjencive ndryshojnë (edhe mes vendeve të Ballkanit Perëndimor), por ato ndjekin një model të ngjashëm. Në Shqipëri, dallimi në ligj është i paqartë, ndaj ka nevojë për ndërhyrje. Për më tepër, organet e të njëjtit lloj mund të funksionojnë në regjime të ndryshme për sa i përket menaxhimit financiar ose statusit të personelit. Prandaj, në praktikë, shumica e agjencive vazhdojnë të operojnë sipas skemave të qeverisjes, të hartuara në mënyrë individuale, që rezultojnë më shumë nga marrëveshje/qasje politike se sa nga një vizion i qartë dhe gjithëpërfshirës i organizimit të administratës publike. Shumë organe publike vazhdojnë të ekzistojnë jashtë tipologjisë zyrtare, duke gëzuar statusin "special". Të gjithë këta faktorë rezultojnë në një peizazh organizativ kaotik, të fragmentuar, me mangësi praktike dhe të prekshme, siç janë diferencat e pashpjegueshme në pagat për të njëjtin pozicion dhe variacione të tjera në kushtet e punësimit në sektorin publik[322].
Treguesi llogaridhënie mat shkallën në të cilën është vendosur udhëheqja/drejtimi dhe llogaridhënia në RAP, rregullsia dhe cilësia e mekanizmave të koordinimit, si në nivelin politik, ashtu edhe në atë administrativ, si dhe performanca e institucionit udhëheqës. Sipas vlerësimit të BE-së, kuadri ligjor për organizimin e administratës qendrore nuk ofron një bazë gjithëpërfshirëse dhe konsistente për krijimin dhe llogaridhënien e institucioneve në varësi dhe agjencive

[319] *European Commission* (2023), *Screening Report Albania 2023*, f.23.
[320] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024*, *(Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.24.*
[321] *Albania Fiscal Transparency Evaluation (January 2016), IMF Country Report No. 16/5.*
[322] *Johnsøn, J., L. Marcinkowski and D. Sześciło (2021), "Organisation of public administration: Agency governance, autonomy and accountability", SIGMA Papers, No. 63, OECD Publishing, Paris, f.46* https://doi.org/10.1787/07316cc3-en. Për versionin shqip shih: www.sigmaweb.org/publications/SIGMA-Paper-No-63-2021-Albanian.pdf

autonome[323]. Për më tepër, edhe tipologjia e përcaktuar në ligj nuk zbatohet në mënyrë konsistente. Struktura organizative e administratës po bëhet më e centralizuar me numrin e autoriteteve/agjencive të varura drejtpërdrejt nga Zyra e Kryeministrit në rritje (aktualisht 26). Në vijim, është planifikuar një ndryshim në ligjin për organizimin e administratës shtetërore, por sfida kryesore do të jetë zbatimi i vazhdueshëm i tij në praktikë. Kuadri ligjor për sigurimin e llogaridhënies menaxheriale duhet të përmirësohet dhe, po ashtu, e drejta e qytetarëve për një administratë të mirë duhet të forcohet më tej. Sipas të dhënave të ofruara nga Avokati i Popullit (AP), 23 nga 72 rekomandimet e nxjerra në vitin 2023 ishin zbatuar plotësisht deri në mars 2024, duke përfaqësuar një normë prej 32% të zbatimit të tyre. Nevojiten më shumë veprime për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të tilla mbikëqyrëse[324]. Kuvendi duhet të forcojë bashkëpunimin me AP-në dhe të trajtojë problemin e mungesës së reagimit të organeve të administratës publike[325].

Kur flitet për llogaridhënien, Shqipëria mbetet një performuese solide rajonale në fushën e llogaridhënies. Në Ballkanin Perëndimor qeverisja qendrore është përgjegjëse për procesin e planifikimit strategjik. Në Shqipëri qeverisja qendrore është përgjegjëse për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, e cila ofron vizionin dhe drejtimin kombëtar për zhvillimin social dhe ekonomik për një periudhë shtatëvjeçare. Në Shqipëri, ashtu si në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, organet e qeverisjes qendrore kanë përgjegjësinë e monitorimit të zbatimit të strategjive kombëtare[326]. Nga ana tjetër, për të funksionuar llogaridhënia dhe eficienca administrative, duhet riparë kuadri rregullator dhe strukturor i një sërë agjencish që veprojnë aktualisht në kuadër të një autonomie të caktuar me varësi nga qeveria qendrore dhe ministri të linjës. Konsolidimet sektoriale janë të shumëllojshme dhe të shpeshta. Modele të caktuara të konsolidimit sektorial mund të identifikohen nga praktikat e mira evropiane si rekomandime të modeleve që mund të aplikohen në kuadër të reformimit.[327]

DOKUMENT PARLAMENTAR

[323] Progresraporti I BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f.26, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

[324] Diskutimet dhe konkluzionet e dala në tryezën publike me temë "Qeverisja e Hapur", zhvilluar me datë 6 dhjetor 2024, e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".

[325] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f. 26, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

[326] OECD (2020), *Government at a Glance: Western Balkans*, *OECD Publishing, Paris,* https://doi.org/10.1787/a8c72f1b-en

[327] *Johnsøn, J., L. Marcinkowski and D. Sześciło (2021), "Organisation of public administration: Agency governance, autonomy and accountability", SIGMA Papers, No. 63, OECD Publishing, Paris, f.12* https://doi.org/10.1787/07316cc3-en. Për versionin shqip shih: www.sigmaweb.org/publications/SIGMA-Paper-No-63-2021-Albanian.pdf

Si modele të tilla mund të përmenden:

- Bashkimi i të gjitha agjencive të ofrimit të shërbimeve që operojnë brenda një fushe politikash, p.sh., bashkimi i administratës doganore dhe tatimore, bashkimi i shërbimeve sociale dhe shërbimeve të punës;
- Bashkimi i rregullatorëve, p.sh., bashkimi i rregullatorëve financiarë, (bashkim i autoritetit mbikëqyrës financiar dhe autoritetit mbikëqyrës të sigurimeve); bashkimi i rregullatorëve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare;
- Bashkimi i autoritetit të konkurrencës me rregullatorin e tregut të postës dhe telekomunikacionit (Holandë).

- **Burimet njerëzore, zhvillimi profesional dhe performanca në shërbimin civil**

Në përgjithësi, kuadri ligjor ekzistues, struktura institucionale dhe strategjitë dhe udhëzimet përkatëse në shërbimin publik dhe menaxhimin e burimeve njerëzore janë kryesisht në përputhje me parimet e administratës publike të elaboruara nga OECD/SIGMA[328]. Megjithatë, zbatimi i përditshëm dhe rezultatet në këtë fushë përfshijnë disa boshllëqe dhe mospërputhje. Ndërsa shërbimi civil është profesional dhe i qëndrueshëm deri në nivelin e mesëm drejtues, rreziku i politizimit në nivelin e lartë drejtues mbetet një shqetësim. Reforma e pagave, e miratuar në maj 2023, solli ndryshime strukturore të kufizuara, por rriti pagat e nëpunësve civilë. Reforma nuk arriti të adresonte çështje kyçe, të tilla si kompleksiteti i strukturës së pagave ose mungesa e lidhjeve me performancën e punës. Mjetet digjitale të disponueshme për menaxhimin e burimeve njerëzore nuk përmbajnë të gjitha të dhënat përkatëse, të tilla si përshkrimet e punës ose vlerësimet e performancës. Megjithatë, portali digjital për rekrutim liston të gjitha njoftimet e punës për administratën e qeverisë qendrore, siç mandatohet nga kuadri ligjor në fuqi.

Për sa i përket zhvillimit profesional të administratës publike, edhe pse parashikohet nga legjislacioni i shërbimit civil, mekanizmi i ngritjes horizontale në shkallë pagash në bazë të performancës nuk zbatohet për shkak të një shkalle të lartë subjektiviteti të vlerësimit nga drejtuesit gjatë ushtrimit të vlerësimit të performancës. Të dhënat e fundit treguan se afërsisht 80% e performancës së punonjësve vlerësohet si "e mirë" ose "shumë e mirë". Po punohet për marrjen e masave të nevojshme për të reduktuar subjektivitetin në masën e mundshme në lidhje me këto vlerësime. Ndërhyrjet e fundit në sistemin e pagave nga prilli 2023 rritën vlerën e komponentit të vjetërsisë, që pritet të zëvendësojë mekanizmin e shkallëve/klasave të pagave. Në lidhje me rishikimin e legjislacionit, është parashikuar edhe ndryshimi në ligjin "Për shërbimin civil", për të përmirësuar mekanizmat e vlerësimit të performancës dhe karrierës[329]. Po ashtu, duhet të harmonizohen përshkrimet e vendeve të punës në të gjithë administratën. Pasja e përshkrimeve të harmonizuara të punës në të gjithë administratën publike mund të ndihmojë në sigurimin e një procesi rekrutimi të drejtë dhe të bazuar në merita, si dhe të inkurajojë lëvizshmërinë dhe zhvillimin e aftësive të tërthorta. Ndaj, lind nevoja për ndryshim në ligjin 152/2013, "Për

- Integrimi i inspektorateve (agjencitë rregullatore të zbatimit). Kjo mund të përfshijë integrimin e inspektorateve që operojnë brenda një zone specifike risku, duke ndjekur qasjen "një risk - një inspektorat", të promovuar nga OECD-ja (OECD, 2014), p.sh., duke bashkuar të gjitha organet që merren me sigurinë ushqimore.
- Konsolidimi i ofrimit të shërbimeve nga zyrat mbështetëse të administratës qeveritare në një strukturë të vetme qendrash mbështetëse të përbashkëta. Kjo përfshin, në veçanti, integrimin e ofrimit të shërbimeve, të tilla si menaxhimi i pronës dhe i flotës, menaxhimi financiar (kontabiliteti, administrimi i borderosë), prokurimi ose infrastruktura e TI-së.
- Integrimi i degëve territoriale të administratës së qeverisë (heqja ose riorganizimi i degëve territoriale të administratës qeveritare si faktori kryesor që çon në uljen e numrit të përgjithshëm të organeve qeveritar) apo integrimi i administratës territoriale nën strukturën e zyrave të qeverisjes së qarkut (nivel vendor) që sjell një ulje të numrit të organeve administrative. Konsolidimet sektoriale zakonisht mbështeten në grupimin e funksioneve të ngjashme në grupe në një organizatë të vetme. Kjo qasje është përdorur nga qeveritë që kërkojnë përfitime efikasiteti dhe sinergji përmes reformave organizative.

[328] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024*, *(Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris; f.43-65.*

[329] *European Commission (2023), Screening Report Albania 2023*, f.*28.*

DOKUMENT PARLAMENTAR

nëpunësin civil" në lidhje me strukturën e pagave, si dhe miratimi i metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës pas ndryshimeve ligjore, si dhe harmonizimi i tyre[330].
Qëllimi është krijimi i një shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, forcimi i kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet me fokus te meritokracia dhe profesionalizmi.

- Rekomandime në lidhje me pushtetin qendror

Sa i takon llogaridhënies, konkludohet dhe rekomandohet:
→ Qeveria shqiptare duhet të finalizojë dhe miratojë strategjinë e re të RAP-it, si dhe të garantohet zbatimi i strategjive menjëherë pas miratimit.
→ Qeveria duhet të rishikojë efektivitetin e modelit aktual dhe të strukturave për monitorimin e strategjive të RAP-it në nivel administrativ, me qëllim konsolidimin dhe riorganizimin e sistemit, në mënyrë që të reduktohet fragmentimi dhe të përmirësohet koordinimi.
→ Qeveria duhet të sigurojë diskutime dhe takime më të rregullta të të gjitha strukturave të nivelit politik dhe administrativ përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e RAP-it në të pesë strategjitë e përfshira në SFRAP. Aktorët e jashtëm dhe organizatat joqeveritare duhet të përfshihen në monitorimin e RAP-it në mënyrë më të rregullt dhe sistematike për të garantuar një llogaridhënie më të mirë.
→ Nevojitet miratimi i një kuadri legjislativ që rregullon siç duhet tipologjinë dhe kriteret për krijimin e organeve vartëse dhe linjat e qarta të llogaridhënies, përmes ndryshimeve të ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", si dhe hartimi i akteve nënligjore në bazë të ndryshimeve ligjore.
→ Iniciativat e vazhdueshme për eficiencën dhe thjeshtimin e procedurave administrative duhet të institucionalizohen për të garantuar që shërbimet publike të jenë jo vetëm të aksesueshme në mënyrë digjitale, por edhe miqësore për përdoruesit dhe të kryhen me efikasitet.
→ Qeveria duhet të krijojë një strukturë organizative për administratën publike që ndjek një tipologji të qartë, mundëson drejtimin efektiv ministror dhe garanton llogaridhënie, si dhe efikasitet.
→ Institucionet e përfshira në SFRAP (me miratimin/plotësimin e kornizës së re SFRAP) duhet të plotësojnë boshllëqet që ekzistojnë në kornizat e treguesve të performancës, duke përfshirë finalizimin e treguesve dhe objektivave të nivelit të rezultateve, për të qenë në gjendje të matin progresin drejt objektivave të reformës. Të dhënat dhe informacionet e monitorimit duhet të përdoren për të ndihmuar në zhvillimin e një kornize të re treguesish, për të përmirësuar kornizën e ardhshme strategjike të RAP.
→ Zyra e Kryeministrit, bashkë me ministrin përgjegjës për RAP-in, duhet të konsiderojë krijimin e një faqe interneti të qeverisë qendrore për të ofruar informacione të rregullta dhe të përditësuara mbi SFRAP-in e Qeverisë, si dhe për zbatimin dhe monitorimin e tij.
→ Megjithëse strukturat organizative dhe menaxhuese për RAP-in janë krijuar, arkitektura e përgjithshme e grupeve të menaxhimit të politikave të integruara (IPMG) për të koordinuar dhe

[330] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, 2023-2030. Gjetje e mbështetur edhe nga Informacion i ardhur në GENL në kuadër të komenteve të sjella prej ekspertëve ndërkombëtare (organizatat ndërkombëtare).

DOKUMENT PARLAMENTAR

udhëhequr zbatimin në nivel administrativ në të gjitha fushat kryesore të RAP-it është komplekse (gjashtë grupe tematike të IPMG dhe një komitet teknik mbulojnë të gjitha RAP dhe fushat e MFP). Vendi duhet të sigurojë koordinimin ndërmjet këtyre strukturave të ndryshme.

→ Lidhja ndërmjet mbështetjes teknike dhe politike për RAP-in duhet të forcohet. Qëndrueshmëria financiare duhet të përmirësohet përmes rishikimit më të mirë të burimeve të përgjithshme financiare, pasi aktualisht zbatimi i reformës varet shumë nga financimi nga donatorët e jashtëm.

→ Institucionet përgjegjëse duhet të sigurojnë që të gjitha raportet e kërkuara monitoruese të hartohen dhe publikohen në kohë, siç kërkohet nga kornizat përkatëse të matjes së performancës. Raportet vjetore të monitorimit duhet të përgatiten dhe publikohen në tremujorin e parë, pas përfundimit të vitit raportues.

→ Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, si dhe institucionet e tjera kompetente duhet të sigurojnë që përcaktimi i kostos së strategjive të RAP-it të kryhet në mënyrë konsistente dhe adekuate për të përmirësuar monitorimin dhe zbatimin e RAP-it. Kostoja e të gjitha strategjive të përfshira në SFRAP-in e ri duhet të bazohet në të njëjtën metodologji, për të lejuar monitorim efektiv dhe përmirësim të qëndrueshmërisë financiare të reformave.

→ Duhet marrë në konsideratë rishikimi i pozicionimit institucional të autoriteteve rregullatore që raportojnë aktualisht në Kuvend, duke siguruar që ato janë të përfshira në zbatimin e politikave të Qeverisë. Duke respektuar autonominë funksionale të rregullatorëve, kjo mund të përfshijë mekanizma për përafrimin e objektivave të tyre strategjike me prioritetet e politikave të qeverisë, si dhe raportimin e detyrimeve të këtyre rregullatorëve.

Kuvendi duhet të forcojë bashkëpunimin me këto institucione dhe të adresojë problemin e mungesës së reagimit të organeve të administratës publike.

→ Zbatimi i vazhdueshëm dhe efektiv i dispozitave për rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e nëpunësve civilë, bazuar në merita, në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin e lartë, si dhe vazhdimi i reformës së sistemit të pagave për nëpunësit civilë dhe të fillojë sërish automatizimi i sistemit të listës së pagave.

→ Kuadri rregullator i shërbimit civil ka ende boshllëqe legjislative, duke përfshirë mungesën e një politike shpërblimi dhe mungesën e një klasifikimi të harmonizuar të vendeve të punës. Dispozitat për rekrutimin dhe promovimin e bazuar në merita ekzistojnë, por duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha nivelet në praktikë.

→ Duhet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive dispozitat për rekrutimin, promovimin dhe shkarkimin e bazuar në merita sipas përcaktimeve në ligjin e shërbimit civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin e lartë;

→ Kapaciteti administrativ për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe zhvillimin legjislativ duhet të forcohet më tej. Përdorimi i vlerësimeve të ndikimit rregullator (VNR) duhet të përmirësohet dhe zgjerohet. Cilësia e VNR-ve, gjithashtu, duhet të përmirësohet dhe të zbatohen edhe për legjislacionin dytësor (aktet nënligjore).

DOKUMENT PARLAMENTAR

→ Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) në lidhje me ofrimin e programeve të saj të trajnimit për zhvillimin profesional, ka nevojë për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe digjitale të saj.
→ Garancitë që informacioni publik të jetë lehtësisht i arritshëm dhe i përditësuar për qytetarët dhe përfaqësuesit e medieve është thelbësor për të siguruar llogaridhënie dhe transparencë në veprimtaritë e qeverisjes.
→ Përdorimi i indikatorëve të performancës në fusha si shërbimet, menaxhimi i burimeve njerëzore e financiare dhe monitorimi i tyre ndihmon në identifikimin e problematikave dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike.
→ Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut. Fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për rrezikun e korrupsionit dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse janë të rëndësishme për të krijuar një kulturë të përgjegjshmërisë dhe të integritetit në shoqëri[331].

3.3.2 Kontrolli, monitorimi dhe menaxhimi i ndërmarrjeve shtetërore (NSH)

Ndërmarrjet shtetërore (NSH) janë aktorë të rëndësishëm ekonomikë dhe mund të rrisin aktivitetin ekonomik dhe konkurrencën nëse sigurohet një fushë e barabartë loje me kompanitë private. Zbatimi i politikave, kornizave institucionale dhe ligjore, që kontribuojnë në neutralitetin konkurrues midis firmave private dhe ndërmarrjeve shtetërore, marrin rëndësi në kushtet e zhvillimit të vendit. Transparenca dhe llogaridhënia[332] në lidhje me këto struktura shtetërore fokusohet në raportimin financiar dhe jofinanciar dhe praktikat e auditimit, duke përfshirë masat e integritetit kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e aksionarëve të pakicës.
Qeveria qendrore në Shqipëri është pronare e shumicës ose e plotë e rreth 76 NSH-ve, të cilat janë të pranishme në disa sektorë të rëndësishëm sistematik. Vlen të përmenden një sërë NSH qendrore me rëndësi sistemike, duke përfshirë: sektorin e transportit, Hekurudhat Shqiptare dhe disa ndërmarrje portuale; në sektorin e shërbimeve të tjera Posta Shqiptare; në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, e cila është prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në Shqipëri, kompania e shpërndarjes së energjisë elektrike OSHEE dhe kompania e transmetimit të gazit Albgaz. Shteti zotëron, gjithashtu, disa NSH që operojnë në sektorët primarë, duke përfshirë kompaninë e prodhimit të naftës Albpetrol dhe dy kompani të mëdha minerare. Së fundi, shteti zotëron disa kompani të pasurive të paluajtshme dhe prodhuese: shtatë kompani që operojnë në sektorin financiar, disa universitete dhe dy klube futbolli. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjithashtu, ka aksione minoritare në 28 kompani që nuk konsiderohen NSH, duke përfshirë shumë kompani prodhuese.
Lidhur me komponentin që analizohet (llogaridhënie), për sa u takon këtyre ndërmarrjeve shtetërore (NSH) në Shqipëri, disa gjetje vlejnë të përmenden[333].

[331] Raport-monitorimi i realizmit të planeve të integritetit të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.
[332] OECD (2024), *Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania, Competitiveness and Private Sector Development, OECD Publishing, Paris*, f.92. https://doi.org/10.1787/541ec4e7-en
[333] OECD (2024), *Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania, Competitiveness and Private Sector Development, OECD Publishing, Paris*, f.92. https://doi.org/10.1787/541ec4e7-en

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Këto NSH operojnë në një mënyrë kryesisht të decentralizuar nën disa ministri të pronësisë, pa një politikë pronësie nga e gjithë qeveria për të profesionalizuar dhe harmonizuar praktikat e pronësisë ose për të qartësuar objektivat e shtetit në lidhje me NSH-të. Një NSH është privatizuar gjatë dekadës që nga viti 2012 dhe asnjë privatizim nuk është duke u zhvilluar apo planifikuar.
- Përkundër një rregullimi të ri të vitit 2022 lidhur me emërimet e bordeve të NSH-ve në shoqëritë aksionare shtetërore, dobësitë vazhdojnë në kualifikimet dhe pavarësinë e bordit të NSH-ve, duke përfshirë praninë e individëve të lidhur politikisht, si zëvendësministrat, në disa borde të NSH-ve. Në disa NSH shteti anashkalon bordet e drejtorëve për të emëruar shefat ekzekutivë (CEO), duke i privuar bordet nga roli i tyre i praktikës së mirë për të mbikëqyrur menaxhmentin pa ndërhyrje politike.
- Mangësitë e rëndësishme në aranzhimet e pronësisë dhe bordit të NSH-ve rrisin rreziqet e ndërlidhura me korrupsionin e NSH-ve, duke përfshirë praninë e individëve të lidhur politikisht në bordet e tyre, si dhe paqartësi për objektivat e korporatës.
- NSH-të u nënshtrohen standardeve të shëndosha bazë të raportimit financiar, ndërsa ato të një madhësie të caktuar u nënshtrohen kërkesave shtesë për raportim jofinanciar në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së. Shteti nuk mbledh të dhëna të centralizuara të performancës për NSH-të dhe nuk publikon një raport të përgjithshëm mbi aktivitetet dhe performancën e tyre, duke nënkuptuar një boshllëk llogaridhënieje për ministritë, bordet dhe menaxherët përgjegjës për NSH-të.
- Për sa u përket kushteve të barabarta me kompanitë private, shumica e NSH-ve në Shqipëri janë të inkorporuara sipas ligjit për shoqëritë tregtare, në përputhje me praktikat e mira. Megjithatë, shtrirja e subvencioneve shtetërore për NSH-të, së bashku me mungesën e pritjeve të normës së kthimit, shtrembëron kushtet e barabarta të lojës kur bëhet fjalë për kushtet e financimit të NSH-ve.

Mungesa e një politike të qartë të pronësisë shtetërore, që të reflektojë arsyet kryesore për pronësinë shtetërore, mund të përkthehet në objektiva të paqarta të performancës për NSH-të, si dhe në boshllëqe në llogaridhënie për ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e NSH-ve. Asnjë kërkesë specifike për raportimin financiar dhe jofinanciar për NSH-të nuk është përpunuar në Shqipëri, por NSH-të janë subjekt i kërkesave përkatëse të zbatueshme për të gjitha kompanitë. Veçanërisht atyre u kërkohet të dorëzojnë pasqyrat financiare vjetore në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, e cila më pas i publikon ato. NSH-të e mëdha duhet të përgatisin pasqyrat financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar, ndërsa NSH-të më të vogla mund të raportojnë duke përdorur standardet kombëtare të kontabilitetit. Subjekteve të mëdha me interes publik me mbi 500 punonjës u kërkohet të përgatisin raporte jofinanciare për mbrojtjen e mjedisit, përgjegjësinë sociale, trajtimin e punonjësve, respektimin e të drejtave të njeriut, antikorrupsionin, si dhe diversitetin e bordit (në përputhje me Direktivën e BE-së 2014/95/BE). Si një vend që kërkon të anëtarësohet në BE, Shqipëria duhet të veprojë në përputhje me direktivat e

DOKUMENT PARLAMENTAR

BE-së për raportimin e qëndrueshmërisë. Në kontekstin e këtij vlerësimi, autoritetet evidentojnë se më pak se 20% e NSH-ve raportojnë mbi praktikat e qëndrueshmërisë dhe se në mesin e 21 NSH-ve në portofolin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, tre NSH publikuan raportet e qëndrueshmërisë në vitin 2022. Ekziston, gjithashtu, hapësirë për të përmirësuar raportimin e NSH-ve për arritjen e objektivave të politikave publike, për ato NSH që janë të ngarkuara me objektiva të tillë[334].

Shteti nuk prodhon një raport vjetor të përgjithshëm mbi aktivitetet ose performancën e portofolit të tij të NSH-ve në tërësi. Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT) publikon një listë vjetore të institucioneve të sektorit publik, e cila përfshin të gjitha NSH-të në pronësi të qeverisë qendrore dhe kontribuon në transparencën e shtetit në lidhje me ndërmarrjet që zotëron. Megjithatë, lista nuk ofron të dhëna për vlerësimin e korporatës, punësimin ose performancën për ndërmarrjet individuale dhe kështu nuk mund të konsiderohet një raport i përgjithshëm mbi performancën e portofolit të NSH-ve. Autoritetet shqiptare janë në procesin e zhvillimit të një sistemi të ri monitorimi financiar të NSH-ve me mbështetjen e Bankës Botërore, por ai ende nuk është funksional.

Sa u përket praktikave të auditimit, NSH-të u nënshtrohen dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare, që kërkojnë që të gjitha shoqëritë aksionare, si dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar që përmbushin disa kritere, t'i auditojnë pasqyrat e tyre financiare nga një auditor i jashtëm. Në praktikë, një pjesë e konsiderueshme e NSH-ve nuk i kanë pasqyrat e tyre financiare të audituara nga një auditor i jashtëm. Auditimet e jashtme janë një mjet thelbësor për të siguruar që pasqyrat financiare të NSH-ve pasqyrojnë me saktësi gjendjen financiare të kompanisë dhe ofrojnë një bazë të besueshme për vendimet e aksionarëve dhe bordit, që, ndër të tjera, lidhen me investimet dhe shpenzimet. Sipas informacionit të dhënë për 21 NSH-të në portofolin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, vetëm 8 nga ato NSH iu nënshtruan auditimit të pasqyrave financiare në vitin 2022. NSH-të, pasqyrat financiare të të cilave nuk janë audituar, përfshijnë disa ndërmarrje të rëndësishme ekonomikisht ose sistematike, si p.sh. Posta, një shoqëri aksionare që punëson 2 500 persona, dhe AgroKredit, i cili, megjithëse punëson një numër relativisht të vogël njerëzish (130), është aktiv në mbarë vendin dhe luan një funksion të rëndësishëm të politikës publike për ofrimin e financimit të synuar për individët dhe kompanitë, me fokus zhvillimin rural dhe turistik[335].
Sa u përket masave kundër korrupsionit dhe integritetit, ka mangësi të rëndësishme në aranzhimet e pronësisë dhe përgjegjësive të bordit të NSH-ve dhe pavarësisë, që rrisin rrezikun e ndërhyrjes politike në vendimet dhe operacionet e menaxhmentit të NSH-ve. Fakti që CEO-t e disa NSH-ve, duke përfshirë shumicën e NSH-ve në portofolin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, emërohen drejtpërdrejt nga aksionarët shtetërorë, përkeqëson rrezikun që ata CEO të marrin vendime të korporatës në interes të politikanit(ëve) që i kanë punësuar ata e jo në interes të

[334] OECD (2024), *Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania, Competitiveness and Private Sector Development, OECD Publishing, Paris*, f.95-96. https://doi.org/10.1787/541ec4e7-en
[335] OECD (2024), *Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania, Competitiveness and Private Sector Development, OECD Publishing, Paris*, f.95-96. https://doi.org/10.1787/541ec4e7-en

DOKUMENT PARLAMENTAR

ndërmarrjes. Ekzistojnë disa masa mbrojtëse brenda legjislacionit në fuqi. Ligji për shoqëritë tregtare përcakton që anëtarët e bordit dhe CEO-t duhet të marrin parasysh në mënyrë adekuate interesat e kompanisë dhe aksionarëve të saj dhe do të mbajnë përgjegjësi për angazhimet e kompanisë, në masën e aseteve të tyre, nëse veprimet e tyre, ose dështimi për të kryer veprime të caktuara, përfshijnë abuzimin e shoqërisë për qëllime të paligjshme ose trajtimin e aseteve të kompanisë si të tyret. Drejtorët ekzekutivë duhet të shmangin konfliktet aktuale dhe të mundshme të interesit ndërmjet interesave personale dhe atyre të kompanisë. Megjithatë, autoritetet nuk kanë përpunuar pritshmëri specifike për NSH-të në lidhje me vendosjen e masave kundër korrupsionit dhe integritetit dhe NSH-ve nuk u kërkohet të kryejnë vlerësime të rrezikut të korrupsionit[336].

3.3.3 Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet në lidhje me pushtetin vendor

Duhet përmendur se në lidhje me qeverisjen vendore raportet e ndryshme monitoruese vënë theksin në disa gjetje dhe problematika për adresim. Ndarja e përgjegjësive mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore vijon të mbetet një çështje për adresim dhe ende ekziston nevoja për të përmirësuar kuadrin ligjor për funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV). Është bërë përparim në uljen e hendekut të pagave midis niveleve të qeverisjes qendrore dhe vendore. Megjithatë, duhet vazhduar kjo përpjekje për NJVV-të e vogla, për të tërhequr dhe mbajtur staf të kualifikuar, bazuar në parimin e pagës së barabartë për pozicione të barabarta. Njësive të vetëqeverisjes vendore ende u mungojnë burimet e mjaftueshme dhe të qëndrueshme financiare dhe kapacitetet administrative për të ushtruar me efektivitet kompetencat e tyre në mënyrë plotësisht të kënaqshme. Autonomia fiskale e NJVV-ve mbetet në rrezik dhe ofrimi i shërbimeve publike cilësore në nivel lokal mbetet i kufizuar[337]. Efikasiteti, transparenca dhe llogaridhënia e menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor duhet të përmirësohet. NJVV-të duhet, gjithashtu, të vazhdojnë zhvillimin dhe zbatimin e plotë të planeve të integritetit vendor. Përpjekje të mëtejshme të koordinuara duhet të ndiqen për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin e qeverisjes vendore në procesin e anëtarësimit të vendit në BE, si dhe për të ndërtuar kapacitetet e duhura administrative për të përfituar nga mbështetja financiare e BE-së. Konsultimi dhe llogaridhënia ndaj publikut në nivele të NJVV-ve mbeten të kufizuara. Nevojiten ende përpjekje për të përmirësuar burimet financiare të njësive të qeverisjes vendore, kapacitetin administrativ dhe autonominë fiskale[338].

Pavarësisht sa parashikon ligji për vetëqeverisjen vendore në lidhje me bashkëpunimin mes dy apo më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkëpunimi ndërvendor), treguesit nuk janë shumë pozitivë. Administrata qendrore mbledh disa informacione themelore nga bashkitë për iniciativat e tyre të këtij bashkëpunimi përmes Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, por nuk

[336] Po aty.
[337] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f.23, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[338] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f.4. https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

DOKUMENT PARLAMENTAR

ofron udhëzime metodologjike apo stimuj financiarë për të mbështetur më tej krijimin e partneriteteve lokale. Shumica e bashkive (37 nga 61) marrin pjesë në bashkëpunimin ndërvendor, por format dhe kohëzgjatja e këtyre nismave janë shumë të ndryshme, duke e bërë shpesh të vështirë shpërndarjen më të mirë të këtij bashkëpunimi në të gjithë vendin. Koordinimi më i mirë, si vertikal, ashtu edhe horizontal, dhe rregulloret më specifike mbi format e bashkëpunimit dhe financimin e qëndrueshëm padyshim që do të promovonin bashkëpunimin ndërvendor në Shqipëri[339]. Kompetencat e përbashkëta të autoriteteve përdoren kryesisht lidhur me shërbimet që bashkitë duhet të ofrojnë në lidhje me menaxhimin e ujit dhe kanalizimeve dhe të mbetjeve të ngurta. Është evidentuar vetëm një rast i një marrëveshje të nënshkruar ndërmjet katër bashkive. Bashkitë Delvinë, Sarandë, Finiq dhe Konispol dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kanë nënshkruar një marrëveshje për krijimin e Entit të Kompetencave të Përbashkëta në fushën e ujësjellës-kanalizimeve në shtator 2022[340].
Strategjia për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 përfshin, si një nga masat e saj, rivitalizimin dhe futjen e stimujve/skemave të reja për marrëveshje dhe bashkëpunim ndërvendor me sektorin privat dhe organizatat joqeveritare. Në këtë kontekst, duhet të bëhet një analizë e detajuar e stimujve ekzistues, duke përfshirë arsyet e mungesës së përdorimit të tyre, mundësitë e rivitalizimit dhe skemat e reja të mundshme që do të futen në qeverisjen vendore. Institucionet inkurajohen të bashkëpunojnë me përdorimin e modeleve pozitive që lidhen me bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërvendor ose nëpërmjet delegimit të kryerjes së disa funksioneve bashkiake në këshillat e qarkut. Aktualisht, nuk ka as udhëzime nga administrata qendrore për të mbështetur qeveritë lokale për të bashkëpunuar dhe as mekanizma financiarë apo stimuj për të mbështetur këtë bashkëpunim[341].

Reforma administrative territoriale mbetet për t'u konsoliduar më tej si pjesë e agjendës më të gjerë të decentralizimit. Duhet të sigurohet një monitorim sistematik dhe në kohë i këtij procesi dhe i mekanizmave për ta realizuar atë. Strategjia e re ndërsektoriale 2023-2030 për decentralizimin dhe qeverisjen vendore, e cila synon të konsolidojë procesin e decentralizimit, u miratua në prill 2023. Këshilli Konsultativ vazhdon të funksionojë si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor. Në të ardhmen mund të shihet mundësia e zgjerimit të tij duke ftuar edhe aktorë të tjerë[342]. Që prej vitit 2018, në NJVV janë krijuar struktura të mirëfillta për integrimin evropian, pjesë e organigramës së bashkive. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të angazhuar NJQV-të dhe shoqatën e qeverisjes vendore në fazat e para të nismave legjislative, si dhe për të intensifikuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror, si dhe duhet të sigurohen nivele të përshtatshme

[339] OECD/SIGMA (2024), *Inter-municipal co-operation in the Western Balkans, SIGMA Paper No. 70,* f.10. www.oecd.org/en/publications/inter-municipal-co-operation-in-the-western-balkans_a78a01e6-en.html
[340] Po aty, f.52.
[341] OECD/SIGMA (2024), *Inter-municipal co-operation in the Western Balkans, SIGMA Paper, No. 70,* f.62. www.oecd.org/en/publications/inter-municipal-co-operation-in-the-western-balkans_a78a01e6-en.html
[342] Diskutimet dhe konkluzionet e dala në tryezën publike me temë "Qeverisja e Hapur", zhvilluar me datë 6 dhjetor 2024, e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".

DOKUMENT PARLAMENTAR

përfaqësimi. Angazhimi i organeve të zgjedhura të pushtetit vendor dhe administratës vendore në procesin e integrimit në BE duhet të forcohet, veçanërisht në kontekstin e negociatave për anëtarësim në BE[343].

Po ashtu, theksojmë se pjesëmarrja e grupeve të ndryshme sociale duhet të inkurajohet në lidhje me vendimmarrjen lokale në interes të komunitetit, veçanërisht kur flasim për grupet vulnerabël. Kështu, p,sh., pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në administratë duhet të përmirësohet dhe koordinimi ndërministror, kombëtar dhe vendor për përfshirjen e romëve duhet të forcohet më tej[344]. Qytetarët mund të përfshihen dhe të jenë aktivë kur janë të informuar mbi çështjet e rëndësishme dhe mbi proceset që ndikojnë në jetën e tyre, ndaj këtu ka rëndësi që qytetarët të kenë akses në informacion përmes publikimit të dokumenteve dhe vendimeve të rëndësishme në platformat *online,* faqet zyrtare të bashkive dhe institucioneve, si dhe përmes kanaleve të tjera të komunikimit. Platformat e konsultimit publik ku qytetarët mund të japin mendimet e tyre mbi politikat, projektet ose legjislacionin në diskutim është një mënyrë shumë efikase që i nxit qytetarët të jenë aktivë. Rëndësi ka rritja e transparencës duke ofruar raporte të rregullta për qytetarët mbi rezultatet e denoncimeve apo kërkesave të tyre. Pjesëmarrja qytetare nxitet duke krijuar një mjedis që inkurajon dialogun, transparencën, llogaridhënien dhe veprimin e përbashkët ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë, duke e bërë qeverisjen më të hapur për të gjithë, duke ndërmarrë këto hapa:

- Informimi i publikut për përparësitë vendore, programet dhe planet e hartuara;
- Mbajtja e konsultimeve me publikun dhe/ose grupet e interesit në lidhje me politikat publike dhe mbledhjen e përvojës ose ekspertizës së tyre;
- Bashkëpunimi me publikun për të zhvilluar zgjidhje për problemet lokale (përfshirë proceset e bashkë-krijimit, të tilla si në formulimin e angazhimeve të Planit të Veprimit të Partneritetit për Qeverisje të Hapur(PQV));
- Angazhimi i komuniteteve lokale në proceset e vendimmarrjes përmes proceseve të diskutimeve, votimit (siç është buxhetimi me pjesëmarrje dhe referendumet), dhe mjete të tjera vendimmarrëse.

- **Rekomandime në lidhje me pushtetin vendor**

Krahas progresit të qëndrueshëm për sa u përket parametrave të transparencës dhe të llogaridhënies, në nivel vendor (të përmendura më sipër) mund të merren disa masa për të përmirësuar qeverisjen vendore, për krijimin e një mjedisi të përgjegjshëm për të gjithë qytetarët. Si të tilla masa rekomanduese përmendim:

- Vendi duhet në veçanti të përgatitet për zbatimin efektiv të *acquis*-ve të BE-së sipas Kapitullit XXII dhe të përfshijë kërkesat e fondeve të ardhshme strukturore/kohezionit në strukturën institucionale, në sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe në kapacitetin administrativ, duke siguruar që të gjitha instrumentet dhe fondet të bëhen

[343] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[344] Po aty, f.72.

DOKUMENT PARLAMENTAR

gradualisht në përputhje me kërkesat e BE-së për sa i përket programimit dhe parimeve të partneritetit.

- Shqipëria duhet të përmirësojë si sistemin e saj të monitorimit, ashtu edhe sistemin e saj kombëtar të vlerësimit, për të siguruar përputhjen me kërkesat e legjislacionit mbi politikën e kohezionit të BE-së;

- Duhet të vijojë zbatimi i Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal (2021-2027) dhe të përfundojnë planet e zhvillimit rajonal, të cilat duhet të nxisin potencialin zhvillimor nëpërmjet ndërhyrjeve të decentralizuara bazuar në plane të integruara lokale dhe/ose rajonale dhe strategjitë. NJVV-të duhet, gjithashtu, të vazhdojnë zhvillimin dhe zbatimin e plotë të planeve të integritetit vendor.

- Shteti shqiptar duhet të qartësojë përgjegjësitë ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale në përputhje me progresin e arritur në lidhje me decentralizimin dhe të forcojë më tej kapacitetet administrative të organeve qendrore dhe lokale, veçanërisht në nivelin qendror, duke siguruar personel adekuat dhe duke rishikuar strukturën e pagave në pushtetin vendor, si dhe duke e mbajtur në prioritet në agjendë decentralizimin fiskal.

- Përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel vendor për të garantuar një administratë profesionale dhe të përgjegjshme.

- Këshilli Konsultativ që vazhdon të funksionojë si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor nevojitet të zgjerohet duke ftuar edhe aktorë të tjerë.

- Duhet të forcohet bashkëpunimi ndërvendor, për një aplikim më të gjerë të këtij bashkëpunimi në të gjithë vendin. Koordinimi më i mirë, si vertikal, ashtu edhe horizontal, rregulloret më specifike mbi format e bashkëpunimit dhe financimin e qëndrueshëm, padyshim që do të promovonin bashkëpunimin ndërvendor në Shqipëri.

- Ndërgjegjësimi dhe Edukimi i Publikut. Fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për rrezikun e korrupsionit dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse janë të rëndësishme për të krijuar një kulturë të përgjegjshmërisë dhe të integritetit në shoqëri[345].

- Duhet të hartohen udhëzues për promovimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarrjen e politikave në nivel vendor.

[345] Raport-monitorimi i realizmit të planeve të integritetit të njësive të vetëqeverisjes vendore për Vitin 2023.

DOKUMENT PARLAMENTAR

3.4 Konkluzionet dhe çështjet për zgjidhje/drejtimet e ndërhyrjeve

- Mbetet prioritet finalizimi dhe miratimi i strategjisë së re për reformën e administratës publike, për të kompletuar Kuadrin Strategjik të Reformës në Administratën Publike (SFRAP) në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian. Rishikimi i efektivitetit të modelit aktual dhe të strukturave për monitorimin e kuadrit strategjik të reformës në administratën publike, në mënyrë që të reduktohet fragmentimi dhe të përmirësohet koordinimi. Aktorët/grupet e interesit duhet të përfshihen në monitorimin e RAP-it në mënyrë më të rregullt dhe sistematike për të garantuar një llogaridhënie më të mirë.
- Përmirësimi i procesit të politikëbërjes në nivelin qendror dhe lokal, përmes koordinimit dhe monitorimit efikas.
- Institucionet e përfshira në SFRAP (me miratimin/plotësimin e kornizës së re SFRAP) duhet të plotësojnë boshllëqet që ekzistojnë në kornizat e treguesve të performancës, duke përfshirë finalizimin e treguesve dhe objektivave të nivelit të rezultateve, për të qenë në gjendje të matin progresin drejt objektivave të reformës. Të dhënat dhe informacionet e monitorimit duhet të përdoren për të ndihmuar në zhvillimin e një kornize të re treguesish, për të përmirësuar kornizën e ardhshme strategjike të reformës në administratën publike.

Zyra e Kryeministrit, bashkë me ministrin përgjegjës për reformën në administratën publike, mund të konsiderojnë krijimin e një faqeje interneti të qeverisë qendrore për të ofruar informacione të rregullta dhe të përditësuara mbi kornizën e re strategjike të reformës në administratën publike, si dhe për zbatimin dhe monitorimin e saj.

- Rishikimi i pozicionimit institucional të autoriteteve rregullatore që raportojnë aktualisht në Kuvend mbetet për adresim dhe duhet të përforcohet roli i mbikëqyrjes parlamentare ndaj qeverisë.

Po ashtu, Kuvendi duhet të forcojë mbështetjen e aktiviteteve monitoruese të institucioneve publike të pavarura me rol mbikëqyrës (si: Avokati i Popullit, KLSH), pasi shkalla e zbatimit të rekomandimeve të këtyre institucioneve mbetet e dobët.

- Miratimi i një kuadri ligjor që rregullon tipologjinë dhe kriteret për krijimin e organeve vartëse dhe linjat e qarta të llogaridhënies. Në këtë drejtim nevojitet amendimi i ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe hartimi i akteve nënligjore në bazë të ndryshimeve ligjore, me qëllim krijimin e kuadrit efektiv të llogaridhënies për institucionet e varësisë dhe mirëpërcaktimin e tipologjisë së institucioneve të varësisë dhe të agjencive autonome. Legjislacioni sektorial të jetë në përputhje dhe i harmonizuar me Kodin e Procedurave Administrative (KPA).
- Planifikimi afatmesëm dhe koordinimi i politikave në funksion të llogaridhënies. Kostoja e të gjitha strategjive të përfshira në kuadrin e ri strategjik të reformës në administratën publike duhet të bazohet në të njëjtën metodologji (unifikimi i metodologjisë së kostimit SFRAP), për të lejuar monitorim efektiv dhe përmirësim të qëndrueshmërisë financiare të reformave. Konsistenca ndërmjet planifikimit të politikave dhe buxhetimit duhet të përmirësohet më tej. Nevojitet finalizimi në kohë i raporteve vjetore si bazë për vendime

DOKUMENT PARLAMENTAR

menaxheriale dhe masa korrigjuese. Nevojiten veprime të mëtejshme për të forcuar kapacitetet administrative të ministrive të linjës dhe të Zyrës së Kryeministrit për ta bërë menaxhimin më të përgjegjshëm.

- Lidhur me zhvillimin dhe koordinimin e politikave, theksohet rëndësia e rritjes së përdorimit dhe përmirësimit të cilësisë së vlerësimeve të ndikimit rregullator dhe konsultimeve publike, ndërkohë që ekziston një bazë e fortë për zbatimin e këtyre dy proceseve. Synohet përmirësimi i procesit të hartimit të politikave dhe vlerësimit të ndikimit rregullator në të gjithë legjislacionin dytësor.

Përmirësimi i monitorimit dhe zbatimit të RAP-it. Forcimi i koordinimit ndërmjet ministrive dhe institucioneve të tyre përkatëse të varësisë dhe ndërmjet qeverisë qendrore dhe vendore.

- Mekanizmi IPMG duhet të përafrohet me strukturën dhe strategjitë e reja dhe funksionimi i tij mbetet për t'u vlerësuar në praktikë.
- Për të funksionuar llogaridhënia dhe eficienca administrative, duhet riparë kuadri rregullator dhe strukturor i një sërë agjencish që veprojnë aktualisht në kuadër të një autonomie të caktuar me varësi nga qeveria qendrore dhe ministri të linjës, në kuadër të konsolidimit sektorial, mbi bazën e praktikave të mira evropiane.
- Kapaciteti administrativ për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi dhe zhvillimin legjislativ duhet të forcohet më tej. Përdorimi i vlerësimeve të ndikimit rregullator duhet të përmirësohet dhe zgjerohet. Cilësia e VNR/RIA, gjithashtu, duhet të përmirësohet dhe të zbatohen edhe për aktet nënligjore, ku ky vlerësim të kryhet përpara se aktet ligjore/nënligjore të propozuara të përfshihen në agjendën legjislative.
- Ndryshimi i ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil" në lidhje me strukturën e pagave, si dhe miratimi i metodologjisë së klasifikimit të pozicioneve të punës pas ndryshimeve ligjore. Dispozitat për rekrutimin bazuar në merita në legjislacionin për shërbimin civil duhet të zbatohen në mënyrë konsistente, veçanërisht në nivelin e menaxhimit të lartë (TND). Rritja e pagave në shërbimin civil duhet të shoqërohet me një reformë thelbësore të sistemit të pagave duke adresuar dobësitë që lidhen me klasifikimin e vendeve të punës, strukturën e pagave dhe shtesat e veçanta. Po ashtu, nevojitet përmirësimi i mekanizmave të vlerësimit të performancës dhe karrierës përmes ndryshimeve në ligjin "Për nëpunësin civil". Përdorimi i indikatorëve të performancës në menaxhimin e burimeve njerëzore e financiare dhe monitorimi i tyre merr rëndësi në këtë drejtim.
- Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit civil dhe burimeve njerëzore. Nevojiten politika mbështetëse që mbulojnë zhvillimin e menaxhimit të burimeve njerëzore për të zbatuar Udhërrëfyesin për Reformën e Administratës Publike (PAR) 2023-2030. Me ndryshimet që do të bëhen, kuadri legjislativ, duke përfshirë legjislacionin dytësor për rekrutimin, vlerësimin e performancës, zhvillimin profesional dhe procedurat disiplinore dhe shkarkimet, do të ofrojë garanci më të mira që nëpunësit civilë të kenë bazën e nevojshme për të kryer detyrat e tyre me profesionalizëm, neutralitet dhe llogaridhënie dhe kufizimin e ndërhyrjeve politike në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Finalizimi i zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Burimeve Njerëzore në administratën e qeverisë qendrore nga DAP, duke siguruar plotësimin e tij dhe llogaritjen e listës së pagave, si dhe ribërjen funksionale të platformës administrate.al për të siguruar që politikat kombëtare të burimeve njerëzore bazohen në të dhëna dhe prova. Njësitë e burimeve njerëzore duhet të përmirësojnë ofrimin e të dhënave analitike dhe cilësore për vendimmarrje. DAP-i duhet, gjithashtu, të mbledhë të dhëna bazë për burimet njerëzore për të gjithë nëpunësit publikë.
- Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore duhet të realizohet në përputhje me politikën rajonale dhe të kohezionit të BE-së. Për këtë, së pari lind nevoja për zbatimin efektiv të ligjit nr.102/2020 "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin", përmes miratimit të akteve nënligjore. Po ashtu, nevojitet zbatimi i programeve të politikave të kohezionit, si dhe forcimi i bashkëpunimit institucional.
- Duhet të vazhdohet me strategjinë dhe planin kombëtar për zhvillimin dhe kohezionin rajonal dhe të përfundojnë/miratohen planet e zhvillimit rajonal, të cilat duhet të nxisin potencialin zhvillimor nëpërmjet ndërhyrjeve të decentralizuara bazuar në plane të integruara lokale dhe/ose rajonale.
- Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore është i rëndësishëm për Shqipërinë në drejtim të zbatimit të programit kombëtar IPA dhe përdorimit e menaxhimit të fondeve të BE-së. Nevojitet ngritja e kapaciteteve nga të gjitha institucionet për zbatimin e programeve të politikave të kohezionit, si dhe forcimi i bashkëpunimit institucional nën drejtimin e SASPAC-ut për negociatat e Kapitullit XXII.
- Respektimi/aplikimi i parimit të partneritetit, duke kërkuar përfshirjen e autoriteteve publike përkatëse, partnerëve socio-ekonomikë dhe shoqërisë civile në të gjitha fazat e programimit, për të përgatitur terrenin për politikën e ardhshme të kohezionit në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes mbi Partneritetin.
- Intensifikimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet pushtetit qendror dhe vendor. Nevojitet përmirësimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore në nivel vendor për të garantuar një administratë profesionale dhe të përgjegjshme. Në këtë drejtim pritet të ngrihet Akademia e Pushtetit Vendor, e cila do të realizojë programin e saj të trajnimeve në lidhje me administratën vendore, duke mbështetur kështu praktikat më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore në qeverisjen vendore.
- Këshilli Konsultativ që vazhdon të funksionojë si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor, nevojitet të zgjerohet duke ftuar edhe aktorë të tjerë.
- Mbetet të qartësohen përgjegjësitë ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore në përputhje me progresin e arritur në decentralizim dhe të forcohen më tej kapacitetet administrative të organeve qendrore, rajonale dhe vendore. Ndaj, ndarja e përgjegjësive ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror vazhdon të jetë një çështje për adresim.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Përpjekje të mëtejshme të koordinuara duhet të ndiqen për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin e qeverisjes vendore në procesin e integrimit në BE dhe për të ndërtuar kapacitete të përshtatshme administrative për të përfituar nga mbështetja financiare e BE-së.
- Ekziston ende nevoja për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij për funksionet e njësive të qeverisjes vendore (NJVV). Këto organe vazhdojnë të kenë mungesë të burimeve financiare dhe kapaciteteve administrative të mjaftueshme dhe të qëndrueshme, dhe autonomia e tyre fiskale mbetet në rrezik. Po ashtu, ofrimi i shërbimeve publike cilësore në nivel vendor mbetet i kufizuar.
- Reforma administrative territoriale mbetet për t'u konsoliduar më tej si pjesë e agjendës më të gjerë të decentralizimit. Duhet të sigurohet një monitorim sistematik dhe në kohë i këtij procesi dhe i mekanizmave për ta realizuar atë.
- Duhet të forcohet bashkëpunimi ndërvendor, gjë që kërkon një koordinim më të mirë si vertikal, ashtu edhe horizontal. Nevojiten të miratohen rregullore/udhëzime specifike mbi format e bashkëpunimit dhe financimin e qëndrueshëm për të promovuar bashkëpunimin ndërvendor në Shqipëri, ku përgjegjësia në nivel qendror i takon ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor përmes AMVV-së. NJVV-të duhet, gjithashtu, të vazhdojnë zhvillimin dhe zbatimin e plotë të planeve të integritetit vendor.
- Pjesëmarrja e grupeve të ndryshme sociale duhet të inkurajohet në lidhje me konsultimin publik dhe vendimmarrjen lokale në interes të komunitetit, veçanërisht kur flasim për grupet vulnerabël. Hartimi i udhëzuesve për promovimin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarrjen e politikave në nivel vendor, veçanërisht për grupet vulnerabël.
- Kontrolli, monitorimi dhe menaxhimi i ndërmarrjeve shtetërore duhet të përmirësohet që të realizohet në mënyrë efektive, me instrumente të qarta llogaridhënie. Këtu marrin rëndësi përcaktimi i objektivave të qarta të performancës për ndërmarrjet shtetërore, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së tyre; publikimi i raporteve vjetore të performancës financiare dhe jofinanciare, në përputhje me direktivat e BE-së për raportimin e qëndrueshmërisë; harmonizimi i praktikave të pronësisë për të qartësuar objektivat e shtetit në lidhje me NSH-të, dhe auditim i jashtëm për të siguruar transparencë dhe ofruar një bazë të besueshme për vendimet e aksionarëve dhe bordit që, ndër të tjera, lidhen me investimet dhe shpenzimet.
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut. Fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut për rrezikun e korrupsionit dhe për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse janë të rëndësishme për të krijuar një kulturë të përgjegjshmërisë dhe të integritetit në shoqëri.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Kapitulli IV: Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara

4.1. Konteksti

Qeverisja elektronike dhe ofrimi i shërbimeve rregullohet nga instrumente normative që ofrojnë kuadrin rregullator për ofrimin e shërbimeve publike, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura brenda bazave përkatëse të të dhënave qeveritare. Që nga hapja e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, Shqipëria ka bërë një sërë përpjekjesh për të përmbushur kërkesat e BE-së në fushat e administratës publike, reformave gjyqësore dhe përmirësimit të shërbimeve publike. Këto përpjekje janë të ndërlidhura me qëllimin e përgjithshëm për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe aksesin e qytetarëve në shërbimet publike.
Në këtë kuadër, progres-raporti i BE-së për Shqipërinë 2024 evidenton nevojën për të pasur një strategji gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve, e cila duhet të përfshihet në Strategjinë e ardhshme të Reformës së Administratës Publike (RAP) që pritet të miratohet[346]. Raporti *Screening Albania* 2023 përqendrohet më shumë te proceset dhe kornizat rregullatore që duhen përmirësuar për të përmbushur kërkesat e BE-së. Raporti OECD/SIGMA 2024 ndalet në ofrimin e shërbimeve dhe digjitalizimin bazuar në katër parimet e administratës publike për këtë qëllim. Ndërsa raporti mbi Udhërrëfyesin e Reformës në Administratën Publike adreson përmirësimet e nevojshme për t'ii bërë shërbimet publike më të aksesueshme për të gjithë qytetarët, pavarësisht vendndodhjes së tyre.

Në dekadën e fundit, Shqipëria ka bërë hapa të konsiderueshëm drejt digjitalizimit të shërbimeve publike. Kjo reformë synon si publikun (ofrimi i shërbimeve publike online për qytetarët dhe bizneset), ashtu edhe vetë administratën (digjitalizimi i proceseve të punës së administratës)[347]. Portali *e-Albania* është bërë pika kryesore e kontaktit për qytetarët dhe bizneset që kërkojnë të përfitojnë nga shërbimet e administratës në mënyrë elektronike. Në të kaluarën, proceset burokratike dhe dokumentacionet e nevojshme për të kryer shërbime administrative kërkonin vizita të shumta në zyrat e institucioneve publike. Kjo ishte shpesh një eksperiencë e lodhshme për qytetarët, veçanërisht për ata që jetonin në zonat rurale, të cilët duhej të udhëtonin në qytete për të përmbushur nevojat e tyre. Sot, falë digjitalizimit, shumë prej këtyre procedurave mund të përfundojnë nga komoditeti i shtëpisë, duke kursyer kohë dhe para. Portali *e-Albania* ka përmirësuar mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike pa kosto, pa radhë dhe pa kontakt fizik me punonjësit e administratës. Planifikohet ristrukturimi dhe ridizenjimi i portalit *e-Albania* dhe shërbimet që ai ofron për t'u bërë më të aksesueshme[348].

Shqipëria ka ndërmarrë një reformë të thellë digjitale, që synon të lehtësojë proceset administrative dhe të përmirësojë aksesin në shërbime për qytetarët dhe bizneset. ADISA *(Agency for the Delivery of Integrated Services Albania*) u krijua në tetor 2014 si Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve

[346] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f. 26, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[347] *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.32.
[348] Informacion shkresor i AKSHI-t, dt. 28.10.2024.

DOKUMENT PARLAMENTAR

të Integruara, në përgjigje të nevojës së qytetarëve shqiptarë për shërbime publike efikase, cilësore dhe transparente. Ajo kishte si mision të veprimtarisë ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet ngritjes dhe administrimit të sporteleve pritëse për qytetarët *(front office)*, si dhe qendrave të shërbimeve publike të integruara me një ndalesë *(one-stop-shop)* për shërbimet që kryheshin nga institucionet dhe agjencitë e qeverisë qendrore dhe/ose të njësive të qeverisjes vendore, sipas legjislacionit në fuqi ose marrëveshjeve përkatëse. Në vitin 2021 ADISA kishte një rrjet prej 21 qendrash shërbimi rajonale në të gjithë vendin. Në vijim të procesit të digjitalizimit të shërbimeve publike, qendrat e shërbimit fizik të ADISA-s u mbyllën në 1 maj 2022[349].
Sulmet agresive kibernetike të vitit 2022 ndaj Shqipërisë, të cilat vunë në rrezik shumë prej sistemeve qeveritare, treguan edhe një herë rëndësinë e mbrojtjes së infrastrukturës së informacionit. Për të adresuar sfidat kibernetike, është hartuar e miratuar Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Kibernetike[350] me qëllim forcimin e sistemeve tona të sigurisë kibernetike, zbulimit, parandalimit të sulmeve kibernetike dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj incidenteve të mundshme. Po ashtu, është miratuar edhe Strategjia e re e Sigurisë Kombëtare[351], ku siguria kibernetike është pjesë thelbësore e sigurisë kombëtare dhe për këtë Shqipëria është e përkushtuar që të rrisë sigurinë kibernetike të infrastrukturave të saj të informacionit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u bashkuar në këtë qasje me vendet e tjera demokratike. Synimi është një fokus më i madh në avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të saj për mbrojtjen kundër kërcënimeve hibride. Për sa u përket masave të sigurisë, vlerësohet se Shqipëria ka përmirësuar zbatimin e marrëveshjes së saj të sigurisë së informacionit me BE-në[352].

Digjitalizimi është kthyer në një prioritet kombëtar në Shqipëri, veçanërisht në fushën e shërbimeve publike, ku synohet ofrimi i aksesit më të thjeshtë, transparent dhe efektiv për qytetarët. Sipas raportit *Screening* 2023 dhe të dhënave të AKSHI-t, 95% e shërbimeve publike tashmë ofrohen vetëm *online* në portalin e-Albania[353], ndërsa rreth 3,3 milionë përdorues janë regjistruar për të përfituar nga këto shërbime[354]. Kjo reformë digjitale ka ndikuar veçanërisht në përmirësimin e efikasitetit të institucioneve dhe përshpejtimin e proceseve administrative. Po ashtu, synohet të vijohet më tej me ri-inxhinierimin dhe do fillojë personalizimi i shërbimeve publike, për të thjeshtuar procedurat administrative, për t'u përafruar me parimin e "vetëm një herë"[355] dhe për të zvogëluar kohën e marrjes së shërbimit.

[349] *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.33.
[350] Shih për më gjerë https://www.mod.gov.al/images/strategji-MoD/2024/strategjia-Mbrojtje-Kibernetike-2024-2028-290324.pdf
[351] Strategjia e re e sigurisë kombëtare është miratuar me ligjin nr. 14/2024.
[352] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f. 91, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[353] *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.33.
[354] Informacion shkresor i AKSHI-t, dt. 28.10.2024 dhe përditësuar me të dhëna statistikore në mars 2025.
[355] Termi i përdorur i parimit "vetëm një herë" gjen pasqyrim në dispozitat e KPA-së, që lidhen më pikat e shërbimit me një ndalesë.

Në portalin e-Albania[356]:

- Ofrohen 1 252 shërbime *online* ose rreth 95% e të gjitha shërbimeve publike.



- Të regjistruar në total në portalin *e-Albania* deri në Shkurt 2025: 3,3 milionë të regjistruar (qytetarë dhe biznese).



Progresi në digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve publike në Shqipëri ka sjellë përfitime të rëndësishme për qytetarët dhe bizneset, por, gjithashtu, ka ngritur shqetësime për aksesin e barabartë, veçanërisht për qytetarët vulnerabël dhe ata me aftësi të kufizuara digjitale. Këto problematika janë reflektuar në progres-raportet e BE-së 2023 dhe 2024 dhe raportin *Screening* 2023 për Shqipërinë. Digjitalizimi i shërbimeve publike ka sjellë përfitime të rëndësishme për bizneset, përfshirë përmirësime në ofrimin e shërbimeve të tilla si taksat dhe licencat. Kjo ka kontribuar në formalizimin e ekonomisë dhe uljen e korrupsionit. Barometri i Biznesit të Ballkanit 2022[357] raportoi një rritje të kënaqësisë së bizneseve me shërbimet publike, të mbështetura nga rritja e digjitalizimit. Qeveria ka plane për të përmirësuar më tej aksesin në shërbimet digjitale për

[356] Informacion shkresor i AKSHI-t, dt. 28.10.2024 dhe përditësuar me të dhëna statistikore në mars 2025.
[357] *Regional Cooperation Council* (2022), *Balkan Barometer 2022 (business opinion), Bosnia and Herzegovina*, www.rcc.int/pubs/140/balkan-barometer-business-opinion-2022

personat me aftësi të kufizuara, duke e bërë platformën *e-Albania* më të aksesueshme. Po ashtu, janë planifikuar përmirësime për një version të thjeshtuar për disa përdorues dhe përmbajtje në gjuhë të huaja. Në këtë kuadër, synohet përmirësimi i portalit *e-Albania* dhe infrastrukturave mbështetëse të tij, duke sjellë funksionalitete të reja për qytetarët dhe bizneset në përfitimin e shërbimeve publike[358], të cilat tashmë ofrohen në masën 95% vetëm *online* në *e-Albania*.
Qeveria ka vijuar përpjekjet e saj për të krijuar disa mundësi për të garantuar cilësinë e shërbimeve publike. Kjo ka rezultuar në një progres të mirë në përgjithësi, edhe pse disa potenciale, në aspektin e ndërveprueshmërisë dhe pagesave elektronike, mbeten të pashfrytëzuara. Digjitalizimi i shërbimeve mbështetet mirë nga platforma e ndërveprueshmërisë (interoperabilitetit) dhe nga një numër në rritje i sistemeve të informacionit të ndërveprueshëm, të cilat lejojnë që formularët të plotësohen automatikisht. Zgjidhjet për autentifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit ekzistojnë, megjithatë ato janë vetëm pjesërisht të harmonizuara me legjislacionin e BE-së, veçanërisht me Rregulloren (BE) 2024/1183 (eIDAS2.0) të miratuar së fundmi[359].

Megjithëse digjitalizimi i shërbimeve publike në Shqipëri ka sjellë përfitime të dukshme, sfidat mbeten për të siguruar akses të barabartë dhe trajtim të drejtë për të gjithë qytetarët. Përmirësime të mëtejshme në infrastrukturën digjitale, sigurinë e të dhënave dhe mbështetjen për qytetarët vulnerabël janë të nevojshme për të siguruar që digjitalizimi të jetë një instrument gjithëpërfshirës dhe efektiv.

4.2. Progresi dhe arritjet

Digjitalizimi ka lehtësuar proceset administrative dhe ka përmirësuar aksesin në shërbime për qytetarët dhe bizneset. Duke përdorur potencialin e Inteligjencës Artificiale (IA) dhe *Big Data*, Shqipëria synon të nxisë një qeverisje më efikase, transparente dhe më të përgjegjshme.
Mjaft raporte ndërkombëtare ofrojnë një pasqyrë të detajuar të zhvillimeve të rëndësishme që ka bërë Shqipëria gjatë viteve të fundit në fushën e administratës publike, digjitalizimit dhe përmirësimit të aksesit në shërbime. Kështu, raporti i fundit i monitorimit nga OECD/SIGMA 2024 për Shqipërinë[360] vlerëson përparimin në fushën e digjitalizimit të shërbimeve publike dhe identifikon disa çështje që mbeten për t'u adresuar. Ky raport analizon performancën e Shqipërisë në përputhje me parimet e administratës publike dhe ofron rekomandime për reformat/masat e nevojshme që duhen ndërmarrë. Kështu, disa nga përparimet kryesore përfshijnë: rritja e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve digjitale nga qytetarët dhe bizneset; përmirësimi i infrastrukturës së IT-së dhe kapaciteteve teknologjike të institucioneve publike; zhvillimi i platformave të reja digjitale për ofrimin e shërbimeve publike.

[358] Informacion shkresor i AKSHI-t, dt. 28.10.2024.
[359] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris;* f.103.
[360] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris,* f.89-105.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Sipas të dhënave të AKSHI-t, janë marrë nëpërmjet *e-Albania*-s 49 milionë shërbime publike dhe janë gjeneruar në total 40 milionë dokumente me vulë elektronike. Po ashtu, janë 15,2 milionë shërbime publike të marra përmes *e-Albania*-s vetëm vitin e kaluar, në 2024-n, ose 12% më shumë se në vitin 2023.



Aktualisht, 63 regjistra elektronikë janë të ndërlidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, të cilët komunikojnë dhe shkëmbejnë të dhëna në kohë reale në formë të sigurt dhe të besueshme, duke bërë të mundur që aktualisht 69% e fushave në formularët e aplikimeve në shërbimet publike në *e-Albania* të parambushen nga komunikimi në kohë reale i regjistrave elektronike të institucioneve të ndryshme me njeri-tjetrin. Ndër vite vihet re një rritje e numrit të transaksioneve të kryera në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit (GG), ku numërohen mbi 395 milionë transaksione të realizuara në vitin 2024. Vetëm në 2 muajt e parë të 2025 numërohen 70 milionë transaksione.

DOKUMENT PR



Përtej arritjeve dhe progresit, mbeten ende çështje për t'u adresuar: forcimi i mëtejshëm i sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale; integrimi i plotë i sistemeve digjitale ndërmjet institucioneve të ndryshme publike; trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të administratës për të përdorur teknologjitë e reja; aksesi i barabartë në shërbime dhe mbështetja për personat vulnerabël.

4.2.1. Legjislacioni shqiptar në qasje me *acquis* të BE-së

Për qëllime të kësaj analize dhe pa pretenduar të jemi shterues, më poshtë trajtohen disa nga ligjet kryesore:

Kodi i Procedurave Administrative (KPA)

Kodi ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor. Në Kod gjejnë rregullim disa parime të rëndësishme, ku ndër to theksojmë: parimi i ligjshmërisë, parimi i informimit, parimi i mbrojtjes së të dhënave dhe parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit, parimi i transparencës, parimi i deburokratizimit dhe i eficiencës, parimi i dhënies së ndihmës aktive, etj.

Në këtë kod prezantohen mënyrat/format dhe procedurat për aksesin elektronik në veprimtarinë administrative. Kështu, në rastin e parimit të dhënies së ndihmës aktive parashikohet se organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike[361]. Po ashtu, në lidhje me të drejtat e palëve gjatë procedurës administrative, ky kod njeh të drejtën që të gjitha palët në një procedurë administrative të njihen me dokumentet e dosjes së kësaj procedure, si dhe të marrin kopje të tyre. Kur dokumentacioni administrohet në formë elektronike, organi

[361] Neni 10/2 i Kodit të Procedurave Administrative.

publik i siguron palës mjetet e nevojshme teknike për njohjen me të. Organi publik mund t'i bëjë dokumentet elektronike të aksesueshme nga interneti, nëse kjo nuk cenon sigurinë e të dhënave të mbrojtura sipas ligjit[362]. Gjithashtu, kërkesat me të cilën personat i drejtohen organit në një procedurë administrative mund të dërgohen edhe në rrugë elektronike, me kusht që të tregohet qartë autori i saj[363]. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim organet publike dhe procedurat administrative në të cilat paraqiten kërkesat me mjete elektronike dhe kërkesat teknike përkatëse. Kërkesat teknike duhet të jenë jodiskriminuese dhe t'u referohen produkteve dhe teknologjive përgjithësisht të disponueshme dhe ndërvepruese me produktet e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në përdorim të përgjithshëm. Çdo organ publik duhet të publikojë kërkesat teknike në faqen e tij zyrtare të internetit[364].

Dispozita të tjera me rëndësi të këtij kodi lidhen me njësimin e dokumenteve dhe vërtetimin e nënshkrimit, duke përfshirë edhe njësimin në lidhje me dokumentet elektronike. Kështu, çdo organ publik, me kërkesë, mund të lëshojë kopje ose pjesë të njësuara me origjinalin të akteve të nxjerra nga ai vetë ose të dokumenteve të tjera nën administrimin e tij. Njësimi i kopjeve në letër të një dokumenti elektronik lidhur me një nënshkrim elektronik, të kopjeve të një dokumenti elektronik, prodhuar për të riprodhuar një dokument me shkrim, si dhe certifikimin e kopjeve të një dokumenti elektronik në një tjetër format teknik, të ndryshëm nga dokumenti origjinal i lidhur me nënshkrimin elektronik, dhe çdo vërtetim tjetër në lidhje me dokumentet në formë elektronike, rregullohet me ligj të veçantë[365].

Po ashtu, në pjesën e pestë të kodit, Kreu I lidhet me aktin administrativ dhe te forma e aktit administrativ parashikohet edhe forma elektronike, sipas nenit 98 të tij. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto raste, vlen nënshkrimi elektronik i organit publik, sipas legjislacionit në fuqi[366]. Nënshkrimi elektronik gjen pasqyrim edhe në rastin e kontratës administrative, sipas përcaktimeve që burojnë nga neni 119 i KPA-së.

Kreu IX i KPA-së parashikon rregullat për pikat e shërbimit me një ndalesë[367], ku për të gjitha shërbimet, për të cilat është përcaktuar sipas ligjeve të posaçme një pikë e shërbimit me një ndalesë, të gjitha procedurat administrative kryhen nëpërmjet këtyre pikave të shërbimit me një ndalesë. Pikat e shërbimit me një ndalesë informojnë apo vënë në dispozicion të të interesuarve të gjithë informacionin e nevojshëm për procedurën administrative, përfshirë edhe të dhëna për mjetet dhe kushtet për aksesin në regjistrat publikë dhe në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe për mjetet e ankimit në rast mosmarrëveshjeje. Këto shërbime kryhen drejtpërdrejt në pikën e shërbimit me një ndalesë, si dhe nëpërmjet postës apo mjeteve elektronike.

[362] Neni 45/4 i Kodit të Procedurave Administrative.
[363] Neni 58 i Kodit të Procedurave Administrative.
[364] Neni 59/7 i Kodit të Procedurave Administrative.
[365] Neni 50 i Kodit të Procedurave Administrative.
[366] Neni 99/4 i Kodit të Procedurave Administrative.
[367] Nenet 74-76 të Kodit të Procedurave Administrative.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Dhe së fundi, do të ndalemi tek njoftimet dhe rregullat e njoftimit. Sipas nenit 147 të KPA-së, organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit. Në çdo rast organi publik kryen njoftimin duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston. Si formë e njoftimit, një dokument i shkruar mund të njoftohet edhe përmes mjeteve elektronike. Njoftimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik bëhet kur marrësi ka rënë paraprakisht dakord për këtë mënyrë njoftimi dhe nëse ligji nuk parashikon një formë tjetër të detyrueshme njoftimi. Një shkresë, dërguar me mjete të komunikimit elektronik, vlerësohet e marrë në përputhje me parashikimet e ligjit për komunikim elektronik[368]. Njoftimi nëpërmjet publikimit elektronik është, po ashtu, një mënyrë e parashikuar nga KPA-ja në nenin 161 të tij. Njoftimi mund të bëhet nëpërmjet publikimit në një regjistër elektronik të hapur për publikun në rastin e parashikuar nga ligji i posaçëm dhe vetëm nëse marrësi është vënë në dijeni paraprakisht për datën e saktë kur bëhet publikimi. Njoftimi i një dokumenti elektronik mund të bëhet edhe nëpërmjet shkarkimit nga një server i caktuar, i mbyllur për publikun, vetëm nëse palës i sigurohet, paraprakisht, akses nëpërmjet mjeteve elektronike autentike të identifikimit, dhe nëse ajo është vënë në dijeni me një njoftim paraprak për datën apo periudhën e saktë kur dokumenti mund të shkarkohet. Në këtë rast, njoftimi vlerësohet si i bërë në datën e shkarkimit të tij nga serveri.

Ligji për qeverisjen elektronike i miratuar në vitin 2023[369] ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike për ndërtimin e infrastrukturës së informacionit dhe sigurisë digjitale. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive të autoriteteve publike dhe/ose subjekteve private në lidhje me krijimin, zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve të infrastrukturës së informacionit, detyrimin e autoriteteve publike dhe/ose subjekteve private në zbatimin e standardeve të teknologjisë së informacionit, përcaktimin e rregullave për krijimin dhe ofrimin e shërbimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, si dhe aksesin, përpunimin e protokollimin e dokumentit elektronik[370]. Qeverisja elektronike mbështetet në disa parime të përgjithshme me rëndësi si: a) siguria e infrastrukturave të sistemeve të informacionit dhe shërbimeve të lidhura me të; b) ligjshmëria; c) mbrojtja e interesit të publikut; ç) paraqitja vetëm një herë; d) të dhënat e hapura; dh) ndërtimi i infrastrukturës së qeverisjes elektronike; e) mbrojtja e të dhënave personale[371].
Me ndryshimet e bëra këtij ligji në vitin 2024 parashikohet, gjithashtu, ofrimi i shërbimit të nënshkrimit elektronik për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, ndryshim ky i cili sjell risi të shumta për qytetarët, duke përfshirë lehtësimin e procedurave administrative, reduktimin e nevojës për printim dhe dorëzim fizik të dokumenteve dhe sigurimin e një mënyre të sigurtë dhe më të lehtë për të firmosur dokumentet. Ofrimi i shërbimeve të autentifikimit, nënshkrimit dhe vulës elektronike, si

[368] Neni 156 i Kodit të Procedurave Administrative.
[369] Ligji nr.43/2023 "Për qeverisjen elektronike", *Fletore Zyrtare* nr.99, dt. 05/07/2023, i ndryshuar me ligjin nr.100/2024, *Fletore Zyrtare* nr. 168, dt. 3.10/2024.
[370] Neni 1 i ligjit nr.43/2023 "Për qeverisjen elektronike", i ndryshuar.
[371] Neni 5 i ligjit nr.43/2023 "Për qeverisjen elektronike", i ndryshuar.

DOKUMENT PARLAMENTAR

dhe certifikatës elektronike për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, përmirëson efikasitetin dhe lehtëson qasjen dhe aksesin në shërbimet qeveritare dhe bizneset. Me këtë ligj shfuqizohet ligji nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", dhe kështu përfundon plotësisht dhe roli i ADISA-s, proces i filluar që në vitin 2022.

Ligji nr. 107/2021 "Për bashkëqeverisjen" bën përcaktimin e rregullave për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse, rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së administratës shtetërore përmes platformës "Me ty për Shqipërinë që duam".
Ndër parimet kryesore të këtij ligji përfshihet parimi i rritjes së aksesit në shërbimet publike[372] dhe parimi i inovacionit të vazhdueshëm[373]. Sipas këtij ligji, platforma "Me ty për Shqipërinë që duam" është një bazë të dhënash shtetërore elektronike, e organizuar në bazë seksionesh dhe ka si qëllim të jetë një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi për të adresuar në kohë reale çështje të politikëbërjes, për të diskutuar reforma e masa të rëndësishme, duke mundësuar përfshirjen e personave fizikë dhe juridikë për politikat qeverisëse në çdo sektor apo për ecurinë e punës së çdo ministrie dhe 6 institucioneve të tjera të administratës shtetërore, me qëllim garantimin e bashkëqeverisjes me qytetarët. Të dhënat e platformës administrohen nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, me qëllim kontrollin e veprimtarisë administrative të institucioneve të administratës shtetërore, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Procesi i autentifikimit dhe i identifikimit në platformën "Me ty për Shqipërinë që duam" realizohet nëpërmjet *"Single-Sign-On"* të Platformës Qeveritare të Ndërveprimit. Këshilli i Ministrave miraton seksione të reja, si dhe rregulla të detajuara për seksionet e platformës, të dhënat parësore e dytësore, që regjistrohen në platformë për dhënësit e informacionit, për ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave[374].
Në platformën "Me ty për Shqipërinë që duam" gjenerohet automatikisht baza e të dhënave që administrohet nga Agjencia për çdo rast; të dhënat dhe historiku i rasteve të ardhura deri në zgjidhjen e tyre përfundimtare. Nga baza e të dhënave të platformës ekstraktohen të dhëna për një çështje konkrete, të cilat përdoren për përmbushjen e qëllimit të këtij ligji, si dhe kanë cilësinë e një dokumenti zyrtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik. Në çdo rast mbahet parasysh parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Në platformën "Me ty për Shqipërinë që duam" të dhënat e qytetarëve apo të personave fizikë ose juridikë që regjistrohen në platformë mbahen konfidenciale, duke iu nënshtruar mbrojtjes, ruajtjes dhe detyrimit për

[372] Neni 6 i ligjit nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen" përcakton: *"Institucionet e administratës shtetërore, në përputhje me kompetencat e tyre dhe në përmbushje të parimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, duhet të garantojnë përfitimin e shërbimeve publike ndaj çdo shtetasi, pavarësisht nga gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, nëpërmjet procedurave administrative të thjeshta dhe transparente, të cilat nëpërmjet zgjidhjeve inovative e teknologjike mundësojnë një akses më të madh të qytetarëve në shërbimet publike".*
[373] Neni 7 i ligjit nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen" përcakton: *"Institucionet e administratës shtetërore nxisin përdorimin e teknologjisë dhe metodologjisë inovative të komunikimit për ndërveprimin me grupet e interesit dhe çdo qytetar, me qëllim zhvillimin e ideve dhe bashkëkrijimin e zgjidhjeve për mirëqeverisjen e vendit, duke përdorur mundësitë që krijohen nga platformat elektronike qeveritare, përfshirë edhe përdorimin e publikimin e të dhënave sipas parimit të qeverisjes së hapur".*
[374] Neni 16 i ligjit nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen".

DOKUMENT PARLAMENTAR

mospërhapje dhe këto të dhëna dhe çështjet e trajtuara nga platforma mund të publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë vetëm pas pëlqimit të individit ose të subjektit privat. Procedura dhe metodologjia e ndërveprimit mes sistemeve elektronike dhe protokolleve të institucioneve për kalimin automatik në platformë të çështjeve të parashikuara në këtë ligj përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ligji nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" ka bërë përparim të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit legjislativ me direktivat e BE-së[375]. Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën (BE) nr. 2022/2555, të Parlamentit dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2022, "Mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian", e cila ka ndryshuar rregulloren (BE) nr. 910/2014 dhe direktivën (BE) nr. 2018/1972, si dhe ka shfuqizuar direktivën (BE) nr. 2016/1148. Qëllimi i këtij ligji është arritja e një niveli të lartë të sigurisë kibernetike, duke përcaktuar masat e sigurisë, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve fizikë dhe juridikë, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e sigurisë kibernetike. Ky ligj erdhi si nevojë për të përmirësuar mbrojtjen ndaj rritjes së kërcënimeve kibernetike, me qëllim garantimin e një mjedisi digjital të sigurt. Përcaktimi i masave të sigurisë synon arritjen e një niveli të lartë të sigurisë kibernetike për rrjetet dhe sistemet e informacionit në Republikën e Shqipërisë. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha subjektet publike dhe private, që administrojnë sisteme dhe rrjete të informacionit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
Me anë të këtij ligji krijohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK)[376], si person juridik, publik, në varësi të Kryeministrit. Misioni i Autoritetit është të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë kibernetike për rrjetet dhe sistemet e informacionit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të garantojë siguri e besueshmëri në përdorimin e nënshkrimit elektronik, identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Autoriteti është institucioni përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, i cili koordinon punën me institucionet e tjera përgjegjëse për sigurinë kibernetike. Duke konsideruar se ligji parashikon edhe subjekte të tjera përgjegjëse për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në Shqipëri, nevojitet një bashkëpunim dhe koordinim i ngushtë mes këtyre subjekteve për garantimin e sigurisë kibernetike. Ky bashkëpunim shtrihet edhe tek aktorët ndërkombëtarë në fushën e sigurisë kibernetike dhe autoritetet kombëtare të vendeve të tjera nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare. Në kuadër të përmbushjes së angazhimeve, në terma të sigurisë kibernetike, si vend anëtar i NATO-s dhe Organizatës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), AKSK koordinon dhe bashkërendon punën midis këtyre organizmave dhe institucioneve kombëtare.

[375] *Directive (EU) 2022/2555 of the European Parliament and of the Council of 14 December 2022 on measures for a high common level of cybersecurity across the Union, amending Regulation (EU) No 910/2014 and Directive (EU) 2018/1972, and repealing Directive (EU) 2016/1148 (NIS 2 Directive) (Text with EEA relevance).* *http://data.europa.eu/eli/dir/2022/2555/oj*

[376] Shih VKM nr. 783, datë 18.12.2024 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike". Për më shumë informacion mbi AKSK-në shih https://aksk.gov.al/

DOKUMENT PARLAMENTAR

Në dhjetor 2024, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", duke shfuqizuar ligjin e mëparshëm të vitit 2008. Kjo erdhi si nevojë për miratimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale të përafruar plotësisht me *acquis*-në e BE-së. Siç evidentohet edhe në raportin e BE-së për Shqipërinë të 2024, shqetësim mbetet trajtimi i të dhënave personale nga kompanitë private dhe administrata publike, si dhe dobësitë e sistemeve qeveritare të IT-së. Nevojiten masa mbrojtëse të forta për të parandaluar shkeljet e të dhënave personale, si dhe veprime të mëtejshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për rreziqet e mundshme dhe për të rritur kapacitetin parandalues të institucioneve publike[377].
Ky ligj i ri është i përafruar me rregulloren nr. 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 27 prill 2016, mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, si dhe shfuqizimin e direktivës 95/46/EC (në vijim, GDPR)[378]. Përafrimi i legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis*-në e Bashkimit Evropian në këtë fushë, është i rëndësishëm, me qëllim që qytetarëve dhe bizneseve shqiptare t'u garantohen standardet më të larta evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, të përshtatura për epokën digjitale, në një kohë kur përpunimi i të dhënave personale në epokën digjitale është shumëfishuar.

Akte të tjera rregullatore

Evidentohet se Korniza Kombëtare e Ndërveprueshmërisë (miratuar në tetor 2023[379]), është në përputhje me Kornizën aktuale Evropiane të Ndërveprueshmërisë (Interoperabilitetit) të vitit 2017. BE në raportin për Shqipërinë të vitit 2024 vëren se mund të nxitet përafrimi i mëtejshëm me Aktin e Evropës së Ndërveprueshme (The Interoperable Europe Act), të miratuar në prill 2024. Kjo kornizë jep udhëzime përmes një grupi rekomandimesh për institucionet publike se si të përmirësojnë administrimin e proceseve të tyre. Objektivi i kornizës së ndërveprimit është që të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të sektorit publik në Shqipëri, duke përmirësuar shërbimet e ofruara ndaj qytetarit dhe biznesit.
Po ashtu, për të mbështetur aplikimin e sigurt të inteligjencës artificiale, është miratuar VKM nr. 479, datë 24 korrik 2024, mbi metodologjinë gjithëpërfshirëse dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale brenda vendit, veçanërisht në institucionet e sektorit publik. Ky dokument përcakton udhëzime të qarta për zhvillimin, menaxhimin dhe rregullimin e sistemeve të IA-së, duke u mbështetur në standardet ndërkombëtare të vendosura nga Instituti Kombëtar i Standardeve dhe Teknologjisë (NIST), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Bashkimi Evropian (BE). Ky përafrim siguron që Shqipëria t'u përmbahet

[377] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f. 34, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[378] *Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation),* http://data.europa.eu/eli/reg/2016/679/oj
[379] Korniza Kombëtare e Ndërveprimit është miratuar me udhëzimin nr. 2, datë 30.10.2023, të nxjerrë nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Ajo është përafruar me Kornizën Evropiane të Ndërveprimit të fundit të përditësuar, (EIF), të datës 23 mars 2017, si pjesë e Komunikimit të miratuar nga Komisioni Evropian (COM (2017)134).

DOKUMENT PARLAMENTAR

standardeve globale për sigurinë, mbrojtjen e të dhënave dhe konsideratat etike në lidhje me përdorimin e IA-së, ndërsa bën thirrje, gjithashtu, për pjesëmarrje aktive në iniciativat globale të qeverisjes së IA-së. Gjithashtu, është hartuar Strategjia e parë Kombëtare për Inteligjencën Artificiale, e cila pritet të miratohet në vitin 2025[380]. Gjatë procesit të hartimit, AKSHI është asistuar dhe konsultuar nga ekspertë të Microsoft-it, konsulentë ndërkombëtarë dhe ekspertë të BE-së përmes mekanizmit TAIEX, por edhe ekspertë vendas.

Po ashtu, Rregullorja eIDAS është rishikuar nga BE-ja dhe ka hyrë në fuqi në maj 2024, për të zhvilluar kuadrin teknik dhe rregullator për portofolin e ardhshëm të identitetit digjital të BE-së[381]. Rregullorja e BE-së 2024/1183 vendos një kornizë gjithëpërfshirëse evropiane të identitetit digjital. Ajo përcakton standardet dhe procedurat për krijimin, menaxhimin dhe njohjen e identiteteve digjitale, si dhe promovon ndërveprimin dhe besimin në transaksionet digjitale brenda BE-së. Me këtë rregullore prezantohet "Portofoli Evropian i Identitetit Digjital" ose "Portofoli EUDI". Në kuadër të legjislacionit, duhet të ndiqet ky trend ndryshimesh që të bëhet përshtatja dhe harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë evropian, për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të digjitalizimit të shërbimeve publike.

BE-ja thekson nevojën për të forcuar gjithashtu ndërveprueshmërinë *(interoperabilitetin)* ndërkufitare përmes një kuadri kombëtar ndërveprueshmërie, si bazë për shërbimet publike digjitale ndërkufitare, të ndërveprueshme, me në qendër njeriun.

Së fundi, nuk mund të lëmë pa përmendur miratimin nga Këshilli i Ministrave të dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027" (AKR 2024–2027), në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor"*[382]*. Ky instrument është miratuar më 14 maj 2024 përmes Rregullores nr. 2024/1449 të Bashkimit Evropian "Për miratimin e facilitetit të reformave dhe rritjes për Ballkanin Perëndimor", në kuadër të lancimit të nismës për propozimin e Planit të Ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. AKR 2024–2027 përfshin masa që lidhen me prioritete në fushat/shtyllat e politikave kryesore, ku një ndër to është tranzicioni digjital. Ndër objektivat kryesorë të dokumentit të politikës AKR 2024–2027 është objektivi 3: Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurt, të qëndrueshme dhe me shërbime të aksesueshme[383]. Për të arritur këtë objektiv, parashikohen disa iniciativa kryesore, që konsistojnë

[380] Diskutimet dhe konkluzionet e dala në tryezën publike me temë "Integriteti i Administratës Publike dhe Ofrimi i Shërbimeve Digjitale për parandalimin e Korrupsionit" (paneli II- *Ofrimi i shërbimeve digjitale*), zhvilluar me datë 4 nëntor 2024, e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".

[381] Rregullorja e BE-së 2024/1183 hyri në fuqi më 20 maj 2024. Ajo ndryshon Rregulloren 910/2014 të BE-së për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit (shkurt: eIDAS). Në anglisht: *Regulation (EU) 2024/1183 of the European Parliament and of the Council of 11 April 2024 amending Regulation (EU) No 910/2014 as regards establishing the European Digital Identity Framework,* http://data.europa.eu/eli/reg/2024/1183/oj

[382] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027"", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor", *Fletore Zyrtare* nr.198/2024.

[383] Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024 "Për miratimin e dokumentit të politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027"", në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor", Fletore zyrtare nr.198/2024.

DOKUMENT PARLAMENTAR

në: i) përafrimin me rregulloren e Bashkimit Evropian për Identitetin Digjital dhe zbatimi i E-Portofolit Digjital për shërbimet publike; ii) përafrimin e kuadrit rregullator për sigurinë kibernetike me standardet e Bashkimit Evropian dhe kërkesat e Direktivës NIS24 të Bashkimit Evropian; iii) përmirësimin e kuadrit rregullator për një infrastrukturë digjitale të sigurt dhe të qëndrueshme; iv) përmirësimin e mjedisit mundësues për bizneset inovative dhe mbështetja e iniciativave të bizneseve me potencial për tranzicionin e gjelbër dhe digjital, si dhe nxitjen dhe rritjen e ekosistemit të sipërmarrjes inovative etj.

Pra, në përfundim mund të themi se kuadri ligjor dhe struktura institucionale për një administratë publike mirëfunksionale është vendosur tashmë. Ky është një konkluzion i evidentuar edhe nga raportet monitoruese ndërkombëtare si p.sh., raporti i OECD/SIGMA 2024[384]. Mangësitë kryesore shfaqen në praktikë lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor dhe arritjen e rezultateve. Për shembull, parimi i "vetëm një herë", i parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, zbatohet në mënyrë jokonsistente. Një zbatim më konsistent i sistemit të vlerësimit të ndikimit rregullator RIA mund të ndihmojë në përcaktimin e pasojave të mundshme të akteve ligjore përpara miratimit, në mënyrë që të garantohet se vetë administrata është në gjendje të zbatojë kërkesat që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi[385].

4.2.2. Kuadri strategjik dhe politikat aktuale ***

Përparimi i vendit në disa fusha kyçe është rezultat i përpjekjeve për të përmbushur kriteret e anëtarësimit në BE dhe të standardeve ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020-2025 dhe Plani i saj i Veprimit[386] synon të garantojë sigurinë kibernetike përmes krijimit dhe funksionimit të mekanizmave institucionalë ndërveprues, instrumenteve ligjore, teknike dhe elementeve kritike të mbrojtjes së hapësirës kibernetike për infrastrukturën digjitale, transaksionet dhe komunikimin elektronik; nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve profesionale, ndërgjegjësimit mbarëkombëtar, forcimit të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar për një hapësirë digjitale më të sigurt. Transformimi digjital i shërbimeve është pjesë e Udhërrëfyesit për Qeverisjen e Mirë dhe Administratën Publike për Shqipërinë 2030.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2023-2028[387], synon të pasqyrojë në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse sfidat dhe kërcënimet kryesore për sigurinë kombëtare të vendit, si dhe të përfshijë përgjigjet institucionale ndaj tyre në harkun kohor 2023-2028.

Sigurimi i infrastrukturës kritike është domosdoshmëri duke promovuar dhe garantuar sigurinë bazë kibernetike për sektorët kritikë dhe sigurimin e vazhdimësisë së tyre. Prioritet konsiderohet

[384] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris*; f.9.
[385] Po aty.
[386] Miratuar me vendimin nr. 1084, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit, 2020–2025", botuar në *Fletoren Zyrtare* nr. 233, datë 30.12.2020.
[387] Shih për më gjerë ligjin nr. 14/2024 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë".

DOKUMENT PARLAMENTAR

edhe mbrojtja e investimeve në këto infrastruktura dhe forcimi i qëndrueshmërisë së tyre përmes parandalimit, detektimit, kundërpërgjigjes, atribuimit dhe marrjes së masave mbrojtëse ndaj aktiviteteve të aktorëve keqdashës në hapësirën kibernetike. Objektiva të rëndësishëm janë edhe përmirësimi i kuadrit ligjor e rregullator, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional. Është e nevojshme të zhvillohen mekanizmat për rritjen e standardeve për infrastrukturën kritike për të përmirësuar me shpejtësi fleksibilitetin dhe qëndrueshmërinë kibernetike, si dhe ndërtimin e aftësive ndërinstitucionale për të pasur implementim sa më të sigurt të infrastrukturave dhe sistemeve digjitale, për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme të gjitha aktivitetet e dyshimta, si dhe për të reaguar me shpejtësi ndaj çdo sulmi, me synim forcimin e normave që zbusin kërcënimet kibernetike dhe që rrisin stabilitetin në hapësirën kibernetike.
Ndërhyrjet e paautorizuara nga sulme kibernetike në sistemet digjitale, vjedhja e informacionit, si dhe çdo aktivitet keqdashës në hapësirën kibernetike, por dhe çdo përpjekje tjetër për të shkatërruar apo dobësuar rrjetet dhe sistemet tona të informacionit, do të mund të minimizohen duke rritur investimet në këtë fushë, kontrollet mbi infrastrukturat dhe shërbimet, si dhe burimet e hetimit.

Kuadri i politikave për zhvillimin e aftësive digjitale përfshihet kryesisht në Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022-2026[388], e cila ka si vizion krijimin e shërbimeve digjitale gjithëpërfshirëse dhe pa kufij për qytetarët dhe bizneset. Kjo agjendë synon të promovojë investimet në fushat kyçe të informatikës së avancuar dhe përpunimit të të dhënave, inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike dhe aftësive të avancuara digjitale të nevojshme për t'i zhvilluar ato. Ai ka potencialin për të lidhur bizneset, administratën publike, qytetarët me teknologjitë më të fundit dhe do të ndihmojë për të qenë globalisht konkurrues dhe autonom nga pikëpamja strategjike, duke zhvilluar dhe udhëhequr shoqërinë drejt transformimit digjital.

Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) u ka ofruar gjithnjë e më shumë mundësi bizneseve dhe qytetarëve për të aplikuar dhe për të marrë shërbime të caktuara publike *online* nëpërmjet portalit *e-Albania*. Procesi i digjitalizimit koordinohet dhe zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), që është institucioni kryesor në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve publike që u ofrohen qytetarëve, bizneseve dhe administratës publike në Shqipëri. Që nga janari 2020 aplikohet vetëm *online* për 95% të shërbimeve publike të institucioneve qendrore dhe që nga maji 2022 merret *online* me vulë elektronike apo nënshkrim elektronik çdo dokument administrativ për të cilin aplikohet *online* përmes portalit *e-Albania*, falë integrimit të sistemeve *back-end*. Procesi i aplikimit *online* për një grup të madh shërbimesh rrit aksesin në shërbimet publike, redukton kohën për të ofruar shërbime, zvogëlon numrin e dokumenteve që duhet të ofrojë aplikanti, si dhe do të reduktojë korrupsionin dhe do të rrisë nivelin e kënaqësisë për qytetarët. Shqipëria ka krijuar një platformë gjithëpërfshirëse për shërbimet digjitale dhe një zhvendosje e shpejtë drejt 100% të shërbimeve

[388] Miratuar me vendimin nr. 370, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale "Agjenda digjitale e Shqipërisë" dhe të planit të veprimit 2022–2026", botuar në *Fletoren Zyrtare* nr. 84, datë 6.6.2022.

DOKUMENT PARLAMENTAR

online hyri në fuqi më 1 maj 2022. Qeveria shqiptare ka vijuar me zgjerimin e ofertës së saj të shërbimeve *online*. Megjithatë, nevojitet të garantohet aksesi i barabartë për grupet vulnerabël, përfshirë personat me aftësi të kufizuara[389].

Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje janë përgjegjës për drejtimin e thjeshtësimit administrativ dhe fokusin në shërbimet përkatësisht për bizneset dhe qytetarët. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është përgjegjëse për të gjitha nismat e digjitalizimit, të cilat kontribuojnë gjithashtu në thjeshtimin administrativ. Në lidhje me digjitalizimin, në vitin 2023 u krijua një grup pune ndërinstitucional për të analizuar rregulloret mbi procedurat administrative dhe për të hartuar propozime për thjeshtim. Grupi i punës u bashkëkryesua nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Ministri i Drejtësisë, si ministria drejtuese për bashkërendimin e ndryshimit të akteve ligjore për zbatimin e propozimeve për thjeshtim. Procesi i derregullimit ka përfunduar tashmë për tre ministri me 81 nga 151 shërbime të thjeshtuara dhe 134 nga 379 kërkesa (p.sh. për paraqitjen e dokumenteve) të eliminuara, megjithëse kërkohen ende përmirësime në sistemet ekzistuese të IT-së për të respektuar ndryshimet e fundit në legjislacion dhe për të siguruar zbatimin e plotë. Gjithsesi, ekziston një rrezik i mundshëm në rastin e nismave të tilla të thjeshtimit dhe derregullimit që buron nga mungesa e vlerësimeve të ndikimit të kërkuara për legjislacionin dytësor, të cilat janë burimet kryesore të barrës rregullatore. Kjo mund të çojë në vendosjen e ngarkesave të reja pa ndonjë kontroll qendror, duke minuar potencialisht efektivitetin e iniciativave individuale dhe të suksesshme për reduktimin e barrës administrative[390].

Kuadri kombëtar i ndërveprueshmërisë, i miratuar në vitin 2014, është në përputhje me Kornizën aktuale Evropiane të Ndërveprueshmërisë (Interoperabilitetit). Po ashtu, Axhenda Digjitale e Shqipërisë është në përputhje me Deklaratën e Berlinit për Shoqërinë Digjitale dhe Qeverisjen Digjitale të Bazuar në Vlera, duke u hartuar sipas parimeve të përshkruara në këtë dokument[391]. Në nëntor 2023 Shqipëria ratifikoi marrëveshjen për anëtarësimin në Programin e Evropës Digjitale dhe në dhjetor 2023 u ngrit një grup pune ndërinstitucional që synonte të promovonte këtë program dhe të koordinonte aktivitetet midis palëve të interesuara[392].
Shqipëria ka bërë disa përparime në përmirësimin e infrastrukturës digjitale, dhe administrata publike përdor tashmë disa sisteme të teknologjisë së informacionit për menaxhimin e shërbimeve, ku kemi edhe raporte të gjeneruara, siç është ai i KLSH-së " Për auditimin mbi performancën e

[389] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f.26, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
[390] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris*; f.37.
[391] *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.23. Për tekstin e plotë të kësaj deklarate shih: https://www.digital-strategy.ec.europa.eu/en/news/berlin-declaration-digital-society-and-value-based-digital-government
[392] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f. 68, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

DOKUMENT PARLAMENTAR

përdorimit të internetit në administratën publike"[393]. Kontrolli i Lartë i Shtetit ndërmori në vitin 2019 procesin e auditimit me temë "Performanca e Përdorimit të Internetit në Administratën Publike", me objektiv vlerësimin e situatës së përgjithshme të rezultuar në institucionet e audituara, ku ka propozuar rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës dhe shfrytëzimin e mundësive për bashkëpunim ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore, autoriteteve, agjencive dhe vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera, në mënyrë që të arrihen standarde të njëjta dhe ofrimi i një shërbimi sa më cilësor, profesional, transparent dhe të përgjegjshëm nga administrata dhe ndaj qytetarëve kundrejt përdorimit të internetit si burim kryesor të qeverisjes elektronike. Synimi i këtij auditimi ishte përcaktimi nëse performanca e përdorimit të internetit në administratën publike i shërben arritjes së objektivave në mënyrë efektive, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin, si dhe disponueshmërinë e vazhdimësinë e shërbimeve të ofruara[394].

Pjesa më e madhe e personelit në administratën publike, edhe pse tashmë janë të familjarizuar me përdorimin e teknologjisë, kanë nevojë për trajnime për të përmirësuar aftësitë e tyre digjitale, si në nivel qendror, ashtu edhe atë vendor. Që administrata të përballojë kërkesat në rritje për digjitalizim duhet të ketë një qasje të integruar, që përfshin investime në infrastrukturë, kapacitetet e burimeve njerëzore, politikat e duhura, që të jenë në gjendje të përballojnë kërkesat në rritje për digjitalizim. Rekrutimi dhe angazhimi i profesionistëve dhe ekspertëve të teknologjisë së informacionit është, gjithashtu, me rëndësi për të mbështetur procesin e digjitalizimit dhe për të siguruar që administrata publike të veprojë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të reflektojë praktikat e mira evropiane në këtë drejtim.

Në kuadër të qeverisjes elektronike, me qëllim menaxhimin e gjithë të dhënave qeveritare, mbetet prioritet forcimi i *GovTech*. Po ashtu, përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të ofruara për publikun në format elektronik, duke rishikuar dhe thjeshtuar proceset e biznesit dhe përdorimin e gjerë të vulës elektronike nga institucionet publike, është një nga objektivat e tjera me rëndësi për t'u realizuar[395]. Treguesi i plotësimit paraprak të formularëve të Standardit të *eGovernment* në 2024 tregon se të dhënat personale janë plotësuar paraprakisht në 65% të formularëve të analizuar të aplikimit *online*. Ky rezultat e vendos Shqipërinë vetëm 6 pikë nën mesataren e BE-së dhe 14 pikë mbi mesataren për rajonin e Ballkanit Perëndimor[396].

Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik mundëson shkëmbimin elektronikisht të të gjitha dokumenteve shoqëruese të dosjes së qytetarit, me nënshkrim elektronik. Kjo zvogëlon barrën për qytetarët dhe bizneset dhe dokumentet e vetme që duhet të ngarkojnë janë vetëdeklarimet dhe dokumentet që ata marrin nga subjektet private. Përmes Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) numërohen 590 000 dokumente të

[393] KLSH (2019). Raport Përfundimtar i Auditimit: *"Për auditimin mbi performancën e përdorimit të internetit në administratën publike,* https://panel.klsh.org.al/storage/phpWWbStv.PDF

[394] Po aty.

[395] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, 2023-2030.

[396] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024*, (*Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing*, Paris; f.99.

DOKUMENT PARLAMENTAR

shkëmbyera midis institucioneve për plotësimin e dosjes së aplikantëve. Janë 220 lloje dokumentesh që sigurohen nga nëpunësit e administratës përmes SQDNE.



Për sa i përket regjistrimit të ngjarjeve të jetës, *e-Albania* funksionon si një *one-stop-shop* (pikë me një ndalesë) që u mundëson qytetarëve apo bizneseve të aksesojnë shumicën e shërbimeve administrative në një portal të vetëm, për të aplikuar për shumicën e shërbimeve lidhur me të njëjtën ngjarje jetësore. Për ngjarje të tilla si p.sh., regjistrimi i biznesit, proceset administrative janë integruar, duke ulur barrën e sipërmarrësve për të plotësuar formularë të ndryshëm për të regjistruar një person juridik, për të aplikuar për një numër fiskal, për të regjistruar kompaninë e tyre si punëdhënës etj. Po ashtu, vlen të përmendet se qeveria ka krijuar një grup pune ndërinstitucional, me urdhrin e Kryeministrit nr. 72, datë 9 qershor 2023, me qëllim integrimin e shërbimeve në ngjarjet jetësore. Aktualisht AKSHI po punon, gjithashtu, për zhvillimin e shërbimeve proaktive dhe njoftimeve për skadimin e ardhshëm të dokumenteve ose kredencialeve. Nga analiza, evidentohet se Shqipëria ka bërë përparime të rëndësishme vitet e fundit në lidhje me digjitalizimin e regjistrave bazë dhe ndërveprueshmërinë, në kuadër të qeverisjes digjitale[397]. Për sa i përket ripërdorimit të zgjidhjeve digjitale, qasja e centralizuar e adoptuar nënkupton që AKSHI të zhvillojë zgjidhje të reja bazuar në ato të mëparshmet. Për sa i përket adoptimit të inteligjencës artificiale në administratën publike, qeveria shqiptare ka miratuar "Dokumentin për Metodologjinë dhe Standardet Teknike të Përdorimit të Inteligjencës Artificiale në Republikën e Shqipërisë"[398] dhe po finalizon hartimin e një strategjie të inteligjencës artificiale[399]. Kjo metodologji është e planifikuar dhe strukturuar në qasjen e një politike makro-menaxhuese dhe makro-orientuese për implementimin e teknologjive dhe të zgjidhjeve të reja të inteligjencës artificiale në Republikën e

[397] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing*, Paris; f.91.
[398] Ky dokument është miratuar me VKM nr. 479, dt. 24.07.2024 "Për miratimin e Dokumentit për Metodologjinë dhe Standardet Teknike të Përdorimit të Inteligjencës Artificiale në Republikën e Shqipërisë".
[399] Diskutimet dhe konkluzionet e dala në tryezën publike me temë "Integriteti i Administratës Publike dhe Ofrimi i Shërbimeve Digjitale për Parandalimin e Korrupsionit" (paneli II- *Ofrimi i shërbimeve digjitale*), zhvilluar me datë 4 nëntor 2024, e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".

Shqipërisë, veçanërisht atyre që prekin institucionet publike nën varësinë e Këshillit të Ministrave. Metodologjia siguron një udhëzues të qartë dhe efektiv për përcaktimin e veprimeve dhe të masave që do të ndërmerren për të garantuar një implementim të suksesshëm dhe të sigurt të teknologjive të reja të inteligjencës artificiale (IA-së). Objekti i metodologjisë për implementimin e inteligjencës artificiale (IA) është të ofrojë një qasje sistematike dhe të strukturuar për zhvillimin, zbatimin dhe menaxhimin e teknologjive të IA-së, si dhe përcaktimin e hapave dhe të proceseve specifike që duhen ndjekur për të garantuar një implementim të suksesshëm dhe efektiv.
Kuadri i politikave për ofrimin e shërbimeve fokusohet kryesisht në promovimin e digjitalizimit. Organizimi institucional për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve përbëhet nga disa autoritete, ku suksesi i tyre varet nga aftësia për të bashkëpunuar në mënyrë efektive. Qëndrueshmëria e iniciativës së vazhdueshme të thjeshtimit të këtyre shërbimeve limitohet në disa raste nga mungesa e procedurave për kontrollin e barrëve administrative që lidhen me daljen e akteve të reja nënligjore[400]. Komentet e përdoruesve mblidhen përmes *e-Albania* -s dhe portalit të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB). Ekziston një metodologji e përgjithshme për standardet e shërbimit si për shërbimet fizike, ashtu edhe për ato elektronike.
Si përfundim, mund të nënvizojmë se në përgjithësi kuadri ligjor ekzistues, struktura institucionale dhe strategjitë e udhëzimet përkatëse në fushën e ofrimit të shërbimeve publike dhe digjitalizimit, janë në përputhje me parimet e administratës publike[401] të adoptuara nga OECD/SIGMA. Ajo që del si problematikë ka të bëjë me kriteret që lidhen me praktikën e zbatimit të tyre dhe rezultatet e synuara.

4.2.3. Inteligjenca Artificiale (IA) dhe përdorimi i saj

Shqipëria ka bërë hapa progresi në transformimin e qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve publike nëpërmjet inovacioneve teknologjike, duke ndikuar ndjeshëm në angazhimin dhe besimin e qytetarëve, të cilat e pozicionojnë Shqipërinë si një lider në Ballkanin Perëndimor. *E-Albania* ka përmirësuar jo vetëm ofrimin e shërbimeve, por ka mundësuar edhe kursime të konsiderueshme për qytetarët, që arrijnë në 19 milionë euro (vetëm nga heqja e tarifave të shërbimeve për shkak të ofrimit të tyre online) dhe duke kursyer vite kohë nëpër radhë[402]. Janë ngritur sisteme elektronike të dedikuara në çdo institucion në përputhje me nevojat specifike të tyre, për të digjitalizuar proceset e punës dhe ofrimin e shërbimeve *online*. Ato janë të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit për të shkëmbyer të dhëna në kohë reale (më shumë se 23 milionë transaksione realizohen në muaj) dhe për të mundësuar ofrimin e shërbimeve elektronike në platformën *e-Albania*. Marrëdhënia shtet-qytetar ka ndryshuar tërësisht për shkak të këtyre ndryshimeve pozitive. Pamja e radhëve nëpër sportele, pritjet e pafundme, mbledhja e një tufe letrash nga një zyrë në tjetrën, korrupsioni apo taksa dhe tarifa shtesë, janë pjesë e së shkuarës. Ulja e ndjeshme e kostove, përmirësimi i transparencës dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit janë ndër përfitimet

[400] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris*; f.93.
[401] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris*; f.89-91.
[402] Informacion shkresor i AKSHI-t, dt. 28.10.2024 dhe përditësuar me të dhëna statistikore në mars 2025.

DOKUMENT PARLAMENTAR

kryesore për qytetarët dhe bizneset sot si në nivel qendror, ashtu edhe atë lokal. Portali *e-Albania* shërben si një dëshmi se si teknologjia ka revolucionarizuar aksesin në shërbimet qeveritare, duke përfituar qytetarët dhe bizneset në të gjithë territorin.



Asistenti virtual në platformën *e-Albania* përdor inteligjencën artificiale për të ofruar suport të shpejtë për pyetjet e zakonshme të qytetarëve e bizneseve[403]. Asistenti virtual 1.0, i cili është lançuar në dhjetor 2023, u përgjigjet pyetjeve të qytetarëve në mënyrë të shpejtë dhe efektive[404] (mbi 900,000 përgjigje deri më tani). Versioni i parë i këtij asistenti, i krijuar në bashkëpunim me *Microsoft* dhe bazuar në modelin *ChatGPT-4*, është lançuar në dhjetor 2023. Versioni i dytë i këtij asistenti me fytyrë dhe zë do të jetë i lidhur me autentifikimit e sigurt të *e-Albania - s* dhe do të ofrojë shërbime direkte.

Projekte në zhvillim në lidhje me përdorimin e inteligjencës artificiale

Qeveria shqiptare ka nisur një rrugëtim ambicioz për të integruar inteligjencën artificiale (IA) në sektorë të ndryshëm publikë, për të transformuar shërbimet publike, për të përmirësuar punën e institucioneve dhe për të rritur angazhimin e qytetarëve. Platforma e re e-Albania 2.0, e bazuar në modelin "*life events*" dhe teknologjitë më të fundit, do të ofrojë shërbime më të thjeshta për të

[403] Diskutimet dhe konkluzionet e dala në tryezën publike me temë "Integriteti i Administratës Publike dhe Ofrimi i Shërbimeve Digjitale për Parandalimin e Korrupsionit" (paneli II- *Ofrimi i shërbimeve digjitale*), zhvilluar me datë 4 nëntor 2024, e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".

[404] Shih: https://www.e-albania.al.

gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, gjithashtu edhe me ndihmën e asistentit virtual në versionin e tij 2.0. Me platformën e re do të prezantohen edhe shërbimet elektronike proaktive për të rritur shpejtësinë, cilësinë dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike *online*. Kjo do të sjellë kursim të mëtejshëm kohe për qytetarët si dhe shërbime digjitale më të përdorshme në çdo pajisje, kompjuter apo *mobile.* Kjo do të mundësojë përmirësimin më tej të aksesit, përdorshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve elektronike, për të siguruar një përvojë më të shpejtë, më miqësore për përdoruesit dhe më të personalizuar përmes qasjeve të ngjarjeve të jetës (life Events). Duke përdorur potencialin e IA dhe *Big Data*, Shqipëria synon të nxisë një qeveri më efikase, transparente dhe më të përgjegjshme.

Synimi afatgjatë është të integrohet IA në të gjithë sektorët, duke synuar një ndikim transformues në kujdesin shëndetësor, arsim, bujqësi, taksa dhe tatime etj. Iniciativa të tilla pritet të përmirësojnë ndjeshëm rezultatet e politikave dhe efikasitetin e shërbimeve. Për më tepër, këto iniciativa parashikohen të reduktojnë ndjeshëm punën manuale, të minimizojnë gabimet njerëzore dhe të thjeshtojnë proceset në të gjithë administratën. Adoptimi i teknologjive të IA-së do ta pozicionojë Shqipërinë në krye të inovacionit digjital në qeverisje, duke kontribuar në modernizimin e administratës publike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët. Paralelisht me përmirësimin e portalit *e-Albania,* është në zhvillim edhe Asistenti Virtual 2.0, i cili do të jetë një version më i avancuar. Ky version i ri do të përfshijë jo vetëm përmirësime funksionale, por edhe vizualizimin e asistentit, duke e bërë ndërveprimin më intuitiv dhe miqësor për përdoruesit[405].

Në projektet për përmirësimin e platformës *e-Albania* do të integrohet edhe inteligjenca e biznesit *(Business Intelligence),* për të vizualizuar dhe analizuar siç duhet të dhënat e shërbimeve dhe përdorimit të tyre, në mënyrë që t'u mundësohet institucioneve të marrin vendime më të mira, më të shpejta dhe më efikase gjatë ofrimit të shërbimeve publike, por edhe parashikime më të sakta në këtë aspekt. Gjithashtu, janë në zhvillim e sipër një sërë projektesh që përfshijnë inteligjencën artificiale ku këtu përfshihet edhe IA në transpozimin e *acquis*-së së BE-së në legjislacionin shqiptar[406]. Inteligjenca artificiale do të përshpejtojë procesin e përafrimit ligjor me *acquis*- në e Bashkimit Evropian. Në bashkëpunim me ekspertë të *Microsoft,* puna manuale që juristëve dhe ekspertëve të integrimit do t'u duheshin vite për ta bërë, do të automatizohet me një saktësi të lartë, duke analizuar legjislacionin shqiptar, duke e krahasuar me atë të BE-së, duke hartuar tabelat e përputhshmërisë dhe duke e bërë pothuajse gati për një rishikim te fundit punën e ekspertëve të përafrimit ligjor.

[405] Diskutimet dhe konkluzionet e dala në tryezën publike me temë "Integriteti i Administratës Publike dhe Ofrimi i Shërbimeve Digjitale për Parandalimin e Korrupsionit" (paneli II- *Ofrimi i shërbimeve digjitale*), zhvilluar me datë 4 nëntor 2024, e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".

[406] Diskutimet dhe konkluzionet e dala në tryezën publike me temë "Integriteti i Administratës Publike dhe Ofrimi i Shërbimeve Digjitale për Parandalimin e Korrupsionit" (paneli II- *Ofrimi i shërbimeve digjitale*), zhvilluar me datë 4 nëntor 2024, e organizuar pranë Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për Thellimin e Reformave të Mirëqeverisjes, Sundimit të Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në BE".

DOKUMENT PARLAMENTAR

Gjithashtu, IA planifikohet të përdoret në fushën e sistemit të prokurimeve, duke automatizuar plotësisht procedurat e prokurimit përmes një sistemi elektronik me inteligjencë artificiale, duke eliminuar nevojën për letra dhe komunikim me zyra, duke kaluar në qasjen zero letra dhe zero komunikim me zyrat. Bizneset do të kenë dosjet e tyre virtuale që do të ndërveprojnë me sistemet e tjera shtetërore, duke e bërë procesin më të thjeshtë dhe të barabartë për të gjithë. Për më tepër, sistemi *e-Certis,* i cili është sistemi evropian i prokurimeve, do të mundësojë verifikimin e deklarimeve, ndërsa sistemi *Single Window* i doganave do të lehtësojë më tej këtë ndërveprim. Përdorimi i inteligjencës artificiale dhe *machine learning* do të reduktojë gabimet njerëzore dhe do të automatizojë proceset si hartimi i termave të referencës, përcaktimi i fondeve limit dhe vlerësimi i procedurave të prokurimit. Kjo do të sjellë kursime financiare dhe do të krijojë një garë të drejtë, të barabartë dhe transparente në tendera. Po ashtu, IA do të përdoret në fushën e tatimeve dhe doganave. Inteligjenca artificiale do të përdoret për zbulimin e anomalive në të dhënat dhe faturat e fiskalizimit, duke ndikuar në uljen e evazionit fiskal dhe krimit financiar. Modeli do të analizojë në kohë reale faturat elektronike dhe deklaratat doganore për të identifikuar transaksionet e dyshimta, duke e bërë procesin më efikas dhe duke ulur korrupsionin dhe kohën e trajtimit nga punonjësit. Automatizimi i këtyre proceseve shkurton, gjithashtu, kohën e përpunimit për praktikat tatimore dhe doganore, duke lejuar përdorimin më efikas të burimeve dhe duke u mundësuar punonjësve të fokusohen në detyra komplekse. Kryqëzimi i të dhënave tatimore dhe doganore rrit efikasitetin, integritetin dhe gjenerimin e të ardhurave të sistemeve fiskale. Zhvillimi i zbulimit të anomalive të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ka përfunduar dhe së shpejti do të fillojë trajnimi i stafit. Sistemi i doganave është në fazat e hershme të implementimit, me plane për të integruar së shpejti funksionalitete të ngjashme me bazë IA-në[407].

Këtu vlen të përmendim edhe pagesat elektronike. Pas kërkesës ndër vite të AKSHI-t kundrejt Bankës së Shqipërisë, Shoqatës së Bankave po ashtu dhe vetë institucioneve financiare për realizimin e zhvillimeve teknike nga ana tyre, për t'u ndërlidhur me Platformën Qeveritare të Pagesave Elektronike për mundësinë e kryerjes së pagesës *online* për shërbimet publike, është arritur nënshkrimi i një memorandumi bashkëpunimi për projektin e digjitalizimit për pagesat elektronike për shërbimet publike. Prej më shumë se një viti çdo bankë e nivelit të dytë është duke kryer zhvillime teknike nga ana e tyre për të ofruar mundësinë e kryerjes së pagesave *online* nëpërmjet kanaleve të tyre bankare për shërbimet elektronike në *e-Albania* dhe që nga data 30 janar 2024 disa prej tyre kanë finalizuar dhe janë *live,* duke u listuar si kanal pagese për shërbimet elektronike me pagesë në *e-Albania.* Aktualisht në portalin *e-Albania* pagesa *online* ofrohet për 18 shërbime elektronike përmes 2 kanaleve: *e-banking,* ku aplikanti zgjedh bankën nga e cila do të kryejë pagesën dhe vijon kryerjen e pagesës në aplikacionin bankar të shkarkuar në smartphone të tij dhe me një kartë debiti/krediti**,** ku aplikanti ka mundësinë të vendosë të dhënat e kartës për të finalizuar pagesën brenda dhe jashtë Shqipërisë. Numërohen 33 332 pagesa elektronike të kryera prej janarit 2024.

[407] Informacion shkresor i AKSHI-t, dt. 28.10.2024.

DOKUMENT PARLAMENTAR



4.2.4. Ofrimi i shërbimeve publike të digjitalizuara dhe aksesi në këto shërbime

Një nga arritjet kryesore në Shqipëri ka qenë përshpejtimi i procesit të digjitalizimit të shërbimeve publike. Platforma *e-Albania*, një nga projektet më të rëndësishme të digjitalizimit, ka lehtësuar ofrimin e shërbimeve *online* për qytetarët dhe bizneset. Kjo platformë ka kontribuar ndjeshëm në uljen e burokracisë, kursimin e kohës dhe përmirësimin e qasjes në shërbime për të gjithë qytetarët, veçanërisht ata që jetojnë në zonat rurale, ku aksesi fizik në shërbimet administrative është më i kufizuar. Digjitalizimi ka sjellë, gjithashtu, një përmirësim në transparencë dhe llogaridhënie, duke ulur mundësitë për korrupsion në proceset administrative. Si shembull mund të evidentohet portali i Open Data Albania[408], i cili ka ndihmuar në publikimin e të dhënave të rëndësishme që lidhen me qeverinë, duke ofruar akses për qytetarët dhe organizatat joqeveritare për të monitoruar përdorimin e fondeve publike. Digjitalizimi vlerësohet si një hap drejt përmirësimit të efikasitetit të administratës publike, por, gjithashtu, theksohet nevoja për të zgjeruar infrastrukturën digjitale, sidomos në zonat rurale ku aksesueshmëria në shërbime publike është më e kufizuar.

Administrata shqiptare përdor një mjet IT të Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPSIS) si një mjet digjital të centralizuar për të siguruar që strategjitë janë të ndërlidhura, të qëndrueshme, të monitoruara dhe në përputhje me buxhetet. Autoritetet janë angazhuar t'i kushtojnë vëmendje të veçantë rritjes së cilësisë së raporteve. Për këtë qëllim, ata kanë ofruar trajnime për nëpunësit civilë gjatë 3 vjetëve të fundit, për t'i ndihmuar ata të forcojnë kapacitetet e tyre për të prodhuar raporte monitorimi me cilësi të lartë[409]. Progresi i digjitalizimit të shërbimeve publike në Shqipëri përbën një hap të rëndësishëm në modernizimin e administratës dhe ofrimin e shërbimeve më efikase,

[408] *Open Data Albania* mbledh të dhëna për treguesit social-ekonomikë nga institucionet/zyrat publike, i përpunon dhe i publikon ato bazuar në tema të reja dhe teknologji semantike. Shih: https://opendata.al
[409] *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.23.

transparente dhe të aksesueshme për qytetarët dhe bizneset. Ky proces transformues ka sjellë përmirësime të theksuara në mënyrën se si funksionojnë institucionet publike dhe se si qytetarët bashkëveprojnë me to. Një nga përfitimet më të mëdha ka qenë përmirësimi i transparencës dhe ulja e korrupsionit në sektorin publik.
Në të kaluarën, shumë procese administrative ishin të ndërlikuara, me procedura të gjata dhe shpesh të mbushura me burokraci të panevojshme. Kjo krijonte hapësirë për korrupsion dhe keqpërdorim të pushtetit, duke qenë se qytetarët dhe bizneset shpesh përballeshin me vonesa dhe pasiguri gjatë përpunimit të kërkesave të tyre. Me futjen e platformës *e-Albania*, këto procese u bënë më të qarta, më transparente dhe më të shpejta. Automatizimi i proceseve administrative ka lejuar qytetarët që të ndjekin statusin e aplikimeve të tyre në kohë reale, pa pasur nevojë për ndërveprim të drejtpërdrejtë me zyrtarët. Ky eliminim i kontaktit të panevojshëm ka reduktuar dukshëm hapësirat për korrupsion dhe ka rritur ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë e institucioneve.

Një tjetër përfitim i rëndësishëm i digjitalizimit ka qenë për bizneset. Përpara transformimit digjital, subjektet përballeshin me vështirësi të shumta, duke përfshirë një proces të zgjatur dhe të ndërlikuar për të marrë leje ose për të përfunduar regjistrimin e aktiviteteve ekonomike. Këto procedura kërkonin kohë dhe përfshinin një mori dokumentesh fizike, gjë që rriste shpenzimet dhe vonesat për sipërmarrësit. Me kalimin e shumë prej këtyre shërbimeve në formatin *online*, tani bizneset kanë mundësi të plotësojnë kërkesat e tyre në mënyrë më të thjeshtë dhe të shpejtë, duke kursyer kohë dhe reduktuar kostot administrative. Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 72, datë 9 qershor 2023, është krijuar një grup pune ndërinstitucional me qëllim integrimin e shërbimeve në ngjarjet jetësore *(life events)*. Aktualisht puna është në vazhdim e sipër lidhur me gjashtë ngjarje të ndryshme të jetës. AKSHI po punon, gjithashtu, për zhvillimin e shërbimeve proaktive dhe njoftimeve për skadimin e ardhshëm të dokumenteve ose kredencialeve[410].

Ofrimi i shërbimeve publike është një nga aspektet më të rëndësishme të reformave institucionale. Sipas progresraportit të BE-së për Shqipërinë 2024, ka pasur përmirësime të dukshme në cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve publike. Zbatimi i platformës *e-Albania* ka mundësuar që shumë prej këtyre shërbimeve të ofrohen në mënyrë digjitale, duke ulur kohën e pritjes dhe duke rritur transparencën. Gjithashtu, Raporti mbi Udhërrëfyesin e Reformës në Administratën Publike nënvizon përpjekjet e administratës për të bërë shërbimet më të lehta për qytetarët, me një përqendrim të veçantë në thjeshtimin e procedurave dhe reduktimin e burokracive. *Screening Report Albania* 2023 thekson se duhet të forcohen mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar që shërbimet publike të jenë të barabarta dhe efikase në të gjithë territorin.
Për të fuqizuar luftën kundër korrupsionit, Shqipëria ka marrë masa që të digjitalizojë sa më shumë shërbime. Për shembull, është krijuar një platformë për procesin e prokurimeve publike, një platforme për ankesat në lidhje me platformën e prokurimeve publike, një sistem elektronik për

[410] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris;* f.99.

DOKUMENT PARLAMENTAR

deklarimin e taksave dhe janë digjitalizuar 99% e shërbimeve të taksave. Është krijuar një regjistër i centralizuar i llogarive bankare dhe një regjistër i pronësisë përfituese. Gjithashtu, është plotësisht funksional sistemi i letrave porositëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe ndërveprimi i tij me Prokurorinë e Përgjithshme.
AKSHI drejton dhe bashkërendon vendimet e qeverisjes digjitale në të gjithë administratën publike, duke siguruar ekzekutimin e strategjive dhe shërbimeve digjitale. Shumica e regjistrave publikë, përfshirë ato për biznesin, popullsinë, shëndetin, tokën dhe pronën, dhe automjetet, mbahen në format digjital. AKSHI rregullon dhe koordinon regjistrimet e bazës së të dhënave shtetërore për të lehtësuar shkëmbimin parësor të të dhënave në platformën e ndërveprimit qeveritar, duke siguruar një qasje të efektshme për shërbime efektive të qeverisjes elektronike dhe duke siguruar që qeverisja e të dhënave të jetë koherente dhe sistematike. Portali *e-Albania* ofron një shërbim elektronik të dedikuar për institucionet publike për regjistrimin dhe përditësimin e bazave të të dhënave shtetërore[411]. Kërkesat administrative për lejet e ndërtimit janë lehtësuar. Bizneset tani përfitojnë nga një furnizim më i besueshëm me energji elektrike dhe digjitalizimi në rritje i shërbimeve publike, duke përfshirë zyrat e taksave dhe doganave, duke reduktuar kohën për përpunimin e dosjeve tatimore dhe mundësitë për ryshfet. Kjo kontribuon edhe në formalizimin e ekonomisë, një element tjetër i së cilës ishte futja e faturimit elektronik të TVSH-së, (fiskalizimi), duke filluar nga viti 2021, e cila konsiderohet si një reformë me rëndësi për reduktimin e konkurrencës së pandershme nga evazioni i TVSH-së. Një masë tjetër formalizimi është shkëmbimi automatik i informacionit për llogaritë financiare, i cili ndihmoi në uljen e të ardhurave të padeklaruara nga taksapaguesit dhe individët dhe rritjen e kontributeve sociale me 7% në vitin 2022.

Në lidhje me këto shërbime, merr rëndësi monitorimi i ofrimit të shërbimeve digjitale dhe respektimi i standardeve. Për këtë qëllim ka një dokument me standarde të aprovuara, që synojnë të standardizojnë punën gjatë zhvillimeve teknike dhe implementimit të shërbimeve elektronike[412]. Dokumenti përfshin 14 standarde që duhet të merren parasysh gjatë implementimit dhe zhvillimeve teknike për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve elektronike, si p.sh.

- të kuptuarit e përdoruesve dhe nevojave të tyre, duke mundësuar përfshirjen e tyre në hapa të ndryshëm të dizenjimit të shërbimeve;
- dizenjimin e shërbimeve elektronike të thjeshta për t'u përdorur dhe të përshtatura për njerëzit me nevoja të veçanta;
- aplikimi i metodës "agile" të punës dhe zhvillimeve teknike;
- siguria që shërbimi elektronik është i sigurt dhe në përputhje me politikat e privatësisë;
- aplikimi i përmirësimeve të vazhdueshme në shërbimet elektronike bazuar në reagimet dhe përdorimin e qytetarëve, etj.

[411] Po aty, f.103.
[412] Standardet e shërbimeve elektronike: https://akshi.gov.al/wpcontent/uploads/2023/04/STANDARDET-E-SHE%CC%88RBIMEVE-ELEKTRONIKE_1.1.pdf

DOKUMENT PARAMINTAR

Dokumenti përfshin gjithashtu mekanizmin e vlerësimit, për të siguruar që shërbimet elektronike plotësojnë kërkesat e standardit të shërbimeve gjatë fazave të krijimit ose modernizimit.

Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike ka qenë një objektiv kyç për Shqipërinë. Përmes përpjekjeve për digjitalizim dhe reformë në administratë, është bërë një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të aksesit në shërbime për të gjithë qytetarët, duke përfshirë edhe grupet më të margjinalizuara, si të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Përmirësimet në rrjetin digjital dhe në teknologjinë e informacionit kanë ndihmuar në zgjerimin e shërbimeve dhe në sigurimin e një qasjeje më të lehtë dhe të barabartë për qytetarët në të gjitha rajonet e vendit. Aksesi në shërbime publike është përmirësuar ndjeshëm me anë të digjitalizimit, por sfidat mbeten, veçanërisht për qytetarët që jetojnë në zona të largëta ose që nuk kanë aftësi të larta teknologjike dhe ata me aftësi të kufizuara. Qeveria shqiptare ka planifikuar ndërhyrje për të rritur aksesueshmërinë, ku përmendim krijimin e qendrës së re të kontaktit *Omnichannel*, e bazuar në përvojën globale më të fundit, duke përshtatur një qasje të përqendruar te përdoruesi në ofrimin e asistencës për përdoruesit e shërbimit, duke ofruar kanale të ndryshme komunikimi, si portalin *e-Albania*, asistent virtual, thirrje zanore dhe asistencë direkte nëpërmjet *InfoPoints* në qendrat shumëfunksionale të inovacionit rinor. Gjithashtu, synohet që qendrat shumëfunksionale të inovacionit rinor të kenë kanalin për asistencën direkte si pjesë e qendrës së kontaktit *Omnichannel*, duke shërbyer si një *"InfoPoint"* për të ofruar informacion, udhëzime dhe asistencë për përdoruesit e shërbimeve, të cilët hasin probleme që lidhen me përdorimin e shërbimeve elektronike, si dhe do të jetë në dispozicion të përdoruesve një pajisje vetë-shërbimi për të aplikuar për shërbime digjitale, kur përdoruesi nuk ka akses në një pajisje të tillë. Qendrat do të shërbejnë si një mundësi për t'u ofruar të rinjve dhe grupeve të tjera në rajone të ndryshme trajnime për të përmirësuar aftësitë e tyre digjitale, gjë që kontribuon në përfshirjen digjitale dhe rritjen e aftësive digjitale[413]. Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024 dhe Raporti i Monitorimit OECD/SIGMA 2024 theksojnë, ndër të tjera, nevojën për të rritur aksesin e qytetarëve në shërbimet publike dhe për të siguruar që këto shërbime të jenë të barabarta për të gjithë. Gjithashtu, vihet theksi mbi përmirësimin e kornizës ligjore dhe rritjen e kapaciteteve të administratës për të siguruar qasje të barabartë në shërbimet publike, duke marrë në konsideratë nevojat e shtresave më të cenueshme të popullsisë.

Një tjetër aspekt thelbësor është përmirësimi i cilësisë së të dhënave dhe transparencës. Proceset e digjitalizuara kanë përmirësuar ndjeshëm shkëmbimin e informacionit dhe dokumenteve ndërmjet institucioneve publike, duke minimizuar mundësitë për gabime njerëzore dhe vonesa në përpunimin e të dhënave. Kjo jo vetëm që ka rritur efikasitetin e administratës, por ka përforcuar ndershmërinë dhe transparencën në ofrimin e shërbimeve publike. Një arritje specifike në këtë drejtim ka qenë krijimi i sistemit për Qarkullimin e Dokumenteve Elektronike (EDCS), i cili ka

[413] Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike, 2023-2030. Sipas Udhërrëfyesit, qendra e re e kontaktit Omnichannel dhe Qendrat shumëfunksionale të Inovacionit Rinor do të ngrihen dhe do jenë plotësisht funksionale deri në dhjetor 2025.

DOKUMENT PARAMETAR

lehtësuar shkëmbimin e dokumenteve ndërmjet institucioneve publike, duke eliminuar plotësisht përdorimin e dokumenteve fizike. Ky sistem është jo vetëm një hap drejt eficiencës, por edhe një garanci për reduktimin e burokracisë dhe përmirësimin e shpejtësisë së ofrimit të shërbimeve. EDCS monitorohet rregullisht për të siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe pa ndërprerje, duke kontribuar kështu në krijimin e një administrate më moderne dhe efektive.

4.3. Gjetjet, problematikat dhe rekomandimet

Ka pasur tendenca pozitive në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve me fokus të fortë në shërbimet digjitale në Shqipëri, krahasuar me vendet e tjera të rajonit[414]. Bazuar në një kornizë të qartë politikash dhe mbështetje politike, vende si Shqipëria i digjitalizuan me shpejtësi shërbimet[415]. Kuadri ligjor dhe struktura institucionale për të siguruar që administrata të jetë e orientuar nga përdoruesit tashmë është e vendosur. Gjithsesi, strategjia e re e RAP-it ende nuk është miratuar dhe ajo do të përvijonte një kornizë gjithëpërfshirëse strategjike. Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje çështjes së aksesit të barabartë në shërbimet administrative për personat me aftësi të kufizuara digjitale, personat me akses të kufizuar në pajisjet e IT-së dhe personat me aftësi ndryshe. Synohet të vijohet më tej me ri-inxhinierimin, si dhe do fillojë personalizimi i shërbimeve publike, për të thjeshtuar procedurat administrative dhe për të zvogëluar kohën e marrjes së shërbimit[416].
Rregullorja eIDAS, e rishikuar në vitin 2024 nga BE-ja, synon të zhvillojë kuadrin teknik dhe rregullator për portofolin e ardhshëm të identitetit digjital të BE-së. Shqipëria duhet të ndjekë zhvillimet në këtë fushë për të harmonizuar legjislacionin e saj të brendshëm me kuadrin e ri rregullator. Po ashtu, duhet përmendur se Kodi i Procedurave Administrative ofron kuadrin legjislativ dhe metodologjik për thjeshtimin e procedurave administrative në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ekziston një plan veprimi për zbatimin e kodit, megjithatë evidentohen vonesat në harmonizimin e ligjeve dhe akteve nënligjore sektoriale me këtë kod[417].
Shqipëria ka marrë masa për të siguruar një digjitalizim më të madh të shërbimeve të saj për të forcuar luftën kundër korrupsionit. Kështu, është krijuar dhe funksionon një platformë prokurimi publik, një platformë ankesash prokurimi, një sistem elektronik i deklarimit tatimor dhe janë digjitalizuar 99% e të gjitha shërbimeve tatimore.
Megjithëse digjitalizimi ka sjellë përfitime të mëdha në efikasitetin dhe transparencën e qeverisjes, ky proces nuk ka qenë pa sfida. Shqipëria është një vend me kontraste midis zonave urbane dhe rurale. Në zonat urbane digjitalizimi është mirëpritur dhe përqafuar më lehtësisht, duke ofruar lehtësi në akses dhe përdorim. Megjithatë, në zonat rurale, ku aksesi në internet dhe teknologji është ende i kufizuar, përfitimi nga këto shërbime ka qenë më i vështirë. Mjaft njerëz, veçanërisht të moshuarit dhe grupet e margjinalizuara, kanë hasur vështirësi në përdorimin e platformave digjitale, duke iu drejtuar dyqaneve të kancelarisë apo qendrave të internetit, duke paguar për këtë shërbim dhe duke sfiduar kështu qëllimin e këtij procesi. Nga perspektiva e një qasjeje komunitare

[414] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris*; f.90.
[415] Po aty.
[416] Informacion shkresor i AKSHI-t, datë. 28.10.2024.
[417] *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.33-34.

DOKUMENT PARLAMENTAR

në këto zona rurale dhe peri-urbane të largëta, është e qartë se digjitalizimi i shërbimeve publike nuk ka qenë i barabartë për të gjithë. Këto komunitete, që shpesh përballen me mungesë të edukimit teknologjik, kërkojnë mbështetje të veçantë për të përfituar nga përparësitë e digjitalizimit. Për këtë arsye, është e rëndësishme që qeveria dhe partnerë e aktorë relevantë të bashkëpunojnë për të krijuar mundësi trajnimi dhe për të përmirësuar infrastrukturën teknologjike në këto zona. Po ashtu, duhet përmendur se Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026, në veçanti, ka një sërë treguesish të performancës, por ata nuk janë të lidhur me objektivat e politikës dhe nuk kanë objektiva specifikë, ndaj kjo mbetet të adresohet[418].

Mungesa e aftësive digjitale dhe aksesi në teknologji është një problem në rritje veçanërisht për komunitete të tilla, si ai rom dhe egjiptian, pasi pengon aksesin e tyre në shërbimet publike, të cilat tanimë janë digjitale (kujdesi shëndetësor, arsimi, punësimi, mbrojtja sociale etj.). Kërkohen përpjekje dhe burime shtesë për të përshpejtuar përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve, për të trajtuar diskriminimin, ndarjen arsimore dhe hapësinore, si dhe për të reduktuar hendekun me pjesën tjetër të popullsisë[419]. Deklarata e Poznanit, një dokument politik dinamik që përshtatet në mënyrë progresive me situatën në zhvillim të politikës së përfshirjes së romëve, mbetet një element qendror i politikës që duhet adoptuar për këtë qëllim nga shteti shqiptar. Kërkohet një kuptim më i mirë i përmbajtjes së tij dhe zbatimi i angazhimeve të marra nga Shqipëria në këtë drejtim[420].
Për sa i përket menaxhimit të sigurisë kibernetike, proceset e menaxhimit të rrezikut të informacionit bazohen në një sërë politikash dhe procedurash që përfshijnë të gjitha kontrollet ligjore, fizike dhe teknike. Më 17 korrik 2022 Shqipëria u godit nga një sulm kibernetik që synonte sistemet qeveritare, por platforma *e-Albania* nuk u sulmua; ajo u mbyll manualisht si masë sigurie. Tre ditë më pas, më 20 korrik, sistemi u rikthye në funksionim dhe 1118 nga 1225 shërbime elektronike ishin *online*. Nisur nga kjo ngjarje, qeveria mori angazhimin se programet e trajnimit për sigurinë kibernetike do të zgjeroheshin dhe do të instalohen qendra të vazhdimësisë së biznesit. Pas sulmeve kibernetike të vitit 2022, Shqipëria ka vazhduar të forcojë arkitekturën dhe kapacitetet e saj të sigurisë kibernetike. Me miratimin e ligjit të ri për sigurinë kibernetike në shkurt 2024, është bërë përparim drejt përafrimit të kuadrit legjislativ me Direktivën NIS2. Autoritetet duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre, veçanërisht në fushën e infrastrukturës kritike të informacionit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, dhe të sigurojnë që qendra e re operacionale e sigurisë kombëtare bëhet plotësisht funksionale. Autoritetet duhet të forcojnë më tej kapacitetet e sigurisë kibernetike, duke përfshirë aktivitetet dhe trajnimet për rritjen e ndërgjegjësimit[421]. Për sa i përket mbrojtjes së të dhënave, evidentohet se zbatohet parimi i "logjikës së besimit zero" dhe se të gjithë serverët e të dhënave aktualisht monitorohen nga afër. Ndërkohë që është bërë përparim

[418] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris.*
[419] Shih: *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.69.
[420] *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.69.
[421] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f. 69, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

DOKUMENT PARLAMENTAR

domethënës, ekziston një mungesë qartësie për situatën nga një perspektivë e plotë e sektorit publik, p.sh. miratimi i standardeve përtej atyre që mbulohen nga AKSHI.

Që nga korriku 2024 Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) e ka mbështetur Shqipërinë në shumën prej 333,4 milionë euro. Kjo është dhënë në formën e granteve IPA III për projektet kryesore në fushat e energjisë së pastër, mjedisit dhe klimës, të ardhmes digjitale dhe transportit të qëndrueshëm. BE-ja ofron mbështetje nëpërmjet IPA-s dhe Instrumentit të Politikës së Jashtme për të forcuar qëndrueshmërinë e partnerëve të Ballkanit Perëndimor në përballjen e kërcënimeve hibride, duke përfshirë manipulimin dhe ndërhyrjen e informacionit kibernetik dhe të huaj[422]. Në përputhje me direktivën respektive të BE-së (për mbrojtjen e të dhënave, përmendur më sipër), agjencia përgjegjëse për sigurinë kibernetike ka zhvilluar një strategji për të garantuar mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve, duke synuar përmirësimin e zbatimit të standardeve të sigurisë bazuar në teknologjinë e përmirësuar për infrastrukturat kritike, duke përmirësuar standardet e lidhura me ISO-n, përforcimin e kapaciteteve në këtë fushë dhe rritjen e numrit të agjentëve të sigurisë[423]. Lidhur me të drejtat pronësore, regjistrimi dhe digjitalizimi i të dhënave kadastrale ka vijuar, por me ritme të ngadalta. Ndaj, nevojitet alokimi i burimeve të mjaftueshme dhe finalizimi i kornizës ligjore për të përfunduar proceset kalimtare në fushën e të drejtave pronësore dhe për të përmirësuar transparencën dhe cilësinë e regjistrit të pronave[424].

Progresi i Shqipërisë në digjitalizimin e shërbimeve publike ka qenë i dukshëm, por sfidat mbeten të rëndësishme, veçanërisht për popullsinë rurale dhe grupet vulnerabël. Për të përmirësuar këtë situatë, qeveria, në bashkëpunim me aktorët përkatës, duhet të fokusohet në forcimin e aftësive digjitale, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke u siguruar që askush të mos mbetet prapa në këtë transformim të rëndësishëm digjital. Shfrytëzimi i teknologjisë për informacion dhe konsultime të aksesueshme duhet të garantohet për të gjithë. Nevojitet që platformat digjitale ekzistuese të përshtaten për grupe specifike, si personat me aftësi të kufizuara, për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes. Këto platforma duhet të jenë të aksesueshme dhe të përmbajnë opsione për përdoruesit me nevoja të veçanta, si audio-lexim, përkthime në gjuhën e shenjave dhe opsione për tekste të thjeshtuara.

Bazuar në raportin e OECD/SIGMA 2024, Shqipëria është në krye të ofrimit të shërbimeve digjitale në rajon, duke u mbështetur në kuadrin e saj solid dhe të qëndrueshëm të politikave dhe hapave të ndërmarra në fushën e transformimit digjital, duke arritur të ruajë pozicionin e saj si lidere në rajon në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe transformimit digjital. Pavarësisht disa mangësive dhe boshllëqeve në disa shërbime, nivelet e përgjithshme të kënaqësisë së qytetarëve dhe bizneseve kanë ardhur duke u rritur, duke konfirmuar efektivitetin e politikës dhe reformave të viteve të fundit[425].

[422] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel: 30.10.2024, f. 93, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

[423] *European Commission Screening Report Albania 2023*, f.33.

[424] Progresraporti i BE-së për Shqipërinë 2024, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, f.37, 51, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

[425] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris*, f. 96-97.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Sipas vlerësimit të OECD/SIGMA 2024, kuadri i politikave të ofrimit të shërbimeve është i fragmentuar, kjo pasi Udhërrëfyesi për Reformën e Administratës Publike 2023-2030 mbulon vetëm iniciativat kryesore dhe Strategjia e Agjendës për Shqipërinë Digjitale 2022-2026 fokusohet vetëm në shërbimet elektronike. Aktualisht, Strategjia e re e RAP-it nuk është miratuar ende, prandaj një kornizë gjithëpërfshirëse strategjike që mbulon të gjitha aspektet e dizenjimit dhe ofrimit të shërbimeve të përqendruara te përdoruesit mbetet të finalizohet.

Në lidhje me aspektin institucional, po ashtu janë disa institucione që përfshihen në këtë drejtim. Aktorët kryesorë janë Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), e cila është përgjegjëse për zhvillimin dhe menaxhimin e e-Qeverisjes dhe shërbimeve digjitale, dhe Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADC), e cila ka përgjegjësinë për sigurimin e qytetarëve. Reagimet reflektohen në ndryshimet në ofrimin e shërbimeve, përfshirë mbledhjen dhe monitorimin e ankesave dhe propozimin e nismave për adresimin e tyre. Ministria e Drejtësisë luan një rol të rëndësishëm në procedurat administrative dhe Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit është përgjegjës për uljen e barrës administrative për bizneset. Ministritë e linjës janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve në portofolin e tyre. Koordinimi i të gjithë këtyre aktorëve dhe komunikimi mes tyre ndodh me sukses në kuadër të projekteve konkrete. Megjithatë, një mekanizëm i përhershëm për koordinimin ndërinstitucional mund të forcojë qeverisjen e ofrimit të shërbimeve. Një grup pune ndërinstitucional aktualisht po analizon barrën administrative të rregulloreve ekzistuese për të dalë me propozime për ndryshime për të thjeshtuar procedurat administrative. Megjithatë, analiza *ex-ante* e administrimit të projektrregulloreve të reja nuk zbatohet në mënyrë konsistente[426].

Harmonizimi i legjislacionit sektorial me Kodin e Procedurave Administrative nga ana tjetër ka qenë i ngadalshëm, ndërkohë që përfitimet e plota të zbatimit të parimit "vetëm një herë" nuk janë konkretizuar ende. Përdorimi i mjeteve të menaxhimit të cilësisë në administratën shtetërore mbetet sporadik dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të ngulitur një kulturë të ofrimit të shërbimit të përqendruar te përdoruesi me përmirësim të vazhdueshëm. Për sa i përket përdorimit të mjeteve digjitale në procese të tjera *back-end* të administratës publike (me përjashtim të ofrimit të shërbimeve), performanca është e përzier. Për shembull, platforma *online* për konsultim elektronik është funksionale dhe përdoret për të gjitha proceset e konsultimit në lidhje me projektligjet dhe strategjitë, por fusha të tjera si platforma digjitale për akses në legjislacion ose mjetet digjitale të burimeve njerëzore tregojnë rezultate më të dobëta, për shkak të mungesës të veçorive thelbësore[427].

4.3.1 Gjetjet dhe problematikat kryesore

Megjithëse janë bërë hapa të rëndësishëm, disa sfida dhe probleme të rëndësishme vazhdojnë të qëndrojnë. Ndërsa digjitalizimi ka përparuar më tepër në zonat urbane, zonat rurale kanë mbetur

[426] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris,* f.90.

[427] OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris*, f.105.

DOKUMENT PARLAMENTAR

pas për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe aksesit në internet. Njerëzit në këto zona kanë hasur vështirësi për të përfituar nga shërbimet digjitale.
Një problem tjetër është që shumë prej tyre, veçanërisht të moshuarit dhe ata që kanë nivel të aftësive teknologjike, nuk i kanë njohuritë e nevojshme për ta përdorur teknologjinë. Kjo i lë jashtë sistemit të shërbimeve publike një pjesë të popullsisë.
Ndihma e drejtpërdrejtë, përmes programeve të edukimit teknologjik dhe investimeve në infrastrukturë, është thelbësore për të siguruar që këta qytetarë të mos mbeten pas në këtë transformim digjital.
Si gjetje dhe problematika kryesore, përmendim:

- Forcimi i infrastrukturës digjitale, duke përfshirë ndërtimin e qëndrueshmërisë kibernetike: Autoritetet shqiptare duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre, veçanërisht në fushën e infrastrukturës kritike të informacionit, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, si dhe duhet të forcojnë më tej kapacitetet e sigurisë kibernetike, duke përfshirë aktivitetet dhe trajnimet për rritjen e ndërgjegjësimit.
- Projektligji "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit", që synon të përafrohet me Rregulloren Evropiane të Identitetit Digjital, që krijon kornizën e re të shërbimeve të identitetit dixhital dhe të mirëbesimit të BE-së, ende nuk është miratuar. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për përafrimin me direktivën e privatësisë elektronike.
- Shqipëria duhet të përmirësojë mbledhjen e të dhënave statistikore mbi performancën dixhitale dhe konkurrencën dixhitale, sipas Indeksit të Ekonomisë dhe Shoqërisë Dixhitale.
- Digjitalizimi i pjesshëm: Ndonëse është bërë përparim i konsiderueshëm në digjitalizimin e shërbimeve publike, disa shërbime ende kërkojnë ndërveprime fizike me administratën. Kjo krijon një hendek midis qytetarëve që kanë qasje në teknologji dhe atyre që janë të paaftë t'i përdorin apo kanë aftësi të kufizuara digjitale.
- Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026 fokusohet vetëm në digjitalizimin e shërbimeve dhe, megjithëse rreth 95% e shërbimeve administrative janë të disponueshme vetëm në formë digjitale, do të ishte e rëndësishme të miratohej një kuadër strategjik edhe për elementet e tjera të dizajnimit dhe ofrimit të shërbimit me në qendër përdoruesin të tilla, si aksesi në kontaktet e mbetura fizike me institucionet publike dhe thjeshtimi i procedurave ose mjetet e menaxhimit të cilësisë totale.

Udhërrëfyesi për RAP 2023-2030 mbulon iniciativat kryesore që bien nën objektivin "Administrata publike vendos përdoruesin në qendër dhe ofron shërbime me cilësi të lartë dhe lehtësisht të aksesueshme online dhe offline për të gjithë qytetarët dhe bizneset". Megjithatë, pavarësisht formulimit të këtij objektivi të përgjithshëm, nismat e parashikuara kanë të bëjnë kryesisht me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve digjitale.

- Kufizimet në zonat rurale: Në zona të caktuara, veçanërisht në rajonet rurale dhe malore, individët vazhdojnë të kenë një qasje të kufizuar në shërbimet digjitale, për shkak të mungesës së infrastrukturës së avancuar të internetit dhe pajisjeve të nevojshme. Kjo krijon një hendek në aksesin në shërbime për qytetarët e këtyre zonave.
- Aftësitë e kufizuara të qytetarëve: Një tjetër problem është mungesa e aftësive digjitale midis qytetarëve, veçanërisht midis të moshuarve dhe atyre me njohuri të pakta në teknologjinë e informacionit. Për të përfituar plotësisht nga shërbimet digjitale, qytetarët duhet të kenë një nivel bazë të aftësive digjitale, gjë që aktualisht përbën një sfidë për shumë individë. Po

DOKUMENT PARLAMENTAR

ashtu, mungesa e aftësive digjitale dhe aksesi në teknologji është një problem veçanërisht për komunitete të tilla, si romët dhe egjiptianët, pasi pengon aksesin e tyre në shërbimet publike.

- Problemet me transparencën dhe llogaridhënien: Pavarësisht përmirësimeve të konsiderueshme, korrupsioni dhe mungesa e llogaridhënies mbeten një shqetësim i vazhdueshëm në administratën publike. Raportet e BE-së theksojnë se, ndonëse janë krijuar mekanizma për monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të institucioneve publike, duhet bërë më shumë për të forcuar transparencën dhe për të parandaluar abuzimet.
- Nevojitet përshtatja e platformave digjitale ekzistuese me opsione të dedikuara për grupe specifike si, për shembull, personat me aftësi të kufizuara, për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në proceset e vendimmarrjes. Këto platforma duhet të jenë të aksesueshme dhe të përmbajnë opsione për përdoruesit me nevoja të veçanta, si audio-leximi, përkthime në gjuhën e shenjave dhe opsione për tekste të thjeshtuara.
- Në lidhje me aksesin digjital në legjislacion, legjislacioni primar është i disponueshëm për publikun online dhe pa pagesë. Megjithatë, jo i gjithë legjislacioni dytësor është ende i disponueshëm në internet. Për më tepër, funksionet e kërkimit nuk i lejojnë përdoruesit të kërkojnë akte ligjore sipas datës së zbatimit, gjë që kufizon përdorimin e portalit[428].
- Qeveria mban një portal të hapur të dhënash për informacionin e sektorit publik, por ai nuk përfshin një funksion kërkimi të avancuar dhe nuk ka informacion lehtësisht të gjetshëm se si të lidhesh përmes një ndërfaqeje programimi automatik për të shkarkuar të dhëna në masë. Për më tepër, nga katër domenet e mbuluara në Direktivën 2019/1024 të BE-së "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik", disponohen vetëm të dhëna për trafikun e tyre. Katër nga tetë grupet e të dhënave me vlerë të lartë, të mbuluara në Rregulloren Implementuese të Komisionit 2023/138 dhe BE-së, janë publikuar aktualisht në portalin e të dhënave[429].
- Korrupsioni në administratë: Administrata publike përballet ende me probleme të korrupsionit, çka dëmton besimin e qytetarëve dhe minon përpjekjet për një administratë të drejtë dhe efikase.
- Pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në proceset digjitale: Pavarësisht përmirësimeve në infrastrukturën digjitale, përfshirja aktive e qytetarëve në shërbimet digjitale është ende e ulët, sidomos në zonat rurale dhe për grupet e margjinalizuara, të cilat kanë vështirësi në përdorimin e platformave digjitale.
- Ndërgjegjësimi qytetar: Shumë qytetarë nuk janë të informuar për shërbimet që ofron platforma *e-Albania* dhe përfitimet që ato sjellin. Kjo çon në përdorimin e pamjaftueshëm të këtyre shërbimeve, veçanërisht nga ata që kanë më shumë nevojë për to.
- Mangësitë në trajnimin e administratës: Administrata publike përballet ende me mangësi në trajnimin e punonjësve për t'iu përgjigjur sfidave të reja që sjell digjitalizimi. Pavarësisht përpjekjeve dhe progresit për të përmirësuar kapacitetet e burimeve njerëzore, mbetet ende një problem për adresim në trajnimin dhe përgatitjen e plotë të administratës për të përdorur teknologjinë e re.
- Siguria digjitale dhe mbrojtja e të dhënave personale: Shqipëria ka përjetuar sulme kibernetike, të cilat kanë zbuluar dobësi në sistemet e mbrojtjes së të dhënave dhe në sigurinë e

[428]OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024(Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris*, f.105.

[429][429]OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris, f.105*.

DOKUMENT PARLAMENTAR

sistemeve *online*. Këto ngjarje kanë treguar nevojën për përmirësimin e masave të sigurisë dhe përditësimin e kornizës rregullatore, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian.

- Për të garantuar sa më mirë cilësinë e shërbimeve publike, përtej progresit të mirë në përgjithësi, disa potenciale, në aspektin e ndërveprueshmërisë (interoperabilitetit) dhe pagesave elektronike, mbeten të pashfrytëzuara.
- Lidhur me të drejtat pronësore, regjistrimi dhe digjitalizimi i të dhënave kadastrale ka vijuar, por me ritme të ngadalta. Ndaj, nevojitet alokimi i burimeve të mjaftueshme dhe finalizimi i kornizës ligjore, për të përfunduar proceset kalimtare në fushën e të drejtave pronësore dhe për të përmirësuar transparencën dhe cilësinë e regjistrit të pronave.

Ndërsa identiteti digjital miqësor për përdoruesit, nënshkrimi digjital, shërbimet e besimit, pagesat digjitale dhe zgjidhjet e shpërndarjes digjitale janë të disponueshme dhe të miratuara ligjërisht, ka vend për përmirësim në lidhje me identitetin elektronik. Mungon një pasqyrë gjithëpërfshirëse e përdorimit aktual të *e*-ID-së dhe nënshkrimit elektronik. Statistikat janë të disponueshme për përdorimin e nënshkrimit në *e-Albania* dhe platforma të tjera qeveritare, por nuk janë parashikuar për përdorimin e nënshkrimit elektronik në dokumente private.

4.3.2 Rekomandimet kryesore

Miratimi i strategjisë së re RAP për të plotësuar Kornizën Strategjike të Reformës së Administratës Publike (SFRAP) : nevojitet një kornizë gjithëpërfshirëse strategjike që mbulon të gjitha aspektet e dizajnit dhe ofrimit të shërbimit të përqendruar te përdoruesit.
Qeveria duhet të krijojë një strategji gjithëpërfshirëse për të adresuar nevojat e atyre që nuk kanë akses të lehtë në teknologji ose nuk zotërojnë aftësitë e nevojshme për të përdorur shërbimet *online*. Po ashtu, miratimi i Strategjisë mbi Inteligjencën Artificiale mbetet një prioritet, strategji e cila është draftuar dhe konsultuar me ekspertë të fushës dhe duhet të miratohet.
Konsolidimi dhe zbatimi efektiv i kuadrit ligjor për shërbimet digjitale, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave. Në përputhje me progresin e bërë në fushën e digjitalizimit, duhet të përforcohet kuadri ligjor që rregullon sigurinë kibernetike dhe privatësinë e të dhënave, si dhe zbatimi i tij sa më i mirë praktik. Zbatimi i standardeve të sigurisë në administratën publike dhe mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve duhet të jenë prioritete për të siguruar besimin e publikut në shërbimet digjitale, si dhe të jenë të harmonizuara me standardet dhe legjislacionin europian për të përmbushur kriteret e anëtarësimit në BE.

- Lidhur me miratimin e projektligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit, që synon të përafrohet me Rregulloren Evropiane të Identitetit Digjital, që krijon kornizën e re të shërbimeve të Identitetit Digjital dhe të Mirëbesimit të BE-së, nevojiten përpjekje të mëtejshme për përafrimin me Direktivën e Privatësisë Elektronike.
- Qeveria duhet të fillojë zhvillimin e projekteve për miratimin e portofolit elektronik dhe mjeteve dhe standardeve të tjera të reja, të prezantuara nga Rregullorja Evropiane e Identitetit Dixhital të vitit 2024 ose Rregullorja 2024/1183 e BE-së.
- Qeveria duhet të krijojë një mekanizëm të përhershëm ndërministror për reduktimin e barrës administrative, si për analizën *ex-ante* të ligjeve dhe akteve nënligjore, ashtu edhe për analizën *ex-post* të barrës ekzistuese në praktikë.
- Shqipëria duhet të përmirësojë mbledhjen e të dhënave statistikore mbi performancën digjitale dhe konkurrencën digjitale, sipas Indeksit të Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale.

DOKUMENT PARAMENTAR

- Qeveria duhet të sigurojë që të gjitha institucionet e qeverisë qendrore që ofrojnë shërbime publike të mbledhin, publikojnë dhe analizojnë tregues të krahasueshëm të performancës, bazuar në përkufizime dhe kritere të përbashkëta.
- Pavarësisht miratimit të strategjisë, Plani i Veprimit të Sigurisë Kibernetike 2023-2025 ende nuk është miratuar për ta përafruar me standardet e harmonizuara të BE-së, për ta mbrojtur infrastrukturën kritike dhe për të përmirësuar sigurinë kombëtare. Nevojitet bashkëpunim më i fortë me sektorin privat dhe shoqërinë civile, për të përmirësuar zbatimin dhe monitorimin e politikave të sigurisë kibernetike.
- Rritja e aksesit në shërbimet digjitale. Shqipëria duhet të përqendrohet në zgjerimin e infrastrukturës digjitale në zona të largëta dhe të ofrojë trajnime për përmirësimin e aftësive digjitale të qytetarëve. Aktorët lokalë mund të luajnë një rol të rëndësishëm duke ofruar trajnime për përdorimin e platformave *online*, si dhe asistencë në aksesimin e pajisjeve digjitale për grupet në nevojë.
- Ndërtimi i një shoqërie digjitale të sigurt, të qendrueshme dhe me shërbime të aksesueshme, si objektiv dhe prioritet që buron nga dokumenti politik Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Europian "Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor", pjesë e Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor.
- Qeveria duhet të ketë prioritet përfundimin e harmonizimit të legjislacionit të posaçëm me Kodin e Procedurave Administrative, bazuar në metodologjinë e dakordësuar dhe sigurimin e burimeve të nevojshme. Ministria e Drejtësia (MD), në bashkëpunim me AKSHI-n, duhet ta shfrytëzojë, gjithashtu, këtë mundësi për të thjeshtuar dhe ri-inxhinieruar procedurat administrative.
- Përmirësimi i aksesit dhe transparencës në administratën publike. Për të siguruar një administratë më të hapur dhe të përgjegjshme, rekomandohet forcimi i sistemit të llogaridhënies përmes instrumenteve të monitorimit të pavarur. Ky sistem do të duhet të jetë i integruar me platformat ekzistuese digjitale, si *e-Albania*, dhe të sigurojë raportim të rregullt mbi efektivitetin dhe efikasitetin e shërbimeve publike. Qytetarët duhet të kenë mundësi të kontribuojnë në procesin e monitorimit përmes platformave të ankesave dhe konsultimeve publike. Për më tepër, transparenca në përdorimin e fondeve publike mund të forcohet përmes krijimit të sistemeve të integruara financiare, që mund të monitorohen lehtësisht nga publiku.
- Zgjerimi i ndërveprimit mes institucioneve publike dhe sektorit privat. Për të përshpejtuar digjitalizimin e shërbimeve dhe rritjen e cilësisë së tyre, duhet të forcohet bashkëpunimi me sektorin privat, veçanërisht me kompanitë teknologjike dhe organizatat e biznesit. Ky partneritet mund të ndihmojë në zhvillimin e aplikacioneve të reja të shërbimeve digjitale dhe në përmirësimin e sistemeve ekzistuese, për t'i bërë ato më të përdorshme dhe më të aksesueshme për publikun e gjerë. Për më tepër, eksperienca e sektorit privat mund ta ndihmojë administratën publike në identifikimin dhe zbatimin e teknologjive më të reja për rritjen e efikasitetit administrativ.
- Përmirësimi i aftësive digjitale të qytetarëve. Një element tjetër kyç është rritja e aftësive digjitale të qytetarëve, veçanërisht të atyre që kanë vështirësi për të përdorur platforma teknologjike. Organizimi i kurseve të trajnimit dhe fushatave ndërgjegjësuese mbi përdorimin e shërbimeve digjitale si për qytetarët, ashtu edhe për administratën, do të kontribuonte në një integrim më të gjerë të platformave digjitale. Për ta arritur këtë qëllim, mund të krijohen partneritete me organizata të shoqërisë civile dhe organizata ndërkombëtare që ofrojnë programe të edukimit digjital.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Rritja e investimeve në infrastrukturën digjitale dhe forcimi i kapaciteteve administrative. Investimet në infrastrukturën digjitale mbeten një prioritet kyç për qeverinë shqiptare. Zona rurale dhe ato të largëta duhet të kenë akses në internet me shpejtësi të lartë dhe pajisje teknologjike për të siguruar barazi në aksesin në shërbime, si dhe duhet të ketë investime të mëtejshme në zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në administratën publike për të përballuar kërkesat e reja, veçanërisht në nivel vendor.
- Mbështetja për grupet më vulnerable: Për të përmirësuar qasjen në shërbime për personat e moshuar dhe ata me aftësi të kufizuara, si dhe te komuniteti rom/egjiptian e të tjerë, sugjerohet vendosja e disa qendrave fizike për shërbime dhe ofrimi i ndihmës teknike nga operatorët e qendrave të dedikuara. Po ashtu, duhet të krijohen programe të asistencës specifike për këta individë, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive digjitale të tyre.
- Duhet të bëhet funksionale qendra e kontaktit O*mnichannel*, duke shërbyer si një asistent informacioni i mundësisë së fundit, për të ofruar informacion për përdoruesit e shërbimeve elektronike që hasin probleme, si dhe të ofrojë mjete të vetëshërbimit që qytetarët mund t'i përdorin për të aplikuar për shërbime elektronike.
- *Po ashtu*, synohet që qendrat shumëfunksionale të inovacionit rinor të kenë kanalin për asistencën direkte, si pjesë e qendrës së kontaktit *Omnichannel*, duke shërbyer si një *Info-Point* për të ofruar informacion, udhëzime dhe asistencë për përdoruesit e shërbimeve, të cilët hasin probleme që lidhen me përdorimin e shërbimeve elektronike, si dhe do të jetë në dispozicion të përdoruesve një pajisje vetëshërbimi për të aplikuar për shërbime digjitale, kur përdoruesi nuk ka akses në një pajisje të tillë.
- Siguria digjitale dhe mbrojtja e të dhënave: Nevojitet përmirësimi i masave të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale për të parandaluar sulmet e ardhshme dhe për të mbrojtur të dhënat sensitive të qytetarëve, në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, të harmonizuar me Acqui-në e BE-së.
- Rritja e ndërgjegjësimit për shërbimet *online*: Qeveria duhet të fokusohet në krijimin e fushatave ndërgjegjësuese për përfitimet e shërbimeve digjitale, duke përfshirë informimin e qytetarëve për të gjitha mundësitë që ofron platforma *e-Albania.* Ky ndërgjegjësim do të kontribuojë, kështu, në përdorimin më të gjerë të shërbimeve publike *online* dhe do të rrisë përfshirjen digjitale të qytetarëve.
- Administrata shqiptare duhet të garantojë akses të barabartë në shërbimet administrative dhe trajtim të barabartë për të gjithë. Duhet të përpunohet një politikë gjithëpërfshirëse për të udhëhequr zgjerimin e shërbimeve *online*, integrimin e shërbimeve *online* dhe ballë për ballë, duke adresuar njëkohësisht çështjen e analfabetizmit digjital. Shqipëria duhet të rrisë kapacitetet administrative për të punuar në përfshirjen e shtresave sociale, si, për shembull, komuniteti rom/egjiptian dhe për të përmirësuar koordinimin ndërministror, kombëtar dhe lokal, si dhe duhet të vazhdojë të zbatojë angazhimet e Poznanit dhe rekomandimet e miratuara gjatë Seminarit të Pestë të Romëve.

4.4 Konkluzionet dhe çështjet për zgjidhje / drejtimet e ndërhyrjeve

Përmes Progresraportit të BE-së për Shqipërinë i vitit 2024, *Screening Report Albania* të vitit 2023, Raportit të Monitorimit nga OECD/SIGMA të vitit 2024 dhe raportit mbi Udhërrëfyesin e Reformës në Administratën Publike, është e qartë që Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në procesin e reformave, veçanërisht në fushën e digjitalizimit dhe përmirësimit të aksesit në shërbime. Megjithatë, mbeten disa sfida të rëndësishme që kërkojnë zgjidhje, siç rezulton në analizën si më poshtë.

DOKUMENT PARLAMENTAR

1. Konsolidimi i kuadrit ligjor për shërbimet digjitale, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, harmonizimi i tij i plotë me *Acqui*-në e BE-së, po ashtu, zbatimi efektiv i legjislacionit dhe strategjive të miratuara.
2. Harmonizimi i legjislacionit të posaçëm me Kodin e Procedurave Administrative. Në përgjithësi, administrata kërkon më shumë ndërgjegjësim, trajnime, udhëzime dhe mbështetje se si të integrohen perspektiva të ndryshme, si, për shembull, dizajni i shërbimit ligjor, teknologjik dhe i përqendruar te përdoruesi), në një qasje koherente për thjeshtimin e procedurave administrative, veçanërisht nga aplikimi i parimit "vetëm një herë".
3. Përmirësimi i kapaciteteve administrative. Administrata publike ende përballet me kapacitete të kufizuara, veçanërisht në trajtimin e shërbimeve komplekse dhe digjitale. Theksi vihet në zhvillimin e burimeve njerëzore, përmes trajnimit të vazhdueshëm dhe përmirësimit të standardeve të punës.
4. Përforcimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë. Lufta kundër korrupsionit dhe përmirësimi i llogaridhënies në shërbimet publike mbetet një prioritet i lartë. Institucionet duhet të krijojnë mekanizma më të fortë monitorimi dhe raportimi për të rritur transparencën në administratë dhe për të minimizuar abuzimet me detyrën.
5. Garantimi i aksesit të barabartë në shërbimet administrative dhe trajtim i barabartë për të gjithë përmes përpunimit të një politike gjithëpërfshirëse dhe antidiskriminuese.
6. Për sa i përket ripërdorimit të zgjidhjeve digjitale brenda sektorit publik, AKSHI-i, si zhvillues dhe ofrues i centralizuar i zgjidhjeve të IT-së, garanton ripërdorimin e zgjidhjeve të tyre në të gjithë pushtetin qendror. Megjithatë, nuk ka mjete mjaftueshëm të disponueshme për të lehtësuar ripërdorimin e zgjidhjeve digjitale për institucionet e sektorit publik që nuk mbulohen ende nga shërbimet e AKSHI-t.
7. Reduktimi i hendekut rural-urban: pavarësisht digjitalizimit, hendeku në aksesin në shërbimet publike midis zonave rurale dhe urbane mbetet një sfidë. Kërkohet një investim më i madh në infrastrukturën digjitale për zonat e largëta dhe përmirësimi i qasjes në internet për të gjithë qytetarët.
8. Qëndrueshmëria e reformave: reformat e ndërmarra, sidomos ato që lidhen me digjitalizimin e shërbimeve publike, të jenë të qëndrueshme dhe të mbështetura me burime të qëndrueshme financiare dhe teknike. Për këtë është thelbësore bashkëpunimi i ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Kapitulli V: Efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike

5.1 Konteksti

Reforma e menaxhimit të financave publike vazhdon të jetë një prioritet i Shqipërisë, jo vetëm si një nga parakushtet për anëtarësimin në Bashkimin Europian në kuadër të Reformës së Administratës Publike (RAP)[430], por gjithashtu synon mbështetjen e një ekonomie më të zhvilluar me shërbime më të mira për qytetarët.
Strategjia sektoriale e MFP-së 2023-2030 është zhvilluar në përputhje me kuadrin strategjik për zhvillimin kombëtar, integrimin evropian, reformat ekonomike dhe qeverisjen e mirë. Kjo strategji është e strukturuar në gjashtë shtylla, me disa komponentë në secilën shtyllë.

5.1.1 Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut[431]

Objektivi specifik i kësaj shtylle mbulon komponentët e programimit makroekonomik të matur dhe realist, analizës së qëndrueshmërisë së borxhit, menaxhimit të riskut fiskal dhe mbikëqyrjes fiskale.
Kapaciteti për programimin makro-ekonomik, duke përfshirë parashikimet makro-fiskale, është zhvilluar me kalimin e viteve, i përforcuar gjithashtu nga mbështetja dhe përpjekjet bashkëpunuese me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bashkimin Europian. Objektivi kryesor i programimit makro-ekonomik është i dyfishtë.
Së pari, të mbështesë dhe forcojë stabilitetin makroekonomik të vendit.
Së dyti, të nxisë një mjedis të favorshëm për rritje të lartë dhe të qëndrueshme ekonomike, duke u përpjekur për një konvergjencë drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Europian. Projeksionet makro-fiskale shërbejnë si inpute integrale për PBA-në dhe programin e reformave ekonomike, si dhe për buxhetet vjetore si në deklaratën para-buxhetore, ashtu edhe në raportin vjetor të monitorimit të buxhetit. Sigurimi i një parashikimi të matur, të drejtë dhe të kujdesshëm të treguesve makro-ekonomikë është një prioritet parësor. Kjo përfshin përdorimin e një qasjeje të kujdesshme dhe të mirinformuar në parashikimin e variablave kryesorë ekonomikë, duke ofruar një bazë për vendime të informuara të politikave.
Qëndrueshmëria e borxhit është një tjetër komponent i rëndësishëm i menaxhimit të financave publike. Krijimi i një kuadri gjithëpërfshirës të analizës së qëndrueshmërisë së borxhit deri në vitin 2027 synon të forcojë qëndrueshmërinë e borxhit, të identifikojë në mënyrë proaktive risqet e mundshme që lidhen me borxhin në të ardhmen, të vlerësojë ndikimin e politikave aktuale në trajektoren e borxhit dhe të nënvizojë domosdoshmërinë për ndërhyrje të politikave në kohë.
Kuadri i Analizës së Qëndrueshmërisë së Borxhit do të shërbejë si një mjet strategjik për të informuar më mirë vendimmarrësit për implikimet afatgjata të dinamikës së borxhit, duke kontribuar në praktikat e matshme të menaxhimit të borxhit, në qëndrueshmërinë e përgjithshme të financave publike, si dhe në stabilitetin makro-ekonomik të vendit.

Procesi i menaxhimit të risqeve fiskale në Shqipëri është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2016, me krijimin e Sektorit të Risqeve Fiskale si pjesë e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit (Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit). Shtrirja e risqeve fiskale që po

[430]VKM nr. 390, date 13.12.2023 'Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030': https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/13/737
[431]Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf

monitorohen dhe raportohen është rritur gradualisht dhe përfshin aktualisht risqet që lidhen me borxhin, zhvillimet makro-ekonomike, ndërmarrjet shtetërore (NSH), PPP-të dhe kontratat koncesionare, detyrimet e prapambetura, të ardhurat, pushtetin vendor, procedurat ligjore dhe çështjet gjyqësore. Parashikohet përmirësimi i cilësisë dhe zgjerimi i fushës së menaxhimit të riskut fiskal. Për shembull, duke përfshirë gradualisht në kuadrin e monitorimit risqet që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike.

Në përputhje me Udhërrëfyesin e Reformës në Administratën Publike, si dhe me rekomandimet dhe rregulloret e BE-së, do të krijohet një institucion i pavarur fiskal, Këshilli Fiskal, në kuadër të procesit të integrimit në BE. Qëllimi i Këshillit Fiskal do të jetë, ndër të tjera, vlerësimi i politikës fiskale të qeverisë.

Ministria e Financave ka mirëmbajtur dhe përmirësuar sistemet për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të shëndosha fiskale, të udhëhequra nga rregullat fiskale, parashikime të forta makro-ekonomike dhe menaxhim solid të riskut fiskal.

Pajtueshmëria me rregullat fiskale është raportuar në mënyrë transparente në dokumentet kryesore, duke përfshirë kornizën makro-ekonomike dhe fiskale, programin e reformës ekonomike dhe raportin mbi zbatimin e buxhetit vjetor/situata makro-ekonomike dhe fiskale. Ministria përgatiti pasqyrën e parë të riskut fiskal për vitin 2022 në bazë pilotimi në vitin 2023. Ai ishte, gjithashtu, një dokument referimi i përdorur, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar si FMN-ja, për përpilimin e dokumentit të radhës (*Fiscal Risk Survey* 2023).

5.1.2 Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent[432]

Objektivi specifik i shtyllës së dytë mbulon komponentët, si: planifikimi strategjik i integruar, planifikimi buxhetor afatmesëm, menaxhimi i investimeve publike, financat vendore, monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit.

Në kuadër të një planifikimi strategjik të integruar, organet qeveritare kanë krijuar një seri gjithëpërfshirëse strategjish dhe plane veprimi shoqëruese në fuqi, të përbërë nga Strategjia Kombëtare gjithëpërfshirëse për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE),për të cilat janë zhvilluar dhe po rinovohen rregullisht disa strategji sektoriale, nënsektoriale, ndërsektoriale dhe rajonale.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) ka hartuar rregullore dhe udhëzime për të udhëhequr zhvillimin dhe monitorimin e strategjive dhe planeve të tyre të veprimit në një mënyrë të qëndrueshme. Gjithashtu, është vënë në funksion një sistem informacioni (SIPI/IPSIS) për të mbështetur procesin e planifikimit të integruar.

Procesi i planifikimit buxhetor afatmesëm(PBA) është forcuar dhe që nga viti 2017 është përmirësuar besueshmëria e planeve afatmesme të shpenzimeve. Ky progres u atribuohet përpjekjeve për të forcuar rolin e PBA-së në procesin buxhetor nëpërmjet ndryshimeve rregullatore dhe aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve. Përmirësime janë bërë në formulimin e PBA-së, si dhe në cilësinë e dokumentacionit të PBA-së (Deklarata e para-buxhetit dhe dokumentacioni buxhetor vjetor) dhe në informacionin mbi performancën. Për më tepër, koncepti i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) ka përparuar për shkak të legjislacionit dhe rregulloreve të përmirësuara. Të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore prezantojnë politikat dhe buxhetet e tyre në përputhje me parimet e barazisë gjinore.

[432]Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Planifikimi dhe monitorimi i projekteve të investimeve publike zbatohet nga Ministria e Financave (MF), SASPAC-u dhe institucionet buxhetore.
Pas vlerësimit të Menaxhimit të Investimeve Publike (PIMA) të vitit 2016, një sërë reformash kanë filluar dhe janë finalizuar së fundmi. Këtu përfshihet prezantimi dhe miratimi me VKM i Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare; një kërkesë për një studim fizibiliteti për projektet që tejkalojnë pragun financiar, që është përcaktuar për secilin sektor, dhe një kërkesë për një plan ekzekutimi të projektit me një normë minimale të zbatimit financiar, me synimin për të reduktuar borxhet e mundshme dhe për të përshpejtuar zbatimin e projektit. Këto ndryshime po pasqyrohen në aktet nënligjore.
Në lidhje me këto reforma janë zbatuar edhe disa aktivitete trajnimi.
Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar Shqiptar (SIMFSH) ka një modul të dedikuar për MIP-në, i cili përdoret për planifikimin e pjesës së buxhetit kapital të PBA-së dhe, gjithashtu, për raportimin e ekzekutimit të buxhetit kapital. Për një periudhë afatshkurtër, fokusi kryesor i MF-së është vënia plotësisht në funksion e reformave të fundit, të cilat kërkojnë trajnim shtesë të stafit të angazhuar në MIP në të gjithë shërbimin civil dhe disa përshtatje të SIMFSH-së.
Reformat për formulimin e PBA-së në nivel vendor dhe për transfertat për bashkitë janë zbatuar në lidhje me Agjendën e Reformës së Decentralizimit të Qeverisjes Vendore. Pas Reformës Administrative Territoriale në vitin 2015, numri i njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVQV) është reduktuar nga 373, në 61, dhe është krijuar Këshilli Konsultativ, për të debatuar dhe dakordësuar për çështje të ndryshme ndërmjet pushtetit qendror dhe atij vendor.
Agjenda e Decentralizimit u avancua më tej, fillimisht përmes një ligji organik "Për vetëqeverisjen vendore", i cili përcakton kompetencat dhe funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore. Për të siguruar burime të qëndrueshme financimi, llogaridhënie dhe transparencë për strukturën e re të qeverisjes vendore kërkohej një kuadër i fortë rregullator. Rrjedhimisht, në vitin 2017 u miratua ligji i ri "Për financat e vetëqeverisjes vendore" Ky ligj përforcon autonominë fiskale vendore, duke zgjeruar opsionet e financimit dhe duke përcaktuar rregullat dhe procedurat për menaxhimin e financave publike (MFP) në nivelin vendor. Ky ligj balancon rritjen e autonomisë financiare me disiplinën fiskale, duke vendosur rregulla për shpenzime të kujdesshme, politika transparente, parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe harmonizim të proceseve buxhetore me qeverinë qendrore.
Për të siguruar një planifikim të mirintegruar dhe efikas, janë bërë arritje të rëndësishme për forcimin e menaxhimit financiar në qeverisjen vendore në kuadrin rregullator, si miratimi i ligjit "Për vetëqeverisjen vendore", ligji "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ashtu edhe disa akte nënligjore dhe udhëzime.
Sistemi i mbikëqyrjes financiare të bashkive nga qeveria qendrore, gjithashtu, është përmirësuar, me qëllim të mbështetjes së bashkive në vështirësi fiskale. Bashkitë me nivel shumë të lartë borxhesh dhe detyrimesh të prapambetura duhet të përgatisin dhe zbatojnë një plan rehabilitimi financiar nën mbikëqyrjen e MF-së. MF-ja përgatit raportin vjetor "Për gjendjen e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore", për monitorimin e gjendjes financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.
Gjithashtu, formulimi i PBA-së nga NJVQV-të është zhvilluar më tej duke respektuar autonominë vendore. NJVQV-të zhvillojnë PBA-në e tyre me programet buxhetore, qëllimet e politikave, objektivat, produktet dhe TKP-të dhe monitorojnë e raportojnë për zbatimin e buxhetit. Është duke u zhvilluar një reformë për të përafruar strukturën programore të buxhetit të NJVQV-ve me marrëveshjet e ofrimit të shërbimeve në çdo bashki.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Një nga objektivat e kësaj shtylle është pasja e një sistemi gjithëpërfshirës dhe transparent për monitorimin dhe raportimin e buxhetit në nivel të institucioneve buxhetore dhe në nivel qendror, që mbulon të gjitha aspektet e raportimit buxhetor.
Kuadri ligjor i menaxhimit të buxhetit është konsoliduar me qëllim krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe transparent të monitorimit dhe raportimit të buxhetit në nivel të institucioneve buxhetore. Përmirësimet në monitorimin e performancës financiare të sektorit të qeverisjes qendrore synojnë ndryshimin e shpeshtësisë së raportimit, përmbajtjen e tij dhe përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të palëve përkatëse. SIMFSH-ja, i projektuar si një zgjerim i Sistemit Informativ Financiar Qeveritar (SIFQ) ekzistues, ka edhe modulin e Monitorimit të Buxhetit dhe Portofolit të Projekteve, i cili është tashmë në përdorim. Në këtë kontekst janë përmirësuar raportet e zbatimit të buxhetit gjatë vitit, raporti i performancës makro-ekonomike, fiskale dhe buxhetore i mesvitit dhe raporti i fundvitit. Në vitin 2023 është nxjerrë një udhëzues i ri për monitorimin e buxhetit. Në përputhje me ligjin organik të buxhetit, Ministri i Financave nxjerr një udhëzues standard, i cili përmban udhëzime për procedurat, formatet dhe afatet që duhet të ndjekin të gjitha Njësitë e Qeverisjes Qendrore gjatë kryerjes së raporteve periodike të monitorimit të ekzekutimit të buxhetit. Në këto rrethana, udhëzimi i ri, i nxjerrë në maj të vitit 2023,synon ta përmirësojë më tej procesin e monitorimit të kryer nga ministritë e linjës (ML), institucionet buxhetore (IB), por nuk është në objektin e tij parashikimi i një raporti të monitorimit të buxhetit agregat.
Gjithashtu, udhëzuesi i ri përcakton të gjitha procedurat dhe afatet që duhen ndjekur nga të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare dhe jofinanciare, produktet dhe objektivat e politikave të realizuara për çdo program. Anekset e reja të miratuara në kuadër të këtij udhëzimi, të cilat mund të gjenerohen përmes SIMFSH-së, përmbajnë të dhëna për ecurinë e shpenzimeve buxhetore sipas klasifikimit të tyre ekonomik, si dhe performancën e produkteve që lidhen me treguesit kyçë të performancës së tyre për çdo program buxhetor.
Pajtueshmëria e dokumenteve të reja strategjike me udhëzimet e Sistemit të Planifikimit të Integruar (IPS) është përmirësuar ndjeshëm. Me miratimin e VKM nr. 887/2022 ka hyrë në fuqi një rregullore e rishikuar për Menaxhimin e Investimeve Publike (PIM). U prezantuan udhëzime shtesë për vlerësimin e rëndësisë strategjike të projekteve të investimeve publike dhe renditjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Aktivitete të ndryshme trajnimi u kryen për të siguruar zbatimin efektiv të udhëzimeve të reja të PIM. Një sistem i ri i menaxhimit të buxhetit lokal u zhvillua dhe u miratua për të përmirësuar përgatitjen dhe monitorimin e buxhetit në nivel nënkombëtar. Janë futur, gjithashtu, procedura të reja për monitorimin e zbatimit të projekteve të investimeve publike.

5.1.3 Menaxhimi dhe mobilizimi i të ardhurave[433]

Objektivi specifik i kësaj shtylle ka synim rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe mbulon komponentët: menaxhimi i taksave, menaxhimi i taksës së pasurisë (kadastra fiskale) dhe menaxhimi doganor.

Rritja e të ardhurave ka si synim të krijojë hapësirë fiskale për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet një kombinimi të reformave të politikave tatimore dhe modernizimit të

[433]Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

sistemeve administrative, për të siguruar përputhjen me rregulloret e BE-së dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për taksapaguesit.
Gjatë viteve të fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka zbatuar disa reforma në fushën e menaxhimit të të ardhurave. Këto përfshijnë përmirësime në menaxhimin e pajtueshmërisë së riskut, investime në sistemet e teknologjisë së informacionit, strukturat organizative dhe transparencën për taksapaguesit përmes fushatave ndërgjegjësuese, faqeve miqësore të internetit të përdoruesve dhe qendrave të thirrjeve. Formalizimi i ekonomisë ka qenë një fokus kyç dhe nismat e fundit nënvizojnë angazhimin për të rritur aftësitë e autoritetit tatimor. Për të forcuar pajtueshmërinë midis individëve me pasuri të lartë, është krijuar rishtazi një departament i specializuar në DPT. Gjithashtu, në vitin 2022 u finalizua një iniciativë fiskalizimi, që synonte t'i jepte DPT-së të dhëna të detyrueshme në kohë reale. Kjo përfshin integrimin e një sistemi të IT-së që kap informacionin e arkës dhe të faturave elektronike. Me synim rritjen e mobilizimit të të ardhurave dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, MF-ja ka zhvilluar dhe zbatuar më shumë se 70% të masave dhe aktiviteteve në politikat tatimore dhe reformat e administrimit të të ardhurave, pjesë të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2022-2026.
Krijimi i një kadastre fiskale plotësisht funksionale dhe një sistemi efektiv të mbledhjes së taksës së pasurisë synon të gjitha pronat në të gjitha bashkitë e vendit, me qëllim sjelljen e të ardhura shtesë për qeveritë vendore. Reforma e fundit në fushën e taksës së pasurisë synon të rrisë të ardhurat për bashkitë, duke kaluar nga një sistem i taksimit të bazuar në çmimin mesatar të referencës për ndërtesat dhe një sistem i thjeshtë tatimor, bazuar në sipërfaqen për tokën bujqësore dhe truallin, në një sistem taksimi modern që takson edhe ndërtesat edhe parcelat, bazuar në vlerën e tregut të këtyre pasurive të paluajtshme. Sfidë kryesore ka qenë krijimi i një baze të dhënash gjithëpërfshirëse të integruar të pasurive të paluajtshme. Të gjitha pasuritë e paluajtshme të regjistruara do të vlerësohen në bazë të vlerës së tregut.
Gjatë fazës së parë të reformës së taksës u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë (DPTP) dhe Kadastra Fiskale.
DPTP-ja luan një rol vendimtar, duke përfshirë menaxhimin e regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), si dhe udhëheqjen, nga pikëpamja metodologjike, në lidhje me administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme. Një program pilot, që përfshin nëntë bashki, u lançua për të vlerësuar efikasitetin e Sistemit Informativ të Kadastrës Fiskale (SIKF), i shoqëruar nga sesione të gjera trajnimi për anëtarët e stafit të bashkive.
Gjatë fazës së dytë, në vazhdim të reformës, është hartuar projektligji "Për tatimin mbi pasurinë e paluajtshme". Dispozitat e versionit aktual të projektligjit të ri përfshijnë që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të përgatisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, zonat e vlerës dhe çmimet e referencës për tokën.
Synimi për vitin 2030 është të kemi një administratë doganore efektive, e cila ofron shërbime të përmirësuara për qytetarët dhe bizneset, dhe funksionon në përputhje me standardet dhe legjislacionin e BE-së.
Deri më sot raportohen arritje të rëndësishme në reformat doganore, veçanërisht në përafrimin e Kodit Doganor Shqiptar me Kodin Doganor të BE-së. Automatizimi i doganave ishte një prioritet gjatë viteve të fundit, ndaj u bënë përpjekje për të futur dhe përmirësuar sisteme të tilla, si: Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Transitit (SRKT), Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave (SIMT) dhe përmirësimi i moduleve ekzistuese në Asycuda (sistemi kryesor në administratën doganore).
Me ofrimin e trajnimeve të stafit, kapaciteti institucional për të analizuar dhe zhvilluar politikat tatimore dhe për të menaxhuar reformat tatimore është rritur gradualisht. Konsolidimi i sistemit të fiskalizimit dhe qasjet e përmirësuara të menaxhimit të riskut kanë mbështetur reduktimin e

DOKUMENT PARLAMENTAR

hendekut të pajtueshmërisë me TVSH-në. Për më tepër, legjislacioni i ndryshuar i mundëson administratës tatimore që ta adresojë më mirë pasurinë e pajustifikuar. Hartimi i një strategjie për ofrimin e shërbimit të tatimpaguesve, së bashku me vazhdimin e trajnimit të stafit, synon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për tatimpaguesit. Në vitin 2023 u hartua një ligj i ri për tatimin mbi pronën dhe iu nënshtrua procesit të konsultimit publik si pjesë e iniciativës së reformës së tatimit në pronë, e cila pritet të përfundojë në vitin 2030. Menaxhimi i doganave është përmirësuar, gjithashtu, në përputhje me Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore. Koha e përpunimit të deklaratave doganore është reduktuar dhe numri i aplikimeve të suksesshme nga operatorët ekonomikë ka vazhduar të rritet. administrata doganore shqiptare ka vazhduar të modernizojë proceset e saj të biznesit dhe menaxhimit të riskut përmes trajnimit të stafit, investimeve në sistemet e informacionit, siç është Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave, zhvillimit të një kuadri integriteti dhe përpjekjeve për të luftuar informalitetin dhe korrupsionin. Gjithashtu, ka pasur një rritje të numrit të operatorëve ekonomikë të autorizuar dhe progres në zhvillimin e Dritares së Vetme Kombëtare.

5.1.4 Kontabiliteti dhe menaxhimi i zbatimit të buxhetit[434]

Objektivi specifik i menaxhimit i zbatimit të buxhetit dhe praktikave të kontabilitetit, të përmirësuara dhe të përafruara me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e BE-së" mbulon llogaritë kombëtare të qeverisë, kontabilitetin, prokurimin publik, menaxhimin e borxhit, menaxhimin e likuiditetit, dhe menaxhimin e aseteve.

Nëpërmjet Llogarive Kombëtare të Qeverisë synohet prodhimi i Statistikave Financiare të Qeverisë (SFQ) dhe Tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkaluar (TPDT), në përputhje me kërkesat e Sistemit Evropian të Llogarive (SELL 2010).
Për të realizuar përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë, burimet kryesore të të dhënave të përdorura janë: (i) Sistemi i Informacionit Financiar të Qeverisë së Shqipërisë (SIFQSH) për të dhënat që lidhen me njësitë buxhetore, (ii) pasqyrat financiare për njësitë ekstra-buxhetore, (iii) Sistemi i Menaxhimit të Borxhit dhe Analizës Financiare (SMBAF), (iv) Llogaritë Financiare për sektorin e QP nga Banka e Shqipërisë, dhe (v) të dhëna të tjera plotësuese, të përpiluara dhe të përgatitura nga INSTAT.
INSTAT mbështetet nga Eurostat për përafrimin e Statistikave Financiare të Qeverisë me kërkesat e BE-së dhe transmeton rregullisht tabelat e SFQ dhe Tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkaluar në Eurostat me statusin "jo për publikim".
Përgatitja dhe publikimi i pasqyrave financiare (të konsoliduara), në përputhje me zhvillimin e kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri (SNKSP), pas shtrirjes së SNKSP në të gjitha institucionet e qeverisë qendrore, është një nga synimet për t'u arritur deri në vitin 2030.
Sistemi i informacionit që përdoret për kontabilitetin dhe operacionet e thesarit është SIFQ. Sistemi është zhvilluar me kalimin e kohës, duke përfshirë integrimin e plotë me Sistemin e Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) për listën e pagave në vitin 2022 dhe sistemin e Automatizuar të Prokurimit Publik për prokurimet në vitin 2020. Institucionet më të mëdha buxhetore (nga gjithsej, afërsisht 1020 institucione buxhetore) janë lidhur drejtpërdrejt me SIFQ deri në fund të vitit 2022. Të gjitha këto janë: ministri, tri bashki të mëdha dhe disa institucione të tjera të mëdha publike.

[434]Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf

DOKUMENT PARAMENTAR

Përafërsisht, 300 institucione buxhetore janë të lidhura me sistemin e arkivës elektronike deri në fund të vitit 2022. Është planifikuar që numri i institucioneve buxhetore, që kanë akses, të arrijë gjithsej në 728 në vitin 2024. Përafërsisht, 250 institucione buxhetore, kryesisht më të vogla, nuk do të lidhen me SIFQ përmes modulit të 'arkivës elektronike' në SIFQ, pasi këto institucione nuk përmbushin kërkesat ligjore për të siguruar tre nënshkrime në urdhërpagesat. Mund të kërkohet një përqendrim i numrit të njësive të vogla shpenzuese për qëllime të menaxhimit dhe kontrollit financiar të shëndoshë. Sistemi SIFQ menaxhohet nga MF dhe mirëmbahet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).
Menaxhimi adekuat i detyrimeve të prapambetura në sistemin e kontabilitetit ka qenë një prioritet i lartë në vitet e kaluara. Janë krijuar procedura për të siguruar që transaksionet financiare, si, për shembull, kontratat e prokurimit, urdhrat ekzekutivë që rrjedhin nga çështjet gjyqësore, e të tjerë, të regjistrohen në kohë në sistem. Nënraportimi i detyrimeve të prapambetura ende nuk është eliminuar plotësisht.
Në vitin 2018, MF-ja filloi përgatitjet për reformën e kontabilitetit, me synimin për të qenë plotësisht në përputhje me SNKSP deri në vitin 2030.

Vitet e fundit, është bërë përparim domethënës në përafrimin e legjislacionit të prokurimit publik me direktivat e BE-së. Është miratuar ligji "Për prokurimin publik" dhe janë miratuar një sërë aktesh nënligjore dhe rregulloresh, duke përfshirë miratimin e rregullave të prokurimit publik, VKM për prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, fjalori i përbashkët i prokurimit e të tjera. Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE) ka ardhur duke u përmirësuar, duke përfshirë realizimin e funksionaliteteve të reja në SPE, për t'u përafruar me ndryshimet e ligjit të ri. Një ndërfunksionim ndërmjet SIFQ dhe SPE u krijua në vitin 2020, duke siguruar që autoritetet kontraktore të mund të verifikonin disponueshmërinë e fondeve përpara se të vazhdonin me procedurat e prokurimit.
Agjencia Shqiptare e Prokurimit Publik (APP), në cilësinë e saj si rregullatore e prokurimit publik, vazhdon të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të ri të prokurimit publik. APP ka publikuar një udhërrëfyes në lidhje me përdorimin e prokurimit publik të gjelbër, duke përfshirë një metodologji për kriteret dhe specifikimet teknike përkatëse. Përdorimi i kritereve të gjelbra në prokurimin publik kërkon rritje të kapaciteteve dhe njohurive mbi konceptin e Prokurimit Publik të Gjelbër nga autoritetet kontraktore. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ka forcuar pavarësinë e tij me zbatimin e ndryshimeve ligjore në vitin 2018. Një sistem elektronik i menaxhimit të ankesave për prokurimet publike u bë funksional që nga viti 2021. Të gjitha vendet vakante të planifikuara u plotësuan deri në fund të vitit 2022 dhe, në të njëjtin vit, KPP-ja përmirësoi efikasitetin e shqyrtimit të ankesave si për sa i përket numrit të ankesave të trajtuara jashtë afatit, ashtu edhe për kohën e nevojshme për shqyrtimin e ankesave. KPP do të vazhdojë ta mbajë fokusin në vendimmarrjen në kohë dhe efektivitetin në procesin e shqyrtimit të ankesave, duke mbajtur në ekuilibër shpërndarjen e burimeve, ndryshimet rregullatore dhe përmirësimet teknologjike.

Synimi për vitin 2030 është të funksionojë një sistem gjithëpërfshirës i menaxhimit të borxhit që siguron që nevojat e qeverisë për financim dhe detyrimet e saj për pagesën e borxhit të përmbushen me koston më të ulët të mundshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, në përputhje me një shkallë të kujdesshme risku.
Kuadri ligjor i menaxhimit të borxhit është konsoliduar me disa ndryshime të realizuara kohët e fundit, për të reflektuar përmirësime mbi përgatitjen e Strategjisë së Menaxhimit të Borxhit (SMB). Hartimi dhe publikimi i SMB-së në baza të rregullta është institucionalizuar plotësisht. Një plan

DOKUMENT PARLAMENTAR

vjetor i huamarrjes u publikua për herë të parë në vitin 2022, duke përcaktuar qartë strategjinë dhe instrumentet e huamarrjes që do të përdoren. Kalendari tremujor i ankandeve publikohet në kohë, duke plotësuar një plan vjetor të emetimit të brendshëm, të përfshirë në planin vjetor të huamarrjes. Publikohet një buletin statistikor tremujor i borxhit dhe raporti vjetor për zbatimin e SMB-së. Në janar 2023, u prezantua një format i Kodit Ndërkombëtar për Letrat me Vlerë të qeverisë (ISIN-Numri i identifikimit ndërkombëtar të letrave me vlerë), me qëllim rritjen e aksesit të investitorëve të huaj në tregun vendas të letrave me vlerë të qeverisë.
Procesi i parashikimit të fluksit të likuiditetit është përmirësuar kohët e fundit. Parashikimet mujore të fluksit të likuiditetit prodhohen për 12 muaj përpara dhe parashikimet ditore përgatiten për periudhën e ardhshme tremujore. Planet buxhetore të marra nga subjektet shpenzuese dhe të dhënat historike janë një input për parashikimet. Përveç qasjes së parashikimit nga lart-poshtë, është zbatuar një pilotim me tri ministri të linjës dhe me autoritetet tatimore e doganore për të plotësuar parashikimin me informacion nga poshtë-lart. Për të përmirësuar saktësinë e parashikimeve dhe për të minimizuar devijimet, nevojitet një vlerësim periodik i saktësisë së parashikimit nga DPTH. Për sa i përket menaxhimit të parasë, vihet re që nga depozitat e llogarive të thesarit pranë Bankës së Shqipërisë, të ardhurat nga interesi nuk janë shumë të larta. Gjithashtu, ka një qasje më fleksible ndaj sasisë së rezervave monetare që duhet të mbajë.

Synimi për vitin 2030 është të kenë përfunduar procedurat dhe sistemet për regjistrimin dhe vlerësimin e të gjitha aseteve publike, në përputhje me standardet e miratuara të kontabilitetit.
Për qëllime të kontabilitetit, në SIFQ është krijuar një modul i regjistrit publik të aseteve. Duke marrë parasysh boshllëkun e konsiderueshëm të të dhënave në regjistrat e aseteve fikse, në kuadër të projektit të BB-së "Zhvillimi i kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri (SNKSP)", u krye një vlerësim i cilësisë, plotësisë, metodologjisë dhe saktësisë së aseteve fikse. Si rezultat, u hartuan disa udhëzime të tilla, si: (i) një udhëzim për njohjen fillestare, matjen dhe çregjistrimin e çdo klase të aseteve, (ii) një metodologji për regjistrin e aseteve fikse dhe (iii) një plan veprimi për inventarizimin e aktiveve dhe masat e propozuara për inventarizimin në nivel njësie biznesi. Në lidhje me hapjen e regjistrit, është ofruar trajnim për përdoruesit e sistemit.

AGFIS mbetet sistemi kryesor i informacionit për menaxhimin financiar të qeverisë. Institucione të shumta buxhetore kanë fituar akses në sistem, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet Arkivit Elektronik (*Web Portal*). Mbi reformat e kontabilitetit është punuar në zhvillimin e kuadrit ligjor dhe sigurimin e mbështetjes nga donatorët, ndërkohë që trajnimi i SNKSP për kontabilistët e sektorit publik vazhdon. Janë përgatitur ndryshime në kuadrin rregullator të Prokurimit Publik dhe në veçanti VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe zbatimi i Prokurimit Publik të Gjelbër ka avancuar me përgatitjen e udhëzuesit dhe metodologjisë për Prokurimin Publik të Gjelbër dhe kryerjen e një sërë trajnimesh për profesionistët e prokurimit. Ministria e Financave ka publikuar Planin Vjetor të Huamarrjes 2024 dhe Raportin e Strategjisë së Menaxhimit të Borxhit 2022. Për përmirësimin e menaxhimit të aseteve, janë ndërmarrë hapa për krijimin e kuadrit të duhur rregullator në lidhje me vlerësimin dhe inventarizimin e publikut, aseteve dhe për përgatitjen e një regjistri të konsoliduar të pasurisë në institucionet qendrore.

DOKUMENT PARAMENDIM

5.1.5 Kontrolli i brendshëm financiar publik[435]

Objektivi specifik i shtyllës 5 "Sistemi i kontrollit të brendshëm financiar publik" profesionalizohet më tej në të gjitha institucionet buxhetore, në përputhje me kërkesat e integrimit në BE dhe mbulon menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, inspektimin financiar publik dhe shërbimet e koordinimit kundër mashtrimit, dhe menaxhimin e fondeve të BE-së.

Synimi për vitin 2030 është të kemi sisteme të fuqishme të menaxhimit financiar dhe kontrollit funksional në të gjitha institucionet publike në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe praktikat e mira ndërkombëtare/BE.

Praktikat e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në institucionet publike janë përmirësuar gradualisht me kalimin e kohës. Megjithatë, cilësia e MFK-së, si dhe përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret, ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet institucioneve publike. Në veçanti, në fushën e kontrollit të brendshëm vërehet hapësira për përmirësime të llogaridhënies menaxheriale dhe menaxhimit të riskut. Kuadri ligjor, i përbërë nga ligji "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe disa akte nënligjore, është në proces ndryshimi për të adresuar reformat e vazhdueshme në këtë fushë. Gjithashtu, manuali i MFK-së është duke u përmirësuar dhe përshtatur më tej. Të gjitha ndryshimet janë në përputhje me kërkesat e BE-së, siç përcaktohet në kapitullin 32 të *Acquis*. Është krijuar procesi i vetëvlerësimit vjetor të cilësisë së sistemit të MFK-së, nëpërmjet një pyetësori; raportimi pasues në MF; zhvillimi i planeve të përmirësimit të MFK-së dhe zbatimi i tij nga institucionet publike. Gjetjet kryesore raportohen në raportin vjetor të KBFP dhe diskutohen nga bordi i KBFP. NJQH/MFK mbështet institucionet publike me asistencë të drejtpërdrejtë në zbatimin e kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Synimi për vitin 2030 është të sigurohet një auditim i brendshëm me vlerë të shtuar në të gjitha institucionet publike, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo mund të arrihet nëpërmjet një funksioni të brendshëm të auditimit të brendshëm ose shërbimeve të përbashkëta, duke siguruar respektimin e standardeve të miratuara ndërkombëtarisht për auditimin e brendshëm. Objektivi është që të ofrohen rekomandime kuptimplota, si për nivelin ekzekutiv të institucionit buxhetor, ashtu edhe për komitetin e auditimit. Për më tepër, përmirësimi i kuadrit të certifikimit për audituesit e brendshëm dhe ofrimi i mundësive të zhvillimit profesional në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar do të kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të profesionit.

Llojet më të avancuara të auditimit të brendshëm si auditimi i TI-së, auditimi i performancës, auditimi i të ardhurave dhe auditimi i projektit janë prezantuar pjesërisht. Kuadri i auditimit të bazuar në risk, në kombinim me parimet e parandalimit, zbulimit dhe adresimit të parregullsive të mundshme, mashtrimit dhe korrupsionit duhet të operacionalizohet dhe institucionalizohet më tej për të qenë plotësisht efektiv. Përmirësimi dhe ruajtja e kualifikimeve dhe aftësive profesionale të të gjithë kuadrit të auditimit të brendshëm mbeten sfidë dhe prioritet.

Synimi për vitin 2030 është që të ketë një inspektim financiar publik efektiv, në mënyrë që (i) të garantojë respektimin e ligjit në përdorimin e fondeve publike dhe të ofrojë ndihmë në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, në përputhje me standardet profesionale, dhe (ii) të koordinojë hartimin, miratimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit, për të mbrojtur më mirë interesat financiare të BE-së dhe për të monitoruar e forcuar më tej rolin koordinues të SHKKM.

[435]Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf

DOKUMENT PARAMENDIMOR

Shqipëria është e vendosur të sigurojë një sistem kontrolli që do të parandalojë mashtrimet, parregullsitë dhe llojet e tjera të keqmenaxhimit financiar të fondeve publike në njësitë e sektorit publik. Që nga viti 2015 u prezantua ligji i ri "Për inspektimin financiar publik (IFP)" dhe disa akte nënligjore, rregullore, udhëzime dhe manuale. Këto ndryshime legjislative u shoqëruan me ndryshime organizative, si krijimi i Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik (DIFP), si funksion i pavarur brenda MF-së. IFP është një aktivitet *ex-post* mbi rregullsinë e transaksioneve dhe veprimtarive të tjera të menaxhimit të financave publike, i kryer nën përgjegjësinë e njësive publike dhe individëve, me qëllim (i) përcaktimin e shkeljeve të akteve normative dhe verifikimin e dyshimeve për ndonjë mashtrim të kryer; (ii) zbulimin e parregullsive dhe dëmeve të shkaktuara në pronën e njësive publike; dhe (iii) identifikimin e personave përgjegjës për shkeljet e kryera dhe marrjen e masave zhdëmtuese, disiplinore ose administrative, sipas nivelit ose llojit të përgjegjësisë. Aktivitete të shumta për ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë trajnime, mentorime dhe vizita studimore, kanë kontribuar në rritjen e profesionalizmit të stafit të drejtorisë. Pas rekomandimeve dhe kërkesave rregullatore të BE-së do të zhvillohet, miratohet, zbatohet dhe monitorohet Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.
Synimi për vitin 2030 është që të ketë sisteme të përshtatshme të MFP, në përputhje me kërkesat e BE-së për menaxhim të shëndoshë financiar, në mënyrë që të përthithen në mënyrë efektive fondet e BE-së.

Konferenca e Parë Ndërqeveritare për Negociatat e Anëtarësimit me Shqipërinë u zhvillua më 19 korrik 2022 dhe shqyrtimi nisi në të njëjtën datë. Shqipëria po merr ndihmë financiare në kuadër të IPA III, ku objektivi kryesor është të mbështesë përfituesit në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike, që kërkohen për të përmbushur vlerat e Bashkimit. Shumë etapa të rëndësishme janë përfunduar deri më tani, si ratifikimi i marrëveshjes kornizë financiare të partneritetit ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Shqipërisë për IPA III, dhe manualet e procedurave, që do t'i dorëzohen së shpejti Komisionit Europian. Meqenëse asistenca IPA III zbatohet nëpërmjet metodave të ndryshme, si menaxhimi i drejtpërdrejtë, menaxhimi indirekt dhe menaxhimi i përbashkët, Shqipëria do të duhet të përgatitet të përthithë financimin e marrë, duke krijuar dhe forcuar kapacitetet administrative dhe institucionale. Rritja e burimeve shtesë aty ku nevojiten dhe ngritja e kapaciteteve të stafit do të jetë një nga prioritetet e strukturave të përfshira në trajtimin e IPA III.

Janë bërë ndryshime në ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK)", shoqëruar me përditësime të manualit të MFK-së dhe udhëzime të ndryshme. Ministria e Financave ka mbështetur institucionet publike në rritjen e llogaridhënies menaxheriale dhe menaxhimit të riskut, duke rezultuar në rritjen e përputhshmërisë me kërkesat e MFK-së. Pas ndryshimit të ligjit "Për auditimin e brendshëm" është bërë progres i dukshëm në zhvillimin e mjeteve dhe mekanizmave për kontraktimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm. Ministria e Financave vazhdoi të mbështesë profesionalizimin e praktikave kryesore të auditimit të brendshëm përmes zhvillimit të udhëzimeve dhe ofrimit të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve. Inspektimi Financiar Publik dhe Rrjeti i Shërbimit të Koordinimit Kundër Mashtrimit ka ndërmarrë hapat e parë për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Krijimi i kuadrit ligjor IPA III ka përfunduar me miratimin e VKM nr. 540/2023. Kjo u pasua me aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve të strukturave të IPA III.

DOKUMENT PARLAMENTAR

5.1.6 Mbikëqyrja e jashtme[436]

Synimi për vitin 2030 është të sigurohet që funksioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit të jetë bazuar në parimet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA) dhe në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (SNISA), nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor, rregullator dhe metodologjik dhe vendosjes së mjeteve dhe kapaciteteve të mjaftueshme të audituesve dhe stafit mbështetës.

Pavarësia dhe mandati i KLSH-së sigurohet me ligj dhe me kalimin e viteve janë adoptuar Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe kuadri rregullator është përshtatur me këto standarde. KLSH auditon çdo vit në përputhje me planin e saj vjetor të auditimit bazuar në risk, të përzgjedhura nga institucionet e qeverisjes qendrore, ndërmarrjet shtetërore, partneritetet publike private dhe nga viti 2021 të gjitha 61 NJQV-të, në përputhje me ligjin "Për qeverisjen vendore". Në vitin 2018 është futur një Kod i ri i Etikës. KLSH ka krijuar bashkëpunim me Iniciativën Zhvillimore të ONISA, Organizatën Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (OEISA), Gjykatën Evropiane të Auditimit (programet e praktikës), CEF Slloveni (për programet e trajnimit), SIGMA, trajnime të auditimit të brendshëm dhe angazhime dypalëshe me ISA të tjera, për zhvillimin e kapaciteteve të KLSH si institucion dhe stafit të tij audites. KLSH ka zgjeruar fushën e përgjegjësisë edhe me auditimin e barazisë gjinore dhe arritjen e OZHQ-ve. KLSH vendosi bashkëpunim me partnerët e zhvillimit për pilotimin e auditimit të jashtëm të PPP-ve dhe kontratave koncesionare, si dhe për futjen e teknikave të auditimit, mbështetur nga TI, për përmirësimin e praktikave të auditimit. Gjithashtu, komunikimi dhe angazhimi me Parlamentin, qeverinë, medien dhe qytetarët është rritur dhe pritet të përmirësohet më tej me zhvillimin e Strategjisë së re të Komunikimit 2022-2025. Hapat për përmirësimin e ndjekjes adekuate të rekomandimeve të auditimit të KLSH-së, që ka qenë një çështje kyçe, janë bërë nëpërmjet një rregulloreje parlamentare, që synon të sigurojë një mekanizëm më efektiv për monitorimin e ndjekjes së gjetjeve të auditimit. Parashikohet më shumë punë në këtë fushë.

Në vijim të vlerësimit të Kuadrit për Matjen e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (KMP-ISA), të zbatuar në vitin 2022, KLSH ka zhvilluar dhe miratuar Strategjinë e saj të Zhvillimit për 2023-2027. Disa pika kryesore të strategjisë përfshijnë futjen e auditimeve të specializuara dhe qasjeve fleksible të auditimit, përmirësimin e komunikimit të KLSH me Parlamentin dhe qytetarët, si dhe vazhdimin e zgjerimit dhe trajnimit të kuadrit të auditimit.

Synimi për vitin 2030 është të sigurohet që mjedisi mundësues dhe struktura mbështetëse ndaj Komisionit për Ekonominë dhe Financat të jetë e profesionalizuar duke ndjekur praktikat e mira të BE/OECD, të cilat i lejojnë Parlamentit të zbatojë më mirë mandatin e tij të kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Mandati i Parlamentit në sistemin e qeverisjes është i përcaktuar qartë dhe fushat e përgjegjësisë së Komisionit për Ekonominë dhe Financat në sistemin e MFP-së përfshijnë: politikat ekonomike, buxhetin e shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, privatizimet dhe sistemin bankar. Vlerësimet e fundit të PEFA[437] dhe SIGMA[438] arrijnë në përfundimin se "Parlamenti, përfshirë Komisionin për Ekonominë dhe Financat, tregon një performancë relativisht solide, por, gjithashtu, identifikon

[436]Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026, https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf

[437]*Albania PEFA Evaluation 2017: https://www.pefa.org/node/481*

[438]*Albania SIGMA Monitoring report 2021: https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration. https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf -*

DOKUMENT PARAMETAR

hapësirë për përmirësim". Si vazhdim i këtyre vlerësimeve, janë dhënë disa rekomandime, duke përfshirë krijimin e nënkomisioneve. Zhvillimet ndërkombëtare sugjerojnë se angazhimi më i fortë i Parlamentit përgjatë ciklit buxhetor (politika dhe qëndrueshmëria fiskale, shqyrtimi i buxhetit dhe propozimet buxhetore suplementare, shqyrtimi i ekzekutimit të buxhetit, raportet financiare dhe të auditimit, si dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare) kontribuojnë në përmirësimin e MFP-së. Në këtë kontekst, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat ka shprehur interesim të madh për të zhvilluar më tej rolin e tij në sistemin e përgjithshëm të qeverisjes së mirë dhe MFP.

Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit vazhdoi të përmirësojë më tej kontrollin efektiv të institucioneve publike, duke rritur mbulimin dhe standardet e auditimit, për të siguruar mbikëqyrje të plotë të proceseve financiare dhe për të forcuar praktikat e ndjekjes së auditimit të jashtëm, thelbësore për ruajtjen e llogaridhënies dhe transparencë në praktikat e menaxhimit financiar. Në të njëjtën kohë, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat po përparon në mënyrë aktive drejt përmirësimit të shqyrtimit legjislativ të raporteve të auditimit, me mbështetjen e disa partnerëve zhvillimorë.

Në kuadër të dokumentit[439] të miratuar të politikave shtetërore, Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023-2030, në lidhje me fushën e menaxhimit të financave publike, ndër angazhimet që do të ndërmerren, janë:

1. Rritja e qëndrueshmërisë së parashikueshmërisë së tavaneve buxhetore afatmesme, nëpërmjet përcaktimit të treguesit "Devijime të tavaneve të programit buxhetor afatmesëm nga tavani buxhetor", i miratuar nga Parlamenti;
2. Përgatitja e një legjislacioni dytësor/udhëzimi për të detajuar procedurat për përgatitjen e një aneksi specifik, që përbëhet nga përllogaritjet e devijimeve dhe arsyet përkatëse;
3. Rritja e ndërgjegjësimit dhe llogaridhënies së Ministrisë së Financave dhe Këshillit të Ministrave në procesin e përgatitjes së tavaneve buxhetore në të gjitha fazat;
4. Përgatitja dhe miratimi i ligjit të ri "Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme" dhe aktet nënligjore përkatëse, me qëllim përmirësimin e të ardhurave nga kjo taksë;
5. Përafrimi i legjislacionit tatimor shqiptar me direktivat e BE-së, në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.
6. Konsolidimi fiskal vazhdon të jetë objektivi kryesor i politikës fiskale për të garantuar stabilitetin makro-ekonomik të vendit gjatë gjithë kohës dhe, veçanërisht, gjatë sfidave dhe vështirësive ekonomike, si një premisë thelbësore për të siguruar një rritje ekonomike relativisht të lartë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.
7. Përgatitja e paketës fiskale për përmirësimin dhe thjeshtimin e procedurave zbatuese të legjislacionit tatimor;
8. Objektivi përfundimtar i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave (SAA) për periudhën 2022–2026 është rritja e të ardhurave me +2,5% të prodhimit të brendshëm bruto, deri në fund të vitit 2026;
9. Monitorimi efektiv i risqeve fiskale, veçanërisht i atyre që lidhen me detyrimet kontingjente, është prioritet për menaxhimin e financave publike.

Ministria e Financave do të forcojë kapacitetet e Njësisë së Riskut Fiskal, duke marrë në konsideratë asistencën nga partnerët ndërkombëtarë për përmirësimin e monitorimit dhe menaxhimit të riskut fiskal. Gjithashtu, në lidhje me risqet fiskale do të bëhet publikimi i

[439]VKM nr. 390, date 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030": https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/13/737

Deklaratës së Risqeve Fiskale, si një dokument më vete, çdo vit brenda muajit maj të vitit fiskal të ardhshëm.

10. Ngritja e Këshillit Fiskal, si dhe përgatitja e një dokumenti përshkrues që paraqet modalitetet e mundshme për Këshillin Fiskal. Gjithashtu, zhvillimi i planit të kostuar për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Fiskal.
11. Hartimi dhe miratimi i metodologjisë së përditësuar për inventarizimin, vlerësimin dhe zhvlerësimin e aseteve në sektorin publik.
12. Zhvillimi i metodologjisë për vlerësimin e projekteve të reja koncesionare/PPP.
13. Koordinim i ngushtë i MF-së me investitorët dhe aktorët e tregut, në drejtim të rritjes së transparencës, parashikueshmërisë dhe efektivitetit të procesit të huamarrjes, në përputhje me objektivat e strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit. Ndjekja e një praktike për përgatitjen dhe publikimin e planit vjetor të huamarrjes para fillimit të vitit të ri kalendarik.

5.2 Progresi dhe arritjet

Bazuar në raportet vjetore të monitorimit të MFP-së, të marra në shqyrtim për vitet 2015-2022, mund të themi se gjatë zbatimit të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike ndër vite ka patur një progres të kënaqshëm në realizimin e masave të ndërmarra, ndër të cilat përmendim:

1) Kapaciteti për programimin makro-ekonomik është zhvilluar, duke përfshirë parashikimet makro-fiskale;

2) Procesi i menaxhimit të risqeve fiskale në Shqipëri është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2016, ku është zgjeruar monitorimi i ndërmarrjeve shtetërore;

3) Qeveria shqiptare ka miratuar Mekanizmin e Qasjes për të gjithë sektorin në vitin 2015, në mënyrë që të sigurojë koordinim, programim dhe monitorim në të gjithë sektorët. Ky mekanizëm është rishikuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018 “Për zbatimin e qasjes për gjithë sektorin për ndërsektorët dhe krijimin e funksionimin e mekanizmit të integruar (ndërkufitar) sektorial””;

4) Ndryshimet në ligjin organik të buxhetit (LOB) në 2016 fuqizuan Parlamentin të votonte dhe të miratonte tavanet e PBA-së në nivel programi dhe për t’i bërë detyruese për periudhën trevjeçare;

5) Në Ministrinë e Financës u krijua Drejtoria për Taksën e Pasurisë. Gjatë vitit 2018 u rishikua kuadri ligjor dhe plotësua me aktet nënligjore, që lidhen me ligjin të ri të taksës mbi pronën;

6) Lidhur me menaxhimin e borxhit dhe likuiditetit, është krijuar një Strategji Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit dhe analiza e qëndrueshmërisë së borxhit ndërmerret rregullisht;

7) Progres është arritur me ndryshimin e ligjit të prokurimit publik (LPP) për ta përafruar më tej me *Acquis*(direktivat e reja të BE-së),të miratuar në vitin 2014 dhe miratimin e akteve nënligjore. Ligji u ndryshua përsëri në vitin 2017, me qëllim funksionimin dhe forcimin e pavarësisë së Komisionit të Prokurimit Publik;

8) Masa ligjore dhe rregullatore janë ndërmarrë për të rritur pavarësinë e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP);

9) Progres i mirë u arrit me integrimin e SIFQ në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), i cili doli në përdorim në nëntor 2021;

DOKUMENT PARLAMENTAR

10) U nënshkrua në vitin 2016 Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet MFE-së, Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe BSH-së;

11) Gjatë viteve 2015-2018, janë bërë përmirësime dhe ndryshime në ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe janë miratuar disa akte nënligjore në mbështetje të legjislacionit parësor;

12) Në lidhje me Kontabilitetin, u realizua analiza e hendekut, pas së cilës u miratua një plan veprimi strategjik për vendin, për kalimin në SNKSP në muajin tetor 2019;

13) Komunikimi dhe angazhimi me Parlamentin, qeverinë, medien dhe qytetarët është rritur në zbatim të Strategjisë së re të Komunikimit 2022-2025, si dhe është miratuar Strategjia e Zhvillimit për periudhën 2023-2027.

Progresi i bërë deri në vitin 2022 është i mbështetur në strukturën me 7 objektiva specifikë të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, të cilët janë:

Objektivi specifik 1: Kuadri fiskal i qëndrueshëm dhe i matur;
objektivi specifik 2: Planifikimi i mirintegruar dhe efikas;
objektivi specifik 3: Mbledhja e të ardhurave;
objektivi specifik 4: Ekzekutimi efikas i buxhetit;
objektivi specifik 5: Transparenca e financave publike;
objektivi specifik 6: Kontroll i brendshëm efektiv;
objektivi specifik 7: Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike.

Në kuadër të paraqitjes në mënyrë të përmbledhur, jepet grafiku numër 3.1 si më poshtë, i cili paraqet nivelin e arritjes për secilin objektiv specifik.
Grafiku 3.1 Niveli i arritjes së Objektivave Specifikë (OS) për vitin 2022



Burimi: Ministria e Financave (2024), Raporti i Vjetor për vitin 2022 i Monitorimit të Strategjisë 2019-2022

Strategjia[440] e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030, përveçse trajton disa sfida me të cilat po përballet Shqipëria në rrugën e saj drejt BE-së, përfshin në planin e saj të veprimit edhe vlerësime të bëra nga partnerët ndërkombëtarë të tilla, si: vlerësimi i shpenzimeve publike dhe

[440]Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Plani i Veprimit 2023-2026
https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Strategjia-e-Menaxhimit-te-Financave-Publike-2023-2030.pdf

përgjegjshmërisë financiare (gjerësisht i njohur si PEFA) dhe vlerësimi "Mbështetja për përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit" (gjerësisht i njohur si SIGMA). Procesi i Vlerësimit të PEFA-s për Shqipërinë filloi në maj 2024 dhe përfundoi në dhjetor 2024. Vlerësimi do të mbulojë të dhënat për vitet fiskale 2021, 2022 dhe 2023.

Vlerësimi PEFA 2024 synon t'i sigurojë Shqipërisë një vlerësim të performancës së menaxhimit të financave publike (MFP) në nivel qendror bazuar në metodologjinë PEFA, bazuar në 31 tregues performance. Procesi i vlerësimit të SIGMA për Shqipërinë nisi në janar 2024 dhe përfundoi në tetor 2024. Parimet e Administratës Publike janë të organizuara në 6 fusha tematike, 32 parime dhe 270 nënparime. Ministria e Financave është përgjegjëse për fushën tematike "Menaxhimi i financave publike", si dhe kontribuon në 5 fushat e tjera tematike. Gjetjet dhe rekomandimet nga raporti final i vlerësimit të PEFA-s dhe SIGMA-s do të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së për periudhën 2027-2030.

5.2.1 Progresi për Objektivin specifik 1 "Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur"

Lidhur me kuadrin fiskal është zhvilluar kapaciteti për programimin makro-ekonomik, duke përfshirë parashikimet makro-fiskale, i përforcuar gjithashtu nga mbështetja dhe përpjekjet bashkëpunuese me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimin Evropian. Kjo reflektohet në aftësinë për të matur PBB nominale në vlera edhe më të ulëta (-0.2 miliardë lekë) sesa parashikimet nominale të PBB-së nga *World Economic Outlook* gjatë periudhës 2016-2023[441]. Për të siguruar një kuadër fiskal të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm, u bënë përpjekje për (i) rritjen e besueshmërisë së kuadrit fiskal dhe (ii) identifikimin dhe kontrollin më efektiv të rreziqeve fiskale. Gjatë vitit 2022, niveli i arritjes së treguesve të performancës së rezultateve është vlerësuar si "shumë i mirë", me 100% progres të bërë, duke qëndruar në të njëjtën kategori, krahasuar me vitin 2021 (100%).

Gjithashtu, procesi i menaxhimit të risqeve fiskale në Shqipëri është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 2016, ku është zgjeruar monitorimi i ndërmarrjeve shtetërore. Në tetor 2018 u miratua nga Këshilli i Ministrave dhe u paraqit zyrtarisht në Kuvend Pasqyra e Risqeve Fiskale (PRF), e cila paraqet risqe të ndryshme dhe të rëndësishme fiskale. Në MF u krijua Njësia për Riskun Fiskal (NJRF), përgjegjëse për analizimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale të qeverisë. Pasqyra e parë e Risqeve Fiskale (PRF) u publikua me buxhetin vjetor të vitit 2019. Botimi i PRF tregon se është ngritur një infrastrukturë e besueshme e menaxhimit të riskut, me qëllim për të përballuar sfidat që dalin në rrugën e zhvillimit të vendit. Gjatë vitit 2019 filloi puna për të thelluar dhe zgjeruar mbulimin e PRF-së për të përfshirë një gamë më të gjerë risqesh, përfshirë ata që lidhen me ndërmarrjet shtetërore utilitare, detyrimet e prapambetura dhe detyrimet që lidhen me kontratat PPP[442]. Në maj 2020 u publikua për herë të parë Raporti Vjetor Përmbledhës për vitin 2019 me informacion financiar dhe jofinanciar për PPP-të aktive.[443]. Fokusi i NJRF-së është monitorimi i NSH-ve që mund të kenë ndikim potencial në buxhet, dhe jo domosdoshmërisht

[441]Raporti vjetor i monitorimit të MFP-së për vitin 2019, f. 13
https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/Raporti-i-Monitorimit-i-Strategjise-MFP-2019.pdf
[442]Raporti vjetor i monitorimit të MFP-së për vitin 2019, f. 14
https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/Raporti-i-Monitorimit-i-Strategjise-MFP-2019.pdf
[443]Raporti vjetor i monitorimit të MFP-së për vitin 2022, f. 17
https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/2022-Raporti-Vjetor-i-Monitorimit-t%C3%AB-Strategjis%C3%AB-s%C3%AB-MFP-s%C3%AB.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

monitorimi i të gjitha NSH-ve, as rritja e numrit të NSH-ve të monitoruara aktualisht. Kështu, hapat e ardhshëm të NJRF-së janë monitorimi i NSH-ve, të cilat mund të kenë ndikim potencial në buxhet, siç janë sektori i energjisë dhe sektori i furnizimit me ujë.[444]

Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje e progresit të bërë mbi Treguesit e Performancës për OS1, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së 2019-2022.

Tabela 3.1 Treguesit e performancës për objektivin specifik 1 (SO1)

Rezultati	Treguesi i performancës	Vlera bazë (2018)	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera faktike VF 2022
I) Rritja e besueshmërisë së kuadrit fiskal	Ia) Raporti mes borxhit dhe PBB	68%	66.3%	76.1%	74.5%	64.6%
	Ib) PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimet e FMN-së Perspektiva Ekonomike Botërore	-5.9 billion ALL	-16.5billion ALL	ALL -0.2 billion	-0.03 billion ALL	(-) 0.2 billion ALL
	Ic) Bilanci primar	+0.5%	0.20%	-4.7%	-2.6%	(-) 1.9%
	Id) Diferenca ndërmjet suficitit /deficitit aktual dhe suficitit/deficitit të synuar të vendosur në buxhetin për vitin aktual	-18%	-4%	-17.0%	-29.2%	(-)6.72%
	Ie) Devijimi në përqindje i arkëtimit aktual është brenda përqindjes së përcaktuar të /vlerësimit fillestar të buxhetit të miratuar për të ardhurat tatimore dhe doganore	-1.4%	-3.50%	-16.80%	1.20%	8.7%
II) Janë identifikuar dhe trajtohen më efektivisht risqet fiskalë	IIa) Raportimi i riskut fiskal (PEFA PI 10)	C (2017)	B+	B	B	B

Burimi: Ministria e Financave (2024), Raporti i Vjetor i Monitorimit të Strategjisë për periudhën 2019-2022

Sipas raportit SIGMA 2024, nëntreguesi për monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale është vlerësuar me 9/9 pikë, kurse nëntreguesi për raportimin vjetor të ndërmarrjeve shtetërore, fondeve ekstrabuxhetore dhe qeverisjes lokale ka një vlerësim shumë të ulët, me 2/10 pikë. Kjo dëshmon përmirësimet e vazhdueshme që duhen bërë në këtë drejtim, siç është raportimi i performancës financiare të ndërmarrjeve shtetërore.

Gjithashtu, sipas këtij raporti, nëntreguesi i objektivave fiskalë ka marrë vlerësim maksimal 12/12 pikë, kurse raportimi vjetor i të ardhurave, shpenzimeve dhe huamarrjes ka një vlerësim 7/10 pikë. Objektivat fiskale të qeverisë janë të përcaktuara në kuadrin makrofiskal. Në vlerësimin e bërë nga raporti SIGMA 2024 për periudhën 2021-2023 ka devijime të mëdha ndërmjet ecurisë së borxhit publik dhe deficitit fiskal, në krahasim me objektivat e miratuara. Për vitin fiskal 2023, kuadri makro-fiskal 2023-2025 përcaktoi një objektiv borxhi prej 77,6% të PBB-së, por rezultati aktual i borxhit për vitin 2023 ishte dukshëm më i ulët, në 59,2% e PBB-së. Për të njëjtin vit, deficiti ishte

[444]Raporti vjetor i monitorimit të MFP-së për vitin 2019, f. 14
https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/Raporti-i-Monitorimit-i-Strategjise-MFP-2019.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

planifikuar në 5,4% të PBB-së, ndërsa rezultati aktual ishte më i favorshëm 3,7% e PBB-së[445]. Kjo ecuri tregon një pozicion fiskal më të konsoliduar sesa ishte planifikuar, duke çuar në një perspektivë të përmirësuar ekonomike. Megjithatë, në raport sugjerohet se qeveria mund të marrë në konsideratë objektiva fiskale më ambiciozë, kur diskuton në lidhje me politikat fiskale, pasi objektivat fiskalë aktualë mund të jenë më të relaksuar.

5.2.2 Progresi për Objektivin specifik 2 "Planifikim i mirintegruar dhe efikas"

Për të siguruar një planifikim dhe buxhetim të mirë-integruar dhe efikas të shpenzimeve publike, janë bërë përpjekje për: përmirësimin e procesit dhe dokumentacionit të buxhetit vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm; përmirësimin e Mbikëqyrjes së Menaxhimit të Investimeve Publike (MIP); dhe forcimin e menaxhimit financiar në qeverisjen vendore. Shqipëria ka miratuar Mekanizmin e Qasjes për të gjithë sektorin në vitin 2015 në mënyrë që të sigurojë koordinim, programim dhe monitorim në të gjithë sektorët. Ndryshimet në ligjin organik të buxhetit (LOB) në vitin 2016 fuqizuan parlamentin të votonte dhe të miratonte tavanet e PBA-së në nivel programi dhe për t'i bërë detyruese për periudhën trevjeçare.

Shpenzimet në buxhetin 2022 u rritën në krahasim me fazën teknike të PBA-së 2022-2024. Ndryshimet e mëdha vijnë nga rritja e shpenzimeve për investime publike, duke përfshirë fondet e rindërtimit të nxitura nga vendimet politike.[446]

Lidhur me investimet publike, Këshilli i Ministrave miratoi një procedurë të re në vitin 2018 që synonte krijimin e kritereve të reja për prioritarizimin dhe vlerësimin e projekteve të mëdha të investimit kapital.[447] Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare (LUPK) për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit, u miratua nga KPS-ja në vitin 2020. LUPK ishte një hap i rëndësishëm përpara për Shqipërinë në krijimin e një mjeti të besueshëm planifikimi afatgjatë e shumëvjeçar për investimet publike të nxitura nga politikat në Shqipëri. Gjatë vitit 2022, Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare u përditësua bazuar në metodologjinë standarde, të hartuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) dhe nga asistenca e BE-së, duke shtuar projekte të reja strategjike, të cilat janë vlerësuar nga SASPAC dhe janë verifikuar nga KPS-ja. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, me qëllim rritjen e cilësisë së propozimeve për investime publike të mëdha të paraqitura për miratim, SASPAC në bashkëpunim me asistencën teknike të BE-së ka zhvilluar metodologjinë për të vlerësuar Relevancën Strategjike të propozimeve të projekteve të investimeve dhe Formularët e Vlerësimit të Rëndësisë Strategjike për 6 sektorët kryesorë.

Për sa i përket menaxhimit të financave publike në vetëqeverisjen vendore janë realizuar arritje të rëndësishme në kuadrin rregullator, si miratimi i ligjit "Për vetëqeverisjen vendore", i ligjit "Për

[445]*SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration*. https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

[446]Raporti vjetor i monitorimit të MFP-së për vitin 2022, fq. 19: https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/2022-Raporti-Vjetor-i-Monitorimit-t%C3%AB-Strategjis%C3%AB-s%C3%AB-MFP-s%C3%AB.pdf.

[447]Raporti vjetor i monitorimit të MFP-së për vitin 2022, fq. 21 https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/08/2022-Raporti-Vjetor-i-Monitorimit-t%C3%AB-Strategjis%C3%AB-s%C3%AB-MFP-s%C3%AB.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

financat e vetëqeverisjes vendore" dhe disa akteve nënligjore dhe udhëzime. Në vitin 2018, MF-ja përgatiti dhe aprovoi dy udhëzues të rinj për monitorimin e buxhetit të NJQV-ve dhe përgatitjen e programit të buxhetit afatmesëm, për të garantuar se procedurat dhe raportet do të jenë të unifikuara në planin afatmesëm. Puna për forcimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimin e buxhetit në nivelin e qeverisë vendore përparoi mirë gjatë periudhës 2019-2022. Gjatë vitit 2022 është rishikuar Udhëzimi vjetor i Përgatitjes së PBA-së. Është përgatitur një format i ri për Dokumentin e PBA-së të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV) dhe është përfshirë si aneks i ri i Udhëzimit Vjetor.

Progresi i fundit i Agjendës së Decentralizimit është shoqëruar me disa përmirësime thelbësore në performancën financiare të qeverisjes vendore. Gjithashtu, është forcuar planifikimi strategjik dhe menaxhimi i buxhetit në nivelin e qeverisë vendore nëpërmjet rritjes së normës së mbledhjes së tatimeve dhe reduktimit të stokut të prapambetur të detyrimeve. Ky stok u ul në 10% në vitin 2022 duke shënuar nivelin më të ulët. Raporti i të ardhurave nga burimet e veta të qeverisjes vendore ndaj PBB-së u dyfishua gjatë një periudhe shtatëvjeçare (1,66% në vitin 2022, krahasuar me 0.82% në vitin 2015). Ndërkohë, të ardhurat e NJVQV-ve nga burimet e veta (tatimore dhe jotatimore) janë rritur me 164% ndërmjet viteve 2015 dhe 2022. Mbi 80% e NJVQV-ve kanë shënuar një rritje të rëndësishme të të ardhurave të veta gjatë së njëjtës periudhë që paraqet përmirësim të kapacitetit të tyre fiskal për financimin e shërbimeve vendore. Shpenzimet e pushtetit vendor përfaqësonin rreth 9,02% të totalit të shpenzimeve publike në vitin 2022, krahasuar me 7,7% në vitin 2015.

Për më tepër, sistemi i transfertave të bazuara në formulë, të granteve të pakushtëzuara tek bashkitë është përmirësuar. Grantet për NJVQV-të bazohen në treguesit e numrit të popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të nxënësve dhe rregullohen më tej duke ndjekur një ekuacion financiar bazuar në kapacitetin fiskal të bashkisë për të rritur të ardhurat. Me transferimin e funksioneve të caktuara të qeverisë (arsimi parashkollor, vaditje, administrim pyjor, mbrojtje nga zjarri, rrugë rurale) nga pushteti qendror tek bashkitë në vitin 2016, formula për përcaktimin e transfertave është përshtatur në përputhje me rrethanat. Bashkitë janë të lira të ndajnë dhe të bartin grantet e pakushtëzuara që marrin. Përveç këtyre granteve të pakushtëzuara, jepen edhe disa grante të kushtëzuara për të kompensuar koston e funksioneve të qeverisë qendrore që i delegohen pushtetit vendor, për shembull, regjistrimet civile. Llogaritja e granteve është e rregulluar me ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje e progresit të bërë mbi Treguesit e Performancës për OS2, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së 2019-2022.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Tabela 3.2 Treguesit e performancës për Objektivin specifik 2 (SO1)

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera faktike VF 2022
III) Dokumentet qeveritarë që shërbejnë për planifikim, si SKZHI, Strategjitë Sektoriale dhe PBA-ja janë harmonizuar plotësisht me njëra-tjetrën.	IIIa)Është indentifikuar raporti mes financimit total të parashikuar në strategjitë sektoriale dhe financimit total që është identifikuar për sektorët korespondues brenda PBA-së.	**56% (2017)**	**NA**	**NA***	**60***	**NA**
IV) Përmirësimi i buxhetit vjetor dhe procesit dhe dokumentacionit të PBA-së për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm.	IVa) Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratuar në vitin n/total i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor.	**0.78% (2018)**	**-0.14%**	**22.8% (2020)**	**2.5%**	**12.1%**
	IVb) Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1)	**D (2017)**	**B**	**B**	**B**	**B**
V) Përmirësimi i Mbikqyrjes së Menaxhimit të Investimeve Publike	Va) Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik)	**64% (2018)**	**78%**	**82%**	**90.5%**	**91.4%**
	Vb) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime.	**97% (2018)**	**97%**	**95%**	**99.0%**	**98.4%**
	Vc) Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit	**30.38%**	**28.90%**	**46.35%**	**72.4%**	**75.3%**
VI) Forcimi i menaxhimit financiar në qeverinë vendore	VIa) Normat e mbledhjes së tatimeve (RLGRG)	**4.62%**	**5.6%**	**-4.90%**	**21.3%**	**3.6% (fakt 2022/2021)**
	VIb) Niveli vendor PEFA PI-22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura	**6.8 mld lekë (2018)/ 49.6 mld leke (13.7 %)**	**8.1 mld lekë/ 56.2 mld leke (14.4 %)**	**6.9 bln ALL/51.6 billion ALL (13.3%)**	**6.5 bln ALL/52.583 bln ALL (12.3%)**	**5.9 bln ALL / 58.6 bln ALL (10%)**

Burimi: Ministria e Financave (2024), Raporti i Vjetor i Monitorimit të Strategjisë 2019 – 2022

Sipas raportit SIGMA për vitin 2024[448], treguesi për një buxhet vjetor gjithëpërfshirës, të formuluar brenda një kuadri afatmesëm të besueshëm dhe të vazhdueshëm, duke balancuar nevojat e politikave me kufizimet fiskale, është vlerësuar me 57 nga 100 pikë. Nëntreguesit që kanë pasur një vlerësim më të mirë për vitin 2023 janë: përgatitja e kuadrit fiskal afatmesëm 11,9/15 pikë, dokumentacioni i buxhetit vjetor 11/15 pikë, respektimi i kalendarit buxhetor 3/5 pikë, aksesi publik në informacionin mbi buxhetin 4/5 pikë dhe planifikimi dhe buxhetimi i investimeve kapitale 8/10 pikë. Pavarësisht kuadrit të mirëformuar buxhetor dhe performancës së mirë të procedurave buxhetore, besueshmëria e parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve është relativisht e ulët. Sipas SIGMA 2024, qëndrueshmëria e programit buxhetor afatmesëm është vlerësuar me 11 pikë nga 25 (për të dhënat e vitit 2023). Diferenca mesatare ndërmjet të ardhurave të planifikuara në PBA dhe rezultatit të vitit fiskal 2023 ishte 13%. Përqindja e diferencës ndërmjet shpenzimeve të planifikuara në PBA për vitin 2023 dhe vitin fiskal është 7%.

[448] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration* https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

Besueshmëria e tavaneve të shpenzimeve të përcaktuara në PBA 2024-2026[449] dhe në buxhetin vjetor është gjithashtu e ulët, si në nivelin agregat, ashtu edhe në atë të disagreguar, me një diferencë prej 3% midis nivelit të përgjithshëm të tavanit të shpenzimeve në PBA 2024-2026 dhe nivelit të përgjithshëm të shpenzimeve në buxhetin vjetor. Në nivel ministrie, devijimi mesatar i tavanit të shpenzimeve në 5 ministritë më të mëdha është 11%, duke ulur besueshmërinë e punës së ndërmarrë për përgatitjen e PBA-së, pasi tavanet mund të ndryshohen.

Përmirësime duhen bërë edhe në lidhje me periudhën e shqyrtimit të projektbuxhetit në Kuvend, ku sipas SIGMA 2024, ky nën-tregues është vlerësuar me 4 pikë nga 10. Raporti identifikon luhatje të periudhës midis paraqitjes së projektbuxhetit në Kuvend dhe aprovimit të tij në dy buxhetet e viteve te fundit,[450] sidomos projektbuxheti i vitit 2024 i cili është dërguar në Kuvend në 30 tetor 2023.

Vitet e fundit është përmirësuar monitorimi dhe raportimi i shpenzimeve kapitale. Qeveria miratoi një rregullore të re nr. 887, datë 27 dhjetor 2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike"[451], e cila përcakton kërkesën që ministritë e linjës të përgatisin raporte mujore për zbatimin e projekteve të investimeve kapitale, duke përfshirë të dhënat për zbatimin fizik dhe treguesit e performancës, si dhe t'i dorëzojë ato në MF. Raportet mujore shërbejnë si bazë për përpunimin e raportit financiar vjetor në fushën e shpenzimeve kapitale. Ky nën – tregues është vlerësuar me 5.8/9 pikë në raportin e monitorimit SIGMA 2024.

Për vitin 2023 treguesi i autonomisë fiskale të qeverisjes vendore është vlerësuar me 52/100 pikë. Të ardhurat e veta zënë 41% të buxhetit të pushtetit lokal. Sfida kryesore në financimin e qeverisjes vendore është pabarazia e konsiderueshme në të ardhurat për frymë, e cila nuk është adresuar mjaftueshëm nëpërmjet formulës së barazisë fiskale. Shumica e bashkive kanë pagesa të prapambetura që tregon nivelin e ulët të disiplinës së menaxhimit financiar midis qeverisjeve vendore. Në raportin e monitorimit SIGMA 2024, nëntreguesi i mundësisë së qeverisjes vendore për të rritur të ardhurat dhe për të menaxhuar financat e veta është vlerësuar me 8,5/23 pikë, i cili është një vlerësim shumë i ulët. Edhe nëntreguesi i rregullave për barazinë fiskale, për të ulur pabarazinë ndërmjet bashkive, është vlerësuar me 4/10.

Nëntreguesi i balancës financiare dhe qëndrueshmërisë fiskale të qeverisjes vendore është vlerësuar me 11,6/26 pikë. Për sa i përket menaxhimit financiar në nivel vendor, rastet e miratimit me vonesë të buxhetit vendor janë relativisht të rralla dhe pothuajse 90% e qeverisjes vendore kanë një suficit operativ ose të paktën një buxhet operativ të balancuar. Megjithatë, pavarësisht nga kjo perspektivë pozitive, 10% e njësive të vetëqeverisjes vendore kanë patur një deficit operativ në vitin 2022, dhe shumica e bashkive (53 nga 61) kanë detyrime të prapambetura në vitin 2023[452]. Në 11 bashki, niveli i detyrimeve të papaguara ka tejkaluar shumën e të ardhurave totale vjetore të tyre në vitin 2023. Situata të tilla janë pasojë e dobësive në praktikat e menaxhimit financiar,

[449] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration.* https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf
[450] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration.* https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf
[451] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration.* https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

[452] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 143*https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

me problemet financiare midis qeverisjes vendore, të cilat shpeshherë nuk reflektohen si deficite buxhetore, por më tepër si pagesa të prapambetura.

5.2.3 Progresi për objektivin specifik 3 "Mbledhja e të ardhurave"

Me qëllim përmirësimin në mbledhjen e të ardhurave, janë bërë përpjekje për (i) rritjen e nivelit të të ardhurave nga tatimet; (ii) reduktimin e informalitetit nëpërmjet rritjes së vetëdeklarimit dhe rritjes së forcës së kontrollit të zbulimit, si dhe (iii) rritjen e nivelit të të ardhurave nga doganat. Një sistem i ri i teknologjisë së informacionit (ti) për administrimin e taksave është vënë në punë që prej janarit të vitit 2015 dhe rishikimet e sistemit përfunduan në vitin 2017. Në vitin 2015, administrata tatimore filloi zbatimin e metodologjisë bashkëkohore të menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë (MRP), duke synuar të përmirësojë pajtueshmërinë e tatimpaguesit bazuar në grupe (për shembull, e fokusuar në industri).

Gjatë vitit 2019 administrata tatimore përfundoi modelin për procedurat e automatizuara të bazuara në risk për të gjitha rimbursimet e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe pjesa dërrmuese e punës për zbatimin e rimbursimeve automatike të TVSH-së është kryer gjatë vitit 2020 dhe është realizuar 95% gjatë vitit 2021. Platforma e rimbursimit është funksionale që prej muajit prill të vitit 2022. Kuadri rregullator i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është rishikuar vazhdimisht për të qenë në përputhje me *Acquis* të BE-së, duke përfshirë zhvillimin më të fundit. Gjatë këtyre viteve është përmirësuar efikasiteti dhe transparenca e dhënies së shërbimit doganor në pikat e kalimit kufitar. Në vitin 2022 Shqipëria priti Misionin e Vlefshmërisë dhe mori vlefshmërinë nga validuesit e Komisionit të BE-së për proceset e Operatorëve Ekonomikë të autorizuar (OEA-s) të zbatuara me sukses nga administrata shqiptare. Gjithashtu, ofrimi i shërbimit ndaj klientit është përmirësuar për shkak të ri-inxhinierimit së shumë proceseve si thjeshtimi i procedurave dhe futja e menaxhimit doganor pa letra për të thjeshtuar pajtueshmërinë. Këto ndryshime rezultuan në përmirësimin e procedurave doganore *online*, reduktimin e kohës së përpunimit doganor dhe rritjen e përdorimit të vlerësimit të riskut. MF-ja ka zhvilluar Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave 2022-2026, me synimin për të mobilizuar të ardhura shtesë për të krijuar hapësirë fiskale për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm. Deri në dhjetor 2023, 13 kompani gjithsej kanë marrë statusin e OEA.

Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë u krijua Drejtoria për Taksën e Pasurisë. Gjatë vitit 2018, MF-ja rishikoi kuadrin ligjor dhe plotësoi aktet nënligjore që lidhen me ligjin të ri të taksës mbi pronën. Reforma për taksën mbi pronën është vonuar për shkak të ngjarjeve të paparashikuara dhe për rrjedhojë gjatë vitit 2020 MFE, SIDA dhe Agjencia Shtetërore e Taksave kanë arritur një marrëveshje, me qëllim shtyrjen e agjendës së reformës për taksën mbi pronën me 2 vjet. Gjatë vitit 2019 nisi tatimi mbi pronën në bazë të vlerës së zonës fiskale për ndërtesat dhe funksionalizimi i mbledhjes së taksave. Duke qënë se projekti është i zgjatur, procesi i vlerësimit nuk është kryer ende për shkak të mungesës së cilësisë së të dhënave ose mungesës së të dhënave. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë dhe Agjencinë Suedeze të Tatimeve gjatë vitit 2023, kanë hartuar projektligjin "Për tatimin në pronë". Ky projektligj do të vendosë tatimin e pronës bazuar në vlerën e tregut sipas një metodologjie, që përfshin standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe konceptet/elementet e vlerës së tregut[453].

[453]Draft-raporti i Monitorimit të MFP-së për vitin 2023

DOKUMENT PARLAMENTAR

Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje e progresit të bërë mbi Treguesit e Performancës për OS3, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së 2019-2022.

Tabela 3.3 Treguesit e performancës për Objektivin specifik 3(SO1)

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera faktike VF 2022
VII) Rritja e nivelit të të ardhurave nga tatimi	VIIa) Baza e tatimit të bizneseve	112 428 biznese (2017)	113 829 (+1.24%)	47.6% (165,955 biznese në 2020)	62.4% (182,632 biznese në 2021)	85% (208,043 biznese në 2022)
	VIIb) % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N /mbledhja faktike në vitin N-1 -100% (nga tatimet)	>0	259.462 milion Lekë(PBB,in 2019) (5.23%)	-7.20%	14.5%	13.8%
	VIIc) Përpjestimi i borxhit të tatimit të mbledhur në vitin N kundrejt shumës së prapambetur të detyrimeve tatimore	63%	74.00%	78.39%	62.7%	68.1%
VIII) Ulja e informalitetit nga rritja e vet-deklarimit dhe rritje e forcës së kontrollit të zbulimit	VIIIa) Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës	6.60%	3.48%	2.21% (2,876,202 të kthyera në 2020, vs 2,814,005 në 2019)	-8.08% (2,641,559 të kthyera në 2021 vs 2,876,202 në 2020)	1.7% (2,685,283 të kthyera në 2022 vs 2,641,559 in 2021)
IX) Kadastra fiskale tërësisht funksionale	IXa) Numri i ndërtesave të regjistruara dhe të faturuara	46.67% (2017) (700 000/1 500 000)	47.5% (570000/1200 000)	80% (1 200 000/1 500 000)	80% (1 200 000/1 500 000)	1,260,587
X) Rritje e nivelit të të ardhurave nga doganat	Xa) % e mbledhjes faktike të ardhurave doganore në vitin N /mbledhja faktike e të ardhurave doganore në vitin N-1 -100% (nga doganat)	>0	2.09%	-6.10%	25.7%	15.6%
	Xb) Koha e përpunimit të deklaratave doganore	(2018) 143.81	453 min/ deklarime	97	88	95

Burimi: Ministria e Financave (2024), Raporti i Vjetor i Monitorimit të Strategjisë 2019 – 2022

Sipas vlerësimit të raportit SIGMA 2024**,** administrata tatimore ka zbatuar relativisht mirë planet e saj të mbledhjes së të ardhurave me një realizim 102.4% e planit për vitin 2023. Diferenca në përbërjen e të ardhurave për të njëjtin vit ishte 5% me devijime midis planit dhe faktit,[454] prej 5% për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), -4% për të Ardhurat Personale Tatimore (TAP) dhe -8% për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave (CIT). Nëntreguesi i efiçiencës në mbledhjen e tatimeve është vlerësuar me 10/10 pikë në raportin SIGMA 2024. Ky vlerësim lidhet me faktin se kostoja e mbledhjes së tatimeve është e ulët. Sipas këtij raporti, kostoja totale e administratës tatimore ndaj të ardhurave neto të mbledhura është 0,78% për vitin 2023. Megjithatë, pavarësisht planifikimit real të të ardhurave tatimore dhe kostos së ulët e mbledhjes së tyre, efektiviteti i mbledhjes së të ardhurave është minuar nga niveli i lartë i detyrimeve të prapambetura (42% në 2023). Ky nën tregues është vlerësuar me 11/20 pikë. Sipas këtij raporti, administrata tatimore ka përpunuar një plan për identifikimin dhe zvogëlimin e rreziqeve në administrimin e të ardhurave dhe ka miratuar një plan për përmirësimin e përputhshmërisë, por ai nuk mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha tatimet dhe detyrimet kryesore.

[454] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 114,* https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

5.2.4 Progresi për objektivin specifik 4 "Zbatim efikas i buxhetit"

Përpjekje janë bërë për të siguruar një përdorim efikas dhe efektiv të burimeve buxhetore të miratuara. Progres i mirë u arrit me integrimin e SIFQ me Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), i cili doli në përdorim në nëntor 2021 dhe për herë të parë 45 institucione buxhetore (IB) mundën të ekzekutonin listën e pagave përmes SIFQ gjatë vitit 2021, 120 IB gjatë 2022 dhe 300 IB gjatë 2023. Një njësi e veçantë për reformën e kontabilitetit u krijua brenda Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DHMFKK) për të mbështetur procesin e kalimit në kontabilitetin në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara përmes miratimit të një kuadri rregullator që është bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP).

Si hap i parë, u përgatit Plani i Veprimit Strategjik i Vendit për Reformën e Kontabilitetit 2019-2027. Pas miratimit të planit të veprimit, u ndërmorën hapa për zhvillimin e kuadrit ligjor dhe rregullator. Deri më tani, SNKSP janë përkthyer në gjuhën shqipe, janë hartuar 10 udhëzime (akte nënligjore), të cilat janë objekt miratimi nga ministri i Financave në fazat e mëvonshme, të shoqëruara me manuale specifike, që lidhen me këto udhëzime dhe që do të miratohen gjithashtu. Gjithashtu, janë ndërmarrë hapat e parë për hartimin e një ligji të ri të kontabilitetit dhe është siguruar nga konsulenti struktura që duhet të ketë ligji.

Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve kanë filluar dhe 25 individë (stafi i MF-së, kontabilistë të sektorit publik, universitetet, Organizatat Profesionale të Kontabilitetit) janë trajnuar përmes një programi të gjerë trajnimi në SNKSP (siguruar nga Instituti i Financave Publike dhe Kontabilitetit). Më pas, për 500 (nga rreth 1,100 gjithsej) kontabilistë të qeverisë u zhvillua një trajnim më i shkurtër mbi SNKSP. U krye një rishikim i funksionalitetit të SIFQ, krahasuar me kërkesat e SNKSP, në kuadër të projektit të BB-së "Zhvillimi i kontabilitetit të sektorit publik në Shqipëri (SNKSP)" i cili dha rekomandime për shtimin e moduleve dhe llogarive në SIFQ. Për më tepër, ai identifikoi zgjidhje alternative për plotësimin e boshllëqeve të të dhënave përmes mjeteve ose tabelave që mund të përdoren për gjurmimin e informacionit, përpunimin e tij dhe përcaktimin e hyrjeve që do të regjistrohen në sistemin SIFQ në baza periodike. Gjithashtu, është bërë një analizë e përgjegjësive institucionale brenda MF-së dhe funksionit më të gjerë të kontabilitetit të qeverisë qendrore duke ofruar rekomandime specifike që do të merren parasysh për riorganizimin e mëtejshëm të funksionit brenda Ministrisë.

Lidhur me menaxhimin e borxhit dhe likuiditetit, është krijuar një Strategji Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (2022 – 20226) e përditësuar dhe analiza e qëndrueshmërisë së borxhit ndërmerret rregullisht. Këto janë hapa pozitivë në lidhje me menaxhimin e borxhit dhe likuiditetit që kanë ndikuar në uljen e raportit të borxhit ndaj PBB nga 64,6% në 2022 në 58,9% në 2023. Që në vitin 2015 është krijuar një grup i përhershëm pune për përgatitjen e Strategjisë Afatmesme të Borxhit me përfaqësues nga MFE dhe BSH. Në vitin 2015 ata prodhuan Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB) 2015 – 2017. SAMB është përditësuar dhe publikuar nga MFE-ja në baza vjetore, bazuar në metodologjitë dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare. Kuadri ligjor për menaxhimin e borxhit të qeverisë qendrore është përfshirë në Kushtetutë, Ligjin për Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garancitë e Huave Shtetërore (2006) dhe Ligjin për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor (2016).

DOKUMENT PARLAMENTAR

Lidhur me prokurimin publik, është arritur progres në ndryshimin e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) për të përafruar më tej me *acquis* të BE-së, i miratuar në vitin 2014 dhe në miratimin akteve nënligjore. Ligji u ndryshua përsëri në vitin 2017, me qëllim funksionimin dhe forcimin e pavarësisë së Komisionit të Prokurimit Publik. Për sa i përket Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), masat ligjore dhe rregullatore janë ndërmarrë për të rritur pavarësinë e saj. KPP-ja e re u vu në zbatim në 16 korrik 2018. Nga data 27 tetor 2021, sistemi elektronik i menaxhimit të ankesave në fushën e prokurimit publik është krijuar dhe është zbatuar me sukses. Lidhur me menaxhimin e fondeve të jashtme, gjatë vitit 2015 është nxjerrë një udhëzim, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të fondeve të jashtme nga Ministri i Financave. Është vënë në zbatim një sistem për menaxhimin e fondeve të jashtme në qershor të vitit 2018 dhe është punuar për forcimin e pajtueshmërisë me futjen e të dhënave të kërkuara dhe përdorimin e tyre si burimin kryesor të informacionit për të gjitha fondet e donatorëve.

Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje e progresit të bërë mbi Treguesit e Performancës për OS4, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së 2019-2022.

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera faktike VF 2022
XI) Zbatimi efikas i buxhetit (me anë të përdorimit të TI-së)	XIa) Shuma totale e buxhetit që është ekzekutuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit të ekzekutuar nga qeveria qendrore.	**74% (2018)**	75%	78%	75.5%	76.80%
XII) Detyrimet e prapambetura minimizohen	XIIa) PEFA 22.1. Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal)	**nën 6% (B PEFA)**	A	4.40%	nën 3% (2.2%)	1.87%
	XIIb) PEFA 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve (në SIFQ)	**C (2017)**	C	A	A	A
XIII) Ulet kostoja e huasë dhe likuiditeti është I disponueshëm kur nevojitet	XIIa) Stoku i borxhit të brendshëm të risistemuar brenda një viti	**56.7%**	50.90%	46.7	48.0%	49.0%
	XIIb) Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm	**780 ditë**	787 ditë	783	793	780
XIV) Rritet eficenca dhe transparenca e sistemit të prokurimit	XIVa) % në vlerë për procedurat e përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve	**22% (2018)**	49.80%	47,4%	60.2%	25.19%
	XIVb) Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit	**54.7%**	16%	22.10%	10.8%	10.1%

Burimi: Ministria e Financave(2024), Raporti i Vjetor i Monitorimit të Strategjisë 2019 – 2022

Sipas raportit SIGMA 2024 treguesi i burimeve të mjaftueshme për të mbuluar zbatimin e buxhetit dhe ofrimin e shërbimeve në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme është vlerësuar me 60 pikë nga 100. Sipas këtij raporti, pavarësisht konsolidimit të Sistemit të Informacionit Financiar të Qeverisë (SIFQ), ka rreth 19 llogari për qëllime të ndryshme të cilat operojnë jashtë llogarisë së thesarit. Ky nëntregues është vlerësuar me 6/10 pikë. Sistemi i kontrollit të detyrimeve, i cili realizohet nëpërmjet SIFQ është konsoliduar, por, sipas raportit detyrimet e prapambetura, mbeten ende të larta. Për vitin 2023 detyrimet e prapambetura janë ulur me 67% në krahasim me vitin

2020, ose me 35% krahasuar me vitin 2022[455]. Detyrimet e prapambetura monitorohen nga njësia e riskut fiskal, por menaxhimi i tyre është në nivele të ulëta i vlerësuar me 0.3/10 sipas këtij raporti.

Në raportin e monitorimit SIGMA 2024, nëntreguesi i menaxhimit të borxhit dhe nëntreguesi i uljes së riskut të borxhit qeveritar janë vlerësuar me 7/10 pikë. Ky vlerësim tregon përpjekjet për uljen e borxhit dhe zbutjen e riskut të lidhur kryesisht me normat e interesit dhe kursin e këmbimit. Megjithatë, strategjia në vlerësimet e saj përfshin vetëm borxhin e qeverisë qendrore dhe jo atë të qeverisë lokale edhe pse ka një vlerë shumë të ulët (0,01% të PBB).[456]

Treguesi i cilësisë së kuadrit ligjor për prokurimin publik dhe PPP/koncesionet është vlerësuar me 91/100 pikë në raportin e monitorimit SIGMA 2024. Niveli i përafrimit të legjislacionit të prokurimeve publike me direktivat e Bashkimit Europian dhe parimet e traktatit të Bashkimit Europian është vlerësuar pothuajse me pikët maksimale, 33/35 pikë dhe 20/20 pikë. Vetëm përafrimi i legjislacionit të PPP/koncesioneve me direktivat dhe parimet e Bashkimit Europian është vlerësuar me 8/15 pikë, çka tregon për përmirësimet e vazhdueshme që duhen bërë në këtë drejtim.

Treguesi mbi mbështetjen, drejtimin dhe koordinimin në mënyrë efektive nga institucionet qendrore të zbatimit dhe monitorimit të sistemit të prokurimit publik është vlerësuar me 83/100 pikë sipas raportit të monitorimit SIGMA 2024. Nëntreguesi i zhvillimit dhe zbatimit me eficiencë dhe efektivitet të politikave të prokurimit publik nga institucionet qendrore është vlerësuar 22/22 pikë. Po kështu edhe nëntreguesi i zhvillimit dhe zbatimit me eficiencë dhe efektivitet të politikave të PPP/koncesioneve nga institucionet qendrore është vlerësuar 12/12 pikë. Sipas këtij raporti, edhe nëntreguesi i cilësisë së strategjisë dhe planit të veprimit për zhvillimin e prokurimeve publike dhe PPP/koncesioneve për vitin 2023 është vlerësuar me 21,8/23 pikë. Vlerësim të kënaqshëm ka pasur edhe nëntreguesi i cilësisë së monitorimit dhe raportimit të sistemit të prokurimeve publike 16/19 pikë. Raporti SIGMA 2024 vendos theksin në përfshirjen më të plotë të kriterit social dhe kriterit të respektimit të mjedisit në procedurat e prokurimeve publike, të cilët janë dy nën-tregues që kanë marrë vlerësimin më të ulët përkatësisht 6/12 pikë dhe 5/12 pikë.

Treguesi i efikasitetit, ekonomisë dhe konkurrueshmërisë së operacioneve të prokurimit publik është vlerësuar me 64/100 pikë. Nëntreguesit që kanë pasur vlerësimin më të lartë, sipas raportit të monitorimit SIGMA 2024, janë: niveli i procedurave konkurruese 5/5 pikë, përdorimi i *e-procurement* 6/7 pikë, planifikimi dhe përgatitja e procedurave të prokurimit 7,6/8 pikë, eficiencë e mënyrave dhe metodave moderne 10,9/15 pikë. Në vitin 2023, subjektet prokuruese kanë lidhur 767 marrëveshje[457] (740 në vitin 2022).

Pavarësisht përmirësimeve në drejtim të procedurave dhe sistemit të prokurimit, rezultatet nga Anketa e Përgjithshme e Bizneseve[458], të realizuara nga SIGMA për administratën publike, tregojnë se 42% e përfaqësuesve të bizneseve që u përgjigjën, refuzuan të merrnin pjesë në procedurat e prokurimit publik në tre vitet e fundit për shkak se procedura e prokurimit dukej se

[455]*SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 115,https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf,*
[456]*SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 116,https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf*
[457]*SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 131,https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf*
[458]Anketim i realizuar me telefon ne nje zgjedhje rastësore biznesesh në Shqipëri

DOKUMENT PARLAMENTAR

ishte e përshtatur për ofertues të caktuar. Kjo përqindje është më e lartë se mesatarja e rajonit (30%)[459]. Përgjigje të tjera të shpeshta ishin se procedura dukej shumë burokratike (19%) ose se marrëveshja dukej se ishte mbyllur përpara publikimit të tenderit (18%). Përgjigjet e tjera ishin se afati për dorëzimin e ofertave ishte i pamundur të përmbushej (13%) ose se kriteret e vlerësimit ishin të paqarta (9%). Vlerësimi për Nëntreguesin e përdorimit të kriterit për dhënien e kontratës është 2/8 pikë.

Sipas raportit të monitorimit SIGMA 2024, treguesi i disponueshmërisë dhe cilësisë së mbështetjes për autoritetet kontraktuese dhe aktorët e tjerë për të forcuar profesionalizimin e operacioneve të prokurimit publik është vlerësuar 75/100 pikë. Nëntreguesi i disponueshmërisë së këshillimit dhe mbështetjes operacionale është vlerësuar me 32,4/36 pikë. Përpjekje janë bërë edhe në rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimeve për prokurimin publik dhe për subjektet prokuruese. Nëpërmjet bashkëpunimit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), i cili është institucioni kryesor përgjegjës për bashkërendimin dhe monitorimin e zbatimit të programeve të trajnimi kushtuar administratës publike, në vitin 2023 janë organizuar disa kurse trajnimi për prokurimin sipas nivelit të njohurive (bazë, të mesme dhe të avancuara)[460]. Gjithashtu, APP ka bashkëpunuar me Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), e cila ka ndihmuar në përgatitjen dhe finalizimin e një udhërrëfyesi për profesionalizimin e funksionit të prokurimit. Ky bashkëpunim ka për qëllim zhvillimin e një program trajnimi gjithëpërfshirës dhe të certifikuar që synon profesionalizimin e funksionit të prokurimit publik në Shqipëri, në përputhje me praktikat më të mirat ndërkombëtare. Nëntreguesi i disponueshmërisë së trajnimeve cilësore për punonjësit e prokurimeve publike dhe aktorët e tjerë është vlerësuar me 18,4/28 pikë.

Situata e koncesioneve dhe kontratave të Partneritetit Publik-Privat (PPP) paraqitet më pak e favorshme. Sipas raportit të monitorimit SIGMA 2024 nëntreguesi i disponueshmërisë së këshillimit dhe mbështetjes operacionale për koncesionet/PPP është vlerësuar me 6/12 pikë. Nuk ofrohet një mbështetje po aq efikase në fushën e koncesioneve/PPP. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) publikon udhëzime për autoritetet kontraktore në lidhje me koncesionet/PPP-të, por nuk ofrohen mundësi për t'u përgjigjur në mënyrë të shpejtë pyetjeve në lidhje me zbatimin praktik të rregullave të PPP-ve/koncesioneve për autoritetet kontraktore. Në mënyrë të ngjashme, ka mungesë të zgjidhjeve të përditësuara rregullisht në platformën *online* për problemet e zakonshme praktike me të cilat përballen aplikuesit.

Në raportin e monitorimit SIGMA 2024 identifikohet se përmirësime janë bërë edhe në drejtim të rritjes së aksesit të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në informacionin në çdo fazë të procesit të prokurimit publik duke përfshirë planifikimin dhe performancën e kontratave. Të gjitha informacionet relevante për prokurimin publik, procedurat, duke filluar me planifikimin dhe duke vazhduar me njoftimet e kontratave, shpalljen e kontratave fituese dhe duke përfunduar me njoftimet e nënshkrimeve të kontratave, publikohen në faqen e APP-së ku mund të aksesohen nga çdo palë e interesuar. Në raport theksohet se APP, gjithashtu, merr parasysh komentet e bëra nga shoqëria civile. Nëntreguesi i rolit të shoqërisë civile është vlerësuar me 9/12 pikë.

DOKUMENT PARLAMENTAR

[459] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 131,https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf*

[460] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 133,https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf*

Një sistem i pavarur i rishikimit të prokurimit siguron efektivitet, shpejtësi dhe kompetencë në trajtimin e ankesave. Krijimi i kësaj strukture të pavarur (KPP) që merret me trajtimin e ankesave në drejtim të prokurimeve, në përputhje me direktivat e BE, ka rritur ndjeshëm transparencën në procesin e rishikimit. Treguesi i pavarësisë, efikasitetit dhe kompetencës në procesin e rishikimit është vlerësuar me 91/100 pikë në raportin e monitorimit SIGMA 2024. Pjesa më e madhe e nën – treguesve për vitin 2023 kanë vlerësim maksimal ku mund të përmendim, mekanizmat dhe procedurat kundrejt vendimeve të prokurimit 13/13 pikë, pavarësia dhe përgjegjësia e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) dhe anëtarëve të saj 13/13 pikë, efektiviteti në trajtimin e ankesave dhe mekanizmat për të zbatuar vendimet e tij 9/9 pikë, ndërsa cilësia e vendimmarrjes së KKP 11/11 pikë.

Gjatë vitit 2023, numri i ankesave të dorëzuara në KPP arriti në 866, dukshëm më shumë se në vitet e mëparshme (794 në vitin 2022, 768 në vitin 2021 dhe 741 në vitin 2020), por më pak se gjatë pikut të vitit 2019, kur KPP mori 1052 ankesa[461]. Në vitin 2023, si në periudhat e mëparshme, janë paraqitur më së shumti ankesa të autoriteteve kontraktore në lidhje me vlerësimin e ofertave. Në vitin 2023, KPP pranoi plotësisht 54,8% të ankesave dhe refuzoi 27,6%. Rastet e mbetura u mbyllën[462] si rezultat i vendimeve të autoriteteve kontraktore (11%), tërheqja nga ankuesit (5,2%) ose mosmarrja në konsideratë (1,4%). Pavarësisht numrit në rritje të ankesave të paraqitura, pjesa e vendimeve të miratuara nga KPP dhe apeluar në gjykatë është ulur nga 10% në vitin 2020, në 4.4% në vitin 2023[463]. Të gjitha vendimet e miratuara nga KPP-ja publikohen të plota në faqen e saj, me arsyetim, menjëherë pas miratimit të tyre.

5.2.5 Progresi për objektivin specifik 5 "Transparenca e financave publike"

Në lidhje me sigurimin e një raportimi transparent nga ana e qeverisë u nënshkrua në vitin 2016 Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet MF-së, Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe BSH-së. Gjatë vitit 2017, për herë të parë, INSTAT përpiloi dhe transmetoi GFS për llogaritë jofinanciare për sektorin e qeverisjes së përgjithshme pas ESA 2010. Sipas Anketës së Buxhetit të Hapur të vitit 2017, që nga viti 2015 Shqipëria ka rritur (a) disponueshmërinë e informacionit buxhetor, të dhënë në Raportin e Auditimit dhe Pasqyrën e Para-Buxhetit, dhe (b) numrin e raporteve të publikuara të ekzekutimit të buxhetit. Gjithashtu, procedurat për zbatimin e buxhetit të "gjatë vitit" janë përmirësuar dhe për herë të parë në faqen e internetit të MF-së. Në vitin 2017 u publikuan raporti i mesit të vitit i performancës makroekonomike, fiskale dhe buxhetore të qeverisë. Aplikacioni *Boost* është i disponueshëm në faqen e internetit të MF-së, që prej prillit të vitit 2018. Duke filluar nga viti 2015, Ligji Vjetor i Buxhetit 2016 u formulua në një mënyrë më transparente dhe gjithëpërfshirëse dhe u publikua "Buxheti me një Vështrim" dhe një version i thjeshtuar i "Buxheti i Qytetarëve".
Duke filluar nga viti 2019 është zhvilluar dhe publikuar çdo vit një udhëzues për buxhetin qytetar. Në lidhje me kontabilitetin, u krye një analizë hendeku, e cila krahasonte kuadrin aktual rregullator të kontabilitetit me SNKSP-të, gjetjet e kësaj analize u prezantuan në seminarin e zhvilluar në maj të vitit 2017. Bazuar në analizën e hendekut, qeveria miratoi një Plan Veprimi Strategjik për vendin për kalimin në SNKSP në muajin tetor 2019. Gjithashtu, u krijua një funksion specifik brenda

[461] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 136, https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf*
[462] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 136, https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf*
[463] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 136,https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf*

Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit, Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPHKBFP)-së, dedikuar kontabilitetit, përgjegjës për përditësimin e metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik si edhe të akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin privat. Gjatë vitit 2021 janë kryer disa aktivitete si analiza e mangësive të standardeve kombëtare të kontabilitetit në krahasim me SNKSP dhe një raport që vlerëson ndikimin sasior për zbatimin e secilit SNKSP. Gjithashtu, janë dhënë disa draft udhëzime kontabël lidhur me elemente të ndryshme të pasqyrave financiare, që do të përdoren në përgatitjen e pasqyrave financiare bazuar në SNKSP. Gjatë vitit 2023 është hartuar koncepti i projektit për zbatimin e metodologjisë së re të kontabilitetit në sektorin publik, i diskutuar me Bankën Botërore dhe SECO.
Gjatë viteve 2015-2023 janë bërë përmirësime dhe ndryshime në ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe janë miratuar disa akte nënligjore në mbështetje të legjislacionit parësor. Për të pasur një sistem të fortë të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në vitin 2020 u miratuan tre dokumente të rëndësishme, konkretisht: (1) dokumenti i politikave për zhvillimin e mëtejshëm të KBFP-së në Shqipëri për periudhën 2021–2022, (2) udhëzim për delegimin e detyrave dhe (3) metodologjia për rishikimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm. DHMFKK ka zhvilluar disa aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin e zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve mbi rëndësinë e zbatimit të suksesshëm të MFK-së. Është ofruar asistencë teknike dhe është kryer vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në ato njësi publike të përzgjedhura. Janë zhvilluar aktivitete monitorimi në terren të funksionimit të sistemit të MFK-së në disa institucione buxhetore, si dhe disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve, përfshirë trajnime, këshillime dhe vizita studimore.

Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje e progresit të bërë mbi Treguesit e Performancës për OS5 sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së 2019-2022.

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera faktike VF 2022
XV) Fuqizim i sistemeve dhe kapaciteteve për të përgatitur statistikat financiare të qeverisë sipas standardeve ndërkombëtare	XVa) Përgatitja e llogarive kombëtare të qeverisë sipas metodologjisë ndërkombëtare SELL 2010)	**50% (2018)**	**75%**	**75%**	**75.0%**	**89.5%**
XVI) Llogaridhënia dhe transparenca me anë të raportimit të performancës financiare dhe jo-financiare është rritur	XVIa) Raportet e publikuara financiare vjetore dhe ato gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën finan-ciare dhe jofinanciare, përfshire TKP-të	**Janë përgatitur formate të reja pë RZVB & te gjatë vitit**	**Janë implementuar formate të reja**		**25.6%**	**38.5%**
XVII) Ofrohen mundësi formale për pjesëmarrjen e publikut ne procesin e buxhetit	XVIIa) Vlerësimi nga Indeksi për Buxhetin e Hapur (Pjesëmarrja e Publikut)	**2 out 100 (2017)**	**7/100**	**7 nga 100**	**7 nga 100**	**6 nga 100**
XVIII) 'Prezantimi i pasqyrave financiare sipas kuadrit të përzgjedhur SNKSP"	XVIIIa) Kalimi në fazën ku pasqyrat financiare të qeverisë do të paraqesin kontabilitetin në bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara.	**0%**	**0%**	**0%**	**10.0%**	**40.0%**
XIX) Përgatitja e regjistrit të plotë të aktiveve të sektorit Publik bazuar në rregulloret e përmirësuara për vlerësimin dhe inventarin e këtyre aktiveve	XIXa) Asetet publike të regjistruara në SIFQ	**6 (2018)**	**6**	**3**	**0**	**2**

Burimi: Ministria e Financave (2024), Raporti i Vjetor i Monitorimit të Strategjisë 2019 – 2022

PARLAMENTAR

Sipas raportit të monitorimit SIGMA 2024, treguesi për zbatimin e buxhetit në përputhje me vlerësimet dhe raportimin e tij në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente, duke lejuar shqyrtimin në kohë, është vlerësuar me 70/100 pikë për vitin 2023. Nëntreguesi i zbatimit të buxhetit në përputhje me ndarjet buxhetore është vlerësuar me 15,1/20 pikë. Nëntreguesi i përmbajtjes së raporteve vjetore financiare të qeverisë është vlerësuar me 6/8 pikë dhe nëntreguesi i transparencës dhe cilësisë së raporteve financiare të qeverisë është vlerësuar me 11/14 pikë.

5.2.6 Progresi për objektivin specifik 6 "Kontroll i brendshëm efektiv"

Lidhur me auditimin e brendshëm, është miratuar ligji "Për auditimin e brendshëm (AB)", si edhe aktet nënligjore. Gjatë vitit 2021, ligji "Për auditimin e brendshëm (AB)" është rishikuar dhe drafti i parë është finalizuar, si dhe janë përditësuar tre udhëzime të AB. Ndërsa gjatë vitit 2023, ndryshimet u miratuan me ligjin nr. 12, datë 2.02.2023 "Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik""[464]. Gjatë viteve 2015-2023, në vijim të përmirësimeve dhe ndryshimeve të bëra në ligjin "Për auditimin e brendshëm", u miratuan disa akte nënligjore në mbështetje të legjislacionit parësor. Janë zhvilluar aktivitete monitorimi në terren të funksionimit të AB në disa institucione buxhetore, si dhe disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve, duke përfshirë trajnime dhe këshillime. Lidhur me inspektimin financiar publik, vlerësimi i nevojave për trajnim për inspektorët financiarë të brendshëm dhe të jashtëm është kryer në tremujorin e parë të çdo viti dhe janë organizuar trajnime sipas kërkesës. Raportet vjetore përgatiten çdo vit, shpërndahen dhe publikohen në faqen zyrtare të MF-së, duke përfshirë gjetjet mbi inspektimet financiare publike. Nënshkrimi i 17 marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme ndihmoi në forcimin e funksionimit të rrjetit të Shërbimit të Koordinimit Kundër Mashtrimit (SHKKM) ndër vite.

Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje e progresit të bërë mbi Treguesit e Performancës për OS6 sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së 2019-2022.

DOKUMENT PROJEKT

[464]Ligj nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" (ndryshuar me ligjin nr. 12/2023, datë2.2.2023) https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/10/22/114/e12b9d0d-a63d-4efd-be99-d1485ecc667e;q=Ligji%20nr.114%2F2015

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera faktike VF 2022
XX) Llogaridhënie efektive menaxhierale në të gjithë institucionet publike	XXa) Niveli i zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në praktikë brenda institucioneve buxhetore	**2.71 nga 4 (Urdhër i Ministrit të Financave nr. 117, datë 01.04.2019 Metodologjia e Monitorimit të Performancës)**	**2.4**	**2.56**	**2.61**	**2.84**
	XXb) Mekanizmat për llogaridhënien menaxheriale në kuadrin rregullator	**2.7 nga 4 (Urdhër i Ministrit të Financave nr. 117, datë 01.04.2019 Metodologjia e Monitorimit të Performancës)**	**2.5**	**2.90**	**2.95**	**2.91**
XXI) Forcimi i funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik	XXIa) % e rekomandimeve të zbatuara të auditimit të brendshëm	**57% (2018)**	**60%**	**65%**	**62%**	**56%**
	XXIb) Kuadri për auditimin e brendshëm është harmonizuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm	**Kuadri i auditimit të brendshëm nuk është plotësisht në përputhje me SNAB**	**Rishikimi i Manualit të AB**	**Është kryer analiza e hendeqeve**	**a) Është përgatitur versioni i parë i draft ligjit të rishikuar për AB b) Janë përditësuar 3 udhëzime për AB**	**Ligji nr. 12/2023 "Për disa amendime dhe ndryshime në ligjin e AB" miratuar dhe hyrë në fuqi.**
	XXIc) % e rekomandimeve bazuar në sistem që janë adresuar kundrejt numrit total të gjetjeve që janë adresuar	**35% (2018)**	**37%**	**42%**	**67%**	**76%**
XXII) Inspektim financiar publik efikas	XXIIa) % e rekomandimeve të zbatuara të inspektimit financiar (të nxjerra me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë)	**VF18 70%**	**83.30%**	**85%**	**88%**	**90%**

Burimi: Ministria e Financave (2024), Raporti Vjetor i Monitorimit të Strategjisë 2019 – 2022

Sipas raportit të monitorimit SIGMA 2024, treguesi i përshtatshmërisë së kuadrit operativ të kontrollit të brendshëm dhe funksionimit të tij në praktikë është vlerësuar me 64/100 pikë. Kuadri rregullator për kontrollin e brendshëm në sektorin publik është i plotë dhe aplikohet për të gjithë njësitë qeveritare[465]. Disa elementë të kontrollit të brendshëm të tilla, si praktikat e menaxhimit të rrezikut, kanë treguar përmirësime thelbësore në vitet e fundit, ku mund të përmendim nëntreguesin e rregullsisë dhe plotësimit të praktikave të menaxhimit të riskut, i cili është vlerësuar me 15/15 pikë në këtë raport. Nëntreguesi i kuadrit rregullator dhe politikave për kontrollin e brendshëm është vlerësuar me 6/10 pikë. Koordinimi i kontrollit të brendshëm është vlerësuar me 7/10 pikë. Rol të rëndësishëm luan Njësia Qendrore e Harmonizimit (NJQH) të MF-së. Në përputhje me ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK)"[466], nëpunësit e autorizuar të njësive të qeverisjes qendrore duhet të përgatisin një deklaratë për cilësinë dhe funksionimin e sistemeve të tyre të kontrollit të brendshëm dhe të kryejnë një vetëvlerësim të proceseve të kontrollit të menaxhimit financiar. Pavarësisht kuadrit të fortë rregullator, në vitin 2023 u identifikua një hendek i rëndësishëm në strategjitë mbështetëse për kontrollin e brendshëm për

[465] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 120* https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

[466] Ligji nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK)", miratuar në 8 korrik 2010 dhe amenduar nga ligji nr. 110/2015 dhe ligji nr. 14/2023.

shkak të periudhës tranzitore nga përfundimi i strategjisë në vitin 2022, deri në miratimin e strategjisë pasardhëse në 2024.

Sipas raportit SIGMA 2024, Nëntreguesi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit në vend është vlerësuar me 9,9/15 pikë. Nëntreguesi i llogaridhënies menaxheriale është vlerësuar me 10,7/15 pikë. Përgjegjësia menaxheriale brenda njësive të sektorit publik tregon hapësirë për përmirësim. Ndërsa legjislacioni lejon delegimin e vendimmarrjes nga menaxherët e lartë në nivele më të ulëta, praktika aktuale e delegimit nuk është ende e mirë përcaktuar. Vendimmarrja mbi prokurimet apo rekrutimet nuk është e deleguar, po kështu edhe vendimmarrje të tjera administrative në lidhje me miratimin e lejeve për të lëvizur, etj. Pra, vendimmarrja nuk delegohet në nivele më të ulëta drejtimi, por identifikohet në raportin e monitorimit SIGMA 2024.

Nëntreguesi i llogaridhënies institucionale ka një vlerësim të ulët 5,1/12 pikë sipas raportit SIGMA 2024. Në performancën e këtij treguesi ndikon numri i konsiderueshëm i njësive buxhetore të nivelit të parë. Sipas ligjit organik të buxhetit, ministritë e linjës janë përgjegjëse për koordinimin e përgatitjes së buxhetit brenda sektorëve të tyre. Por numri i njësive buxhetore të nivelit të parë që nuk janë ministri ose organe kushtetuese e limitojnë rolin koordinues të ministrive. Shqipëria ka 59 njësi buxhetore të nivelit të parë, shifër e cila është poshtë mesatares së institucioneve të Ballkanit Perëndimor, e cila është 63 njësi buxhetore, por shumë më e lartë se mesatarja e institucioneve të Bashkimit Europian, e cila është 18. Numri i ministrive të linjës është 12, e përafërt me mesataren e BE, e cila është 13, kurse numri i organeve kushtetuese është 19, afërsisht 4 herë më e lartë se mesatarja e BE e cila është 5. Numri i institucioneve të tjera buxhetore të nivelit të parë është 28[467]. Planet vjetore dhe raportet e aktiviteteve të këtyre institucioneve vartëse shpesh përmbajnë objektiva specifikë dhe objektiva të matshëm në nivel produkti, por jo në mënyrë të vazhdueshme në nivelin e rezultateve. Këto plane dhe raporte të aktiviteteve nuk i dorëzohen gjithmonë ministrive dhe dëshmitë e dialogut të performancës ndërmjet ministrive dhe organeve të tyre vartëse nuk ofrohen gjithmonë.

"Praktikat e menaxhimit të parregullsive dhe mashtrimit kanë nevojë për përmirësim, pasi risqet e mashtrimit nuk vlerësohen në përgjithësi dhe raportimi i parregullsive nuk është një praktikë e zakonshme", theksohet në raportin e monitorimit SIGMA 2024. Sipas këtij raporti, ky tregues ka marrë vlerësimin më të ulët në këtë kategori 2.9/13 pikë.

Kuadri rregullator për auditimin e brendshëm në sektorin publik përcaktohet nga ligji i auditimit të brendshëm[468] (AB). Ky legjislacion specifikon pavarësinë funksionale të auditimit të brendshëm dhe përcakton kompetencat dhe detyrat e audituesve të brendshëm. Ai, gjithashtu, përcakton kërkesat minimale organizative dhe madhësinë e njësive të auditimit të brendshëm, duke lejuar rregullime bazuar në llojin dhe madhësinë e institucionit. Në këtë kontekst, nëntreguesi i përshtatshmërisë së kuadrit rregullator të kontrollit te brendshëm është vlerësuar me 10/10 pikë në raportin e monitorimit SIGMA 2024. Gjithashtu, vlerësim 10/10 pikë ka marrë edhe nëntreguesi i kapacitetit organizativ të kontrollit të brendshëm dhe nëntreguesi i konsistencës së planifikimit të auditimit të brendshëm në institucionet buxhetore.

[467]*SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg* 122 https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

[468]Ligji nr 114/2015 "Për kontrollin e brendshëm të sektorit publik", miratuar më 22 Tetor 2015 dhe amenduar nga ligji nr. 12/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 114/2015", miratuar në 2 Shkurt 2023

Raportimi i auditimit të brendshëm është në nivel të kënaqshëm. Në raportin e monitorimit SIGMA 2024 ky tregues është vlerësuar më 9,8/10 pikë. Në anketimin e SIGMA-s me nëpunësit publikë rezulton se draft-raportet e auditimit diskutohen me të audituarit, ku 88% e menaxherëve e konfirmojnë këtë praktikë. Përveç kësaj, 85% e menaxherëve të lartë dhe të mesëm i perceptojnë rekomandimet e auditimit të brendshëm si të dobishme, duke treguar një ndikim të mundshëm pozitiv në menaxhimin e sektorit publik[469]. Shkalla e pranimit të rekomandimeve të AB nga të audituarit ishte 99% në vitin 2023. Megjithatë, shkalla e raportuar e zbatimit të rekomandimeve të pranuara është mjaft e ulët në 60%. Kjo del tek vlerësimi 8,1/15 pikë i Nëntreguesit ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit.

Pavarësia dhe objektiviteti i auditimit të brendshëm në sektorin publik vlerësohen pozitivisht, me disa pika të forta të theksuara. Sipas rezultateve të Anketës SIGMA[470] të nëpunësve publikë për administratën publike në Ballkanin Perëndimor 2024, është raportuar nga drejtuesit e auditimit të brendshëm se 96% e raporteve të auditimit i drejtohen kreut të organizatës.

Të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm, që mbulojnë qeverinë qendrore, entet e tjera të sektorit publik dhe vetëqeverisjen vendore, përgatisin dhe përditësojnë rregullisht planet strategjike dhe vjetore të auditimit. Këto plane përputhen me kërkesat ligjore kombëtare dhe standardet ndërkombëtare, duke mbuluar të gjitha departamentet, proceset dhe buxhetin e plotë të organizatës. Megjithatë, ka disa pika kritike për t'u marrë parasysh. Teksa planet në përgjithësi janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, shpesh atyre u mungojnë njohuri të detajuara, si, për shembull, në mënyrën sesi analiza e riskut përdoret për të përcaktuar prioritetet, pasi ky informacion zakonisht nuk jepet si aneks ose si dokument i veçantë.

5.2.7 Progresi për objektivin specifik 7 "Mbikëqyrja e jashtme efektive e financave publike"

Gjatë zbatimit të strategjisë së MFP-së 2019-2022, në vitin 2020 vlen të theksohet krijimi i një grup pune për të punuar për ndryshimet e ligjit, ku gjatë vitit 2022, grupi i punës shqyrtoi ndryshimet ligjore përkatëse të propozuara në vitin 2018. Manualet për auditimin e përputhshmërisë, financiar, të performancës dhe TI-së janë rishikuar dhe ndryshuar gjatë vitit 2020 dhe 2021. Manuali i Auditimit të Performancës u ndryshua në vitin 2021, si dhe Manualet e Auditimit Financiar, të Performancës dhe Përputhshmërisë u përditësuan në vitin 2022. Në vitin 2019 u miratua një metodologji e re për planifikimin e aktivitetit të auditimit bazuar në risk dhe gjithashtu u përgatit një manual për Sigurimin e Cilësisë që plotëson standardet SNISA 40. Plani vjetor i auditimit përgatitet çdo vit bazuar në këtë metodologji. Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i stafit të auditimit ishte një nga objektivat strategjikë të KLSH-së dhe çdo audites ka marrë mesatarisht 25-28 ditë trajnim gjatë periudhës 2019–2022. Komunikimi dhe angazhimi me Parlamentin, qeverinë, medien dhe qytetarët është rritur në zbatim të Strategjisë së re të Komunikimit 2022-2025, si edhe është miratuar Strategjia e Zhvillimit për 2023-2027. Megjithatë, niveli i arritjes së objektivave të treguesve të performancës së rezultateve që synojnë forcimin e funksionit të mbikëqyrjes së jashtme duke e sjellë atë në përputhje me standardet e Organizatës

[469] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 124*, https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf
[470] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 124*, https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

DOKUMENT PARLAMENTAR

Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA) është 117% në vitin 2022, duke treguar një përkeqësim të lehtë në krahasim me vitin 2021 (120 %).

Në tabelën e mëposhtme jepet një paraqitje e progresit të bërë mbi Treguesit e Performancës për OS7 sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së MFP-së 2019-2022.

Rezultati	Treguesi i Performancës	Vlera bazë	Vlera faktike VF 2019	Vlera faktike VF 2020	Vlera faktike VF 2021	Vlera faktike VF 2022
XXIII) Përmirësimi i mëtejshëm i auditimit të jashtëm për të rritur sa më shumë vlerat dhe përfitimin e tij në shoqëri	*XXIIIa) % e rekomandimeve të pranuara dhe të zbatuara të auditimit nga subjektet a audituara	**N pr 2017 = 93% N zb 2017 = 50,5 %**	**N pr 2018= 95% N zb 2018= 52.2 %**	**N pr:94% N zb:47%**	**N pr: 93% N zb: 55%**	**N pr: 97% N zb: 50%**
	XXIIIb) Pesha e auditimeve finaniare (auditim financiar i pastër + auditim i kombinuar) dhe auditim performance	**Auditim Financiar (9%) Auditim Performance (10%) (2017)**	**42% auditim përputhshmëri e**	**AF: 7% AP: 12,5%**	**AF: 36,7% AP: 11,5%**	**AF: 54% AP: 9%**

Burimi: Ministria e Financave (2024), Raporti i Vjetor i Monitorimit të Strategjisë 2019 – 2022

Për vitin 2023, treguesi i përshtatshmërisë së kuadrit ligjor të kontrollit të jashtëm dhe funksionimit të tij në praktikë është vlerësuar me 79/100 pikë në raportin e monitorimit SIGMA 2024. Legjislacioni siguron pavarësinë e KLSH-së dhe mandati i tij është i gjerë, duke mbuluar të gjitha fondet publike dhe kryerjen e auditimeve financiare, të përputhshmërisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ky nëntregues është vlerësuar me 10/10 pikë në raport për vitin 2023. Kurse treguesi i pavarësisë ligjore, organizative dhe menaxheriale të KLSH-së është vlerësuar me 17,9/20 pikë. Sipas rezultateve të Anketës SIGMA[471] të nëpunësve publikë për administratën publike në Ballkanin Perëndimor 2024, perceptimi i pavarësisë së KLSH-së është 80% në vitin 2024. Kjo shifër është më e lartë se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor që është 69%.

Nëntreguesi i rekomandimeve të pranuara është vlerësuar 9/10 pikë në këtë raport, ndërsa nëntreguesi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të auditit ka një vlerësim të ulët 7,8/15 pikë. I matur në përqindje ky vlerësim është 52%, vetëm 2 pikë përqindje më i lartë se në vitin 2022.

KLSH-ja është e autorizuar të kryejë auditime financiare, të përputhshmërisë, performancës dhe teknologjisë së informacionit. Plani vjetor i auditimit të KLSH-së përcakton auditimet e detyrueshme dhe auditime të tjera të zgjedhura në bazë të riskut[472]. Gjatë tre viteve 2021 – 2023, KLSH ka kryer nga 118 deri në 140 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë në vit. Ndërsa mbetet e paqartë se çfarë përfaqëson ky numër në terma të mbulimin të buxhetit të përgjithshëm të shtetit, më shumë auditime janë duke u kryer në krahasim me vlerësimet e mëparshme. Për vitin 2023 KLSH ka përfunduar 17 auditime të performancës, të cilat mbulojnë aspekte të sektorëve

[471] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 138*https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

[472] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 139,*https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf

kryesorë si zhvillimi ekonomik, arsimi, mjedisi, drejtësia dhe rendi, shëndetësia, administrata publike, infrastruktura dhe sigurimet shoqërore.

Ndonëse KLSH vazhdon të zhvillojë kapacitetet e veta të auditimit të performancës dhe menaxhimit të cilësisë, përdorimi i kufizuar i raporteve të tyre nga Parlamenti ndikon në kufizimin e rolit të tij. Ky nëntregues për vitin 2023 është vlerësuar me 2/10. Për të forcuar bashkëpunimin midis KLSH-së dhe Parlamentit është krijuar një Nënkomision për auditimin në sektorin publik, i cili do të ketë një funksion më direkt sesa Komisioni i Ekonomisë dhe Financave. Nënkomisioni do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e raporteve të auditimit të KLSH-së, organizimin e seancave dëgjimore dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

5.3 Gjetjet dhe problematikat

Sipas raportit të Bankës Botërore 2021[473], "Forcimi i Qëndrueshmërisë së Modelit të Rritjes në Shqipëri", është identifikuar se kompleksiteti dhe natyra e decentralizuar e kontabilitetit aktual, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, kanë penguar zbatimin e tij në Shqipëri. Megjithatë, miratimi i raportimit të kontabilitetit aktual do t'u sigurojë autoriteteve të dhëna financiare gjithëpërfshirëse dhe të sakta. Sipas këtij raporti, qeveria duhet të adresojë arsyet e nivelit të ulët të përputhshmërisë në institucionet buxhetore që kanë akses të drejtpërdrejtë në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) dhe po e përdorin atë për të menaxhuar dhe monitoruar ekzekutimin e buxhetit dhe detyrimet e prapambetura.

Përgjegjshmëria menaxheriale në Shqipëri është e kufizuar për shkak të autoritetit të centralizuar dhe mungesës së llogaridhënies vertikale me njësitë vartëse, duke penguar ofrimin efektiv të shërbimeve dhe monitorimin e performancës në të gjithë sektorët. Ndërkohë, Shqipëria duhet të forcojë kapacitetin e saj të auditimit të jashtëm për të ndërtuar një mekanizëm të fuqishëm të llogaridhënies financiare publike. Kontrolli i Lartë i Shtetit fokusohet në përafrimin e auditimeve me standardet ndërkombëtare dhe përmirësimin e komunikimit me palët e interesuara për të siguruar ndjekjen e rekomandimeve, në vend të kryerjes së auditimeve të rregullta financiare. Gjithashtu, është gjetur se taksat mbi pronën dhe mjedisin janë burime efikase të të ardhurave publike, të cilat janë të pashfrytëzuara në Shqipëri. Ndërkohë që të dyja janë të dizajnuara në parimet e duhura, normat e tyre tatimore janë shumë të ulëta dhe gama e gjerë e përjashtimeve i mban të ardhurat nën mesataren e vendeve homologe. Për më tepër, ka sfida në lidhje me zhvillimin e kadastrës gjithëpërfshirëse, e cila do të regjistronte, lidhte dhe përditësonte informacionin për pronat dhe tatimpaguesit, si dhe kapacitetin e bashkive për të administruar tatimin në pronë në mënyrë të decentralizuar. Rritja e normës së tatimit në pronë, pasi të jetë zhvilluar plotësisht kadastra fiskale, mund të sjellë një të ardhur shtesë prej 0,3–0,5% të PBB-së.

Në raportin e Komisionit Europian 2022[474] për Shqipërinë janë identifikuar disa fusha që kanë nevojë për përmirësim. Lidhur me zhvillimin e politikave dhe qeverisjen e integruar strategjike, për të arritur konsistencë në praktikat e raportimit, është thelbësore të zbatohet plotësisht Sistemi

[473]Banka Botërore (2021). Forcimi i Qëndrueshmërisë së Modelit të Rritjes në Shqipëri. https://documents1.worldbank.org/curated/en/099845001312232607/pdf/P1752090e8141b05a08afc06ea6bc385da3.pdf

[474]Progresraporti i BE-së për Shqipërinë (2022). https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

Informatik i Planifikimit të Integruar. Gjithashtu, është e nevojshme të ndërmerren hapa për të garantuar që të gjitha strategjitë kombëtare, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, të përfshijnë konsideratat gjinore dhe të shpërndajnë buxhetet në një mënyrë të ndjeshme gjinore. Lidhur me fushën e menaxhimit të financave publike, një nga rekomandimet e raportit të mësipërm lidhet me transparencën buxhetore. Transparenca buxhetore mbetet përgjithësisht e kënaqshme me publikimin e të gjitha dokumenteve kryesore buxhetore, megjithatë nevojitet ende përmirësim i mëtejshëm në cilësinë dhe formatin e dokumenteve, duke përfshirë publikimin e raporteve të auditimit online në kohën e duhur. Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, kërkohen përpjekje të forta për zbatimin e reformave të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) përtej Ministrisë, krahas monitorimit të rekomandimeve nga raporti vjetor i KBFP-së nëpër institucionet buxhetore. Agjencitë në varësi dhe njësitë e qeverisjes vendore janë më të dobëtat sa u përket sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe kontrolli i brendshëm duhet të përmirësohet nëpërmjet një bashkëpunimi të zgjeruar ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit, Parlamentit dhe Ministrisë së Financave, duke avancuar me menaxhimin e riskut në proceset financiare dhe operacionale, si dhe duke siguruar delegim efektiv të përgjegjësive për të forcuar llogaridhënien e përgjithshme. Gjetjet e këtij raporti në fushën e auditimit të brendshëm cilësojnë se funksioni i auditimit të brendshëm ende nuk ka dhënë opinione mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë buxhetore, si dhe procedurat e kontrollit të cilësisë për auditimet e brendshme duhet të vazhdojnë të përputhen me standardet dhe të zbatohen plotësisht. Në fushën e inspektimit financiar publik kërkohen përpjekje shtesë për të krijuar një rekord të fortë në raportimin e parregullsive dhe për të rritur bashkëpunimin me autoritetet e zbatimit të ligjit gjatë hetimeve.
Lidhur me auditimin e jashtëm rekomandohet që cilësia e punës së auditimit duhet të rritet për të përmbushur plotësisht standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Gjithashtu, nevojiten ndryshime ligjore për të zgjeruar mandatin e auditimit për të përfshirë të gjitha njësitë publike.

Lidhur me fushën e Menaxhimit të Investimeve Publike, sipas raportit të Komisionit Evropian, *Albania 2023 Report*[475], problemet në menaxhimin e investimeve publike vazhdojnë pavarësisht nismave të reja që synojnë përmirësim. Që nga viti 2017, shpenzimet për investime publike janë rritur ndjeshëm për shkak të rindërtimit pas tërmetit, por shpesh arrijnë kulmin në fund të vitit financiar, duke çuar në rritje të detyrimeve të prapambetura. Reformat e nisura në fund të vitit 2022 synojnë të harmonizojnë dhe përmirësojnë procedurat e vlerësimit për lloje të ndryshme të projekteve të investimeve publike dhe kanë rezultuar deri tani në ngritjen e një Liste Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, e cila gjithashtu forcon prioritetet e projekteve në përputhje me hapësirën fiskale dhe mund të kontribuojë në reduktimin e detyrimeve të prapambetura. Një ndryshim në legjislacionin PPP është ende i nevojshëm për integrimin e PPP-ve në këto procedura të reja.

Sipas raportit të vlerësimit të SIGMA 2021[476] "Mbi parimet e administratës publike", është gjetur se ende nuk është krijuar një mekanizëm i qëndrueshëm për të monitoruar dhe zbatuar rregullat fiskale, si dhe plani për ngritjen e një këshilli fiskal është ende një punë në progres. Gjithashtu, rekomandohet finalizimi i zhvillimit të sistemit të planifikimit të integruar dhe rishikimi i

[475]Progresraporti i BE-së për Shqipërinë (2023). https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en
[476]Vlerësimi SIGMA (2021), 'Parimet e Administratës Publike' https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf

strukturës së fragmentuar të planifikimit të politikave afatmesme. Kjo do të përfshinte hartimin e një kuadri të ri legjislativ për planifikimin dhe vazhdimin e përpjekjeve për të futur sistemin Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar (SIPI). Lidhur me programin buxhetor afatmesëm është gjetur së tavanet agregate të miratuara në PBA janë kryesisht të qëndrueshme, por tavanet e sektorit reflektojnë devijime të konsiderueshme për ministri të ndryshme. Kjo sjell pasiguri dhe paqëndrueshmëri në procesin buxhetor. Për më tepër, rekomandohet zhvillimi më tej i buxhetit afatmesëm si një dokument strategjik, i cili kërkon të respektohen tavanet treguese në nivel sektori apo ministrie në dy vitet e ardhshme. Lidhur me borxhin, është gjetur se ndërsa borxhi vendor mbetet i vogël, Ministria e Financave duhet të zgjerojë fleksibilitetin e saj, duke përfshirë borxhin vendor në strategjinë e menaxhimit të borxhit dhe duke përmirësuar rregullimet e monitorimit dhe auditimit për qeveritë vendore, pasi ky borxh aktualisht është i përjashtuar nga Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit. Lidhur me Prokurimin Publik, rekomandohet rishikimi dhe heqja e ngarkesave administrative që nuk kërkohen nga ligji i BE-së dhe që nuk sjellin vlerë të shtuar duke rritur pjesëmarrjen e kompanive të huaja.
Për sa i përket transparencës buxhetore, është gjetur se transparenca e procesit buxhetor pengohet nga liria relativisht e madhe për rialokime në ndarjet buxhetore pa miratimin e parlamentit gjatë ekzekutimit të buxhetit (më shumë se 5%). Lidhur me kontabilitetin, rekomandohet që Ministria e Financave duhet të shtojë përpjekjet e saj për të zhvilluar standardet e kontabilitetit në përputhje me normat ndërkombëtare, por në vend që të miratojë plotësisht Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të bazuar në të drejta dhe detyrime të konstatuara, ajo duhet të ndjekë një qasje graduale të informuar nga një analizë e plotë kosto-përfitim për zbatimin e standardeve të reja të kontabilitetit. Lidhur me përgjegjshmërinë menaxheriale, rekomandohet të bëhet progres në aranzhimet për llogaridhënien menaxheriale ndërmjet ministrive dhe organeve vartëse. Ndërkohë, rekomandohet të jepet më shumë vëmendje ndaj risqeve të Teknologjisë së Informacionit (TI) duke pasur parasysh rëndësinë e shtuar të sistemeve të TI-së. Gjithashtu, është identifikuar që nivelet e përgjithshme të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm bien nën normën 60% të zbatimit, duke treguar se njësitë nuk po përfitojnë mjaftueshëm nga përmirësimet në kontrolle ose përputhshmërinë e rekomanduar nga auditimi i brendshëm. Shkalla aktuale e zbatimit të rekomandimeve sugjeron se nevojitet vëmendje e mëtejshme që institucionet të përfitojnë plotësisht nga puna e auditimit të brendshëm.

Sipas raportit të FMN për Shqipërinë, Artikulli IV[477], lidhur me prokurimin publik, autoriteteve u kërkohet të publikojnë kontratat e prokurimit publik që kanë të bëjnë me shpenzimet e lidhura me rikuperimin e pandemisë dhe tërmeteve, emrat e kompanive të fituara dhe pronarët e tyre përfitues. Ndërkohë, rekomandohet zbatimi i menjëhershëm i masave të transparencës dhe llogaridhënies për shpenzimet emergjente.
Lidhur me risqet fiskale, sipas raportit të FMN "Raporti i FMN-së për Shqipërinë Nr. 21/259, 2021[478]", Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të përbashkëta për të monitoruar dhe menaxhuar më mirë risqet fiskale në rritje. Risqet fiskale janë rritur dhe mungesa e të dhënave të qarta mbi ekspozimin e qeverisë e bën të vështirë vlerësimin dhe menaxhimin efektiv të tyre. Informacioni i

[477]Raporti i FMN për Shqipërinë, Artikulli IV (2021). https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2021/12/07/Albania-2021-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-510834
[478]Raporti i FMN-së për Shqipërinë Nr. 21/259, 2021. https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2021/12/07/Albania-2021-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-510834

kufizuar mbi ekspozimin qeverisë ndaj PPP-ve është një sfidë kryesore. Lidhur me politikat fiskale, ndërsa rimëkëmbja forcohet, politika fiskale duhet t'i japë përparësi rritjes së të ardhurave për të rritur fleksibilitetin në të ardhmen. Rekordi i qeverisë për menaxhimin e deficiteve dhe reduktimin e borxhit ka ndërtuar besueshmëri, duke mundësuar një përgjigje të shpejtë ndaj goditjeve ekonomike. Rekomandohet një rregullim afatmesëm për të arritur një deficit primar prej 2.4% të PBB-së në vitin 2022, duke kaluar në një suficit primar prej 1.5% deri në vitin 2024, duke kërkuar një rregullim total strukturor prej 3.8% për tre vjet. Kjo përfshin masa thelbësore duke filluar nga viti 2022, si mbyllja e boshllëqeve tatimore dhe shkurtimi i shpenzimeve me prioritet të ulët, të cilat duhet të ndikojnë minimalisht në rritjen. Me këtë strategji, borxhi i qeverisë mund të kthehet në nivelet para pandemisë deri në vitin 2026, duke supozuar se nuk do të ketë goditje të reja. Të ardhurat e papritura duhet të kursehen për reduktim më të shpejtë të deficitit dhe borxhit. Nëse rimëkëmbja pëson pengesa, duhet të vendoset mbështetje më e lartë e synuar, duke supozuar se financimi është i disponueshëm.

Një nga gjetjet e vlerësimit të performancës së TADAT[479] për Shqipërinë lidhet me menaxhimin e riskut të burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). DPT ka një proces gjithëpërfshirës të menaxhimit të riskut të kapitalit njerëzor. Megjithatë, ai nuk përfshin detajet e vlerësimit të riskut në raportin e tyre vjetor. Një tjetër gjetje lidhet me detyrimet e prapambetura. Stoku i detyrimeve është i lartë.

Sipas raportit të Progresraportit[480] për Shqipërinë, sa u përket risqeve fiskale, Shqipëria duhet të forcojë kapacitetet e Ministrisë së Financave për të siguruar një monitorim efektiv të risqeve fiskale. Shqipëria ka zgjeruar gradualisht fushën e monitorimit dhe raportimit. Megjithatë, janë të nevojshme kapacitete të mëtejshme për të monitoruar efektivisht risqet fiskale, veçanërisht ato që lidhen me detyrimet e varura nga partneritetet publike-private, ndërmarrjet shtetërore dhe garancitë.

Nuk ekziston një Këshill Fiskal, një organ i pavarur mbikëqyrës me mandatin, për të vlerësuar risqet fiskale dhe për të monitoruar përputhshmërinë me rregullat fiskale. Mangësi të tjera vërehen në monitorimin e risqeve fiskale nga borxhet dhe detyrimet e ndërmarrjeve shtetërore, si dhe borxhin e qeverisjes vendore. Nuk ka një raportim sistematik mbi borxhin e ndërmarrjeve shtetërore.

Sipas Progresraportit[481] për Shqipërinë, sa i përket cilësisë së programit të buxhetit të mesëm (PBA) ka pësuar përmirësime. Shqipëria duhet të përmirësojë më tej besueshmërinë e PBA dhe të miratojë Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave, me qëllim rritjen e të ardhurave tatimore dhe mbështetjen për reforma të përgjithshme fiskale. Ligji organik i buxhetit, i cili është legjislacioni kryesor që rregullon procesin buxhetor, është zbatuar sistematikisht në vitet e fundit. Kalendari i buxhetit është hartuar dhe respektohet, si dhe propozimi i buxhetit që i paraqitet Parlamentit është gjithëpërfshirës transparent. Megjithatë, besueshmëria e vlerësimeve të të ardhurave në PBA mbetet e dobët, duke reflektuar devijimin e lartë midis vlerësimeve fillestare dhe të ardhurave reale.

Sipas raportit të Progresraportit[482] për Shqipërinë, rezulton se në PBA, gjithashtu, mungojnë tavanet sektoriale të stabilizuara për të mbështetur zbatimin e politikave nga ministritë përkatëse. Buxheti vjetor shpesh ndryshohet nga qeveria përmes akteve normative gjatë gjithë vitit fiskal,

[479] *TADAT (2022). https://www.tadat.org/performanceAssessmentReports*
[480] *Albania EU progress report 2023: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en*
[481] *Albania EU progress report 2023: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en*
[482] *Albania EU progress report 2023: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en*

shpesh me mungesë transparence dhe arsyetimi ekonomik, duke reflektuar kështu dobësitë e sistemit të planifikimit. Strategjia Afatmesme e të Ardhurave duhet të ndihmojë në rritjen e të ardhurave tatimore dhe të mbështesë reformat fiskale të Shqipërisë, si dhe të ofrojë stabilitet dhe parashikueshmëri të sistemit fiskal.

Sipas Progresraportit[483] për Shqipërinë vlerësohen përpjekjet e Shqipërisë në drejtim të forcimit të efektivitetit dhe transparencës në menaxhimin e financave publike. Menaxhimi financiar publik (MFP) është gjerësisht në fuqi, por duhet përmirësuar. Baza ligjore për MFP-në është kryesisht në fuqi, me një ligj të plotë organik të buxhetit. Në janar 2024, Ministria e Financave dhe Ekonomisë u nda në ministri të veçanta. Struktura u miratua për Ministrinë e Financave të sapokrijuar. Strategjia e re e MFP- së 2023-2030 u miratua në qershor 2024 dhe mbulon në mënyrë retroaktive vitin 2023. Strategjia është gjithëpërfshirëse, mbulon të gjitha aspektet e MFP-së dhe mobilizimit të të ardhurave të brendshme dhe përqendrohet kryesisht në aktivitet afatmesme për periudhën 2023-2026. Kuadri strategjik forcohet më tej nga strategjitë specifike mbi menaxhimin e borxhit, prokurimet, auditin e jashtëm dhe doganat. Më së shumti ndiqen dispozitat e ligjit organik të buxhetit. Megjithatë, rishikimet e buxhetit vazhdojnë të bëhen pothuajse ekskluzivisht nëpërmjet akteve normative nga ekzekutivi, një instrument më i përshtatshëm duhet në rastet e urgjencave. Duhet të ndiqet një kthim në proceset e rregullta të rishikimit të buxhetit nëpërmjet Parlamentit. Kapacitetet e Ministrisë së Financave do të duhet të forcohen më tej. Niveli i detyrimeve të prapambetura është reduktuar, por përpjekjet e vazhdueshme për të forcuar respektimin e angazhimit duhet ende të ndiqen. Është ndërmarrë veprim për të forcuar mbikëqyrjen e riskut fiskal. Transparenca e buxhetit është më së shumti e kënaqshme me të gjithë dokumentet kyç buxhetore të publikuara rregullisht.

Gjithashtu në këtë raport theksohet se ka vetëm një plotësim të pjesshëm të rekomandimeve të raportit të vitit 2023. Edhe në këtë raport të fundit theksi vihet në miratimin dhe zbatimin e Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, përmirësimin e analizës së riskut fiskal, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies të ndërmarrjeve shtetërore duke përfshirë edhe raportet e tyre të përvitshme financiare, krijimin e një Liste Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, duke përfshirë në të edhe PPP dhe një rankim të të gjitha projekteve. Në drejtim të sistemit të prokurimeve kërkohet rritje e përafrimit të legjislacionit me atë të Bashkimit Europian. I njëjti rekomandim vlen edhe për Sistemin e Llogarive të Qeverisë për një përafrim ligjor me BE dhe për një raportim më të plotë të të dhënave në institucionet statistikore të Bashkimit Europian. Forcimi i kapaciteteve në drejtim të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

Në raportin e monitorimit SIGMA 2024[484], krahas vlerësimeve në lidhje me përmirësimin e MFP në shumë drejtime, identifikohen problematika të cilat janë në linjë edhe me identifikimet e mëparshme. Përmirësimi i parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve duke siguruar respektimin e kufijve të shpenzimeve për ministritë dhe për t'u mundësuar atyre zbatimin më efikas të politikave dhe objektivave. Krijimin e një autoriteti të pavarur (Këshilli Fiskal) për të siguruar vlerësimin e pavarur të politikës fiskale, duke rritur kështu besueshmërinë e projeksioneve fiskale dhe qëndrueshmërinë e financave publike në afat të mesëm. Raportimi i borxhit të NSH-ve të mbulojë të gjithë borxhin dhe huamarrjen e tyre, dhe që të mundësohet raportimi i rregullt, për

[483] *Albania 2024 Report, COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en*

[484] *SIGMA Monitoring Reports: Public Administration in Albania 2024 -Assessment against the Principles of Public Administration, pg 139,https://www.sigmaweb.org/publications/Public-administration-in-Albania-2024.pdf*

të ofruar një pasqyrë më gjithëpërfshirëse të borxhit publik dhe për të zbutur rreziqet fiskale të NSH-ve të lidhura me borxhin. Përmirësimi i disponueshmërinë dhe saktësisë së të dhënave në lidhje me pagesat e prapambetura. Konsolidimi i përpjekjeve për të përfunduar reformën e kontabilitetit dhe raportimin financiar vjetor në përputhje me standardet ndërkombëtare.
Krahas rekomandimeve të mësipërme, në raport paraqiten edhe disa rekomandime të tjera më specifike: qeveria duhet të krijojë delegim më të qartë dhe më të qëndrueshëm të autoritetit vendimmarrës nga menaxherët e lartë në nivelet më të ulëta brenda enteve të sektorit publik, për të fuqizuar menaxherët e mesëm dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe reagimin e proceseve të kontrollit të brendshëm. MF duhet të monitorojë zbatimin e procedurave për raportimin e parregullsive dhe mashtrimeve në të gjitha subjektet për të përmirësuar raportimin. Këshilli i Ministrave (KM) duhet të finalizojë harmonizimin e legjislacionit të prokurimit publik, duke eliminuar mospërputhjet e mbetura në ligjin për Koncesionet dhe PPP. Agjencia e Prokurimit Publik (APP) duhet të rishikojë sistemin e kufijve financiarë për zbatimin e dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik në mënyrë të tillë që respektimi i rregullave të BE-së të mos varet nga luhatjet e kursit të këmbimit lekë/euro. APP-ja duhet të analizojë pse paraqiten vetëm tenderë të vetëm për shumë procedura dhe pse një pjesë e rëndësishme e proceseve të prokurimit po anulohen, dhe t'i trajtojë të dyja problemet me masat e duhura. Agjencia e Trajtimit të Koncesionit (ATRAKO) duhet të përditësojë manualet dhe materialet e tjera që mbështesin aplikimin e ligjit për Koncesionet dhe PPP. APP duhet të përmirësojë zbatimin praktik të instrumenteve elektronike si sistemet dinamike të blerjeve dhe, në veçanti, ankandet elektronike. Pas krijimit të Nënkomisionit të Auditimit Publik, Parlamenti dhe KLSH-ja duhet të zhvillojnë më tej bashkëpunimin e tyre për përdorimin efektiv të raporteve të KLSH-së nga Kuvendi. KLSH duhet të shqyrtojë dhe identifikojë, së bashku me të audituarit, arsyet e nivelit të ulët të zbatimit të rekomandimeve dhe të hartojë një plan veprimi për të adresuar këtë çështje. Qeveria duhet të propozojë zgjidhje për të reduktuar pabarazitë në potencialin financiar të qeverisjes vendore duke forcuar efektivitetin e sistemit të barazimit.

5.4 Konkluzione dhe rekomandime

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë progres në drejtim të përmirësimit të transparencës dhe efektivitetit në menaxhimin e financave publike. Kjo theksohet nga analiza e raporteve të monitorimit të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike dhe raporteve ndërkombëtare. Sipas raportit të fundit SIGMA 2024, treguesi mesatar i menaxhimit të financave publike është vlerësuar me nota pozitive, duke qëndruar dukshëm mbi mesataren e këtij treguesi për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, duhen bërë përmirësime të mëtejshme për të qëndruar në të njëjtën linjë me vendet e Bashkimit Europian.

Sikurse del në pah edhe nga analiza e mësipërme arritjet më të mëdha janë bërë në drejtim të legjislacionit, dokumenteve strategjikë dhe krijimit të institucioneve, kurse pika e dobët mbetet zbatimi në praktikë dhe arritja e rezultateve. Bazuar ne rekomandimet e raporteve ndërkombëtare, raporteve të organizatave të Shoqërisë Civile në vend dhe raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjikë, janë adresuar disa problematika për të përmirësuar efektivitetin dhe transparencën në menaxhimin e financave publike:

- Përmirësimi i parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve. Rritja e besueshmërisë së vlerësimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në PBA, duke minimizuar devijimin e lartë midis vlerësimeve fillestare dhe të ardhurave dhe shpenzimeve reale.

- Rritja e qëndrueshmërisë në tavanet sektoriale të shpenzimeve për të mbështetur zbatimin e politikave nga ministritë përkatëse.
- Miratimi sa më shpejt i Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave për të konsoliduar rritjen e të ardhurave tatimore, parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe menaxhimin e detyrimeve tatimore të prapambetura me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit tatimor.
- Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit në shqyrtimin e akteve normative për ndryshim buxheti.
- Krijimi i praktikës për diskutimin e kuadrit makro-fiskal dhe programit buxhetor afatmesëm në Kuvend, si edhe forcimin e kapaciteteve njerëzore të Kuvendit në lidhje me analizat buxhetore.
- Krijimin e një autoriteti të pavarur (Këshilli Fiskal) për të siguruar vlerësimin e pavarur të politikës fiskale, duke rritur kështu besueshmërinë e projeksioneve fiskale dhe qëndrueshmërinë e financave publike në afat të mesëm, si edhe duke monitoruar risqet fiskale me qëllim uljen e tyre.
- Raportim i rregullt fiskal periodik i ndërmarrjeve shtetërore nëpërmjet standardizimit të metodologjisë së raportimit fiskal të tyre, me qëllim identifikimin dhe reduktimin e risqeve fiskale.
- Për të pasur një planifikim strategjik të integruar, sistemi i informacionit (SIPI) duhet të shtrihet në një përdorim më të gjerë, pasi deri më tani është përdorur vetëm në një masë të kufizuar dhe janë bërë plane për të përmirësuar SIPI për t'i shërbyer më mirë nevojave të përdoruesve të tij.
- Harmonizimi dhe integrimi i strategjive në nivele të ndryshme dhe zhvillimi i strategjive dhe planeve të veprimit me kosto adekuate brenda burimeve të disponueshme të alokuara përmes Programeve Buxhetore Afatmesme.

Gjithashtu, disa rekomandime në fushën e menaxhimit të borxhit, në lidhje me kuadrin rregullator dhe ndryshimet në kuadrin makroekonomik, si dhe kushtet e tregjeve financiare, të cilat mund të cenojnë arritjen e objektivave të synuara, duhet të adresohen:
- Garancitë dhe nën-huadhënia është e rregulluar mirë në ligjin e borxhit, megjithatë një kuadër i duhur mbetet ende për t'u zhvilluar. DPB kryen një vlerësim të riskut të kredisë për NSH-të dhe qeverinë vendore që kërkojnë garanci ose kur përfitojnë nga operacionet e nën-huadhënies.
- Përshtatja dhe rritja e fleksibilitetit në emetimet e tregut të brendshëm, që i nënshtrohen paqëndrueshmërisë së tregut financiar, si dhe ndryshimeve të tregut, rritjes së normave të interesit.
- Mbajtja parasysh e paqëndrueshmërisë së tregut financiar vendas dhe ndërkombëtar për shkak të ndryshimeve në kuadrin makroekonomik dhe faktorëve të tjerë të jashtëm të panjohur.

Në lidhje me menaxhimin dhe zbatimin efikas të buxhetit, janë bërë përpjekje për përmirësimin e statistikave të Sistemit Financiar të Qeverisë (SFQ). Programi pesëvjeçar i statistikave zyrtare, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (PSZ) 2022–2026, paraqet strategjinë për zhvillimin e statistikave zyrtare dhe të sistemit kombëtar statistikor, duke përfshirë përmirësimin e SFQ. Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet INSTAT, MF-së dhe Bankës së Shqipërisë për statistikat financiare të qeverisë dhe tabelave të procedurës së deficitit të tejkaluar përfshin detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit institucion, të cilat rregullohen me akte ligjore të Bashkimit Evropian në fushën e prodhimit të statistikave financiare të qeverisë dhe raportimit të procedurës së deficitit të tejkaluar.
Megjithatë, disa rekomandime në drejtim të zbatimit më efikas të buxhetit janë:
- Ekziston ende nevoja për të përmirësuar më tej statistikat SFQ dhe PDT për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe metodologjinë SELL 2010, pasi janë rreth 19 llogari për qëllime të ndryshme të cilat operojnë jashtë llogarisë së thesarit;

- Përmirësimi i menaxhimit dhe ulja e detyrimeve të prapambetura, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të SIFQ;
- Duhet të përfundojë harmonizimi i legjislacionit të prokurimit publik, duke eliminuar mospërputhjet e mbetura në ligjin për Koncesionet dhe PPP;
- Agjencia e Prokurimit Publik (APP) duhet të rishikojë sistemin e kufijve financiarë për zbatimin e dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik në mënyrë të tillë që respektimi i rregullave të BE-së të mos varen nga luhatjet e kursit të këmbimit lekë/euro;
- APP-ja duhet të analizojë pse paraqiten vetëm tenderë të vetëm për shumë procedura dhe pse një pjesë e rëndësishme e proceseve të prokurimit po anulohen dhe t'i trajtojë të dyja problemet me masat e duhura;
- APP duhet të përmirësojë zbatimin praktik të instrumenteve elektronike, si sistemet dinamike të blerjeve dhe, në veçanti, ankandet elektronike;
- Agjencia e Trajtimit të Koncesionit (ATRAKO) duhet të përditësojë manualet dhe materialet e tjera që mbështesin aplikimin e ligjit për Koncesionet dhe PPP.
- Për periudhën afatmesme dhe afatgjatë konsiderohen reforma të mëtejshme për të adresuar mangësitë në sistemin e menaxhimit të investimeve publike (MIP) dhe për të parandaluar shpenzimet e panevojshme.
- Përpunimin e mëtejshëm të Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, duke përmirësuar metodologjinë e vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve, forcimin e rolit *gatekeeper* të MF-së (shqyrtimi i pavarur i propozimeve të projektit).
- Në kontekstin e transparencës së financave publike, koncepti i llogaridhënies menaxheriale brenda institucioneve publike ende nuk është kristalizuar plotësisht, ndaj duhet të zhvillohet dhe lehtësohet një kuptim më i thellë i përgjegjshmërisë menaxheriale nga niveli ekzekutiv me mjetet e nevojshme. Janë identifikuar disa dobësi në ndjekjen sistematike të rekomandimeve nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm të cilat duhet të zgjidhen.

Institucionet buxhetore vazhdojnë të zhvillojnë dhe zbatojnë Plane për Përmirësimin e Sigurimit të Cilësisë (PPSC) dhe MF vazhdon të ofrojë zhvillim të vazhdueshëm profesional (ZHVP) dhe trajnime të tjera për Audituesit e Brendshëm përmes programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të trajnimit (CEF) dhe 90% e audituesve të brendshëm në shërbim aktiv janë të certifikuar. Pavarësisht këtyre arritjeve, mbeten një sërë sfidash:

- Plotësimi me stafin e nevojshëm në funksionin e auditimit të brendshëm ose kontraktimi i funksionit të auditimit në të gjitha institucionet publike.
- Rritja e kapaciteteve të ekipeve të auditimit të brendshëm në disa institucione publike dhe veçanërisht në disa njësi të vetëqeverisjes vendore dhe institucione të nivelit dytësor të nivelit qendror.
- Përmirësim me auditimet financiare dhe të pajtueshmërinë që kulmojnë me raporte të forta auditimi, që paraqesin një opinion të qartë auditimi dhe rekomandime praktike për përmirësimin e proceseve të MFK-së dhe biznesit.
- Kuvendi dhe KLSH-ja duhet të zhvillojnë më tej bashkëpunimin e tyre për përdorimin efektiv të raporteve të KLSH-së nga Kuvendi. KLSH duhet të shqyrtojë dhe identifikojë, së bashku me të audituarit, arsyet e nivelit të ulët të zbatimit të rekomandimeve dhe të hartojë një plan veprimi për të adresuar këtë çështje.

DOKUMENT

Kapitulli VI : Qeverisja e Hapur: Eficienca dhe performanca në Administratën Publike

6.1. Qeverisja e hapur dhe modeli OGP[485]

Shumë nga synimet kryesore të modelit të qeverisjes së hapur tentojnë të reflektojnë qasje të bazuara në institucionalizimin e reformave, promovimin dhe mbrojtjen e hapësirës qytetare, mbrojtjen e proceseve demokratike dhe sigurimin e një përgjigje të hapur, e që kërkojnë mbështetjen dhe përfshirjen e parlamenteve. Ekziston gjithashtu një kërkesë në rritje nga qytetarët që parlamentet të jenë më të hapura, gjithëpërfshirëse dhe efektive në përfaqësimin e interesave të të gjithëve qytetarëve.

Nisma globale "Partneriteti për Qeverisjen e Hapur" (*Open Government Partnership*-OGP) është krijuar që në vitin 2011, duke bërë bashkë liderët qeveritarë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, për të krijuar një partneritet unik, një iniciativë për të promovuar qeverisjen transparente, pjesëmarrëse, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme. Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP) përfshin 77 vende dhe 150 qeveri lokale, duke përfaqësuar më shumë se dy miliardë njerëz, si dhe mijëra organizata të shoqërisë civile.

Vizioni i strategjisë aktuale të OGP është: "qeverisja e hapur, e cila bashkëpunon me shoqërinë civile dhe qytetarët për të forcuar demokracinë dhe për të siguruar rezultate më të mira për shoqërinë".

Qeverisja e Hapur, si një qasje globale novatore, nënkupton:

- Të gjithë kanë akses në informacion të rëndësishëm, të përdorshëm dhe në kohë mbi proceset dhe vendimet qeveritare që ndikojnë në jetën e tyre.
- Të gjithë kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë lirisht në formësimin e politikave publike dhe vendimeve që ndikojnë në jetën e tyre.
- Të gjithë kanë lirinë dhe mundësinë për të kërkuar zgjidhje efektive, kur shteti ligjor nuk respektohet, të drejtat e tyre shkelen ose nevojat e tyre nuk përmbushen, pa rrezik ose dëm. Zyrtarët publikë mbajnë përgjegjësi për vendimet dhe veprimet e tyre.
- Burimet publike menaxhohen në mënyrë transparente, të drejtë dhe të barabartë.
- Qeveritë bashkëpunojnë me shoqërinë civile, akademinë, sektorin privat dhe aktorë të tjerë për të gjetur dhe zbatuar zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme për sfidat shoqërore.
- Transparenca, llogaridhënia, pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja janë të integruara në kulturën dhe praktikat e qeverisjes në të gjitha nivelet.

Që nga fillimi i OGP-së, angazhimi parlamentar ka qenë një pjesë integrale e filozofisë së qeverisjes së hapur dhe një element kryesor për të realizuar reforma ambicioze.

Angazhimi parlamentar në OGP varion sipas modeleve të implementuara. Në kontekstin e qeverisjes së hapur, parlamenti posaçërisht ka një rol të rëndësishëm në lidhje me:

Veprimtari legjislative: Mbrojtja e vlerave të qeverisjes së hapur duke prezantuar, rishikuar dhe ratifikuar legjislacionin e rëndësishëm për qeverisjen e hapur ose aprovimin e buxheteve për

[485]Me termin "OGP" (Open Government Partnership) në këtë material do t'i referohemi Partneritetit për Qeverisje të Hapur, shih www.opengovpartnership.org

DOKUMENT PARLAMENTAR

reforma në këtë drejtim. Këtu mund të përmendim miratimin, rishikimin dhe ndryshimin e legjislacionit për të forcuar kuadrin ligjor që rregullon aksesin në informacion, llogaridhënien publike dhe hapësirën qytetare dhe pjesëmarrjen në sektorë ose fusha specifike të politikave, për shembull, klima, gjinia, drejtësia ose në të gjithë qeverisjen si, për shembull, e drejta e informimit, pjesëmarrja publike, të dhënat e hapura, privatësia, fiskalizimi;

Sigurimi i mbikëqyrjes parlamentare: përgjegjshmëria/llogaridhënia e ekzekutivit për reformat në kuadër të qeverisjes së hapur, dhe hapja e proceseve të tyre të mbikëqyrjes në kontrollin publik. Kjo mund të përfshijë raportimin e rregullt publik, proceset e ankesave ose forcimin e rrugëve për çështje gjyqësore me interes publik, forcimin e mbrojtjes së sinjalizuesve, etj.

Hapja e proceseve parlamentare: Miratimi i parimeve të qeverisjes së hapur, transparenca, përgjegjshmëria/llogaridhënia, pjesëmarrja dhe përfshirja në parlament dhe proceset parlamentare. Zbatimi i një sistemi plotësisht funksional të gjurmëve legjislative, duke mundësuar ndjekjen publike të nismave legjislative nga faza e hartimit rishikimit, miratimin dhe, aty ku është e nevojshme, amendamentet ligjore; përmirësimi i mënyrave në të cilat shoqëria civile dhe qytetarët mund të japin kontribute gjatë hartimit dhe rishikimit legjislativ përmes komenteve publike dhe/ose mundësi konsultimi në lidhje me procesin. Vlen të përmendet që i gjithë legjislacioni parësor dhe dytësor duhet të publikohet në një format lehtësisht të aksesueshëm, pa pagesë.

Krijimi i hapësirës për dialog: Nxitja e dialogut mes palëve dhe mbështetja e nevojshme për të përparuar dhe institucionalizuar reformat e qeverisjes së hapur[486].

Llogaridhënia dhe eficienca sipas modelit OGP

Duke iu bashkuar OGP-së, të gjitha vendet anëtare marrin përsipër angazhime, si pjesë e një plani veprimi, që janë ambicioze dhe shkojnë përtej praktikës aktuale të një qeverie, si dhe vlerësojnë dhe raportojnë për performancën e tyre në përmbushjen e këtyre angazhimeve. Të gjithë anëtarët e OGP-së duhet të pajtohen me procesin e OGP-së dhe të mbështesin vlerat dhe parimet e përshkruara në Deklaratën e Qeverisjes së Hapur, të cilës ata i nënshtrohen pas anëtarësimit në OGP.

Në këtë kuadër funksionon një mekanizëm llogaridhënieje (IRM). IRM është mekanizmi i përgjegjshmërisë i OGP-së dhe mjeti kryesor për ndjekjen e progresit të një vendi në kuadër të qeverisjes së hapur. IRM ofron raportim të pavarur, objektiv dhe të bazuar në fakte për të pasur përgjegjshmëri nga anëtarët e OGP-së dhe për të mbështetur përpjekjet e tyre të qeverisjes së hapur. Kjo bëhet përmes raporteve dhe rekomandimeve në kohë gjatë momenteve kyçe të ciklit të planit të veprimit. IRM është një burim i vlefshëm për anëtarët e OGP, i cili kontribuon në ndërtimin e besueshmërisë së partneritetit dhe mundëson të mësuarit dhe ndarjen e eksperiencës tek të gjithë anëtarët e komunitetit të qeverisjes së hapur.

Në rastin e Shqipërisë, gjatë ciklit të Planit të V-të të Veprimit, Mekanizmi i Pavarur i Raportimit hartoi raportin e vlerësimit dhe nënvizonte se ishte vepruar jo në përputhje me procesin e OGP-së, ndërkohë që plani i veprimit ishte zhvilluar pa një forum shumëpalësh. Ndaj, ky problem mbeti të adresohej në procesin e krijimit të planit të ri të veprimit 2023-2025. Mekanizmi i Pavarur i Raportimit ka nënvizuar se duhej të ishte krijuar një forum i përkushtuar shumëpalësh për të

[486]Shih për më gjerë: www.opengovpartnership.org/parliaments-in-ogp/

DOKUMENT PARLAMENTAR

monitoruar zbatimin e planit aktual dhe për të zhvilluar plane të veprimit në të ardhmen që marrin në konsideratë përparësitë e qytetarëve dhe të shoqërisë civile. Në këtë kuadër, qeveria e Shqipërisë, në bazë të këtij rekomandimi, ngriti Komitetin Shumëpalësh të Partneritetit për Qeverisje të Hapur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 145, datë 20.12.2021 "Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shumëpalësh të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur", ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 177, datë 28.10.2022. Urdhri i Kryeministrit synon të kontribuojë në një zbatim më efektiv të standardeve të Qeverisjes së Hapur brenda anëtarësimit të qeverisë Shqiptare në nismën globale të "Partneritetit të Qeverisjes së Hapur" (OGP)[487]. Komiteti Shumëpalësh është një organ konsultativ për përmbushjen e detyrimeve për qeverisjen e hapur në emër të Qeverisë Shqiptare. Zbatimi i detyrimeve si vend anëtar bën të domosdoshëm krijimin dhe funksionimin e Komitetit, i cili do të përmbushë detyrimin për të bashkërenduar një proces kombëtar për miratimin e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur dhe monitorimin periodik të tij. Ministritë e linjës dhe institucionet qendrore marrin masa për të ndjekur objektivat e Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur, zbatimin dhe monitorimin e tij, në përputhje me standardet e OGP-së.

Roli i parlamentit në iniciativën OGP

Angazhimi i parlamenteve në OGP, qoftë përmes pjesëmarrjes zyrtare në procesin e bashkë-krijimit të planeve të veprimit apo mjetet e tjera të koordinimit, ka të bëjë me të gjithë palët e interesuara të OGP.

Për parlamentin, angazhimi me platformën OGP brenda vendit mund të sigurojë një mekanizëm shtesë për të dëgjuar opinione nga qytetarët dhe shoqëria civile, se si deputetët mund t'u shërbejnë më mirë njerëzve/komunitetit që përfaqësojnë, dhe të qëndrojnë në krah të angazhimeve që qeverisja merr përsipër dhe për të cilat është përgjegjëse. Ndërkombëtarisht, OGP ofron një platformë globale për të mësuar nga eksperienca dhe praktikat e vendeve të tjera.

Për ekzekutivin, angazhimi parlamentar ofron mundësi për garantimin e legjislacionit që mundëson realizimin e angazhimeve të pushtetit ekzekutiv, burimet për zbatim dhe institucionalizimin e reformave. Kur ekzekutivi angazhon qytetarët dhe shoqërinë civile në proceset e bashkë-krijimit të Planit Kombëtar të Veprimit OGP. Inputet nga këto grupe shpesh pasqyrojnë aspirata ose kërkesa që nuk mund të adresohen vetëm nga veprimtaria e ekzekutivit, por nevojitet një angazhim më i gjerë.

Për organizatat e shoqërisë civile, angazhimi parlamentar është një aspekt thelbësor i sigurimit të qëndrueshmërisë së reformave në administratë dhe cikle politike, dhe për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të qytetarëve.

Në Shqipëri, bashkërendimi me Kuvendin, për një Parlament të hapur dhe të aksesueshëm, si për sa i takon përmirësimit të Platformës Ndër-institucionale të Mekanizimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ashtu dhe vënies në jetë të Platformës e-legislation, është një nga angazhimet kryesore në kuadër të Planit Kombëtar 2023-2025 të Partneritetit për Qeverisje të Hapur [488]. Pjesë e këtij angazhimi të parlamentit të hapur është implementimi i platformës *e-legislation* (pjesë e projektit PACEP) përmes Standardit AKN4AL (Akomantoso për Shqipërinë)

[487]Partneriteti për Qeverisje të Hapur: Plani Kombëtar 2023-2025, Tiranë: Mars 2023, f.15 https://ogp.gov.al/uploads/2023/4/20230420175207_plani-kombetar-i-veprimit-2023-2025-pqh-mars-2023.pdf.
[488]Partneriteti për Qeverisje të Hapur: Plani Kombëtar 2023-2025, Tiranë: Mars 2023, f.203-204 https://ogp.gov.al/uploads/2023/4/20230420175207_plani-kombetar-i-veprimit-2023-2025-pqh-mars-2023.pdf.

i cili do të rezultojë në një sistem legjislativ të integruar dhe transparent e që do të përmirësojë aksesin në ligjet e konsoliduara dhe të dhënat parlamentare; si dhe shqyrtimi i vendimit 49/2017 të Kuvendit të Shqipërisë "Për ngritjen e një mekanizmi për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese" i cili synon të forcojë rolin e Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Kuvendin në monitorimin e ministrive të linjës në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe të inkurajojë më tej përdorimin e Platformës Ndërinstitucionale Online.

Modelet OGP variojnë por në tërësi ato ndahen në dy drejtime: veprimi/angazhimi parlamentar përfshihet brenda planit kombëtar të veprimit OGP (siç është aplikuar deri tani edhe në Shqipëri); dhe një Plan Veprimi parlamentar i pavarur nga plani kombëtar OGP. Kjo e fundit zhvillohet në rastet kur pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e parlamentit në procesin kombëtar të OGP nuk është ende e realizueshme ose, kur përveç pjesëmarrjes së tyre në planet kombëtare të OGP-së, kjo konsiderohet e dëshirueshme nga parlamenti në kuadër të qeverisjes së hapur. Disa modele për ilustrim jepen më poshtë.

Modeli estonez[489]*:* Parlamenti estonez që në 2002 ka miratuar Konceptin e Zhvillimit të Shoqërisë Civile Estoneze, dokument që ka përcaktuar parimet kryesore për partneritet mes autoriteteve publike dhe shoqërisë civile. Në vijim, qeveria estoneze miratoi dokumentin e Praktikave të Mira të Angazhimit të qeverisë, ministrive dhe OJF. Kjo qasje synonte të përcaktonte parimet kryesore të përfshirjes së shoqërisë civile në politikëbërje si: informimi i aktorëve përgjegjës mbi iniciativa apo dokumente politikash që kanë efekt mbi ta, duke u dhënë kohën e nevojshme në dispozicion për konsultim publik, nevoja për pasjen e feedback-ut dhe komenteve për këtë qëllim. Në vijim, Estonia adoptoi Planin e Veprimit OGP në vitin 2014. Për rrjedhojë, qeveria estoneze krijoi një mekanizëm kombëtar koordinimi që përfshinte qeverinë dhe shoqërinë civile në implementimin dhe monitorimin e praktikave të qeverisjes së mirë.

Një nga aspektet pozitive është se Estonia ka bërë përpjekje serioze për promovimin e mjeteve/mekanizmave të pjesëmarrjes elektronike krahas prioritetit me bazë të gjerë për zhvillimin e qeverisjes elektronike. Nga viti 2001, kur kjo platformë u lançua për herë të parë e deri sot me ndryshimet dhe përmirësimet e bëra, ajo është konsoliduar si platformë *online,* ku qytetarët mund të propozojnë ide mbi politika të caktuara për vendimmarrësit e institucioneve, të konsultojnë drafte legjislative. Estonia gjithnjë i ka dhënë prioritet nevojës për akses në informacionin institucional dhe transparencës së qeverisjes në kuadër të qeverisjes së hapur. Kjo është në linjë të drejtë me vlerat liberale që ekzistojnë në shoqërinë estoneze, me fokus në zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe rolin modest që kanë sindikatat në shërbimin civil si pjesë e administratës publike vendase.

Plani aktual i Veprimit OGP i adoptuar nga Estonia është ambicioz dhe synon të rrisë përpjekjet për transparencë dhe pjesëmarrje të shoqërisë civile në politikë-bërje si dhe të prezantojë angazhime që përbëjnë risi për vendin në lidhje me një politikë-bërje dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna dhe evidenca konkrete. Në të dy rastet, sfidat kryesore lidhen me nxitjen e një kulture të qëndrueshme në sektorin publik për të forcuar impaktin e mekanizmave dhe kuadrit të politikave të reja.

Modeli francez: Versioni francez i Qeverisjes së Hapur është mishërimi i një vizioni global dhe koherent të një modeli të ri demokratik, me fokus në dialog dhe llogaridhënie. Në Francë është

[489]*European Commission (2018), Public administration characteristics and performance in EU28: Estonia, Publications Office of the European Union, Brussels:2018.*

DOKUMENT PARLAMENTAR

ngritur një forum shumëpalësh për të zhvilluar Planin e katërt Kombëtar të Veprimit OGP (2024-2026). Kjo tani do të jetë një nismë e përhershme për të ndjekur procesin e bashkë-krijimit me shoqërinë civile dhe për të përmirësuar mekanizmat e transparencës dhe llogaridhënies për hartimin dhe zbatimin e angazhimeve të OGP-së.

Duke krijuar "koalicione të palëve të interesuara", presidenca franceze ka hedhur themelet për dialogun, zhvillimin dhe bashkëkrijimin mes tyre. Parimi "*të punojmë me ju*" qëndron prapa Këshillave Kombëtare për Rithemelimin (CNR) në fusha të ndryshme të veprimtarisë qeverisëse, me zbatimin e proceseve të reja dhe novatore diskutimi për të dhënë rekomandime për çështjet e mëdha me të cilat përballet shoqëria. çështjet e politikave të caktuara nëse vijnë nga poshtë-lart, nga baza, duke u dhënë qytetarëve një shans për t'u përfshirë në një mënyrë të dukshme dhe të matshme, është një histori suksesi në politikëbërje dhe vendimmarrje. Kështu, në përputhje me parimet OGP, dialogu konstruktiv qeveri-shoqëri civile ka prodhuar 17 angazhime të grupuara në tre prioritete kryesore tematike: a) Përmirësimi dhe forcimi i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe praktikave demokratike të inovacionit për t'u dhënë qytetarëve një rol më të spikatur në vendimmarrjen e qeverisë. Kjo përfshin përmirësimin e aftësive dhe standardeve të sferës së inovacionit, trajnimin e nëpunësve civilë dhe politikëbërësve publikë dhe institucionalizimin e praktikave pjesëmarrëse; b) Përmirësimi i përfshirjes dhe angazhimit të qytetarëve në mbarë vendin për të adresuar sfidat kryesore të politikave publike. Angazhimet këtu fokusohen në përmirësimin e përfshirjes dhe angazhimit të qytetarëve në mbarë vendin, në veçanti për të adresuar fushat prioritare të politikave publike. Qëllimi është përfshirja e gjithë popullatës në proceset demokratike dhe krijimi i një forme më të gjerë dhe më përfaqësuese të pjesëmarrjes qytetare; c) Përdorimi i teknologjisë digjitale për të inkurajuar veprime më transparente dhe më pjesëmarrëse të qeverisjes. Qëllimi i këtij prioriteti është të përmirësojë transparencën e veprimtarisë së qeverisë, duke lehtësuar njëkohësisht aksesin në informacion dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në këto procese. Disa angazhime fokusohen në promovimin e një kulture të hapur digjitale, duke inkurajuar të gjithë aktorët institucionalë që të përdorin softuer me burim të hapur dhe mekanizma të përbashkëta digjitale.

Modeli i Maqedonisë së Veriut: Maqedonia e Veriut aktualisht po zbaton planin e saj të gjashtë të veprimit OGP. Angazhimet në planin e gjashtë të veprimit të Maqedonisë së Veriut janë të organizuara në pesë tema: anti-korrupsion, pjesëmarrja e qytetarëve dhe vendimmarrja pjesëmarrëse, aksesi në drejtësi, zhvillimi dhe përdorimi i teknologjive digjitale dhe aktivitetet që lidhen me ndryshimet klimatike. Maqedonia e Veriut hyn në radhët e atyre vendeve që kanë një plan OGP të veçantë të parlamentit të hapur, ku aktualisht zbaton planin e tretë të veprimit të Parlamentit të Hapur.

Sipas vlerësimit IRM, Maqedonia e Veriut ka vijuar të demonstrojë nivele të larta të pjesëmarrjes publike gjatë bashkë-krijimit dhe zbatimit të planit të veprimit. Plani i gjashtë Kombëtar i Veprimit i Partneritetit të Qeverisjes së Hapur për periudhën 2024-2026 bazohet në intensitetin e mëparshëm të punës duke ndërmarrë angazhime për të rritur pjesëmarrjen e publikut dhe për të ofruar zgjidhje vërtet transformuese. Ai njeh gjithashtu nevojën e sektorit publik për inovacion, për të zhvilluar politika që i përgjigjen nevojave të qytetarëve në përgjigje të tendencave bashkëkohore. Konfirmohet nevoja për të thelluar detyrimet e mëparshme dhe për të përmirësuar cilësinë e tyre përmes angazhimeve për një qeveri të hapur, një parlament të hapur dhe një gjyqësor të hapur.

Bashkimi Evropian dhe Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP) kanë nisur prej 2023 një Partneritet për Demokraci dhe Përgjegjësi për të forcuar demokracinë dhe për të përmirësuar jetën

DOKUMENT PARLAMENTAR

e qytetarëve në të gjithë globin përmes një qeverisjeje të hapur, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme[490]. Falë kontributit financiar nga BE gjatë një periudhe 40 mujore dhe mbështetjes operacionale nga OGP, Partneriteti për Demokraci dhe Përgjegjësi do të avancojë përpjekjet dhe angazhimet e qeverisjes së hapur në lidhje me llogaridhënien, antikorrupsionin, gjininë, rininë, përfshirjen, hapësirën qytetare dhe pjesëmarrjen e publikut si globalisht, ashtu edhe në vendet partnere. Në nivel kombëtar, Partneriteti për Demokraci dhe Përgjegjësi fokusohet në forcimin e aleancave të forta dhe llogaridhënies ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile për të integruar qasjet e hapura, gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse të bashkëkrijimit dhe për të avancuar reformat ambicioze të politikave që përputhen me prioritetet e secilit vend. Në nivel global dhe rajonal, Partneriteti do të nxisë mësimin dhe praktikat e mira ndër-rajonale, ndërtimin e koalicioneve dhe njohuritë tematike rreth llogaridhënies, antikorrupsionit, hapësirës qytetare, përfshirjes dhe pjesëmarrjes qytetare.

Si përfundim, mund të themi se angazhimet e Parlamentit të Hapur po rriten me shpejtësi në kuadër të Partneritetit të Qeverisjes së Hapur (OGP), me shumë parlamente që bashkë-krijojnë angazhimet e tyre ose planet e veprimit për hapjen e mëtejshme legjislative. Shumica e angazhimeve të parlamentit të hapur fokusohen në rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes, por nevojitet më tepër angazhime që përfshijnë masa të llogaridhënies. Duke avancuar në këtë iniciativë, rekomandohet që në lidhje me OGP duhet të synohet që parlamenti të përfshihet më shumë si zbatuesi kryesor i angazhimeve të Parlamentit të Hapur dhe të përfshijë më shumë elementë të mbikëqyrjes publike dhe llogaridhënies.

6.2. Eficienca në administratën publike

Koncepti i efiçiencës së administratës publike përcaktohet si një raport midis inputit dhe rezultatit/outputit, përpjekjeve dhe rezultateve, shpenzimeve dhe të ardhurave, si dhe kostove dhe kënaqësive. Me rreth 75 milion të punësuar, sektori publik është 'industria më e madhe e Evropës, duke punësuar rreth 25% të fuqisë punëtore (rreth 16% vetëm në qeverinë qendrore) dhe përgjegjës për gati 50% të PBB -së. Duke pasur parasysh shkallën dhe qëllimin e saj, administrata publike në lidhje me organizimin dhe menaxhimin e burimeve publike, ka një rëndësi të madhe për jetën e përditshme të qytetarëve evropianë, performancën dhe perspektivat e bizneseve. Cilësia e institucioneve të një vendi është një faktor kryesor përcaktues për mirëqenien e tij ekonomike, por edhe shoqërore. Kapaciteti administrativ njihet gjithnjë e më shumë si një parakusht për përmbushjen e detyrimeve dhe objektivave të traktateve të BE-së, dhe maksimizimi i përfitimeve nga anëtarësimi në BE.

Eficienca është një nga parimet kryesore në veprimtarinë administrative e parashikuar edhe në legjislacionin shqiptar. Kështu, Kodi i Procedurave Administrative në lidhje me parimin e efiçiencës përcakton se "procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm"[491].

Administrata publike tradicionalisht bazohet në arritjen e efikasitetit në punën e organeve publike në përmbushjen e qëllimeve që lidhen me ofrimin e të mirave dhe shërbimeve publike. Cilësia e

[490] www.international-partnerships.ec.europa.eu/news-and-events/news/eu-and-open-government-partnership-launch-partnership-democracy-and-accountability-2023-09-07_en

[491] Neni 18/2 i Kodit të Procedurave Administrative.

DOKUMENT PARLAMENTAR

administratës publike është thelbësore për performancën e saj ekonomike dhe mirëqenien e qytetarëve të saj. Një administratë publike efektive dhe efikase u shërben nevojave të qytetarëve të saj. Është thelbësore që autoritetet publike dhe drejtuesit e tyre të jenë në gjendje të përshtaten me rrethanat në ndryshim, veçanërisht në kohë krize apo në kuadër të avancimit teknologjik dhe sfidave me të cilat përballet shoqëria sot.

Në rastin e Suedisë, ky vend ka një nga modelet e qeverisjes më të decentralizuara dhe më të mëdha në radhët e vendeve të OECD-së, si për sa i përket punësimit në nivel të qeverisë (29% e punësimit total), ashtu dhe shpenzimeve (53% e PBB-së në 2021)[492]. Suedia ka zhvilluar një model unik të bazuar në konsensus për sektorin e saj publik, me ministri të vogla të grupuara nën Zyrat e Qeverisë së bashku me një numër të madh agjencish. Ky model i lejon qeverisë të planifikojë, koordinojë dhe zbatojë politikat dhe strategjitë në një mënyrë të shkathët dhe dinamike. Puna e qeverisë me agjencitë bazohet në urdhëresa për të siguruar vazhdimësinë dhe drejtimin strategjik. Procedurat dhe mekanizmat e bashkërendimit ndërmjet një ministrie të linjës dhe agjencive të saj, në lidhje me detyrat/përgjegjësitë që ka, i mundësojnë qeverisë t'u përgjigjet nevojave urgjente ose prioriteteve të reja. Shteti është një punëdhënës i madh. Agjencia Suedeze për Punëdhënësit Qeveritarë është përgjegjëse dhe zhvillon politikën e punëdhënësve në sektorin shtetëror. Institucionet janë të lira të hartojnë vetë organizimin e tyre, proceset e punës, pagat dhe aftësitë e punës, bazuar në kërkesat e funksionimit të tyre. Zhvillimi i shërbimit dhe efikasitetit në administratën e qeverisë qendrore ka rëndësi dhe normohet nga një bazë ligjore në fuqi prej 2010. Po ashtu ekziston edhe një program i quajtur "Një administratë e qeverisë qendrore në rinovim" që ofron mbështetje për drejtuesit dhe stafin e agjencive në zhvillimin e shërbimit dhe efikasitetit në aktivitetet dhe strukturat organizative të institucioneve qeveritare.

Administrata publike suedeze karakterizohet nga një shkallë e lartë e hapjes/transparencës dhe llogaridhënies, një shkallë më e lartë e autonomisë për nëpunësit civilë sesa mund të gjendet në ndonjë vend tjetër, dhe një decentralizim i gjerë i autoritetit politik në nivel rajonal/lokal, shtrirja e të cilit është e pazakontë në shtetet unitare. Këto tre karakteristika së bashku përcaktojnë pa dyshim një model të veçantë suedez të administratës publike që transparencën, eficiencën dhe llogaridhënien e ka në qendër të saj. Përshpejtimi i digjitalizimit të shërbimeve publike dhe pasja e një qasjeje koherente ndaj qeverisjes digjitale në të gjithë administratën publike mbeten sfida të rëndësishme në Suedi. Gjithashtu një qasje më holistike ndaj integritetit të sektorit publik, veçanërisht në nivel lokal, dhe rishikimi i planit të saj kombëtar kundër korrupsionit është një hap i mirëpritur për të arritur këtë objektiv.

Në rastin e Estonisë, qeveria estoneze i ka kushtuar rëndësi aksesit në informacionet qeveritare dhe transparencës së aktivitetit të qeverisë dhe administratës publike. Kjo është në përputhje me vlerat shumë liberale të aplikuara në shoqërinë estoneze, me përqendrimin në zhvillimin e mjeteve të qeverisjes elektronike. Si pasojë, qytetarët estonezë kanë akses në një larmi të të dhënave qeveritare dhe informacione publike. Webfaqet e administratës janë informuese dhe përditësohen rregullisht. Dokumentet ligjore dhe vendimet e qeverisë janë në dispozicion të publikut dhe mund të aksesohen lehtësisht pa probleme. Estonia është pjesë e grupit të atyre vendeve që karakterizohen nga një kapacitet i lartë për sa i përket gatishmërisë, zbatimit dhe ndikimit të të dhënave të qeverisjes së hapur[493].

[492] www.oecd.org/en/publications/public-governance-monitor-of-sweden_086f9b89-en.html

[493] European Commission (2018), *Public administration characteristics and performance in EU: Introduction*, Publications Office of the European Union, Brussels, 2018

Si përfundim mund të themi, se mbetet prioritet rritja e efektivitetit të administratës publike e cila mund të përmirësojë gjithashtu reagimin, cilësinë dhe efikasitetin e kostos së shërbimeve publike duke forcuar besimin tek institucionet publike. Përmirësimi i përdorimit të mjeteve të menaxhimit të performancës do të mundësonte monitorimin më nga afër dhe rritjen e efektivitetit të sektorit publik si dhe të arritjen e objektivave dhe reformën në administratën publike. Përforcimi i bashkërendimit dhe drejtimit të prioriteteve horizontale mund të rrisë kapacitetin e qeverisë për t'iu përgjigjur prioriteteve aktuale shumëplanëshe.

6.3 Vlerësimi i performancës së administratës publike në disa shtete të Bashkimit Evropian

Organet publike janë përgjegjëse për të ofruar të mirat dhe shërbimet e nevojshme publike për qytetarët, pa asnjë diskriminim, në mënyrë specifike bazuar në mundësitë e përballueshme. Prandaj, objektivat shumëdimensionale të administratës publike kërkojnë që performanca jo vetëm të kufizohet në analizën e thjeshtë kosto-përfitim, por gjithashtu të përfshijë elementin thelbësor të ofrimit të vlerës për qytetarët.

Nëpunësit civilë mund të motivohen përmes shpërblimeve monetare dhe jomonetare. Përtej interesit vetjak ekonomik, vendimet dhe zgjedhjet e nëpunësve civilë ndikohen gjithashtu nga faktorë të tillë si drejtësia, krenaria profesionale dhe përgjegjësia shoqërore. Stimujt monetarë (të njohur edhe si pagesa e lidhur me performancën) motivohen përmes vlerës së tyre të jashtme, siç bëjnë sanksionet përmes shkurtimeve të pagave, uljeve në detyrë dhe shkarkimeve. Nga ana tjetër, stimujt jomonetarë evokojnë forma të brendshme dhe "pro-sociale" të motivimit të një individi, duke përfshirë kënaqësinë në punë, sfidat e reja, lëvizshmërinë, zhvillimin personal dhe njohjen sociale, ndër të tjera. Në të vërtetë, prirja në organizata private dhe në disa organizata publike është drejt "strategjive të shpërblimit total", të cilat përfshijnë një sërë elementesh të paketës së punësimit, përveç pagave. Si për qëllimet e llogaridhënies ashtu edhe për qëllimet e zhvillimit, vlerësimet e performancës duhet të pasqyrojnë variacionin në performancën e punonjësve[494].

Dy mënyra për të mundësuar krahasueshmërinë e vlerësimeve nëpër njësi administrative dhe diferencim të qëndrueshëm dhe të krahasueshëm ndërmjet niveleve të ndryshme të performancës janë trajnimi *ex-ante* dhe kalibrimi *ex-post* i pikëve/vlerësimit të marrë. Nëpërmjet trajnimit të kornizës së referencës, drejtuesve brenda një institucioni u ofrohen udhëzime dhe trajnime se si të vlerësojnë aspekte të ndryshme të performancës dhe të dallojnë nivele të ndryshme të performancës. Kjo është veçanërisht e dobishme për aspekte të sjelljes cilësore dhe aspekte të tjera të performancës që janë të vështira për t'u matur në mënyrë sasiore bazuar në të dhënat administrative. Nëpërmjet kalibrimit, menaxherët në çdo nivel hierarkik mblidhen pasi të bëhen vlerësimet individuale të stafit për të diskutuar dhe krahasuar pikët/vlerësimin e përkohshëm edhe brenda njësive, edhe mes tyre. Të dyja mjetet prezantojnë njëfarë shkalle të sigurimit të cilësisë se si vlerësohet performanca.

Shtetet ndjekin qasje dhe përdorin mekanizma të ndryshme për vlerësimin e performancës së administratës publike. Më poshtë jepen përmbledhtazi disa nga këto modele.

[494]World Bank (2021), *Equitable growth, finance & institutions insight. Performance Management in the Public Administration — Seven Success Factors,* f.16

DOKUMENT PARLAMENTAR

Rasti i Hollandës: Matja e performancës (Rasti i P-Direkt në Holandë)[495]. P-Direkt është qendra e përbashkët e shërbimeve për shërbimet administrative të menaxhimit të burimeve njerëzore për institucionet në të gjithë qeverinë holandeze. Ajo është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për rreth 130,000 përdorues, si punonjës ashtu edhe menaxherë në administratën publike. Shërbimet e saj fokusohen në listën e pagave, duke ofruar informacione për burimet palëve të interesuara dhe përpunimin e transaksioneve të burimeve njerëzore. Për të siguruar shërbime me cilësi të lartë, të besueshme dhe efikase, P-Direkt vendos, mat dhe raporton në mënyrë dixhitale objektivat vjetore për një numër treguesish kyç të performancës që kanë të bëjnë me kënaqësinë e klientit, kohën e përpunimit të kërkesave dhe disponueshmërinë e shërbimeve. Institucionet i përdorin objektivat për të nxitur dhe përmirësuar performancën duke sqaruar pritshmëritë dhe duke identifikuar fushat për përmirësim, në vend të qëllimeve ndëshkuese. Këto objektiva janë të integruara si standarde të performancës në vlerësimin e performancës. Kënaqësia e klientit/qytetarit matet në një shkallë nga 1 deri në 10 dhe vlerësohet përmes anketave elektronike të kënaqësisë pas çdo veprimtarie/aktiviteti dhe përmes thirrjeve telefonike me një kampionim qytetarësh (rreth 10%).

Austria është një nga vendet pa një sistem të vlerësimit individual të rezultateve të nëpunësit, pasi bazohet në parimin e "orientimit nga rezultatet", gjë që do të thotë se performanca vlerësohet bazuar në rezultatet e organizatës në tërësi, thënë ndryshe sa janë përmbushur objektivat e përcaktuar prej njësisë. Çdo njësi organizative përcakton objektivat dhe rezultatet konkrete, të cilat janë të matshme përmes përdorimit të indikatorëve. Në çdo njësi organizative, drejtuesi kryen intervista vlerësimi me çdo punonjës të tij, në të cilat diskutohet për realizimin e objektivave të njësisë, kontributin e nëpunësit, përcaktohen objektivat për vitin vijues, masat e nevojshme për ruajtjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të performancës së nëpunësit e të tjera.

Në Gjermani, nëpunësi i nënshtrohet i) vlerësimit të performancës çdo 3 vjet; ii) vlerësimit të performancës në raste të veçanta që krijohen si pasojë e ndryshimeve të largimit të vlerësuesit apo ndryshimit të pozicionit të punës së nëpunësit, apo kur ky i fundit përfundon periudhën e provës; iii) vlerësimit të kontributit. Vlerësimi i performancës në raste të veçanta dhe vlerësimi i kontributit mbahen në konsideratë gjatë vlerësimit periodik.

Vlerësimi i performancës në Danimarkë kryhet nëpërmjet disa mekanizmave, si: i) indikatorët kryesorë të performancës: punonjësit dhe eprorët e tyre vendosin objektiva dhe qëllime specifike, të cilat përputhen me objektivat më të gjera të institucionit. Kjo qasje siguron që performanca individuale të jetë e lidhur me rezultatet organizative; ii) intervistat për vlerësimin e kontributit individual të nëpunësit në njësinë organizative e të tjera. Vlerësimet e performancës për punonjësit publikë zakonisht kryhen çdo vit. Mbi gjysma e rishikimeve janë vjetore, duke e vendosur Danimarkën mes një grupi vendesh me vlerësime të shpeshta vjetore. Qasja e Danimarkës kombinon menaxhimin e decentralizuar me mbikëqyrjen e centralizuar, duke theksuar stimujt e bazuar në performancë si dhe përdor teknologjinë për të rritur transparencën dhe efikasitetin[496].

Në Itali, vlerësimi i performancës të punonjësve të administratës publike kryhet çdo vit. Ai përfshin vlerësimin organizativ dhe individual. Institucionet e administratës publike hartojnë dhe

[495]World Bank (2021), *Equitable growth, finance & institutions insight. Performance Management in the Public Administration — Seven Success Factors*, f.16

[496]*Staronova, Katarina, Performance Appraisal in the EU Member States and the European Commission (September 2, 2017). Staroňová, K., 2017. Performance Appraisal in the EU Member States and the European Commission. Survey commissioned by the Slovak EU-Presidency.* https://www...eupan.eu/ëp-content/uploads/2019/02/2016_2_SK_Performance_Appraisal_in_the_EU_Member_States_and_the_European_Commission.pdf

përditësojnë çdo vit, pas opinionit detyrues të organit të pavarur të vlerësimit, Sistemin e Matjes dhe Vlerësimit të Performancës. Gjithashtu, institucionet e administratës publike përgatisin Planin e Performancës dhe Raportin Vjetor të Performancës. Po ashtu, bazuar në vlerësimin e performancës, punonjësit e administratës publike përfitojnë shpërblime bazuar në meritokraci. Institucionet e administratës publike vlerësojnë çdo vit performancën organizative dhe individuale. Për këtë qëllim, ata miratojnë dhe përditësojnë çdo vit, pas opinionit detyrues të organit të pavarur të vlerësimit, sistemin e matjes dhe vlerësimit të performancës. Matja dhe vlerësimi i performancës kryhet nga (i) organet e pavarura të vlerësimit të performancës, të cilët janë përgjegjës për matjen dhe vlerësimin e performancës së çdo strukture administrative në tërësi, si dhe propozimin vjetor të vlerësimit të drejtuesve të lartë, (ii) drejtuesit e secilës administratë dhe (iii) nga qytetarë ose përdorues të tjerë fundorë në lidhje me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga administrata, që marrin pjesë në vlerësimin e performancës organizative të administratës[497].

Në Spanjë, ligji nr. 7/2007, datë 12 prill "Për statusin e nëpunësve publikë" e përcakton si detyrim të administratave publike, qendrore apo vendore, krijimin e sistemeve të vlerësimit të performancës së nëpunësve. Vlerësimi i performancës së nëpunësve ka për synim matjen dhe vlerësimin e sjelljes profesionale, performancës apo arritjeve të rezultateve të nëpunësve në mënyrë periodike. Megjithatë, ligji nuk përmban specifikime për shpeshtësinë e kryerjes së këtyre vlerësimeve. Duhet evidentuar se vlerësimet e performancës shërbejnë si bazë për karrierën profesionale në vijë horizontale, dhënien e shpërblimeve, si dhe për vijimin ose përfundimin e marrëdhënieve të punës.

6.3.1. Konkluzione mbi performancën dhe vlerësimin e saj në sektorin publik

Menaxhimi i performancës është një mjet i rëndësishëm në rritjen e produktivitetit të sektorit publik, i cili është kyç për rregullimin efektiv, infrastrukturën dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe efikasitetin e përgjithshëm të shpenzimeve.

Sipas Bankës Botërore, fatura e pagave të qeverisë përbën rreth 10% të produktit të brendshëm bruto globalisht dhe fuqia punëtore e sektorit publik përbën rreth një të tretën e punësimit formal. Me këto përmasa, rritja e rezultateve nga punonjësit dhe organizatat e sektorit publik mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në kursimet e qeverisë, duke krijuar hapësirë për investime të reja dhe duke ndërtuar besimin e qytetarëve te qeverisja e vendit.

Menaxhimi i performancës individuale në sektorin publik është sfidues, por ka edhe disa avantazhe. Madhësia dhe heterogjeniteti i sektorit publik do të thotë se nuk ka një sistem të menaxhimit të performancës të tillë që "që i përshtatet të gjithëve", që funksionon për të gjitha llojet e punëve dhe organizatave në sektorin publik. Në administratën publike ka më tepër vështirësi të matet objektivisht dhe të vlerësohet performanca. Shumica e administratave publike karakterizohen nga sisteme të ngurta të menaxhimit të karrierës dhe kompensimit, gjë që kufizon më tej mundësinë e ofrimit të pagesave të bazuara në performancë dhe stimujve për promovim për shumë njerëz dhe kategori nëpunësish. Megjithatë, sektori publik ka avantazhet e veta. Për shembull, madhësia e tij ofron mundësi zhvillimi përmes lëvizshmërisë, rritjes në karrierë. Gjithashtu, nëpunësit publikë në punën e tyre u ofrojnë shërbime qytetarëve duke kontribuar

[497]Dekreti legjislativ nr. 27/2009 "Mbi optimizmin e produktivitetit të punës publike dhe efikasitetin dhe transparencën e administratave publike" rregullon vlerësimin e bazuar në performancë. https://www.normattiva.it/uri-res/N2Ls?urn:nir:stato:decreto.legislativo:2009-10-27;150

pozitivisht në jetën e tyre. Kjo ndjenjë misioni që ka në vetvete administrata publike ofron mjete për t'i mbajtur ata të motivuar.

Për të përdorur në mënyrë efektive menaxhimin e performancës me qëllim rritjen e produktivitetit të sektorit publik, institucionet publike duhet të fokusohen si në vlerësimin e performancës ashtu edhe në motivimin e stafit dhe për t'i ndihmuar ata të rriten. Kjo kërkon jo vetëm përafrimin e qëllimeve individuale dhe organizative dhe fillimin në nivelet më të larta të shërbimit civil, por edhe përmirësimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së kontekstit se si vlerësohet performanca për lloje të ndryshme pune. Kjo gjithashtu kërkon vendosjen e kujdesshme të stimujve monetarë dhe jomonetarë për të motivuar lloje të ndryshme punonjësish, si dhe ofrimin e mundësive për stafin që të performojë më mirë duke theksuar zhvillimin dhe rritjen profesionale dhe në karrierë të tyre.

Gjithsesi, cilido model i menaxhimit të performancës të zgjidhet, arritja e suksesshme e qëllimeve të tij do të varet kryesisht jo vetëm nga performanca individuale e stafit, por edhe nga angazhimi i menaxherit/drejtuesit dhe cilësia e lidershipit.

DOKUMENT PARLAMENTAR

Bibliografia

a. *Legjislacion dhe akte të tjera rregullatore*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligj nr. 45/2022, datë 28.4.2022 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare";
- *Charter of Fundamental Rights of the European Union*, Official Journal of the European Union, OJ C 326, 26.10.2012, p. 391–407;
- Rregullorja 1049/2001 në lidhje me aksesin e publikut në dokumentet e Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit, https://eur-lex.europa.eu/legal content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32001R1049;
- Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council of 27 April 2016 on the protection of natural persons with regard to the processing of personal data and on the free movement of such data, and repealing Directive 95/46/EC (General Data Protection Regulation), http://data.europa.eu/eli/reg/2016/679/oj.
- Rezoluta 435 (2018)2, *Mbi transparencën dhe qeverisjen e hapur*, Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale, Këshilli i Europës;
- Rezolutë, 'Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023', Kuvendi i Shqipërisë, datë 04.07.2024;
- Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike";
- Ligji nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
- Ligji Nr. 14/2024 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë".
- Ligji Nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit";
- Ligji Nr.43/2023 "Për qeverisjen elektronike", i ndryshuar;
- Ligji nr. 33/2022 "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik";
- Ligji nr. 107/2021 "Për Bashkëqeverisjen";
- Ligji Nr.102/2020, "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin";
- Ligj Nr. 60 /2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve'';
- Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji Nr. 114/2015 "Mbi kontrollin e brendshëm të sektorit publik'', i ndryshuar;
- Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar;
- Ligji nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik";
- Ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil";
- Ligji Nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore";
- Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin'', i ndryshuar;
- Ligj Nr. 10034 date 22.12.2008 "Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve'';

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Ligji nr. 9936, 26.06.2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligji Nr. 9049/2003 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Dekreti nr. 357, datë 10.10.2024 “Për Kthimin e ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Marrë nga https://president.al/presidenti-begaj-dekreton-kthimin-e-ligjit-nr-99-2024/;
- VKM Nr. 859, dt. 26.12.2024 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, planit të veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës”;
- VKM Nr. 436, datë 26.6.2024, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”;
- VKM Nr. 30, datë 22.05.2024, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj 2024-2027”;
- VKM nr. 16, datë 11.1.2024 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026”;
- VKM Nr. 783, datë 18.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”;
- VKM nr. 479, dt. 24.07.2024, “Për miratimin e Dokumentit për Metodologjinë dhe Standardet Teknike të Përdorimit të Inteligjencës Artificiale në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr. 227, datë 09.04.2024. “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore”;
- VKM. Nr. 244, datë 17.04.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me veteqeverisjen vendore”.
- VKM Nr. 621, datë 10.10.2024 “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”;
- VKM nr. 737, dt. 13.12.2023 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023-2030”;
- VKM Nr. 252, datë 20.4.2023, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030, të Planit të saj të Veprimit 2023-2025 e të Pasaportës së Indikatorëve”;
- VKM nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030”;

DOKUMENT PARLAMENTAR

- VKM nr. 370, datë 01.06.2022, "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale "Agjenda digjitale e Shqipërisë" dhe të planit të veprimit 2022–2026";
- VKM nr. 512 datë 18.09.2021, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informim";
- VKM nr. 276, datë 12.05.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2021- 2025";
- VKM nr. 1084, datë 24.12.2020, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit, 2020–2025";
- VKM Nr. 330, datë 22.04.2020, "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore "Sistemi i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit – EACIDS";
- Vendimit i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.08.2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave";
- Urdhër i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, nr. 3/2021, "Mbi miratimin e udhëzimeve për procesin e konsultimit publik";
- Urdhri i Kryeministrit Nr. 90, datë 20.5.2022, "Për ngritjen, përbërjen dhe organizimin e Komisionit të Etikës", i ndryshuar;
- Urdhër Nr. 1 i ILDKPI, datë 27.06.2014 "Për krijimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e strukturave të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave në institucionet publike";
- Udhërrëfyesit për vitin 2025 *"Masat e ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit evropian",* Udhërrëfyesi C. 'Reforma në administratën publike';
- Udhëzimi Nr. 2, datë 30.10.2023 "Për miratimin e Kornizës Kombëtare të Ndërveprimit në Republikën e Shqipërisë", i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Strategjia për Mbrojtjen Kibernetike 2024-2028, Ministria e Mbrojtjes, https://www.mod.gov.al/images/strategji-MoD/2024/strategjia-Mbrojtje-Kibernetike-2024-2028-290324.pdf;
- Strategjia institucionale 2022 – 2025, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Udhëzime për koordinatorët për të drejtën e informimit, https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Udhezime_per_koordinatoret_per_te_drejten_e_informimit.pdf;Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit RIA-Metodologjia.pdf (kryeministria.al);
- Standardet e shërbimeve elektronike: https://akshi.gov.al/wpcontent/uploads/2023/04/STANDARDET-E-SHE%CC%88RBIMEVE-ELEKTRONIKE_1.1.pdf;

b. Raporte, studime dhe publikime të konsultuara

DOKUMENT PARLAMENTAR

- European Commission (2023), *Screening Report Albania*, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en;
- *Progres Raporti i BE-së për Shqipërinë 2024*, Komisioni Evropian, Bruksel:30.10.2024, https://www.neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en
- EU progress Report-Albania 2023: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en;
- OECD/SIGMA (2025), *Public Administration in Albania 2024*, (Assessment against the Principles of Public Administration), SIGMA Monitoring Reports, OECD Publishing, Paris;
- OECD (2024), Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania, Competitiveness and Private Sector Development, OECD Publishing, Paris, https://doi.org/10.1787/541ec4e7-en;
- OECD (2020), *Government at a Glance: Western Balkans*, OECD Publishing, Paris, https://doi.org/10.1787/a8c72f1b-en;
- Komisioni Evropian (2023), Raporti i Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit për Grupkapitullin I "Themeloret", https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572een?filename=AL%20Cluster1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf;
- Regional Cooperation Council (2022), *Balkan Barometer 2022 (business opinion)*, Bosnia and Herzegovina, www.rcc.int/pubs/140/balkan-barometer-business-opinion-2022
- OECD/SIGMA (2021), Monitoring Report: The Principles of Public Administration, Albania, OECD Publishing, Paris; www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf;
- *Partneriteti për Qeverisje të Hapur: Plani Kombëtar 2023-2025*, Tiranë: Mars 2023, https://ogp.gov.al/uploads/2023/4/20230420175207_plani-kombetar-i-veprimit-2023-2025-pqh-mars-2023.pdf;
- Takimi i 11-të i Grupit Special të Reformës në Administratën Publike ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, zhvilluar më 27 qershor 2023, www.eeas.europa.eu/delegations/albania/11th-meeting-public-administration-reform-special-group-between-european-union-and-albania_en?s=214;
- FRA (European Union Agency for Fundamental Rights) (2021), "*Çfarë nënkuptojnë të drejtat themelore për njerëzit në BE- Anketë për të drejtat themelore"*, Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2020-fundamental-rights-survey-human-rights-summary_sq.pdf;
- Raport Monitorimi i Realizmit të Planeve të Integritetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për Vitin 2023;
- Programi Kombëtar për Aderimin në BE 2024 – 2030 dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, Nëntor 2023;
- Albania Fiscal Transparency Evaluation (January 2016), IMF Country Report No. 16/5;
- Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri (2023): Anketa e WBSB në Shqipëri për vitin 2023 me titull *"Perceptimi publik mbi integrimin evropian, ndikimin e aktorëve të jashtëm dhe performancën qeverisëse në Shqipëri",* Maj 2023, Tiranë;

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Johnsøn, J., L. Marcinkowski and D. Sześciło (2021), "Organisation of public administration: Agency governance, autonomy and accountability", SIGMA Papers, No. 63, OECD Publishing, Paris. https://doi.org/10.1787/07316cc3-en. Për versionin shqip shih: www.sigmaweb.org/publications/SIGMA-Paper-No-63-2021-Albanian.pdf;
- A. Shehi (Dollani) & N. Strati (2023), *Policy Paper: Institutional capacities as an influencing factor in the process of aligning Albanian legislation with the EU Acquis*, CSDG, Albania; https://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2023/06/Policy-Paper_eng-1.pdf;
- Raporti *screening* për Grupin e Parë – Themeloret për Shqipërinë, publikuar më 24 korrik 2023.https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/screening-report-albania_en
- Rule of Law Report, country chapter on the rule of law situation in Albania, 2024 *0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925_en (europa.eu)
- Komisioni i Venecias CDL-AD(2011)009, Study no. 470 / 2008, "Stocktaking on the notions of "good governance" and "good administration". https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffilewCDL-AD(2011)009-e
- ReSPA. 2018, Rekomandim për pjesëmarrjen e publikut në procesin e politikëbërjes për Ballkanin Perëndimor.https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say_en
- KE 2020, Përmirësimi i procesit të anëtarësimit - Një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe OECD (2020), Qeveria në një vështrim: Ballkani Perëndimor, Botim i OECD, Paris, https://doi.org/10.1787/a8c72f1b-en
- OECD, 2020, Qeveria me një vështrim: Ballkani Perëndimor, Botim i OECD, Paris, https://doi.org/10.1787/a8c72f1b-en
- Parimet e Administratës Publike, SIGMA/ OECD, 2023. The Principles of Public Administration - 2023 edition - Albanian (sigmaweb.org);
- OECD/SIGMA (2024), *Inter-municipal co-operation in the Western Balkans,* SIGMA Paper No. 70,www.oecd.org/en/publications/inter-municipal-co-operation-in-the-western-balkans_a78a01e6-en.html
- Kasementet. L, *Koordinimi i politikave në Ballkanin Perëndimor*, 2021, ReSPA
- *E drejta e informimit 2023. Ndryshimet ligjore për të drejtën e informimit - Shumë zhurmë për asgjë?* Qendra Res Publica, 2024. https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2024/04/E-drejta-e-informimit-2023_Web.pdf
- Qendra Res Publica, E drejta e informimit. A po synohet të ngrihet një shkallë më lart?, raport për vitin 2022, publikuar në 2023. Raporti gjendet në faqen: https://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2023/09/E-drejta-e-informimit-2022-Res-Publica-NED.pdf
- *Një dekadë nga ligji për konsultimin publik në Shqipëri. Thirrje për reformë,* Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2023.
- *Raport monitorimi. Transparenca proaktive e njësive të vetëqeverisjes vendore,* 2023, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- *Dokument politikash. Sfidat që pengojnë promovimin e kulturës me integritet në qeverisjen vendore.*, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, 2022.

DOKUMENT PARAMENTAR

- *Besimi në qeverisje. Sondazhi i opinionit publik 2023, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim* (IDM).
- *Raporti i Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve*, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, 2022. https://www.partnersalbania.org/publication/raporti-i-monitorimit-te-pjesemarrjes-politike-sociale-dhe-ekonomike-te-te-rinjve-2022/
- *National survey of Albania*, Center for Insights in Survey Research, 2023 https://www.iri.org/wp-content/uploads/2024/02/Alb-2023-Public-Survey-Final.pdf
- Dokument Politikash, *Procesi i konsultimit në Shqipëri në kuadër të integrimit europian – roli i shoqërisë civile*, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA), 2022. https://em-al.org/sq/dokument-politikash-procesi-i-konsultimit-ne-shqiperi-ne-kuader-te-integrimit-europian-roli-i-shoqerise-civile-qershor-2022/
- Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Raporti Vjetor 2020. http://partnersalbania.org/publication/annual-report-2020/
- Komisioni Evropian, Raporti i Shqipërisë 2020. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/albania_report_2020.pdf SIGMA, Monitoring report of Public Administration, Albania, 2021.https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf;
- Raportet Vjetore te Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitet 2021, 2022, 2023.
- Albania and EU enlargement policy. Marrë nga https://www.consilium.europa.eu/en/policies/enlargement/albania/.
- Commission Staff Working Document Analytical Report Accompanying the Communication from the Commission to the European Parliament and the Council Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union, 09 November 2010. Marrë nga https://caa.gov.al/ëp-content/uploads/2023/05/2010progressreporten23390_1.pdf.
- Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-15 COM/2014/0700 final */08 October 2014. Marrë nga https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/ALL/?uri=celex%3A52014DC0700.
- Departamenti Vjetor i Administratës Publike, Raporti Vjetor 2023 – Shërbimi Civil. Marrë nga https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore.
- Draft-Agjenda Kombëtare e Reformave. Mund të aksesohet në faqen elektronike të konsultimit publik. Marrë nga https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/744.
- EU Legislative Acts-Statistics. Marrë nga https://eur-lex.europa.eu/statistics/legislative-acts-statistics.html.
- GRECO, Raundi V i Vlerësimit "Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverinë qendrore (funksionet e larta ekzekutive) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit", Raporti i Përputhshmërisë, 2022. Marrë nga https://rm.coe.int/fifth-evaluation-round-preventing-corruption-and-promoting-integrity-i/1680aa6124.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- IDM, "Forcimi i integritetit të administratës publike në Shqipëri: Analizë e kuadrit mbi etikën që rregullon sjelljen e nëpunësve publikë në Shqipëri", 2021. Marrë nga https://idmalbania.org/ëp-content/uploads/2021/11/Integrity-in-Public-Administration_Alb-1.pdf.
- IDM, Indeksi i Integritetit të Institucioneve Publike, Janar 2024. Marrë nga https://idmalbania.org/sq/indeksi-i-integritetit-te-institucioneve-publike-janar-2024/.
- Instituti i Studimeve Politike, Raport Monitorimi "Dekriminalizimi në Shqipëri 2024 - Gjetje mbi sjelljen e partive dhe institucioneve mbi standardet e dekriminalizimit/integritetit". Marrë nga https://dekriminalizimi.isp.com.al/wp-content/uploads/2024/09/ISP-Dekriminalizimi-dhe-integriteti-Raporti-2024-3.pdf.
- Këshilli i Europës. Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Etika Publike: Mbrojtja e sinjalizuesve: Sfidat dhe mundësitë për qeverisjen lokale dhe rajonale. Marrë nga https://rm.coe.int/booklet-a6-protection-ëhistlebloëers-sqi/1680a5a145.
- Komisioni Europian, Cilësia e Administratës Publike – Një mjet për praktikantët, 2017. Marrë nga https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/quality-public-administration-toolbox-practitioners.
- Komisioni Evropian, Raporti për Shqipërinë – 2023. Marrë nga https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0ben?filename=SËD2023_690%20Albania%20report.pdf.
- Komisioni Evropian. Raporti i Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit për Grupkapitullin I "Themeloret", Korrik 2023. Marrë nga https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/b83313ef-48c5-4bef-9f00-f5d66509572een?filename=AL%20Cluster1%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf.
- Komisioni Evropian. Raporti për Shtetin e së Drejtës 2024 – Shqipëria. Marrë nga https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925en?filename=59158088counchapalbania_al.pdf.
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Raport Monitorimi 2022-2023: Sinjalizimi në 9 bashki të vendit. Marrë nga https://ahc.org.al/ëp-content/uploads/2024/07/Raport-Monitorimi-2022-2023_-Sinjalizimi-ne-9-Bashki-te-vendit.pdf;
- *Raport krahasimor mbi situatën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri për vitet 2022- 2023,* Komiteti Shqiptar i Helsinkit, dhjetor 2023. https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2023/12/Raporti-i-te-Drejtave-te-Njeriut_-Versioni-Shqip.pdf;
- Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit. Raporti i Monitorimit të zbatimit të SNKK 2015-2023 dhe të Planit të Veprimit 2020-2023.
- Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Raporti Kombëtar i hartuar në përgjigje të Raportit të Përputhshmërisë së GRECO për Raundin V të Vlerësimit, dorëzuar në shtator 2024 nga Delegacioni i Shtetit Shqiptar në GRECO.
- Policia e Shtetit, Manuali i Etikës Policore, miratuar me Urdhrin Nr. 980, datë 30.06.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm. Marrë nga https://asp.gov.al/ëp-content/uploads/2024/08/Manuali-i-Etikes-Policore.pdf.

DOKUMENT PARLAMENTAR

- Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të planit të integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore, 12 Tetor 2021. Marrë nga https://www.drejtesia.gov.al/ëp-content/uploads/2021/10/METODOLOGJIA-E-MONITORIMIT-TE-PLANIT-TE-INTEGRITETIT.pdf.
- Raportim i autoriteteve shqiptare në kuadër të Raportit të Komisionit Evropian për Shtetin e së Drejtës, 2024. Marrë nga https://commission.europa.eu/document/download/0154dce1-5026-45de-8b37-e3d56eff7925en?filename=59158088counchapalbania_al.pdf.
- SIGMA. Vështrim Rajonal: Monitorimi i Ballkanit Perëndimor. OECD Publishing. 2022. Marrë nga https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf.
- Raporti i SIGMA Monitoring 2021: Vlerësim i përparimit të Shqipërisë në fushën e digjitalizimit të shërbimeve publike dhe çështjet që mbeten për t'u adresuar;
- KLSH (2019). Raport Përfundimtar i Auditimit: *"Për auditimin mbi performancën e përdorimit të internetit në administratën publike,* https://panel.klsh.org.al/storage/phpWWbStv.PDF;
- Albania PEFA Evaluation 2017: https://www.pefa.org/node/481
- Banka Botërore (2021). Forcimi i Qëndrueshmërisë së Modelit të Rritjes në Shqipëri. https://documents1.worldbank.org/curated/en/099845001312232607/pdf/P1752090e8141b05a08afc06ea6bc385da3.pdf
- Organziata AIS / Open Data Albania ka referuar me herët mbi këtë fenomen: The Council of Ministers assumes the authority of the Legislative. Normative Act No. 1 Amendments to the 2024 Budget Law violates Article 7 of the Constitution, the Principle of Separation of Powers – Albanian Institute of Science (ais.al)
- Progres Raporti i BE për Shqipërinë (2022). https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en;
- *Partneriteti për Qeverisje të Hapur: Plani Kombëtar 2023-2025*, Tiranë: Mars 2023, https://ogp.gov.al/uploads/2023/4/20230420175207_plani-kombetar-i-veprimit-2023-2025-pqh-mars-2023.pdf;
- Raporti i FMN-së për Shqipërinë Nr. 21/259, 2021. https://www.imf.org/en/Publications/CR/Issues/2021/12/07/Albania-2021-Article-IV-Consultation-Press-Release-Staff-Report-and-Statement-by-the-510834
- Raporti vjetor i monitorimit te MFP 2021, https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/2021-Raporti-Vjetor-i-Monitorimit-te-MFP.pdf;
- Raporti vjetor i monitorimit të MFP-së për vitin 2019, https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/09/Raporti-i-Monitorimit-i-Strategjise-MFP-2019.pdf
- Raporti vjetor i monitorimit të MFP-së për vitin 2020;
- TADAT (2022). https://www.tadat.org/performanceAssessmentReports
- Rishikimin Afatmesëm të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020. https://arkiva.financa.gov.al/strategjia-permenaxhimin-e-financave-publike-2019-2022/;
- European Commission (2018), *Public administration characteristics and performance in EU28: Estonia*, Publications Office of the European Union, Brussels:2018;

DOKUMENT PARLAMENTAR

- www.international-partnerships.ec.europa.eu/news-and-events/news/eu-and-open-government-partnership-launch-partnership-democracy-and-accountability-2023-09-07_en
- European Commission (2018), *Public administration characteristics and performance in EU: Introduction*, Publications Office of the European Union, Brussels:2018;
- World Bank (2021), *Equitable growth, finance&institutions insight. Performance Management in the Public Administration — Seven Success Factors;*
- Staronova, Katarina, Performance Appraisal in the EU Member States and the European Commission (September 2, 2017). Staroňová, K., 2017. Performance Appraisal in the EU Member States and the European Commission. Survey commissioned by the Slovak EU-Presidency. https://www.eupan.eu/ëp-content/uploads/2019/02/2016_2_SK_Performance_Appraisal_in_the_EU_Member_States_and_the_European_ Commission.pdf;
- Dekreti legjislativ nr.27/2009 "Mbi optimizimin e produktivitetit të punës publike dhe efikasitetin dhe transparencën e administratave publike" rregullon vlerësimin e bazuar në performance. https://www.normattiva.it/uri-res/N2Ls?urn:nir:stato:decreto.legislativo:2009-10-27;150

c. **Informacione të kërkuara nga grupi i ekspertëve për institucionet**

- Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 19.09.2024.
- Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga zyra e Avokatit të Popullit, datë 19.09.2024.
- Informacion i pranë grupit të ekspertëve nga AKSHI, datë 18.09.2024.
- Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga kabineti i Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin më datë 18. 09.2024.
- Informacion shkresor i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga AKSHI, dt. 28.10.2024 dhe përditësuar me të dhëna statistikore në mars 2025;
- Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga Agjencia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, më datë 18.09.2024.
- Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga Drejtoria e Ndikimit Rregullator, Departamenti i Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave më datë 27.09.2024.
- Informacion i dërguar pranë grupit të ekspertëve nga zyra e Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe të Dhënat Personale, datë 22.10.2024.

DOKUMENT PARLAMENTAR